


MENAXHIMI I NAMAZIT  
Rizbulim i shtyllës së dytë në Islam

Ahmed Bessam Es-Sai



© LOGOS·A  
S H K U P  
PRISHTINË  
T I R A N Ë  
2 0 1 5



LOGOS·A

Ahmed Bessam Es-Sai  
MENAXHIMI I NAMAZIT  
Rizbulim i shtyllës së dytë në Islam

Boton: LOGOS-A  
Biblioteka: MENDIMI ISLAM

Për botuesin: Adnan Ismaili  
Kryeredaktor: Husamedin Abazi  
Redaktor biblioteke: Nexhat Ibrahim

Redaktor gjuhësor: Nazif Zejnullahu  
Redaktor artistik & disenji: Edib Agagjyshi  
Redaktor teknik: Halil Berisha  
Faqosës: Sedat Halimi  
Mbikëqyrës i shtypit: Kemal Ismaili  
Përgatitja kompjuterike: Focus Pro - Shkup  
Shtypi: Focus Print - Shkup

ISBN 978-9989-58-600-2

[www.logos-a.com](http://www.logos-a.com)

Copyright©Logos-A, 2015

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.  
Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimprurës. Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit apo edhe për afirmim të kulturës së leximit në përgjithësi. Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi pa lejen paraprake të Logos-A.

# MENAXHIMI I NAMAZIT

## Rizbulim i shtyllës së dytë në Islam

Ahmed Bessam Es-Sai

PËRKTHEU NGA ARABISHTJA:  
Sadush Tahiri

TITULLI I ORIGJINALIT:  
Ahmed Bessam Es-Saî,  
Idaretus-salah – iadetul-iktishaf  
erruknuth-thani fil-islam,  
Darul Fikr, Liban, 2015





## PËRMBAJTJA:

NAMAZI .....	9
TAKIM ME ALLAHUN.....	11
NËN KUBEN E PARË: Pse namazi? .....	17
TRIBUNA E PARË: Namazi: detyrë dhe e drejtë.....	19
Pjesa 1 Është njëmend i vështirë... pse?! .....	19
Pjesa 2 Udhëtimi nga “detyra” në e “drejtë” .....	22
Pjesa 3 .....	29
Pjesa 4 Kënaqësia e durimit .....	32
TRIBUNA E DYTË: Namazi dhe jeta.....	35
Pjesa 1 Zbulim i çuditshëm që ka emrin namaz.....	35
Pjesa 2 Namazi na riprogramon .....	39
Pjesa 3 Zgjimi për namaz .....	45
Pjesa 4 Namazi menaxhon jetën tonë të përditshme .....	48
Pjesa 5 Kthimi i kornizës (strukturës) së plan-programit tonë ditor. ....	54
TRIBUNA E TRETË: Shumëllojshmëria dhe rëndësia e saj në namaz .....	61
Pjesa 1 .....	61
Pjesa 2 Shumëllojshmëria në numrin e rekatëve... pse?!.....	64
Pjesa 3 Elasticiteti i sunetit në shërbim të shumëllojshmërisë.....	68
Pjesa 4 Ndërrimi i pozitave dhe lëvizjeve... pse? .....	74
Pjesa 5 Shumë alternativa (zgjedhje) dhe parimi (atë që mundem) ....	80
TRIBUNA E KATËRT: Përgatitja për udhëtimin madhështor.....	89
Pjesa 1 Ezani dhe nëntë çudirat e tij.....	89
Pjesa 2 Dy lloje abdesti.....	100
Pjesa 3 Xhamia... pse? .....	112
Pjesa 4 Në pritje të namazit .....	127

<b>NËN KUBEN E DYTË: Fshehtësitë e namazit.....</b>	<b>133</b>
<b>TRIBUNA E PARË: Fshehtësitë e namazit të xhumasë dhe faljes me xhemat.....</b>	<b>135</b>
Pjesa 1 Falja e namazit me xhemat: fshehtësi e civilizimit .....	135
Pjesa 2 Namazi i xhumasë: pastrim i trupit dhe shpirtit.....	149
Pjesa 3 Hytbeja e xhumasë.....	162
<b>TRIBUNA E DYTË: Mi'raxhi tek Allahu .....</b>	<b>171</b>
Pjesa 1 .....	171
Pjesa 2 Rreziku më i madh për përshpirtshmërinë (hushu'): adaptimi .....	182
Pjesa 3 Përshpirtshmëria: punishte e fuqisë magjepsëse .....	185
Pjesa 4 Jashtë dominimit të shqisave .....	191
Pjesa 5 Udhëtim i shenjtë .....	199
<b>TRIBUNA E TRETË: Panel i aparaturave dhe i fluturimit .....</b>	<b>207</b>
Pjesa 1 Çelësat dhe kopsat .....	207
Pjesa 2 Çelësi i kuq numër 1.....	209
Pjesa 3 Çelësa të tjerë në panelin e pilotimit .....	216
<b>TRIBUNA E KATËRT: Fshehtësitë e gjuhës së namazit.....</b>	<b>219</b>
Pjesa 1 Midis leximit dhe recitimit (kiraetit dhe tilavetit) .....	219
Pjesa 2 Gjuha e re e Kur'anit të madhërisëm .....	220
Pjesa 3 Gjuha konsonante dhe fusha e gjelbër .....	221
Pjesa 4 Forma interaktive e leximit.....	224
<b>TRIBUNA E PESTË: Fshehtësitë e fatihasë dhe leximit .....</b>	<b>229</b>
Pjesa 1 Roli i Fatihasë dhe leximit .....	229
Pjesa 2 Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve.....	237
Pjesa 3 Të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit .....	239
Pjesa 4 Sunduesit të Ditës së Gjykimit.....	241
Pjesa 5 Çelësi i kuq numër 2.....	242
Pjesa 6 Udhëzona në rrugën e drejtë. Në rrugën e atyre.....	246
Pjesa 7 Vendzgatjet në suren el-Fatiha .....	251
<b>TRIBUNA E GJASHTË: Domethëniet e uljes së fundit .....</b>	<b>253</b>
Pjesa 1 Boshti i rukusë dhe i sexhdes.....	253

Pjesa 2 Çelësi i kuq numër 3.....	268
Pjesa 3 Hapësirat e gjelbra në ettehijjatu.....	273
Pjesa 4 .....	274
Pjesa 5 Çelësi i kuq numër 4.....	276
Pjesa 6 .....	281
Pjesa 7 Salevatet për Ibrahimin alejhi's-selam .....	282
Pjesa 8 Dy selamet në fund të namazit .....	287
NËN KUBEN E TRETË: Vjelja.....	293
TRIBUNA E PARË: Kthimi në tokë .....	295
Pjesa 1 Dalja nga namazi .....	295
Pjesa 2 Një kohë për lutje dhe pjesë të caktuara (evrad) .....	302
TRIBUNA E DYTË: Bilanci (kapitali).....	317
Pjesa 1 Bilanci dhe ballafaqimi me djallin .....	317
Pjesa 2 Llogaritë pas namazit .....	322
TRIBUNA E TRETË: Shkallët e niveleve.....	327
Pjesa 1 Lista e xhevahireve të arritura të namazi .....	327
Pjesa 2 Lista e xhevahireve të humbura të namazit .....	330
REZYME E LIBRIT .....	333
Le të bëhet e tërë jeta namaz.....	333
BIBLIOGRAFIA .....	341
SHËNIME PËR AUTORIN.....	345

## FALËNDERIM

*Asaj që më shoqëroi në këtë udhëtim të gjatë për rizbulimin e vetvetes dhe namazit tim, shoqes besnike, nënës së kujdesshme, bashkëshortes besimtare, durimtare dhe bashkudhëtares në rrugën e gjatë; Da'de Sheritah, ia dhuroj këtë mirësi që ka mbetur nga ajo që kemi korrë nga namazet tona së bashku.*

*Bessami*

*Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit*

## NAMAZI

Allahu im, Ti e di se me këto meditime dhe fleta të shkruara e kam dashtë vetëm kënaqësinë Tënde dhe Ahiretin tim. Allahu im, sikur të të drejtohem me gjuhën time të dobët e të kufizuar njerëzore, me siguri se nuk do të gjeja fjalë për këtë, se jam njeri i rëndomtë, që u flet njerëzve të rëndomtë, se fjalët e njerëzve janë të paafta të ngrihen tek madhëria Jote, ato nuk përfshijnë dot madhërinë dhe madhështinë Tënde. Allahu im, nëse gjatë rrugës sime për te Ti diku kam hasë në pengesë, apo nuk e kam qëlluar të duhurën, ose gjuha më ka shkuar huq, vetëm Ti e di se unë, fillim dhe mbarim, kam dashur ta arrijë vetëm të vërtetën që Ti e do, e ku do të mundemi ne njerëzit t'i njohim horizontet e qëllimeve të ligjit Tënd, fshehtësitë e asaj që ia shpalle të Dërguarit Tënd në natën e mi'raxhit, kur ai po i pranonte urdhrat e Tua të shenjta që ngërthenin detyrimin e namazit?

Atë që ne mund ta dimë, përkundër dobësisë sonë njerëzore, është se Ti e bërë namazin mëshirë për botët, takim ditor me Ty dhe i paçmuar; në namaz Ty të thërrasim e të lutemi me shpirt, para Teje e dorëzojmë qenien tonë, mbështetemi te muri i shpresës që Ti e ke dhënë, vetëm atëherë rruga na bëhet me dritë, shohim gjithçka qartë, gjerë e gjatë, dhe ngrihemi në maje të njerëzimit, kënaqemi me ngritjen shpirtërore që na çon lart te Ti, nevojat tona i parashtrijmë vetëm para Teje, kërkojmë zbritjen e mëshirës dhe bekimit Tënd, e pastaj fuqia Jote e gjerë dhe mëshira e plotë i shoqëron ata në lumturi, gëzim, dëshpërim e tjera, ua ndriçon errësirat e shpirtit, se Ti ke thënë: *“Është Ai që ju bekon,*

*ndërkohë që engjëjt e Tij luten për ju, me qëllim që Ai t'ju nxjerrë nga errësira në dritë. Ai është Mëshirues ndaj besimtarëve.” (El-Ahzab, 43)*

Allahu im, më shpërble me të mirat që i shpërblen robërit e Tu të mirë nëse e kam qëlluar atë që e kam shkruar, e nëse kam gabuar në ide, vlerësim, sqarim ose shprehje, ashtu që gjuha ime e dobët doli përpara madhësisë Tënde, kurse lapsi im e huqi rrugën për te qielli i urtësisë Tënde, më shpërble o Zoti im për atë që e ke ditur se unë desha vetëm të hedh një dritë në rrugën Tënde të drejtë dhe vetë të ndriçohem me atë, vetë lutjet janë që dalin nga burimi i Mëshirës Tënde për botët, e Ti, o Allahu im, ende je dhe gjithmonë do të jesh Falës, Mëshirues dhe i Dashur, Ti je Mëshiruesi më i madh.

*Robi yt, mysafir në Oxford, Bessami.*

*Muharrem 1434*

*15. 11. 2013*

## TAKIM ME ALLAHUN

Dikush i habitur më tha: Menaxhimi i namazit?!

Po, i thashë. Kur munden të studiojnë menaxhimin e punës për të qëlluar investimet e duhura, e të përfitojmë fitime të majme, që janë fitime të përkohshme, pse të mos menaxhohen edhe punët e ahiretit gjithashtu, e të fitojmë fitime të mëdha, që janë fitime të përvetshme?! A ka punë më të mirë për investim dhe drejtmënaxhim se namazi? Punë e dynjasë dhe ahiretit?!

Në një ditë të muajit Ramazan më ndodhi që disa studentë saudit që studionin në Oksford, të më bëjnë thirrje për një ligjëratë në klubin e tyre. Ligjërata duhej të mbahej para iftarit. Atë ditë zgjodha të flasë për menaxhimin e namazit.

Erdha në kohë të caktuar, dola përpara studentëve dhe me vete kisha një fletë ku kisha shkruar disa rreshta. Si zakonisht i përshëndeta të pranishmit, e pastaj hapa letrën dhe fillova të lexojë rreshtat e shkruara me shpejtësi të madhe, sa që nuk më kuptonin fare se çfarë po thosha. Nuk shkoi një minutë, unë veçse më kisha mbaruar leximin e fletës, shpejt e shpejt mora dhe mbylla fletën dhe dola, duke kërkuar falje e duke thënë: “Më falni se shpejtova, por më duhet të shkoj tani, jam i zënë me një takim tjetër më të rëndësishëm. Mirë mbetshi, thashë me shpejtësi, mora çantën dhe u nisa drejt derës, ndërkaq që në fytyrat e tyre vëreja habinë e madhe gati se goja iu ishte mbyllur, shikimi i tyre sikur ngërthente habinë, mosbesimin se çfarë po ndodhte dhe gatishmërinë për të protestuar, bile edhe injorim dhe nënçmim.

Kështu janë reaksionet spontane të njerëzve kundrejt një sjelljeje njerëzore të pahijshme, siç ishte sjellja ime. E si e paramendoni reaksionin sikur ta bëje një gjë të tillë me Allahun?

Imagjino sikur punon në një restorant që shërben ushqime të llojllojshme për klientët e respektuar dhe, për një çast le punën dhe del jashtë para kohës së caktuar, dhe kur pronari i restorantit të pyet se përse dole jashtë, ti i thua: “dola për të kërkuar pak ushqim për të ngrënë!”

Nuk kaluan disa sekonda dhe unë u ktheva në mesin e studentëve, duke kërkuar falje për sjelljen time të pahijshme, mora t’ua shpjegoj se veprimi im ishte një aktrim i vogël me të cilin për qëllim kisha të bëj hyrjen e ligjëratës sime me ata. Më vonë u tregova se, unë dhe ata e shumë të tjerë, kështu veprojmë me Allahun, ndoshta edhe më keq. Nuk ka ndodhur, siç mund të vlerësoj, se dikush është kthyer pasi ka falur namazin shpejtë, ashtu siç unë e lexova fletën time para jush, e të kërkojë falje prej Allahut, e të thotë: Allahu im, më fal, unë nuk desha të sillem keq me Ty kur shpejtova në namaz dhe shfaqta interesim më të madh për takimin që e kisha pas namazit se interesimi im për takimin me Ty!

Sa gjëra të bukura e të mrekulluara na shpëtojnë prej dore dita ditës, e nuk vërejmë se çfarë po ndodh me veprimin tonë me Allahun në namaz, nëse bën ta quajmë kështu? Ndoshta është më e drejtë të themi: prej nga kjo keq-sjellje, nënvlerësim dhe paedukatë? Cili projekt tregtar investues do të ishte më i madh se ky të cilin Allahu na e ofroi në pjetë të artë, që ne nuk e kishim pritur kurrë?! A do të ishte mirë që atë ta refuzonim e ta nënvlerësonim? Të jemi të logjikshëm me vetveten! Po mirënjohja Hyjnore e shfaqur në horizontet e larta për namazin?! A do të ishte veprimi ynë me të më afër lojës se falënderimit të vërtetë? Me cilin? Me Allahun e Lartmadhëreshëm...

Doemos duhet ta rizbulojmë vetveten, adhurimet tona dhe gjithçka që është përreth nesh, që fëmijët tanë t’i edukojmë në frymën e metodologjisë mendore, që do t’ju ndih-

mojë të rizbulojnë çdo gjë që i rrethon, bile edhe të rejat që i kanë përpara, nëse duam që ata të jenë në jetën e tyre në radhët e mendimtarëve dhe inovatorëve, e jo në radhët e administruesve dhe klasikëve.

Më kujtohet dita kur nëna ime, Allahu e mëshiroftë, u kthye në shtëpi nga vizita e një shoqe të saj krishtere në lagjen Ladhikije. Atëkohë unë isha shtatë apo tetë vjeç. Nëna filloi të na tregojë për vizitën e saj dhe për radion e çuditshme që e kishte sjellë biri i tyre që studionte në Francë. Fjalët e nënës sime kurrë nuk do t'i harroj: "Radioja kishte një dritare në pjesën e përparme, përmes së cilës mund ta shihje personin që flet në të!"

Atë natë nuk bëra fare gjumë, sepse mendoja për njeriun e mjerë që e kanë robëruar në atë sënduk të vogël dhe e kanë mbyllë në të: po si kanë munduar ta fusin aty? Ndoshta e kanë zgjedhur ndonjë shtatshkurtër, që e zë sënduku. Mirë, po si mundet i mjeri...? Më falni, kështu mendoja kur isha i vogël, si del ai për të kryer nevojën natën? Po ku del për ta kryer nevojën? Qindra pyetje më vinin ndërmend dhe nuk më linin të mbyllja sytë. Gjatë kohë kishte kaluar, që unë ta kuptoja se mjeti për të cilin fliste nëna ime ishte televizori.

Sot fëmijët tanë lindin duke pasur pranë televizori, telefon, kompjuter, laptop, celular, satelitë, aeroplanë, vetura, mjete elektronike të çuditshme etj. Këta fëmijë nuk mendojnë shumë për madhësinë e këtyre shpikjeve, e as për zbulimin e madhësisë së shpikësve. Kujtoj se është e rrugës t'i ushtrujmë për zbulimin e madhësisë së këtyre gjërave dhe zbulimin e shpikësve të tyre, që kjo t'i orientojë drejt zbulimit të madhësisë së krijesës, në vetvete dhe përreth tyre, të rizbulojnë madhësinë e Allahut në krijim, t'i orientojë në rizbulimin e vetes së tyre, fesë së tyre dhe adhurimit të tyre, të heqin pluhurin e spontanitetit, zakon-

shmërisë dhe përsëritjes, që gjithmonë të jenë të freskëta në sytë e tyre, sikur i kryejnë për herë të parë në jetë. Kështu na mëson Kur'anit famëlartë, nëse jemi të Kur'anit, të bëjmë rizbulim në shumë ajete të tij:

*"Ai ka krijuar shtatë qiej njërin mbi tjetrin. Nuk mund të gjesh në krijimin e të Gjithëmëshirshmit kurrfarë ceni. Hidhe vështrimin: a sheh ndonjë plasaritje?"* (El-Mulk, 3)

*"A nuk i shohin shpendët mbi kokat e tyre, se si i hapin dhe i mbledhin krahët? Askush nuk i mban ata, përveç të Gjithëmëshirshmit?"* (El-Mulk, 19)

*"Thuaj: "Mendoni: nëse ujërat ju shteren, kush do t'ju sjellë ujë rrjedhës?"* (El-Mulk, 30)

*"Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjësi? A s'ka qenë një pikë fare që derdhej, pastaj u bë droçkë gjaku e më pas Allahu e krijoi dhe i dha formë e përmasa të caktuara, e prej tij bëri çiftin: mashkullin e femrën?! Vallë, Ai Krijues, a nuk ka fuqi që t'i ngjallë të vdekurit?!"* (El-Kijame, 36-40)

*"Nga retë Ne ju lëshojmë ujëra të bollshme për rritjen e drithërave, bimëve dhe të kopshteve të dendura." (En-Nebe', 14-16)*

*"Le të mendojë njeriu për ushqimin e vet: Jemi Ne që lëshojmë ujë me bollëk, pastaj e çajmë tokën në thellësi dhe nxjerrim prej saj drithërat, rrushin e perimet, ullirin e palmat, kopshtet e dendura, pemët dhe gjithë barërat, që t'i gëzoni ju dhe bagëtitë tuaja." (Abese, 24-32)*

*"Vallë, a nuk i shohin devetë, se si janë krijuar?! Po qiellin, se si është ngritur?! Po malet, se si janë vënë të patundura?! Po Tokën, se si është shtrirë?!"* (El-Gashije, 17-20)

Ky program kur'anor i thirrjes zhvillohet në shumë ajete dhe sure, shoqëria që zhvillohet në këtë frymë do të gjejë veten vazhdimisht në gjendje të rizbulimit të vetes dhe asaj që e ka përreth. Por jo vetëm kjo, ajo do të jetë në gjendje civilizuese dhe "imanore" që e shoqëron gjatë gjithë brezave. Ne jemi të thirrur që në prag të çdo mëngjesi të vëmë syza

të reja, me anë të të cilave do ta shohim vetveten dhe botën përreth nesh, sikur e shohim për herë të parë, vetëm atëherë do të mund të vërejmë se sa afër Allahut mund të jemi...

Në shkolla e universitete janë përhapur tejmase studimet e lëndës së menaxhimit, duke pasur parasysh rëndësinë e tij në jetën ekonomike. Lënda e menaxhimit është bërë rruga më ideale e investimit në fushën e industrisë, tregtisë, bujqësisë etj.

Por, a thua kemi menduar ndonjëherë për themelimin e një fushe specializimi në shkolla e universitete për të investuar në projekte më fitimprurëse dhe më afatgjate, më të sigurta dhe më të dobishme, si në këtë botë ashtu edhe në tjetrën?! Pastaj, cili është faktori kryesor i suksesit të projekteve të kësaj bote? A nuk është menaxhimi i adhurimeve?

Namazi është kulmi i adhurimeve apo investimeve në të dyja botët, siç pohon i Dërguari s.a.v.s., ai thotë se në rend të parë është namazi që falet në kohë, pastaj mirësia ndaj prindërve dhe lufta për hir të Allahut.

Mos u habit nëse lufta është e radhitur në thënien e të Dërguarit s.a.v.s. në pikën e tretë, edhe përkundër asaj se është punë e rëndësishme, plot mundime e rrezik!

Transmeton Abdullah ibn Mes'udi dhe thotë: *"E pyeta të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: "Cila është puna më e dashur për Allahun? Ai tha: "Namazi në kohën e vet". E pastaj?, i thashë unë. Ai tha: "Mirësia ndaj prindërve".Po pastaj?, i thashë unë. Ai tha: "Pastaj lufta në rrugë të Allahut". (Muslimi)*

Çudi! Sa fjalë të bukura, edhe pse jemi mësuar që t'i lexojmë pa vëmendje! Xhihadi është çështje e rëndësishme, e madhe dhe e rëndë, duket qartë se aty ka rrezik për shpirtin dhe trupin, rrezik për pronat tona që i kemi në jetë, ndërkaj që namazi ia kalon?! Namazi që falet në kohë? Më i rëndësishëm se xhihadi? Më i shpërblyer dhe më i vlefshëm?! A nuk është çështje që meriton kontemplim dhe shqyrtim

më të madh? Sidomos kur shohim se Allahu i Madhërishëm e përshkruan atë se është e “vështirë” për ne, me përjashtim të “devotshmit” nga ne! Të devotshmit nuk e shohin të vështirë në jetë, devotshmëria e tyre e bën atë lumturi, gëzim e qetësi, mur të fortë për mbështetje në jetën e tyre: *“Kërkoni ndihmën e Allahut me durim e me namaz! Kjo është njëmend e vështirë, përveçse për të devotshmit.”* (El-Bekare, 45)

Ky nuk është libër shkencor akademik, mendimet e mia nuk i kam mbështetur pra në këto burime, para meje kam pasur vetëm Kur’anin dhe Sunetin, bile mbështetja ime në Sunetin ka qenë më e madhe se në Kur’anin, duke pasur parasysh se ai përfshinë mijëra hadithe që sqarojnë detajet e namazit dhe dispozitat e tij, kurse Kur’ani e përmend vetëm në disa ajete.

Mendoj se së bashku do të mund të hymë në shitoren magjike e të mrekullueshme, që na e hapi i Dërguari s.a.v.s. me kapital hyjnor e që ia kalon të gjitha shitoreve të kësaj bote me mall dhe fitim, kapital të sigurt për llogari të kësaj bote dhe të botës tjetër.

NËN KUBEN E PARË  
Pse namazi?





## TRIBUNA E PARË NAMAZI: DETYRË DHE E DREJTË

### Pjesa 1

#### Është njëmend i vështirë... pse?!

Pse namazi?

Pse i anulojmë takimet tona? Pse heqim dorë nga preokupimet tona të përditshme? Pse i mbyllim shitoret tregtare? Pse lëmë pas dore çdo gjë në jetë, sado që të jetë e rëndësishme dhe drejtohem për ta falur namazin?

Pse i Dërguari s.a.v.s. e bëri vijë ndarëse midis imanit dhe kufrit? Përse i Dërguari s.a.v.s. zgjodhi fjalët e tij të fundit para ndarjes nga kjo botë të fliste për rëndësinë e tij dhe ta konfirmonte qartë çështjen e tij? Ai këtë e thoshte në shtratin e vdekjes, duke shtuar: *"Për Allahun, për Allahun, kujdes namazin. Për Allahun, për Allahun, kujdes namazin!"*

A është namazi dënim ose shpërblim? Cila është ana e vështirësisë së tij, nëse vërtet në të ka vështirësi? Cila është ana e kënaqësisë së tij, nëse e ndiejmë vërtet kënaqësinë e tij? Pse namazi në këto kohë të caktuara? Pse i përbërë me këto rekate dhe lëvizje të caktuara dhe numëruara? Pse të falet me këto lexime dhe shprehje? Pse namazi është i pranishëm në çdo religjion? Si bëhet namazi t'ia kalojë vlerës së xhihadit në fushëbetejë? Pse namazi zë këtë vlerë të madhe tek Allahu i Madhërishtëm dhe te i Dërguari s.a.v.s.?!

Më duhet ta pranoj se ka pesëdhjetë vjet që vazhdoj të falem, para se të zbuloj se unë me namaz posedoj projektin më të madh tregtar, fond i buxhetit të Allahut të Madhërishtëm, i vënë në llogarinë time bankare për investim! Se unë

vetëm duhesha të përpiqem të zgjedh rrugën më ideale për menaxhimin e tij dhe punësimin e tij, me qëllim të arritjes së fitimit më të madh dhe kënaqësisë më të madhe që mund ta ëndërrojë ndonjë njeri në faqe të tokës.

Sikur me namaz, nëse do ta kishim kuptuar të vërtetën që ndodh brenda tij, bëhem shkollë që nxjerr muxhahidë, durimtarë, luftëtarë dhe gjithë ata që premtuan se do të flijojnë veten, punën, pasurinë dhe jetën e tyre për hir të Allahut të Madhërishëm.

Namazi nuk është adhurim i thjeshtë në mesin e adhurimeve tjera, ai bën që në thellësitë e ujit të tij të kultivohen rrënjët e sakrificës, flijimit, pastërtisë, devotshmërisë, lartësisë, ngritjes lartë mbi tokë, çlirimit nga materia dhe zemërdëlirësisë para Allahut të Madhërishëm. Të gjitha këto përbëjnë platformën nga e cila nisen shpirti i sakrificës dhe grupet e luftëtarëve; së pari luftëtarët e shpirtit, se këta janë që ushtrojnë llojin më të vështirë të luftës, e pastaj luftëtarët e mbrojtjes së të vërtetës, atdheut, nderit, shpirtit, njeriut, lirisë dhe dinjitetit. Ky është shkaku që i Dërguari s.a.v.s. e bëri adhurimin më të vlefshëm. Transmeton Abdullah ibn Mes'udi r.a. se i Dërguari s.a.v.s. gati se nuk agjëronte ndonjëherë, dhe thoshte: *"Unë nëse agjëroj, bëhem (tregohem) i dobët për namaz, e namazi është më i dashur për mua se agjërimi."* (Hejthemiu në Mexhmeu ez-Zevaid)

A të ka ndodhur ndonjëherë të vëzhgosh luftë midis buburrecave për një copë ëmbëlsire, ku çdonjëra përpiqet ta përvetësojë, grumbull i madh i buburrecave që vërsulen njëra mbi tjetrën, ndonjëra përdor kthetrat e saj të vogla për të prerë këmbët e tjetrës e ta pengojë nga kapja e copës së ëmbëlsirës, kurse tjetra përdorë forcë për ta shtyrë tjetrën etj?! S'ka dyshim se kjo pamje do të lë të habitur dhe të bën të qeshesh për këtë luftë të ashpër e të çuditshme midis dy

ushtrive të vogla! Për çfarë? Për një copë të vogël ëmbëlsire, copë që nuk vlen fare!

Sikur ti të bëje namaz të vërtetë e të plotë, namaz ku vërtet ndien se je ngritur mbi dynjanë dhe ke arritur tek Allahu i Madhërishëm, e pastaj prej lartësive të mëdha t'i shikosh gjërat poshtë në dynja, ato që sapo je ndarë prej tyre, do të vëresh se çdo gjë që më parë në sytë e tu ka qenë e madhe, do të shndërrohet në copë të vogël ëmbëlsire dhe e pavlefshme, pikërisht sikur ajo për të cilën luftonin buburrecat! Është dynjaja jote e pavlerë, kurse buburrecat që luftojnë për këtë copë të vogël të pavlerë je ti dhe njerëzit e tjerë të cilët i lufton ose të luftojnë, i vret ose të vrasin, që më në fund të fitosh copën e vogël të ëmbëlsirës, ose ta fitojnë ata atë dhe ty...

A thua ke ndier ndonjëherë duke u falur se ti vërtet bën këtë udhëtim hapësinor të çuditshëm që të jep këtë vëzhgim të çuditshëm në sy dhe zemër; që pastaj pasurinë, pronat, postin, njerëzit, mosmarrëveshjet, brengën, lodhjen, mashtrimin, tradhtinë, urrejtjen, smirën, kryetarin, të varfërin, të madhin, të voglin dhe gjithçka që është në tokë, t'i shohësh jo më shumë se grimca ëmbëlsire, lojë, zbavitje, garë midis qenieve, që nuk kanë vlerë?! Se e tërë kjo ndodh për shkak të një jete të shkurtër në këtë botë? Jetë ku shfaqen ngjyra dhe forma të ndryshme, por që nuk qëndrojnë gjatë?! Pjesë teatrale që gati ka përfunduar, shfaqja mbaroi, perdja u ul, spektatorët u larguan, mbeti e zbrazët: *"Ta dini, se jeta në këtë botë, nuk është tjetër veçse lojë, dëfrim e zbukurim, si dhe mburrje ndërmjet jush e rivalitet për më shumë pasuri dhe fëmijë:"* (El-Hadid, 20)

Po kush është ai që di më mirë vlerën e këtij investimi në namaz se njeriu i madh, i cili gjatë udhëtimit të çuditshëm e të ndritshëm që kalon kufijtë e perceptimit dhe pranon drejtpërdrejt prej Atij që e bëri detyrim për ne? Prej

atij që i tregoi për numrin, rekatet, plan-programin, rregullat dhe i shpalli fjalët me të cilët ai do t'ia tregonte të tjerëve çështjen e tij, ashtu siç e pranoi, së pari ta investonte vetë i Dërguari s.a.v.s., përkundër asaj se Allahu ia kishte falë të gjitha gjërat në jetë. Transmeton Aisha r.a. se i Dërguari s.a.v.s. falej natën aq sa këmbët i bëheshin të ënjtura dhe ndonjëherë i thoshte: *“Pse po bën kështu, o i Dërguari i Allahut, kur Allahu ti ka falë gabimet e mëparshme dhe të ardhshme? Ai thoshte: “A nuk duhet të jem rob mirënjohës (falënderues)?”* (Buhariu)

Prandaj, nëse është kjo vlera e vërtetë e namazit, atëherë cili do të jetë më i rëndësishëm dhe më me vlerë: luftëtari apo shkolla që ka nxjerrë dhe do të nxjerrë deri në Ditën e Kiametit grupe luftëtarësh dhe luftëtaresh, durimtarë dhe durimtare, që përmendin Allahun dhe që falënderojnë Atë?

Faqet në vijim do të trajtojnë këtë çështje.

## Pjesa 2

### Udhëtimi nga “detyra” në “të drejtë”

Po, namazi në ligjin islam është detyrë (*vaxhib*), kurse i Dërguari s.a.v.s. thotë: *“Urdhëroni fëmijët tuaj për namaz kur t'i mbushin shtatë vjet, rrihni ata për çështjen e namazit (nëse e shpërfillin) kur t'i mbushin 10 vjet.”* (Ahmedi)

Ky është shkaku që namazi nuk është adhurim i zakonshëm, siç janë adhurimet tjera, ai në Kur'an përshkruhet: *“...njëmend e vështirë, përveçse për të devotshmit.”*

I Dërguari s.a.v.s. thotë: *“Midis njeriut dhe kufrit qëndron heqja dorë nga namazi.”* (Muslimi)

Shokët e të Dërguarit s.a.v.s. e dinin se vetëm shpërfillja e namazit e nxjerr njeriun nga Islami: *“Shokët e të Dërguarit s.a.v.s. besonin se shpërfillja e namazit nënkupton kufrin.”* (Tirmidhiu)

Kur'ani famëlartë përsëriti disa herë urdhrat hyjnore për faljen e namazit, ai pohon qartë çështjen e namazit dhe kërkon kujdesin e tij, siç kërkon që t'i urdhërojmë të tjerët për namaz:

- *"Faleni rregullisht namazin, sidomos atë të mesmin...."*  
(El-Bekare, 238)

- *"Ai më ka porositur që të falem e të jap zeqat sa të jem gjallë."* (Merjem, 31)

- *"...e që janë të vazhdueshëm në faljet e tyre."* (El-Mearixh, 23)

- *"...e që i falin namazet rregullisht."* (El-Mearixh, 34)

Mirëpo kjo *"detyrë"* nuk mbetet i tillë në jetën e njeriut, kur ai arrin të njohë natyrën e namazit dhe alkiminë e tij, kur zbulon rëndësinë e tij të vërtetë, këtë lidhje të ngrohtë me Zotin e tij, atëherë fillon që namazi të shndërrohet në periudhë tjetër të re, në atë e *"drejtë"* dhe çfarë e drejtë se...

Le të supozojmë se dikush nga ne ëndërron të marrë ftesë për takim nga kryetari i shtetit ose udhëheqësi suprem, e që pas një kohe vërtet të arrin ftesa dhe, vërtet ndodh takimi me atë që shumë ëndërronte të takohej, që t'ia paraqiste ankesat e t'ia sqaronte nevojat e tij të shumta për të cilat shumë ëndërronte se do të vijë një ditë e këtij takimi. Por, kur zgjohet nga gjumi dhe vëren dëshpërimin e madh, sepse ishte vetëm ëndërr, më vete thotë: *"A nuk mund ta bëj ëndrrën time realitet?"*

Pastaj merr rrugën për ta bërë realitet ëndrrën e tij, përpiqet e lufton, ndërmjetëson me të vegjël e të mëdhenj, humb kohë, pasuri dhe rehati për hir të realizimit të shpresës së tij dhe, më në fund, arrin ta takojë kryetarin, të ulet me të dhe të bisedojë për të gjitha gjërat, sy më sy, pa ndër-mjetësues, pa ndërhyrje të askujt që do t'ia prishë kënaqësinë e bisedës dhe takimit të denjë.

Kështu je në namaz, por dallimi është se ti qëndron para Atij që ka pushtetin e gjithë botëve, Zotin e çdo krijese,

sy më sy, pa ndërmjetësues, pa praninë e ndonjë ministri, dhe para Atij i hedh të gjitha brengat, të gjitha nevojat, kërkesat, pa bërë ndonjë mund e luftë, pa angazhuar ndonjë ndërmjetësues. Në këto çaste kemi kujdes vetëm nga ndërhyrjet e djallit që përpiqet të na i dëmtojë lidhjet e ngrohta me Allahun, të na largojë prej Tij, të na heq nga mendja çdo gjë që na nxit të mendojmë për Atë e të na preokupojë me gjërat e dynjasë dhe kënaqësitë e jetës.

I Dërguari s.a.v.s. thotë: *“Kur thërret ezani, djalli ik, që të mos e dëgjojë ezanin. Por, kur mbaron ezani, ai kthehet. Kështu ndodh edhe kur thërret ikameti, ai me dëgjimin e tij ik, por kur mbaron ikameti, ai kthehet duke fut mendime midis njeriut dhe vetes së tij, i thotë: “Kujtoje këtë, kujtoje këtë, gjëra që nuk i ka kujtuar më parë – ato që nuk i kujtohen para namazit), - kështu derisa njeriut nuk i kujtohet sa ka falë, e kujtdo që nuk i kujtohet sa ka falë, le t’i bën dy sexhde duke qenë ulur.”* (Muslimi)

Imagjino se ke ndërmend të marrësh me qira një shtëpi të madhe që të ka pëlqyer shumë, shtëpi e bukur, magjepse, e gjerë, me kopshte të bukura, me pajisje të mrekullueshme e tjera, dhe në çastin kur ke vendosur për këtë, ulesh për të biseduar me pronarin e shtëpisë për çmimin, kur ja, ai të befason me çmimin e kërkuar: shtëpia jepet me qira që pesë herë në ditë të vish tek unë për të ngrënë ushqim, në llogarinë time, nuk dua asgjë më tepër e as më pak!

Çfarë propozim i denjë është ky?! A e besoni këtë? Po ky është ai propozim që na e ka propozuar Allahu i Madhërishëm për të banuar në tokën e Tij, të kënaqemi me të mirat e Tij, të kapardisemi me delikatesat e tij, të marrim pjesë në ndërtimin e tij. Ai na e përgatiti tokën për këtë rol të rëndësishëm, e shtroi atë për bukuri, me të gjitha stolitë që shtrohet një shtëpi, në të vuri gjëra që nuk mund t’i pararendojmë, e pastaj nga ne kërkoi që vetëm pesë herë në ditë të shkojmë te Ai e të hamë nga të mirat e përgatitura, të

flasim me Atë, t'ia parashtrojmë ankesat e kërkesat, të heqim nga ne ndyrësitat e jetës së përditshme, të heqim barrën e rëndë që e kemi në qafë, e Ai është i kënaqur me ne, i Kujdesshëm për ne, Dëgjues i mirë për të gjitha ato që do t'ia themi...

A nuk i bëjmë të padrejtë vetes sonë, nëse nuk ndajmë kohë për të marrë këto ushqime ditore? Pse harxhojmë gati 30 minuta për barkun tonë, kurse nuk gjejmë kohë për ta mbushur shpirtin tonë? Cila është më e rëndësishme? Ti, nëse nuk arrin të ngopesh pesë herë në ditë, nuk do të vdesësh nga uria, por nëse humb ushqimin e shpirtit, atëherë është e mundur të humbësh gjithçka. Atëherë as ushqimet e barkut nuk do të mund të të kënaqin si duhet, nëse ndien se ti je larg nga Ai që ti dha të gjitha këto.

*“Kur robi fillon të falet, i sillen të gjitha gjynahet dhe i vihen mbi shpatulla, çdoherë që bie në ruku e sexhde, ato bien nga ai (i shlyhen).”* (Ibn Omeri; Albani thotë është hadith sahih)

Selman Farisiu thotë: *“Kujdesuni për këto pesë kohë të namazit, sepse ato janë shpagim për këto plagë, nëse nuk ndodh vrasje; kur njerëzit falin namazin e jacisë, dalin nga tre shtëpi (shkallë): dikush ka gjynah e jo shpërblim, dikush ka shpërblim e jo gjynah, e dikush as shpërblim e as gjynah. Njeriu që ka shfrytëzuar errësirën e natës dhe shkujdesin e njerëzve dhe merr kalin e tij dhe niset për gjynahe. Ky është ai që ka gjynahe e jo shpërblim. E ai që ka shpërblim e jo gjynah është njeriu që shfrytëzon errësirën e natës dhe shkujdesin e njerëzve dhe ngritët për t'u falur. Kurse ai që nuk ka shpërblim e as gjynah është njeriu që ka falë jacinë dhe ka ra të flejë, ky nuk ka as shpërblim e as gjynah.”* (Albani thotë se hadithi është sahih)

Sa lehtë është që e drejta të shndërrohet në detyrë, ndoshta në detyrë të vështirë që mendojmë sa më shpejtë të lirohemi prej tij. Kjo vlen për atë i cili ndien se është duke humbur apo harxhuar kohë nga koha e tij e shtrenjtë kur

fillon të falë disa rekate! Prandaj, në programin e tij ditor ai nuk lë më shumë se disa minuta që i veçon për këtë “detyrë” që mendon se është i detyruar ta kryejë!

“Detyra” lidhet gjithmonë në kujtesën tonë me “barrën”, kurse barra është e rëndë për shpirtin. Njeriu atë e sheh si një gjë që gjithmonë merr e nuk jep, sepse e privon nga e drejta e kohës dhe rehatisë. Këtu fillon shtrembërimi, kështu namazi shndërrohet në barrë nga e cila përpiqen shumë njerëz “të lirohen prej tij” dhe ta heqin nga qafa atë, sikur kjo “detyrë” është vjedhës që ua vjedh pronat e tyre, e jo shpërblim i madh që troket në dyert e tyre dhe dëshiron të hyjë tek ata. Dëgjoni këtë përshkrim besnik të njeriut që kishte vizituar varrin e të Dërguarit s.a.v.s., ta përshëndeste atë, vëni mendjen kësaj “detyrë të rëndë” që dëshironte ta kryente: “Në pallatin e emirit protokolli kërkonte nga anëtarët e delegacionit që t’i mbyllnin telefonat celularë gjatë takimit me të. Ishte gjë e bukur kjo që kërkohet nga ne, së paku vërehej se të gjithë vlerësonin pozitën e njëri-tjetrit. Por, shoku ynë, që dukej elegant atë ditë në namaz të ikin-disë po qëndronte para varrit të Pejgamberit s.a.v.s. dhe priste në radhë për ta përshëndetur. Papritmas cingëroi telefoni i tij, ai nxori atë dhe me zë të lartë filloi të fliste, njerëzit përreth sikur humbën përkushtimin që kishin. E kur i erdhi radha për përshëndetjen e të Dërguarit s.a.v.s., bashkëbiseduesit në telefon në mënyrë elegante i tha: “Një moment më fal, tani jam para varrit të të Dërguarit s.a.v.s., një sekondë, vetëm ta përshëndes”. Pastaj filloi të shqiptonte germa tejet të ftohta e të ngurta, sikur të fliste me shitës patatesh, kurse telefonin e mbante ende në vesh. Kështu mbaroi përshëndetjen pa aromë dhe vazhdoi bisedën telefonike me atë që po fliste”.

Nuk e di, por ndoshta me qëllim të mirë, apo shkujdesje ose nga injoranca, e drejta shndërrohet para nesh në “vetëm

detyrë”, disa herë në detyrë të rëndë, mezi e kryejmë atë, shohim që sa më shpejtë të lirohemi prej tij, kështu shndërron në keqtrajtim dhe paedukatë.

Që këtej, nga ajo që nënkupton koncepti “detyrë”, së paku ne të mëdhenjtë doemos ta kuptojmë të vërtetën se namazi, pothuajse jemi plakur me të dhe ende na duket e thjeshtë, nuk është detyrë që disa e kanë si brengë dhe lodhje para vetes, e as barrë që mendojmë që sa më shpejtë të lirohemi prej tij, me qëllim që t’i rrekemi punëve tjera ditore. Nëse kështu mendojmë, atëherë të dimë se namazi ka humbur përkufizimin e tij pejgamberik që atë e përshkruan duke thënë: *“O Bilal, na rehato me atë (namazin).”*

A thua tani e ke kuptuar vlerën e namazit, besimi yt i freskët e i gjallë do ta vlerësojë atë si një “e drejtë” e çmuar dhe e dashur, do ta vë në plan ditor, bile do ta llogarisë mbi të gjitha të tjerat, projekt i projekteve investuese, do të kapet fort për të, do të luftojë me ata që duan ta heqin nga ai, e si të mos jetë kështu kur namazi është dritë e syve, kënaqësi e shpirtit të Dërguarit s.a.v.s.: *“Namazi më është bërë kënaqësi e syrit tim, thotë i Dërguari s.a.v.s.”* (Bejhekiu)

E si të mos luftojë nëse nga unë hiqet kjo lidhje e ngrohë të dhe e drejtpërdrejtë me Allahun? Nëse nga unë hiqet namazi, atëherë është hequr lidhja me Krijuesin e Madhërishtëm, ka humbur rasti për të më dëgjuar dikush, sikur që më dëgjonte Allahu, askush më nuk më përgjigjet si Ai, askush nuk më shpërblet aq shpejt, sikur që bën Ai: *“Allahu i Madhërishtëm thotë: “O biri i Ademit, mos u trego i pafuqishëm për katër rekate në prag të mëngjesit, të garantoj sukses në mbarrim të ditës (të shpërblej).”* (Ibn Davudi)

*“Pesë kohët e namazit, nga xhumaja në xhuma, nga Ramazani në Ramazan, gjithçka ndërmjet tyre falet, nëse njeriu nuk bën gjynahe të mëdha.”* (Albani thotë se hadithi është sahih)

*“Çdo musliman që merr abdes dhe atë e bën në mënyrë perfekt, e pastaj ngritët për t’u falë dhe e di mirë se çfarë thotë, le ta dijë se nga namazi ka dalë sikur ditën që nëna e ka lindur.” (Albani thotë se hadithi është sahih)*

Tani, a nuk ndien së bashku me mua dhembshuri për atë që zgjedh diç tjetër, e jo namazin? Çfarë raste të bukura i shkojnë huq njeriut çdo ditë?! Ndoshta nuk do të mund ta kuptojë saktë atë që dua ta them, por do të vijë dita që do të shpresojë që sikur të mos e kishte humbur këtë xhevahir të shtrenjtë që dikur e kishte lënë në margjinat e jetës së shkurtër, e shkurtër sado që të zgjasë. Doemos dita e fundit të vjen, tani ose më vonë, e pse të mos e sjell të ardhmen e largët në “këtu” afër, bile si e llogarit veten të sigurt se do të jetojë deri në atë ditë të largët?!

*“Gjashtë veçori janë, që nëse muslimani vdes në njërën prej tyre, le ta dijë se është garanci se Allahu ka për ta futur në Xhenet:*

*- Njeriu që ka dalë për të luftuar, nëse vdekja e takon në fushën e saj, është i garantuar për Allahun.*

*- Njeriu që ka dalë për ta përcjellë xhenazen, nëse vdekja e takon në fushën e saj, është i garantuar për Allahun.*

*- Njeriu që merr abdest dhe atë e bën bukur, e pastaj del për në xhami, nëse vdekja e takon në fushën e saj, është i garantuar për Allahun.*

*- Njeriu që vjen tek udhëheqësi, me qëllim të respektit dhe mbështetjes, nëse vdekja e takon aty, është i garantuar për Allahun.*

*- Njeriu që rri në shtëpi, nuk përgojon muslimanin, nuk i shkakton zemërim e as mundim, nëse vdekja e takon në fushën e saj, është i garantuar për Allahun.” (Aisha r.a., Albani thotë se hadithi është sahih)*

Pyetja nuk është pra: a e ke falë namazin ose jo? Pyetja që duhet t’ia parashtrojmë vetvetes sonë është pas namazit: a u kënaqa vërtet me këtë namaz (a isha i lumtur)? A shijova kënaqësi derisa isha duke u falë? A i ndjeva frytet e tij

në këtë botë? A i shijova frytet e shpërblimit të botës tjetër, apo ishte vetëm një detyrë që e mbarova, e me këtë ia humba vetes këtë kënaqësi të veçantë?

Le të jetë namazi yt biletë falas për një udhëtim të këndshëm, nuk them udhëtim rreth botës, por udhëtim rreth gjithësisë, të arrish te Sunduesi i kësaj gjithësie dhe Drejtuesi absolut i tij. I Dërguari s.a.v.s. thotë: *“Më erdhi Xhibrili me urdhër të Allahut të Lartëmadhërishëm, e më tha: “O Muhammed, Allahu të thotë: “Umetit tënd ia bëra detyrë pesë kohët e namazit, ai që i përmbush ato me përpikëri, abdestin, kohët, rukunë, sexhdet, le ta dijë se për të gjitha ato ai tek Unë ka marrë besën se do ta fusë në Xhenet, e kush më takon, ndërsa ka treguar paplotësim të tyre, ai nuk ka besë tek Unë, nëse dua e dënoj, e nëse dua e mëshiroj.”* (Ibn Abdu el-Berr)

Në fakt, suksemi i kalimit të konceptit tonë për namazin nga faza e “detyrës” në fazën e “të drejtës”, provon se kemi filluar hapin e parë në rrugë që na çon drejt shndërrimit të të gjitha gjërave në jetë nga “detyra” që na duken rraskapitëse dhe të padëshiruara, në “të drejta” me të cilat kënaqemi dhe gëzohemi.

### Pjesa 3

Në jetë na ndodh që shumë herë të ngatërrojmë detyrën me të drejtën, e të mos i dimë vijat ndarëse midis tyre: ku mbaron detyra që të fillojë e drejta dhe ku mbaron e drejta që të fillojë detyra?

Kalimi mbi urën e ndërtuar prej hekuri dhe çimentos për të arritur në anën tjetër të qytetit, do të duket vetëm detyrë për kalimtarët, por sikur të ndërtohej një urë në formë estetike inxhinierike, e të zbukurohej me lule dhe pemë, vizatime e piktura të bukura, që kalimi ynë mbi të na duket i këndshëm, të ndiejmë se vërtet kemi qetësuar mendjen

tonë me shikimet e bukura, kështu kalimi mbi të do të shndërrohej nga një urë hekuri e çimento, në krijesë të gjallë, që kënaqemi me takimin me të dhe bashkëpunimin me të, shndërrohet në të drejtë të shtrenjtë që na bënë të lumtur, bile do të dëshironim që kalimi ynë të zgjaste sa më shumë.

Haxhi është detyrë, ambicie, udhëtim, vështirësi, obligime, mundim, bile edhe rrezik, por kur mendojmë se për çdo hap që e bëjmë në haxh na sjell shpërblim, me siguri se nga koka jonë do të mënjanohen të gjitha këto ndjenja të detyrës, atëherë e drejta fillon të zë vendin e vet në ne, kurse ndjenjat për detyrën sikur nuk kanë vend në shpirtin tonë.

Sadakaja është detyrë, përpjekje, obligim, por kur atë e japim me kënaqësi dhe dimë se çfarë shpërblimi ngërthen si dhe ndiejmë lumturinë dhe gëzimin e atij të cilit i kemi dhënë, atëherë vërtet ndiejmë se si në shpirtin tonë zbret paqja dhe qetësia, pasi kemi kënaqur Zotin tonë, se skamnorit i kemi ofruar kujdes, ngrohtësi dhe siguri.

Agjërimi është detyrë, obligim, uri, etje, durim i paparë, por me çdo minutë që kalon ndiejmë kënaqësi dhe lumturi të jashtëzakonshme, ndiejmë afërsinë e Allahut, se i jemi përgjigjur urdhrit të Tij dhe ndalesës, se është afruar koha e shpërblimit të premtuar nga Ai. Agjërimi nuk do të përkufizohej vetëm në iftarin që e hamë pas një ditë të gjatë plot uri e etje, por mbi të gjitha janë ndjenjat e kënaqësisë së ngadhënjimit në luftën e privimit të shpirtit nga pasionet, pa marrë parasysh shpërblimin hyjnor.

Sa lehtë është që të drejtat që i kemi të shndërrohen në detyra të këndshme, por edhe më lehtë dhe më kënaqësi e lumturi është kur detyrat tona shndërrohen në të drejta.

Në ditën e Bajramit merr telefonin për t'i uruar shokët që i ke, numrat e telefonit i ke të regjistruar një pas një dhe, pa heq shumë mund, përgëzon të gjithë shokët për këtë ditë. Gjatë kësaj kohe ndien se vetëm ke kryer një detyrë, e

asgjë më tepër, se ke zgjedhur fjalë që sa më shpejt të mbarosh urimin në fjalë dhe kaq. Kështu, shokët e tu shndërrohen vetëm në numra, urimi yt për ta është vetëm detyrë e rëndë dhe e mërziur, që nuk bind askënd.

Pse nuk përpiqesh t'i shndërrosh këto "detyra tregtare" në të "drejta", të shijosh kënaqësinë e urimit të bërë për shokët, të ndjesh gëzimin e tyre me bisedën tënde të pastër dhe besnikërinë e pashoq, se ti u flisje me zemër e jo me gjuhë, e ata të ndiejnë se ti vërtet je kënaqur me ndjenjat e tyre të sinqerta, prandaj t'i dhurojnë të njëjta ndjenja që ua dhurove ti, ndoshta edhe më shumë.

Hulumto për të drejtën pas çdo detyre, bëje këtë çështje me të gjithë që janë përreth teje dhe me të gjitha gjërat përreth, bëhu kështu me Zotin tënd kur e thërret në namaz, kur e madhëron dhe kur e kujton, kur lexon dhe kur mendon për madhësitë e Tij.

Që namazi të jetë e drejtë nuk nënkupton që të zhvishet nga elementi i detyrës, çështja e tij është si çështja e të gjitha gjërave të drejta që i trajtojmë në jetë; të drejtën e zgjedhjes, shprehjes, kënaqësisë me natyrën, të drejtën e udhëtimit, pushimit, pagës mujore etj. Të gjitha këto janë të drejta që megjithatë kërkojnë kohë, mund, harxhim, nëse duam t'i arrijmë dhe t'i realizojmë.

Sikur dikush të të merrte në lidhje për të treguar se ke fituar shpërblim të madh material nga ana e një institucioni dhe se duhesh të shkosh në atë institucion për t'i marrë të hollat, a nuk do të kishe shpejtuar me vrap për t'i marrë ato? A nuk do të ishe i lumtur për shpërblimin e tillë? A nuk do të sakrifikoje kohën dhe mundin? A nuk do t'i llogarisje vështirësitë e rrugës për të lehta? Prandaj, a nuk e meriton shpërblimi i namazit këtë mund, bile edhe më shumë? E si mund të krahasohet shpërblimi i namazit me shpërblimin e kësaj bote, sado që e madhe të jetë?!

Si do të mund të kënaqemi me shijen e frytit nëse nuk zgjasim dorën drejt pemës për të këputur frytin? Si do të kënaqemi me gjumin e ëmbël, nëse nuk e kemi rregulluar shtratin me të gjitha gjërat e duhura: mbulesë të ngrohtë, jastëk të butë, ambient të qetë, dhomë pak të ndriçuar etj? Është e vërtetë se Allahu është Ai që shpezëve ua siguron kafshatën e bukës, por shpezët doemos të fluturojnë për ta marrë atë dhe të kënaqen me ngrënien e kësaj kafshate.

#### **Pjesa 4** **Kënaqësia e durimit**

Kur ngasim veturën për të shkuar diku apo në ndonjë punë, të preokupuar jemi vetëm tek vendi që do të shkojmë, sa më shpejtë që mundemi, disa herë me shpejtësi të palejuar.

Si do të ishte sikur ngasjen e veturës ta shndërronim në të drejtë që do të kënaqemi me të? Kujdesemi për kohën dhe durojmë, dalim më herët nga shtëpia, që të kemi kohë të mjaftuar për ngasjen e veturës me ngadalësi. Kështu, udhëtimi ynë na mundëson të kënaqemi me pamjet e bukura gjatë rrugës, të zbulojmë shumëçka që nuk kemi pasur mundësi t'i zbulojmë më parë, të kënaqemi me ngasjen tonë, të shijojmë kënaqësinë e të menduarit, pa mos e lodhur mendjen për kohën që kalon apo për distancën që ka mbet para nesh!

A nuk është e vërtetë se për udhëtimin tënd cakton kohë shtesë, që atë ta bësh kënaqësi për ty dhe për ata që i ke përreth, dhe vërtet kënaqesh, dhe nuk e ke detyrë të rëndë për ty dhe të tjerët? Kështu vepro me namazin tënd.

Çështja kërkon vetëm të bëjmë marrëveshje të qetë e të shkurtër me kohën që do të ndihmojë për durim, që edhe durimi të shndërrohet në kënaqësi. Po ti e ke shijuar më parë ëmbëlsinë e durimit në agjërime? Durim deri në iftar! Durim në gjërat e pakëndshme, deri në ditën kur ato largo-

hen dhe lumturia kthehet në ne, durim në sëmundje deri në shërim, durim në studime deri në sukses...

A je sprovuar me kënaqësinë e durimit tënd dhe privimit tënd nga gjërat që kishe mundësi t'i kesh? A ke provuar madhështinë e mundësisë tënde për të blerë një copë ëmbël-sire, një këmishe të re, një veturë të re e megjithatë je përm-bajtur nga blerja dhe je treguar parimor, modest dhe besnik?

Si do të ishte çështja nëse studenti do ta provonte këtë lloj të durimit? Që veten e tij ta privonte nga loja e dëfrimi, nga dalja me shokët etj, e gjithë këtë privim ta shndërronte në kënaqësi, që mësimin e tij ta konsideronte të drejtë, e jo detyrë e rëndë për të? E çfarë do të ndodhte sikur të paramendonte nxënësi që rri para grumbuj librash studimore, se bëhet gati për të kaluar në një planet tjetër për jetë, atje ku nuk ka shkencë, dituri, art, zbulime, letërsi, se nuk mund të merr me vete asnjë libër, fletë apo dokument, se do të jetë vetëm me kujtesën e tij, se do të jetë përgjegjës në këtë planet të ri për themelimin e një civilizimi të ri, që do të mbësh-tetet në arritjet e deritanishme të njerëzimit në tokë; zbulime, hulumtime shkencore dhe humane, që në fakt janë materie e librave të tij të ndryshëm?

Sikur nxënësi ta paramendonte këtë, me siguri se do të rrekej me zell pas studimit dhe mësimin të sa më shumë materieve studimore, do të shfrytëzonte çdo sekondë të jetës për të mësuar dhe mbajtur mend para se të vijë koha e të kalojë në planetin tjetër për të jetuar përgjithmonë, truri i tij do të barte vetëm sekrete të civilizimit tonë tokësor që do t'i shërbenin për themelimin e një civilizimi të ri atje. Është kënaqësi e imagjinatës dhe durimit. Kështu është çështja e namazit: *“Urdhëroje familjen tënde që të falë namazin dhe këmbëngul për këtë.”* (Ta-Ha, 132)



## TRIBUNA E DYTË NAMAZI DHE JETA

### Pjesa 1

#### Zbulim i çuditshëm që ka emrin namaz

Pse falemi?

Pse namazi? Pse përnjëherë heqim dorë nga të gjitha punët që na preokupojnë, nga familja, punët tregtare, studimet, interesat dhe detyrat jetësore, sado të rëndësishme të jenë dhe nisemi për ta falë namazin? Pse kështu bëjmë pesë herë në ditë?

Cili është sekreti i çuditshëm që i jep namazit këtë rëndësi të madhe? Pse e hasim në të gjitha religjionet, kuptohet në forma të ndryshme, numra, lëvizje dhe kohë? Dëgjoni me vëmendje rregullin e prerë profetik që sqaron rastin për të cilin ishin shpallur ajetet e namazit: *“Kur atyre u thuhej: “Përkuluni (në namaz para Allahut)!” – ata nuk përkuleshin.”* (El-Murselat, 48)

Ky ajet u shpall për banorët e Thekifit, që të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. i thanë: *“Na e heq nga ne namazin, se ne nuk përkulemi, ajo është ofendim. Ai s.a.v.s. nuk pranoi dhe tha: “Nuk ka dobi në një fe që në të nuk ka namaz.”* (Ebu Hajjani në *“Tefsir el-Muhit”* 8-399 dhe Shevkani në *“Fet’h el-Kadir”* 5-361)

Ç’mendon për njeriun që nuk ka asgjë në jetë, as ushqim, as veshmbathje e as vendbanim, e pranë tij kalon një njeri i pasur, që i jep për të ngrënë, e veshë dhe i siguron shtëpi, pos kësaj i siguron të ardhura për furnizim të përhershëm në jetë, por para se të ndahet me të e të merr rrugë, e porositi që herë pas here ta kontaktojë, të jetë i sigurt e i qetë

se është mirë, se nëse ka nevojë për gjë tjetër, do t'ia sjell menjëherë. Mirëpo, nuk shkoi kohë e gjatë dhe varfanjaku e harroi zotërinë e tij, shpërfilli lidhjet me të, derisa mendoi se ishte vetë ai që ma aftësitë e tij kishte arritur të gjitha që i kishte. A nuk nënkupton kjo mosmirënjohjen dhe mohimin?

*“Ai tha: “Kjo më është dhënë vetëm prej diturisë sime”. Vallë, a nuk e dinte se Allahu kishte zhdukur para tij shumë brezni, që kishin qenë më të fuqishëm dhe që kishin grumbulluar më shumë pasuri se ai?” (El-Kasas, 78)*

Njeriu ka gjithmonë nevojë për fuqinë e lartë superiore tek e cila mbështetet në rast vështirësie, që tek ajo kthehet kur atë e kaplon ndonjë e padëshiruar, që me të kënaqet kur bisedon, që asaj ia parashtron të gjitha ankesat e bren-gat, veçmas nëse e ka besimin e plotë. Është fuqia e lartë që këtij njeriu ia dha të gjitha në jetë, se në dorën e saj janë burimet e jetës, fijet e shëndetit të tij dhe familjes, jetës dhe vdekjes, se tek ajo është kthimi në fund, që të gjejmë shpër-blim ose dënim.

*“Kur familjen e të Dërguarit s.a.v.s. e kaplonte ndonjë ngush-tësi ose uri (gjë e padëshiruar), i ftonte ata dhe thoshte: “O familja ime, faluni, faluni.”*

*“Kur familjen e të Dërguarit s.a.v.s. e godiste ndonjë ngush-tësi, ai urdhëronte të falen, e pastaj lexonte ajetin: “Urdhëroje familjen tënde, që të falë namazin dhe këmbëngul për këtë.” (Ta-Ha, 132) (Hejthemiu)*

E si do të ishte puna sikur të mos kishte namaz?

Paramendoni sikur papritur të gjithë telefonat në botë të mos punojnë, të ndërpriten të gjitha lidhjet komunikuese rrjetësore dhe jo rrjetësore, të ndalen stacionet kozmike, to-kësore dhe interneti, të mbyllen të gjitha rrugët tokësore, deta-re dhe ajrore dhe...a thua çfarë do të kishte ndodhur në botë? Çfarë kaosi? Çfarë dëshpërimi? Çfarë humbje, çfarë rënie ekonomike, shoqërore, politike, kulturore e civilizuese?

Ky është roli të cilin e luan namazi ndërmjet nesh dhe Krijuesit tonë, a thua se do të mund të jemi të pavarur prej tij (namazit) qoftë edhe një ditë? Çfarë ndodh nëse shkëputet lidhja e ngrohtë midis nesh dhe Allahut? Prandaj, do të duhet që ta zbulonim vetë këtë mjet komunikues (lidhës) të çuditshëm që na e ka dhuruar Allahu!

E si do të ishte e mundur, nëse nuk do të kishte namaz, të “zbulonim” ne namaz që do të na lidhte me Krijuesin e Madh? Në çfarë forme do të paramendonit ta bënit këtë “zbulim” njerëzor e të rëndësishëm, vallë?

A do të gjenim formë më të mirë se “përbërja” apo “përzjerja” superiore dhe fantastike që përbëhet namazi? Po shikoni se çfarë realizime të jashtëzakonshme, çfarë përbërje të çuditshme, fjalë të sakta e të zgjedhura, lëvizje të dalluara dhe të shkëlqyera e domethënëse ngërthen namazi.

Pastërti, abdest, veshje me rroba të bukura, stolisje e vendit, fjalë të shkurtra paraprake që quhen ezan, aty ngërthehet e tërë feja që të thërret në takim me Zotin e kësaj feje, që nuk zgjatin më shumë se dy rreshta, ikameti, drejtimi kah kibla së bashku me miliona njerëz të tjerë, një drejtim, një simbol historik i shenjtë, i veçantë, ngritja e duarve në kokë, duke i drejtuar shuplakat drejt kibles dhe duke thënë “**Allahu ekber**”, shprehje që na bën të harrojmë gjithçka që është pas nesh. Para nesh tani kemi Allahun e Madh, më të madh se çdo gjë tjetër, se çdo gjë që kemi lënë pas dhe çdo gjë e dynjasë dhe preokupimet e tij, dy sy që me edukatë të lartë, përrshpirtshmëri dhe përgatitje të çuditshme vështrojnë në tokë; fillimi i namazit me lexim të tekstit që nga qielli në tokë e bartën engjëjt e mëdhenj dhe më të denjë, e dorëzuan amanet tek i Dërguari i fundit s.a.v.s.; aty përfshihet falënderimi më i bukur për Zotin e botëve, sepse është Mëshirëplotë dhe i Gjithëmëshirshëm, para Tij përkulemi dhe dorëzohemi, sepse në duart e Tij do të jetë çështja e Ditës së

Kiametit, Ditës së Gjykimit (**maliki jevmi'd-din**), e që pastaj të konfirmojmë adhurimin absolut për Atë (*Ijjake na'budu*), para se të fillojmë të kërkojmë mëshirën e Tij dhe ndihmën e Tij (**ve ijake neste'in**).

Lexojmë deklaratën e dorëzimit dhe nënshtrimit për Zotin e botëve; leximin e teksteve që vetë i zgjedhim nga Kurani famëlartë; amaneti i shenjtë e famëlartë, që na bën të jemi edhe më afër Allahut, më shpirtpastër dhe ndjenja të ngrohta pranë Tij, me besim se përgjigja e Tij është shumë afër.

Pastaj përkulemi 90 shkallë, pohojmë dorëzimin dhe nënshtrimin tonë, duke shiqiptuar shprehjet e madhërimit dhe lartësisimit, që përsëri të ngrihemi duke falënderuar dhe treguar mirënjohës, përgatitje për zbritjen në tokë dhe pluhurosjen e ballit dhe dheun e tokës, aty shqiptojmë shprehjet e pastërtisë hyjnore dhe madhështisë së Tij.

Më vonë, pasi kemi përsëritur këtë disa herë, vijon ulja e fundit, ku veten tonë e vëmë para Allahut, të qetë e të dorëzuar, i drejtohem me përshëndetjet dhe bekimet më të bukura, përshëndesim të Dërguarin e Tij të ndershëm, përshëndesim vetveten dhe gjithë robërit e Allahut të mirë, që përfundimi ynë të jetë me pohim të njëshmërisë së Tij dhe peygamberisë së të Dërguarit të Tij: **“eshhedu en la ilahe il-lallahu ve eshedu enne Muhammeden abduhu ve resuluhu”**. Gjatë kësaj nuk harrojmë të përshëndesim edhe babanë e tij dhe babanë tonë, Ibrahimin alejhis-selam, që të dytë bartën misionin e shenjtë dhe këtë sekret madhështor që na e hapi lidhjen me Zotin e botëve, që pastaj të përfundojmë takimin tonë me dy përshëndetje, duke kthyer fytyrën në të djathtë e në të majtë. Lutjet tona pëshpëriten në këtë ulje të qetë e të mrekullueshme, ulje që shëmbëllen me uljen e robit para mbretit, siç thonë disa nga të parët tanë.

A thua e njohëm madhështinë e kësaj ulje dhe vlerën e saj në këtë botë dhe në botën tjetër?

*"...shndërrojini shtëpitë tuaja në kible (faltore) dhe falni namazin. Dhe sillu lajmin e mirë besimtarëve!" (Junus, 87)*

*"Vërtet që njeriu është krijuar i paqëndrueshëm: kur atë e godet e keqja, ai ligështohet fort, por kur i bie e mira, ai bëhet koprrac. Përjashtim bëjnë ata që falen." (El-Mearixh, 19-22)*

Transmeton Ibn Abasi r.a. dhe thotë se duke qenë në udhëtim i erdhi lajmi për vdekjen e vëllait të tij. Ai menjëherë tha: *"Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi"* - pastaj u largua nga rruga dhe fali dy rekat dhe gjatë kohë qëndroi ulur, pastaj u ngrit dhe tha: *"..ndihmohuni me durim dhe namaz"*.

*"Kur thërret ezani për namaz, hapen dyert e qiellit dhe pranohet lutja." (Ibn Kethiri)*

## Pjesa 2

### Namazi na riprogramon

Valët e mëdha të detit gërryejnë shkëmbinjtë e bregut gjatë tërë kohës. Njëjtë vepron me ne jeta e përditshme. Koha, spontaniteti, adaptimi, zakonshmëria, përsëritja, të gjitha janë veprim i gërryerjes në shkëmbinj, ato gërryejnë atë që namazi e ka realizuar në ne: fuqinë, baraspeshën, pastërtinë e ndyrësirave të jetës së përditshme etj. Këto elemente të kësaj bote përpiqen që me valët e tyre të njëpasnjëshme të na programojnë sipas planit të pasioneve të tyre, kohë pas kohe, ditë pas dite, vit pas viti, deri sa të vijë koha kur ne nuk do të ndiejmë se me kohë kemi ndryshuar, nga ne është larguar ekzemplari origjinal i programit hyjnor i caktuar për ne. Ai "disku dritëdhënës" që nuk ka asnjë "virus" ndodh ta gabojë drejtimin e programit origjinal e të shkojë larg origjinës qiellore.

Falë Allahut, ne edhe më tej e ruajmë ekzemplar origjinal të këtij "disku dritëdhënës", që programon besimin tonë, që të mund të kthehemi tek ai dhe ta riprogramojmë

vetveten për t'i hequr viruset që kanë depërtuar, sëmundjet e devijimet.

Ai është ekzemplari që për ne e ka ruajtur deri tani programin e Kuranit famëlartë, Librin që kurrë nuk pëson ndryshim e as shtrembërim, as shtesë e as mungesë. Ne jemi Umet i dalluar në tokë, Libri ynë është i ruajtur me transmetim origjinal, shkronjë për shkronje, me anë të disa burimeve autentike dhe transmetuesve besnik. Ky program i quajtur namaz është programi profetik, me fjalë dhe vepër, sepse ai s.a.v.s. na e tregon të vërtetën e tij me katër fjalë: *"Faluni ashtu siç më shihni mua duke u falur."* (Albani thotë se hadithi është sahih, *Sahih el-Xhami'*)

Ç'mendon, sikur të mos ishte namazi, a do të ishte e mundur të shpiknim namaz që do të na lidhte me Allahun e Madhërishëm? E ç'mendoni, në çfarë forme do ta paramendonim atë namaz të shpikur nga njeriu?

Sikur të hulumtoni në Tevrat dhe Inxhil, siç janë sot, kurrë nuk do të mund të gjeni ndonjë provë që flet për namazin e Musait apo për namazin e Isait a.s., ashtu që pasuesit e tyre të mund të faleshin si ata. Por, këta pasues shpikën nga vetvetja namaz që edhe sot e kësaj dite e bëjnë, të trashëguar nga gjyshërit e tyre. Por, asnjëri prej tyre nuk mund të kënaqet me pretendimin se është namazi që e ka bërë vetë Musai apo Isai, për një shkak të thjeshtë: se në Tevrat dhe në Inxhil nuk ekziston ndonjë përkrahim i namazit që e kanë bërë këta dy të dërguar të respektuar.

Shumë herë vërej se si disa muslimanë zemërohen mes vete për shkak të mospajtimeve rreth detajeve të vogla në namaz: a t'i ngremë duart në çdo tekbiir apo vetëm në tekbiirin fillestarë? Ku t'i vëmë duart në namaz: lart apo poshtë barkut? Pak më lartë? Pak më poshtë? Hollësi tjera që çojnë në ngatërresa të panevojshme dhe zemërimet e pavlera. A

më besoni nëse ju them se unë kënaqem kur shoh apo dëgjoj për këto mospajtime?

Neve na ka ardhur pasqyra e plotë e namazit të të Dërguarit tonë s.a.v.s., me të gjitha detajet e vogla, gjë e cila na bënë të jemi të lumtur. O Zot, i Dërguar fisnik e besnik është ky, që pati kujdes të plotë që pasuesit e tij t'i udhëzojë drejt këtyre detajeve të vogla që shpjegojnë hartën dhe artin më të rëndësishëm dhe më të ndërlikuar, mjetin fluturues në historinë e njeriut, me të cilin do të mund të ngritën lart në shtresat e hapësirës së lartë, aty ku është Allahu!!

A e kuptoni vlerën që para nesh të kemi fotografinë e plotë e të detajizuar të namazit? A nuk është mrekulli se të gjitha drejtimet juridike pajtohen unanimitisht për detajet edhe më të vogla të tij? Pjesëtarët e religjioneve të tjera kurrë nuk do të mund të sillnin detaje nga librat e tyre të shenjtë formën e faljes së profetëve të tyre, të falen ashtu siç janë falur ata!

Kjo është vlera e namazit tonë, me të gjitha ritet dhe tekstet. Ai është ekzemplar origjinal i programit të përsosur hyjnor, i sistemuar, efikas, kohëshkurtë, riprogramues i njeriut pesë herë në ditë, është përsëritje që mjafton për eliminimin e të gjitha viruseve që kanë depërtuar në programin e jetës sonë gjatë natës dhe ditës, na pajis me mur mbrojtës që pengon viruset e devijimit, që nuk pushojnë të na largojnë nga vetvetja dhe nga natyra jonë Hyjnore. Ky program origjinal fik zjarret e mëdha që kanë përfshirë malet e gjynaheve dhe brengave që ndodhen në çdo cep të jetës sonë të përditshme dhe dëmtojnë rëndë qetësinë dhe rehatinë tonë shpirtërore.

*“Digjeni e digjeni, e kur e falni namazin e sabahut, ai e pastron (shpirtin); pastaj digjeni e digjeni, e kur e falni namazin e drekës, ai e pastron; pastaj digjeni e digjeni, e kur e falni namazin e ikindisë, ai e pastron; pastaj digjeni e digjeni, e kur e falni nama-*

*zin e akshamit, ai e pastron; pastaj digjeni e digjeni, e kur e falni namazin e jacisë, ai e pastron; pastaj flini dhe nuk ju shkruhet asgjë, deri sa të zgjoheni.”* (Albani thotë hadithi është në “Sahih et-Tergib”)

Një mjeke e re japoneze më pyeti: a është e vërtetë se muslimanët falen pesë herë në ditë? Po, i thashë. E si mund ta bëjnë këtë, më tha ajo? A nuk është shumë kjo? I thashë: ti je mjeke, gjatë ditës ballafaqohesh me pranim të shumë pacientëve, a thua sa herë në ditë i pastron duart e tua? Tha: tridhjetë...pesëdhjetë....ajo më shikoi në sy dhe vërejti se unë pashë se çfarë dëshironte të thoshte.....!

Jeta përreth nesh është e mbushur plot me viruse, me joshje dhe dobësi njerëzore, devijime dhe tendenca djallëzore, pastrimi i tyre nuk bëhet me ujë, por me namaz. Uji është mjet që pastron trupin tonë, kurse namazi mjet që pastron brendinë tonë.

Po ç'bëhet nëse nga namazi dalim ashtu siç kemi hyrë, e nuk kemi ndier fare ndryshim të ndonjë gjëje në veten tonë? Se nuk jemi pastruar nga njollat e gjynaheve, nuk jemi pastruar nga viruset që vazhdimisht veprojnë për të na larguar nga rruga e drejtë? Apo nuk kemi ndier sikur të kishim lindur për së dyti?! Kjo nënkupton se nuk është vënë në funksion ekzemplari i “riprogramimit” që përdoret në namaz në formë të duhur. Këtë e provon prezenca e mëtutjeshme të viruseve dhe njollave në thellësi të shpirtit! Njeriu do të del nga namazi i tij ashtu siç ka hyrë në fillim, që përsëri të kthehet aty ku ishte, i dobët, i devijuar dhe i humbur.

Të gjitha adhurimet në thelb ngërthejnë “riprogramimin” e njeriut, kuptohet çdonjëra sipas rolit, kohës dhe specifikeve të veta që i ka.

Agjërimi është plan që merr kohë të gjatë për të zbritur në kompjuterin e shpirtit tonë, ai ka edhe efikasitetin e tij të gjatë. Nevojitet një muaj për zbritjen e tij, por efikasiteti i tij

zgjat një vit të plotë, ai riprogramon pasionet tona që kanë rënduar viruset gjatë tërë vitit të kaluar, riprogramon shikimin tonë para ngacmimeve djallëzore, e që me vite e ka dobësuar djalli, ai riprogramon gjuhën tonë, që me muaj të tërë është ngatërruar me fjalë të këqija, riprogramon shpirtin tonë, ku gjatë tërë vitit kanë depërtuar forma të ndryshme të sëmundjeve djallëzore që gati se nuk i kanë mbytur në ne farat e mëshirës, të vërtetës, të drejtës, mendimit të mirë, kënaqësisë, bindjes, durimit, mirësisë, falënderimit, ëmbëlsisë së besimit dhe fjalëve të mira.

Ky është edhe roli i haxhit, por më afatgjatë dhe më të shtrirë e më të thellë. Haxhi i pranuar shpërblim ka vetëm **Xhenetin**, atij që Allahu ia pranon haxhin, ai kthehet sikur ditën që nëna e ka **lindur**, siç premtan i Dërguari s.a.v.s. Qëndrimi para Shtëpisë së Allahut, qëndrimi në Arefat, kryerja e riteve të caktuara, janë gjëra që tërë jetën të shoqërojnë, nëse të shkon mendja për gjynah, haxhi të kujton e të thotë: “Çfarë po bën o filan, a e di se ke bërë haxhin?!” E nëse të godet ndonjë plogështi e dobësi e kësaj bote, haxhi të thërret me zë të lartë në brendinë tënde: “Mbahu! Ti ke qëndruara para Shtëpisë së Allahut, në Arefat, duke kërkuar falje, duke u penduar dhe kërkuar kthim tek Zoti i kësaj shtëpie, Sunduesit të këtij vendqëndrimi të madhërisëm.”

Dallim i vetëm midis namazit dhe këtyre dy adhurimeve është se namazi vlen vetëm për të zotin që e falë, ai nuk kalon tek tjetri, vlen vetëm në kohë të caktuar, nuk mundemi ta falim kur të duam ne: “Vërtet namazi është detyrë për besimtarët në kohë të caktuar.” (En-Nisa’, 103)

Atij që i kalon një ditë e agjërimit të muajit Ramazan, e kompenson me një ditë tjetër të vitit, ndoshta e paguan me *fidje*, ushqim për fukaratë; ai që nuk mund ta bëjë haxhin, cakton dikë që në vend të tij ta bëjë atë. Është e thënë se bijtë e bëjnë haxhin për prindërit e tyre pas vdekjes, kurse

namazin e kryen vetëm i zoti i tij e askush tjetër, në kohë të caktuar, përndryshe humbet përgjithmonë.

Kjo është veçoria e namazit, sekreti i përsëritjes së tij pesë herë në ditë dhe në kohë të afërt njëra me tjetrën. Namazi na mundëson të ngrihemi lart, të kalojmë horizontet e dynjasë, në çastet që kalojnë në jetën tonë, ai kthen baraspeshën e plotë në vetëdijen tonë, kurse dynjanë na e tregon gjithmonë në formën e saj të vërtetë, të vogël në sytë e tanë, me të gjitha gjërat e saj; armiqësitë, luftërat, komplotet, urrejtjet, garën për pasuri, famë, post dhe fitim të shpejtë, bile namazi nënkupton armën më efikase mbrojtëse që ka besimtari në dorë, që me të të ndihmohet për t'u ballafaquar me ndodhitë e njëpasnjëshme që i ndodhin në jetë, me bindje të plotë dhe i paluhatur, me besim të thellë në ajetin kur'anor: *"Kërkoni ndihmën e Allahut me durim e me namaz"*.

Që këtej kuptojmë rëndësinë e përsëritjes së namazi pesë herë në ditë, sidomos kur kemi parasysh sulmet e djallit që ndodhin për çdo ditë dhe pandërprerë: së pari e falim sabahun, pastaj presim deri në mes të ditës, kohë e gjatë, por të preokupuar me punët e ditës, pastaj falim ikindinë, pak më afër se që kemi pritur prej sabahut deri në drekë, pastaj shumë shpejt vjen koha e akshamit dhe nuk kalon një orë e çerek dhe falim namazin e jacisë dhe bëhemi gati për në shtrat.

Sikur të krahasonim jetën e atij që falet dhe atij që nuk falet, do të ndienim dhembshuri për atë që nuk falet, për atë se ka humbur armën mbrojtëse të rëndësishme me të cilën ndihmohet në çdo çast të jetës, brenga e shqetësime me të cilat ballafaqohet çdo ditë, e ato janë shumë. Jeta e atij që falet është ndryshe, fytyra e tij ndriçon pothuajse tërë ditën, çfarëdo që të ndodh para tij, sytë e tij janë të mbushura plot mëshirë, modesti, butësi e tolerancë, sado që sprovat të marrin hov. Fytyrat e njerëzve përreth na shfaqin qartë ata që falen dhe ata që nuk falen, sytë e atyre që falen janë përherë

të mbushura me mëshirë, atë që Kur'ani famëlartë e përshkruan si "shenjë" e sexhdes që shfaqet në fytyrën e atyre që falen. Kjo nuk nënkupton shenjën e zezë që disa e kanë në ballin e tyre, siç e kuptojnë disa, është shenjë në fytyrë, e jo në ballë.

*"I sheh ata si përkulen dhe bien në sexhde, duke kërkuar dhuntinë dhe kënaqësinë e Allahut. Në fytyrat e tyre shihen shenjat e sexhdes."* (El-Fet'h, 29)

Shenjë që vetëm ata që falen e meritojnë dhe fitojnë.

### Pjesa 3

#### Zgjimi për namaz

*"Falënderimi i takon Allahut që na ngjalli pasi ishim të vdekur dhe tek Ai është kthimi."* (Buhariu)

Kështu na mësoi i Dërguari s.a.v.s. të themi kur zgjohemi në mëngjes dhe fillojmë ditën e re, kthim i përkohshëm në jetë pas vdekjes së përkohshme, siç pohon Kurani famëlartë: *"Allahu ua merr shpirtat atyre që u ka ardhur çasti i vdekjes dhe atyre që nuk kanë vdekur, por që janë në gjumë. Pastaj, Ai ndal shpirtin e atij që i është caktuar vdekja, ndërsa të tjerëve ua lë deri në një kohë të caktuar."* (Ez-Zumer, 42)

Që të rikthesh vijën e qetë shpirtërore që të lidhë me Allahun, e që u zgjove për jetë të re, përpiqu ta ruash natyrën e tij origjinale, të shëndoshë, të qetë e plot shpirt, mos e ndot atë me gjëra dynjaje, mos e dëmto hapësirën e tij ndriçuese me të rejat teknologjike që të zgjojnë në mëngjes. Qëndron larg telefonave dhe zileve shqetësuese, sepse nuk përputhen me origjinalitetin e namazit, qetësinë shpirtërore që bëhet gati që pas disa minutave të pret anijen me të cilën do të kalojë në botën e dritës. Zëri shqetësues nuk krijon këtë ambient shpirtëror të qetë e plot dritë, sepse krijon lëvizje të papërshtatshme me namazin dhe qëllimin e tij:

*“Kur bëheni gati për namaz (pra kur thërret ikameti), mos shkoni duke vrapuar, por shkoni duke ecur (qetë) e që ju ka kapluar qetësia (e lartë shpirtërore), atë që e arrini faleni, e ajo që ju kalon, plotësojeni.”* (Buhariu)

*“Derisa faleshim me të Dërguarin s.a.v.s., u dëgjua një zhurmë e burrave, e kur u fal, tha: “Ç’keni? Thanë: “Shpejtuam për namaz.” Ai tha: “Mos bëni kështu, kur të shkoni për namaz, le t’ju kaplojë qetësia (ecni të qetë), atë që e arrini faleni, e ajo që ju kalon, plotësojeni.”* (Buhariu)

Ora mendore është ajo që na zgjon në mëngjes në kohë të caktuar, sado që dita e nata të jenë të gjata apo të shkurt-ra. Përpiqu të përfitosh nga drita e mëngjesit, fijet e dritës le të depërtojnë në sytë e tu e të zgjojnë nëse të kaplon gjumi.

Ndërkaq, djalli është në pritje të atyre që nuk zgjohen për namaz të sabahut, për ata që namazi nuk është plan i pandashëm ditor, në shtratin e tyre ka mijëra fije që i forcojnë për shtratin dhe nuk i lënë të zgjohen! A thua se do të përgatiten me armë të forta për t’i rezistuar litarëve të fortë që i pengojnë nga ky takim i veçantë dhe i dalluar e i hershëm me Allahun, në këtë kohë të çmuar e të freskët të jetës sonë?! Pse shumë njerëz nuk ia vënë veshin kësaj?

Ai që ka shijuar zgjimin me agimin e mëngjesit, e pastaj daljen nga shtëpia me fijet e para të tij për të shkuar në xhami, e pastaj daljen nga xhamia para lindjes së diellit dhe fillimin e punës ditore, vetëm këta njerëz janë që e dinë vlerën e zgjimit herët, vlerën e thithjes së frymës së mëngjesit të paprekur, kënaqësinë me qetësinë e mëngjesit të hershëm dhe afërsinë me Allahun, jo vetëm në namazin e sabahut, por para çdo namazi dhe pas çdo namazi. Dy apo tre orë pune në këtë kohë të mëngjesit janë baras me orë të tëra të punës gjatë ditës. E si të mos jetë kështu, kur i Dërguari s.a.v.s. i lutej Zotit të tij për ne me këtë lutje të bekuar: *“Allahu im, bekoje Umetin tim në mëngjesin e hershëm.”* (Tirmidhiu)

Është djalli ai që qëndron midis teje dhe zgjimit herët, por nëse ditën e parë i reziston dhe e mund, ditëve tjera do të jetë më lehtë; do të zotohesh se do t'i përmbahesh zgjimit herët, premtim i dhënë nga vetja jote, edhe pse ditët e para të duken sikur ato të parat të muajit të agjërimit, që pas disa ditëve marrin formën e lehtësimit dhe adaptimit fizik, pjesë e pandashme kënaqësie e planit ditor.

Ndonjëherë i hapim sytë dhe ende jemi në shtrat, ja djalli vjen dhe shtrëngon kokën për jastëkun, të thotë: "Mbylli sytë miku im, vazhdo të flesh, mos e dëmto veten në këtë kohë, mos ia humb vetes këtë orë të këndshme të gjumit, është koha më e ëmbël për të pushuar dhe gjumit të thellë, pse po shpejton?"

Është bisedë e djallit që vazhdimisht përsëritet, e si do të arrish t'i mposhtësh cytjet dhe ngasjet e tij? Këtë e shpjegon i Dërguari s.a.v.s. që përpiqet të të ndihmojë ta tejkalosh këtë gjendje dhe ta mbizotërosh atë: "*Djalli lidh tri nyje tek koka e ndonjërit që fle, secilën nyje e vulos me vulë: - është natë e gjatë për ty, shtrihu e fli; e nëse dikush zgjohet dhe e përmend Allahun, njëra nyje zgjidhet; nëse merr abdest, përsëri njëra nyje zgjidhet dhe kur falet, zgjidhen të gjitha nyjet, atëherë gdhiesh shpirtfreskët, e nëse jo - nëse nuk ngrihesh për namaz - zgjohesh shpirtfëlliqur (padisponuar), përtac.*" (Buhariu)

Koncentrohu me mua në fjalitë e fundit të hadithit: "*...zgjidhen të gjitha nyjet, atëherë gdhiesh shpirtfreskët, e nëse jo - nëse nuk ngrihesh për namaz - zgjohesh shpirtfëlliqur (padisponuar), përtac.*" - a nuk e vëren dallimin midis atij që fiton freskinë e zgjimit për namaz të sabahut dhe, tërë ditën është shpirt-freskët, aktiv, i buzëqeshur, i lumtur dhe atij që ka humb namazin e sabahut dhe ka vazhduar gjumin, kurse tërë ditën është shpirtfëlliqur, thuajse çdo gjë urren dhe çdo gjë e urren atë, bile edhe shpirti dhe gjymtyrët e tij nuk janë me të?

Mos thuaj pra: “Nuk mundem të punoj e të mendoj, bile as të bëj diçka tjetër që dua nëse nuk ngopem me gjumë.” Zgjimi herët në mëngjes na tregon se kemi fituar ditën, e nëse jo atëherë e kemi humbu tërë atë ditë. Natyra zbardhi ditën tënde, kështu e programoi Krijuesi i saj për ne dhe Krijuesi ynë, të gjitha mrekullitë e jetës përreth teje fillojnë me fijen e parë të mëngjesit, jo për të bërë gjumë, por për të punuar dhe rregulluar jetën dhe tokën, mos e përbuz këtë begati të Zotit, mos e nënvlerëso atë, mos i nënçmo fuqitë që Allahu i nënshtroi për ne, e as krijesat përreth nesh që fillojnë jetën me ditën e tyre të re. A nuk i shikon shpezët që me agimin e mëngjesit ato fluturojnë në qiell? Po lopët, delet, pulat, të gjitha që Allahu i krijoi në tokë, e që zgjohen herët në mëngjes dhe punojnë pandërprerë, që fillojnë ditën e tyre të re në këtë tokë?

#### Pjesa 4

### Namazi menaxhon jetën tonë të përditshme

Kur isha i vogël më dukej se për namaz të sabahut zgjohesha në mesnatë! Kështu më dukej mua dhe, gjithnjë pyetja veten: pse zgjohem në këtë pjesë të natës?! A nuk është e vërtetë se Allahu dëshiron nga ne që të falim pesë kohë të namazit, pse pra kërkon nga ne që të zgjohemi në kohën më të këndshme të gjumit, e të falemi?! Pse nuk e falim atë në ora shtatë apo tetë, e pse jo në ora dhjetë të mëngjesit? A nuk është edhe ky namaz? A nuk është i njëjtë lexim, sikur në mëngjes herët ashtu edhe në ora dhjetë të ditës? Nëse namazi është për të na ruajtur lidhjen tonë me Allahun dhe për ta larguar djallin larg nga ne, atëherë çfarë roli ka djalli për ne kur jemi në gjumë? Pse frikohemi të humbim lidhjen tonë me Allahun e të rrokullisemi në rretjen e djallit, kur

jemi në gjumë dhe të paaftë për të menduar për çfarëdo lidhje e zgjidhje?

Këto pyetje i parashtrojnë edhe të mëdhenjtë, jo vetëm të vegjlit, por të mëdhenjtë do ta kuptojnë në fund se namazi nuk është vetëm veprim i lidhjes së përhershme me Allahun, por edhe program i jetës.

A thua kohët e punës na i rregullojnë kohët e namazit, apo ndodh e kundërta; kohët e namazit janë struktura (korniza) e përgjithshme e cila rregullon, drejton dhe ndan kohët e punës sonë?

Kohët e namazit janë ndarë dhe rregulluar në mënyrë që të jenë bosht kryesor (elementar) i rregullimit të planit tonë ditor dhe jetës së përditshme, tamam sikur që muaji i Ramazanit rregullon planin tonë vjetor, si në aspektin material ashtu edhe në atë shpirtëror.

Këto kohë nuk janë të caktuar për mua nga ana e drejtorit të zyrës, kryetarit të vendit, ndonjë eksperti shoqëror, ekonomik, politik e psikologjik, ato i ka caktuar i Gjithëdijshmi, Mbisunduesi, Mbikëqyrësi im, Allahu i Lartmadhërishtëm. Është Allahu që ka caktuar kohët e namazit, e askush tjetër, pesë herë në ditë të takohem me Atë dhe të ulem pranë Tij, e sikur të falem në kohë tjetër, më bëhet sikur kam ndryshuar takimin tim me Allahun, sikur kam ardhur në kohë tjetër, jo në kohën kur Ai deshi! Si do të ishte çështja nëse kështu do të vepronim me shokun tonë? E si do të ishte me Allahun? Allahu na ruajt, përveçse kur na kaplon ndonjë gjumë i thellë ose harrojmë, vetëm atëherë mund të ndryshojmë kohën e takimit me Allahun, sepse i Dërguari s.a.v.s. thotë: *“Kush e harron namazin ose fle, atëherë shpagim i tij është që ta falë kur t’i kujtohet.”* (Muslimi)

Midis kohëve të namazit na ndodh të kemi shumë obligime tjera jetësore që duhet t’i kryejmë, e si do të bëjmë përputhjen midis punëve tona dhe kohëve të namazit? Po si

është e mundur që namazi të na ndihmojë në planifikimin e planit të punëve tona ditore?

Më duhet të them se për shumë njerëz televizori sot është bërë planifikues kryesor dhe i vërtetë i planit të jetës së përditshme. Ka njerëz që tërë natën e kalojnë pranë televizorit, duke i shikuar programet e natës, sepse ditën është i zënë.

Sa prej nesh janë që në Ramazan qëndrojnë deri në syfyr, duke përcjellë programet joshëse të natës, e që për fat të keq janë programe dhe emisione që nga viti në vit sa rriten dhe përsosen, që muaji i Ramazanit të shndërrohet në muaj tjetër! Allahu deshi që muaji i Ramazanit të jetë muaj i adhurimit, dhikrit, tesbihut, i'tikafit, por ne e shndërrojmë atë në muaj ushqimi, softe plot ushqime dhe harxhime të tepërta, pazar vjetor i kanaleve satelitore, emisioneve që dëshirojnë ta zhveshin Ramazanin nga kuptimi i tij i vërtetë e ta shndërrojnë në muaj dynjaje, në dëfrim, lojë e zbavitje si në asnjë muaj tjetër!

Koha moderne shënon ndërrim konceptesh dhe kështu humbim Ramazanin dhe prej tij fitojmë vetëm urinë, etjen, gjumin ditën dhe pamundësinë për të bërë punë tjera, gjë për të cilën na paralajmëroi i Dërguari s.a.v.s.: *“Mjerë për agjëruesin që nga agjërimi i tij merr vetëm urinë e etjen...”* (Albani thotë se hadithi është sahih)

Si të arrijmë që nga djalli televizor të rikthejmë ekzemplarin origjinal të programit të vjedhur të jetës sonë të përditshme, pasi ka arritur të ndryshojë programin tonë e ta shtrembërojë, të na bëjë robër të orarit kohor të emisioneve të tij dhe programeve joshëse, në Ramazan dhe jashtë Ramazanit?

Kur'ani famëlartë na flet për gjurmët e djallit që dalëngadalë depërton në jetën tonë. Ai thotë: *“O njerëz! Ushqehuni me të gjitha ato gjëra të lejuara e të mira që gjenden në Tokë dhe mos ndiqni gjurmët e djallit, sepse ai njëmend është armiku juaj i hapur.”* (El-Bekare, 168)

*“Kush ndjek gjurmët e djallit, do të nxitet nga ai të bëjë vepra të këqija e të shëmtuara.”* (En-Nur, 21)

Djali nuk hynë në ne përnjëherë, janë gjurmët e tij që dalëngadalë e çojnë njeriun drejt gjynahut dhe devijimit. Prandaj, pse nuk rezistojmë djallin me taktikat e tij e ta largojmë atë dalëngadalë, hap pas hapi?

Së pari, para nesh kemi aktin (veprimin) e shpërbërjes (shpërthimit) dhe kthimit të konstruksionit (montimit) të njësisve të posaçme kohore me namazin e sabahut. Është sekreti Hyjnor që nuk e dimë, ose ndoshta një pjesë të saj e dimë, por tjetrën jo, që na tërheq nga shtrati ynë në kohën më të ëmbël dhe më të këndshëm të gjumit tonë për ta falë namazin. Mjekët dhe shkencëtarët janë ata që mund të na ndihmojnë të kuptojnë disa nga këto urtësi e fshehtësi, të kuptojmë diçka nga urtësia Hyjnore që për ne ka zgjedhur këtë kohë të hershme të namazit, që shumë religjione tjera i ka bërë të na shohin me çudi, e ndoshta edhe me dhembshuri, që kemi zgjedhur këtë fe “të vështirë” që zgjon njerëzit në mes të natës për t’u falur, për të ngrënë syfyer e ta përmendin Allahun!

Përpiquni t’i vëzhgoni fytyrat e atyre që flenë në pjesën e parë të natës, me qëllim që të zgjohen herët në mëngjes dhe, krahasoni me fytyrat e atyre që deri në mëngjes nuk flenë, e pastaj nuk falin namazin e sabahut. Vetëm kjo na bënë të kuptojmë disa urtësi e sekrete të kësaj përbërje të çuditshme të quajtur “njeri”, që Krijuesi i tij e krijoi me rregullin fiziologjik që thotë: “Koha më e mirë e fillimit të punës së kësaj përbërje pas gjumit është koha para lindjes së diellit, e jo pas tij. Ky është projekti i kësaj përbërje që vjen nga Krijuesi i Urtë. Ne duhet të veprojmë me këtë përbërje, ashtu siç na e ka dorëzuar Krijuesi i tij, e jo siç duam ne, e as të ndryshojmë plan-programin e veprimit të tij. Është plan-program që përputhet me natyrën e përbërjes sonë

njerëzore. Ajo që kemi ndryshuar është programi, e jo përbërja, program që e kemi zëvendësuar me programin Hyjnor që për ne nënkupton kthimin e veçorive njerëzore, garanci e shëndetit, sigurisë dhe lumturisë sonë.

Cila pra është rruga e pajtimit midis këtyre dy programeve të kundërta?

Të themi se koha e namazit të sabahut tani është midis orës katër dhe pesë të mëngjesit. A thua se mundemi të zgjohemi në këtë kohë pasi të kemi kaluar natën duke shikuar ndonjë film deri në mesnatë e më shumë? Natyrisht se jo. Edhe nëse e detyrojmë veten të zgjohemi në kohë të caktuar, ku mbetet përsëritshmëria e namazit, ku mbetet vetëdija për fjalët që do t'i themi në namaz, sytë e tanë do të mbyllën nga lodhja, atë do ta bëjmë me shumë vështirësi! Po edhe nëse arrijmë ta mposhtim gjumin dhe mbylljen e syve me të gjitha forcat që i kemi e të përpiqemi ta detyrojmë veten për ta falë namazin sipas të gjitha rregullave të caktuara, me siguri se përsëri do të shndërrohet nga "e drejtë" në "detyrë", d.m.th. do të jetë detyrë e rëndë kësaj here. Është e natyrshme që pas faljes së namazit të kthehemi me shpejtësi në shtrat për ta plotësuar gjumin, edhe përkundër asaj se i Dërguari s.a.v.s. na paralajmëroi me shumë sinqeritet nga pasojat e gjumit pas sabahut, ai thotë: "*Gjumi pas namazit të sabahut e pengon furnizimin (riskun).*" (Sujuti)

Doemos të ndërmarim hapat e para të evakuimit (tërheqjes) për shpëtim nga litarët e djallit, të shpëtojmë nga robërimi i sëmundjes shoqërore të përhapur në mesin tonë: ahengu i natës!

Është dallim i madh midis programit tonë sot dhe programit pejgamberik që nuk njih atë që ne bëjmë sot, ahengje vrasëse.

*"I Dërguari s.a.v.s. na qortoi ta kalojmë natën në bisedë pas namazit të jacisë."* (Albani thotë se hadithi është sahih)

*“I Dërguari s.a.v.s. ndaloi gjumin para namazit të jacisë dhe bisedën pas namazit të jacisë.” (Busiri)*

Sot vërejmë që njerëzit janë vënë të gjithë në shërbim të sistemit televiziv dhe programit të tij, flejnë atëherë kur televizori fle, e zgjohen kur ai zgjohet, edhe pse ai nuk fle e nuk zgjohet. Pse pra të mos kujdesemi për programin tonë fiziologjik që nuk përputhet fare me programin e televizorit? Pse nuk po arrijmë të njohim trupin dhe shpirtin tonë, që të shpëtojmë nga gremina që kemi ra, të ecim kundër rrymës që na morri natyrën njerëzore dhe na e humbi nga qëllimi i tij?

A keni provuar ndonjëherë në jetë, që së paku të ndjeni kënaqësinë e të ecurit kundër rrymës? Sa bukur është që njeriu të notojë në pishinë të madh i vetëm, ky not i këndshëm, i ëmbël, nxitës e tërheqës nuk është kështu nëse notojmë në një lum të shpejtë dhe i rezistojmë dallgëve të tij. Kështu ndodh me atë që reziston i vetëm rrymës së furishme të plan-programit të jetës sonë sot, veçmas kur e di se është fitues i vetëm midis humbësve, atyre që notojnë siç rrjedh lumi.

A e dini se shumë mendimtarë dhe profesorë universitar në Perëndim nuk lejojnë që në shtëpitë e tyre të hyjë televizori?! Provë e tyre për këtë vendim janë dy shkaqe kryesore:

1 - Televizori të jep të pish nga një gllënjë të mendimit të tij me anë të metodave joshëse që nuk rezistohen. Ato i derdh në kokën tënde, duke mos të lejuar t’i korrigjosh ato, t’i kundërshtosh apo diskutosh? Dëgjo, shiko, prano, hesht dhe kaq!

2 - Televizori të imponon kohën e tij. Ai planifikon programin e jetës tënde të përditshme në mënyrën që ai e do dhe i përshtatet, pa marrë parasysh mënyrën tënde që ti e do dhe të përshtatet.

Do të marrësh aq sa ke dhënë dhe do të gjesh aq sa ke kërkuar plotësimin e kërkesës. Llogaritë bankare janë të hapura, fondet kërkojnë rritjen e tyre, mos u trego koprrac, sepse ose janë në dobinë tënde, ose në dëmin tënd. Mos harro se nata është depoja e shumë shpërblimeve që përpiqemi t'i sigurojmë, andaj qëndro pagjumë për t'i arritur ato, e jo për tjetër. I Dërguari s.a.v.s. thotë: *“Vërtet Allahu shtyn afatin e kohës deri në pjesën e tretë të natës, e kur kalon pjesa e tretë e natës Ai zbret në qiellin e dynjasë dhe thotë: “A ka kush kërkon falje, a ka kush kërkon pendim, a ka kush kërkon, a ka kush lutet... deri në agim të mëngjesit.”* (Muslimi)

*“Njëherë i Dërguari s.a.v.s. e vonoi namazin e jacisë deri në mesnatë, e pastaj doli, e pasi u fal, u drejtua kah ne me fytyrën e tij dhe tha: “Njerëzit janë falur dhe kanë rënë të flenë, ndërsa ju ende llogariteni të jeni në namaz deri sa e pritni atë.”* (Buhariu)

*“Nuk ka argëtim (bisedë nate) pas namazit të jacisë, përveç për dy njerëz: ai që falet dhe mysafiri.”* (Hejthemiu)

## Pjesa 5

### Kthimi i kornizës (strukturës) së plan-programit tonë ditor

Së pari duhet të lirohemi nga diktatura e televizorit dhe imponimit të programit të tij për ne, që pastaj të kalojmë në fazën e imponimit të programit tonë për televizorin dhe programit të jetës që e cakton për ne. Doemos të heqim dorë nga programi ynë i natës, qoftë televizori ose diçka tjetër, në fillim në ora njëmbëdhjetë, e pastaj me hapa të ngadalshëm, ora dhjetë e kështu me radhë, varësisht nga stinët e vitit, me qëllim që në namaz të sabahut të zgjohemi të freskët dhe të vetëdijshëm. Pas kësaj menjëherë duhet të realizojmë programin tonë të ri ditor, i cilësuar si hyjnor, shëndetësor, i shëndoshë dhe frytdhënës.

Programi i ri të hapet me dhikrin ditore dhe leximin e Kur'anit, që muajin e parë na marrin dhjetë minutë, që pastaj dalëngadalë të zgjatet, me qëllim që busulla e trurit tonë të mbajë mend lëvizjen e ndryshimit. Kështu ne fillojmë të zgjohe mi “të programuar” në brendi, sipas kohës së re që e kemi caktuar për veten tonë.

Muaji i Ramazanit, që është muaji i kthimit të programit të plotë të vitit të ardhshëm, është rasti më i mirë për t'i shfrytëzuar këto ndryshime. Kush na pengon që të zotohemi me Allahun se do të rrisim listën e punëve tona të mira, adhurimet dhe dhikrin tonë? Kush na pengon të zotohemi se në çdo Ramazan do të kemi një punë të re, e madhe goftë apo e vogël, se do të heqim dorë nga veprat e shëmtuara? Kështu hap pas hapi dhe vit pas viti të bëjmë çdoherë.

Programin tënd të ri mund ta fillosh me fillimin e muajit të ri të Ramazanit, si p.sh. të zotohesh se do të mësosh përmendësh çdo ditë nga një ajet kur'anor, pa marrë parasysh rrethanat dhe preokupimet e tua. Nëse mendon se kjo është shumë, atëherë le të jetë një ajet në javë (kjo do të thotë 52 ajete në vit!), ndërkohë mund të zotohesh se do të përmbahesh nga shikimi i palejuar, në rrugë dhe kudo tjetër. Nëse kjo të duket e rëndë, atëherë provo një herë në javë, pastaj dy herë, tre herë, deri sa të heqësh dorë krejtësisht nga gjynahu. Kështu vepro me çdo gjë të shëmtuar që e ke: përgojimi, gënjeshtria, mosrespekti i prindërve, i familjes, padrejtësia, egoizmi, vetëmohimi, sjellja e keqe me fqinjët, betimi i rrejshëm në shitblerje, joserioziteti, mendjemadhësia, mendimi i keq, fjalët e këqija, shkujdesi, përtacia etj.

Vetëm kështu do të mund t'ju kthehemi punëve tona duke qenë plot energji të re shpirtërore që e kemi fituar nga ndjenjat tona për fitimin ndaj kësaj sfide, me kënaqësinë e Krijuesit tonë për ne, që doemos ka reflektimin e tij, jo vetëm në shpirt, por edhe në gjymtyrët e trupit dhe procesin e

krijimtarisë sonë, konkretizohet në suksesin dhe arritjen tonë, me bindje dhe kënaqësi se çdo ditë do të realizojmë punë që na imponohen.

Si qëndron puna me namazet e ditës? Doemos që këto namaze t'i bëjmë boshte për renditjen e orarit të punëve tona ditore.

Namazi i drekës bie në mes të programit tonë, me këtë ai do të na jep sferë të rëndësishme dhe taktikë që do të mbështetemi në shpërndarjen e mëtutjeshme të orarit të punëve tona.

A të ka ndodhur ndonjëherë të montosh raftet e drurit për librat? Do të vëresh se konstruksioni i tij është i konstruktuar në mënyrë precize, secila pjesë ka mundësinë e përputhjes me pjesën tjetër, librat e tu arrijnë të vendosen në raftet e bukura dhe të marrin formën e përshtatshme.

Namazi i sabahut, në këtë "integrim" kohor që quhet "ditë", përbën majën e konstruksionit të qëndrueshëm, kurse namazi i jacisë përbënë bazën tokësore, ndërsa namazi i drekës është rafti i pathyeshëm që qëndron në mes të këtij konstruksioni (integrimi).

Që këtej ndodh edhe shpërndarja e "rafteve" të programit tonë ditor: punët para drekës dhe punët pas drekës, në mes tyre qëndron pika e boshtit kryesor: namazi i drekës.

Namazi i ikindisë në stinën e verës së gjatë mund të shndërrohet në program që rendit orarin e punëve tona në dy ose tri faza, ato para dhe pas namazit, siç është takimi me shokët, vizitat familjare, aktivitetet tona humane etj.

Nëse netët e gjata të dimrit na japin mundësinë e faljes së namazeve, veçmas ato të natës, le të jenë ditët e verës mundësi e punëve të mira dhe shërbimit të të tjerëve.

Namazet duhet të jenë konstruksioni ynë i përgjithshëm i programit tonë ditor, hyrje e suksesit tonë dhe të tjerëve. Pse të mos jetë kështu edhe abdesti i përsëritur disa

herë në ditë, stolitë e bukura me të cilat vishemi për të shkuar në xhami pesë herë në ditë? Janë të gjitha këto pra program që kujdeset për pastërtinë tonë, elegancën dhe rregullimin tonë gjatë tërë ditës.

*“O bijtë e Ademit, vishuni përshtatshëm kudo dhe kurdo që të faleni!”* (El-A’raf, 31)

Abdesti para çdo namazi dhe veshja e përshtatshme për çdo namaz nënkupton dukjen e bukur dhe pastërtinë edhe midis kohëve të namazit.

### *Ritmi i namazit dhe ritmi i jetës*

Në dimër kërkojmë ngrohje, kurse në verë kërkojmë të ftohtë, në sëmundje kërkojmë ilaç, në uri kërkojmë ushqim, në etje kërkojmë ujë, në zhurmë kërkojmë qetësi, në frikë kërkojmë siguri...

Jeta moderne është duke kaluar shpejt, bile më shpejtë seç mendojmë ne, sidomos në këtë kohë të elektronikës dhe mjeteve moderne. Sot duhet të na kujtohet se namazet tona janë mbështetje që na ruajnë nga rrota e jetës që bëhet gati të na shkelë dhe të na hajë me dhëmbët e saja të fortë nga hekuri. Natyrisht që rrota e namazit të jetë më e fortë dhe më e shpejtë se rrota e jetës.

Sikur ritmi i namazit të jetë i njëjtë me ritmin e jetës, me interval të shpejtë, e ndoshta edhe në formë çmendurie, s’ka dyshim se atëherë shndërrohet, siç ndodh me shumicën e njerëzve, në barrë të rëndë sikur që janë barrët e jetës së përditshme, që rëndon shpatullat tonë, kohën e humbur shtesë, mundin, lëvizjen dhe nervat; shpejtojmë ta kryejmë atë e të shpëtojmë sa më parë, bile ndodh që disa herë ta anulojmë tërësisht nga jeta jonë, siç ndodh me shumë muslimanë.

Kështu namazi kthehet për ne në “detyrë” mbi shpinë, pasi ishte dhunti e madhe e Allahut, që me ritmin e tij të butë e të këndshëm na nxjerr nga oqeani i jetës së trazuar e i çmendur.

E di se kjo nuk është e lehtë për ne në fillim... por si të ndalemi; mijëra punë, obligime, përgjegjësi, takime, programe, vizita, studim, analizë, vendime që na presin etj?!

Nëse është kjo rruga e vërtetë e të menduarit tonë kur përgatitemi për të fluturuar në hapësirën (kozmosin) e namazit, të dimë se kurrë nuk do të mundemi ta kalojmë as shtresën e jashtme të hapësirës së tij; avioni do të digjet para se të niset.

*“Kthehu e falu, sepse nuk je falë.”*, tha i Dërguari s.a.v.s.

Bazuar në këtë, është e natyrshme që namazet e ditës të falen pa zë, që falësi të lexojë me zë të ulët, që të përshtatet me ritmin e lartë të jetës që zhvillohet në këtë pjesë të zhurmshme të ditës: njerëzit flasin me zë të lartë, dielli bën vapë, lëvizjet e jetës shënojnë ritmin e tyre të lartë, rritja e intervalit të punës dhe aktivitetit, nxitja për fitime të mëdha dhe arritje këmbëngulëse materiale të shpejtë e përplasëse.

Ndryshe nga kjo është namazi i akshamit dhe jacisë, ku falësi lexon me zë, sikur nuk lejon të mbretërojë heshtja e natës, qetësia e plotë, errësira që ka kapluar çdo gjë etj. Leximi ynë në këtë kohë vjen pas ngadalësimit të ritmit të lëvizjes, zmbropsjes së intervalit të madh të përpjekjes, punës e fitimit të pasurisë, ndërprerjes së zhurmës së rrotullimit të mullirit të jetës. Ky lexim vjen për ta mbushur zbrazëtinë, të kthen baraspeshën në shpirtat tonë të mësuara me lodhje, të na ruajë në brendinë tonë baraspeshën e ritmit të jetës, të rregullojë në ne intervalin e zërit dhe pasqyrës dhe lëvizjes, të realizojë në ne baraspeshë shpirtërore në kohën kur gati se jemi afër ta humbim.

Ditën tonë e mbarojmë me namazin e jacisë, para nesh janë katër rekate të gjata, dy prej të cilave i kalojmë duke lexuar me zë dhe gjatë, lexim që përshtatet me heshtjen dhe qetësinë e natës, sikur dita dobësohet që para teje të lë hapësirën e duhur të cilën do ta mbushësh me zërin tënd dhe të lutesh para Allahut. Pastaj falim sunetet dhe vitrin. Namazi ynë mund të vazhdojë edhe më tej, në errësirën e natës, aty ku askush nuk na vëren, përveç Allahut.

Kujtoj se është e udhës të mësojmë se numri i suneteve të namazeve, është i njëjtë me numrin e farzeve të tyre. Kjo na bën të qartë përputhjen e numrit të rekateve të çdo namazi me ndryshimin e pozitive tona jetësore, shkallën e nevojës sonë për lidhjen me Allahun gjatë ditës, natës dhe vështirësive kalimtare.

Numri i rekateve të namazit, farze dhe sunete, përputhet me rritjen e rrezikut të sprovave të jetës, ato janë më pak në namazin e sabahut, në kohën kur njeriu bëhet gati të filloj ditën e të përballet me ujërat e jetës dhe sprovat e tij, kurse më shumë në namazin e drekës, kur njeriu gjendet në mes të stuhisë (shtrëngatës). Numri i rekateve është i madh edhe në namazin e jacisë, sepse nata di të bartë me vete llojlloj sprovash.

Sa gllënjka të mrekullueshme të këtij ilaçi të bukur na përgatiti Krijuesi ynë i Madhërisëm gjatë ditës dhe natës, që të na ruajë dhe mbrojë nga dëmi i asaj që ka krijuar!



## TRIBUNA E TRETË SHUMËLLOJSHMËRIA DHE RËNDËSIA E SAJ NË NAMAZ

### Pjesa 1

Ndoshta e dimë e ndoshta jo, se armiku më i madh i përsëritshmërisë që na bën që me namazin tonë t'i kalojmë sferat e hapësirës së jashtme qiellore për të arritur tek Allahu është dorëzimi ynë që ndodh me kohë dhe adaptim para dominimit të elementit të përsëritjes mekanike dhe spontane të namazit, që pa dyshim humb kuptimin e tij të vërtetë. Cila është rruga e shmangies së këtij rreziku të vërtetë dhe që pandërprerë dhe me këmbëngulje na sulmon në namazin tonë, e që llogaritet faktori më i rëndësishëm që pengon lidhjen tonë me Krijuesin e Lartëmadhërisëm?

Në qoftë se ankon nga pagjumësia dhe dëshiron të humlutoh për mënyrën që do të të ndihmojë për gjumë, atëherë metoda më e mirë që mund ta bësh është përsëritja e ndonjë gjëje: përsëritja e ndonjë shprehje që e mban mend deri në lodhje, koncentrimi i shikimit në ndonjë fotografi që të del përpara dhe atë e imagjimon symbyllur, përsëritja e ndonjë kënge apo ritmi muzikor që e dëgjon, ka të bëjë edhe me zërin e mullirit apo zërin e armëve të rënda, përsëritjen e përkëdheljes së ndonjërit me të cilin jemi mësuar, tamam sikur që bëjmë me fëmijët tanë të vegjël...

Të gjitha gjërat që kanë përsëritje mekanike dhe spontane, na bëjnë të përfundojmë në humbje të vetëdijes dhe çlirimit nga përpjekjet mendore dhe më në fund të arratisemi... - me siguri në gjumë. Armiku i parë i përsëritshmërisë dhe përfshirjes në namaz dhe të menduarit për domethëniet e tij

për arritje tek Allahu, është dorëzimi para spontanitetit dhe shkujdesi nga shumëllojshmëria që na lejon ky adhurim...

Nëse gjatë kohë i përsërisim të njëjtat ajete dhe sure në namaz dhe nuk i ndryshojmë herë pas here, s'ka dyshim se vetes sonë i kemi përgatitur arratisjen ose pavetëdijen, edhe përkundër asaj se jemi në pozitën ku më së shumti kemi nevojë për zgjuarsi, mbikëqyrje dhe kujdes.

Rregullat e namazit, siç i ka caktuar i Dërguari s.a.v.s. me shpalljenga Allahu i Madhërishëm, ngërthejnë faktorë të zbulimit (hapjes) që na mjaftojnë për të na dhënë raste të shumta për shumëllojshmëri dhe ndjenja të ndryshimit dhe përtëritjes, me qëllim që të shpëtojmë nga depërtimi i rrezikut të spontanitetit dhe përsëritjes gjatë namazit:

1. Disa herë rekatet e namazit janë me zë (në sabah), disa herë pa zë (në drekë e ikindi), disa herë të përziëra (aksham dhe jaci).
2. Disa herë ato janë të ditës e disa herë të natës.
3. Disa herë janë katër rekate, disa herë tri, e disa herë dy.
4. Disa herë janë që falen në grup (farzet), e disa herë individuale (sunetet).
5. Disa herë janë të afërta njëra me tjetrën (në stinën e dimrit), e disa herë qëndrojnë larg njëra-tjetrës (në stinën e verës).
6. Kohët e namazit ndryshojnë për çdo ditë, falësi sikur kënaqet me këtë përtëritje ditore të përhershme, për çdo ditë vëren se koha e namazit kthehet për dy ose tri minuta apo ritet për dy ose tri minuta e më tepër, bile kënaqet me këtë ndryshim kur udhëton nga qyteti në qytet ose nga shteti në shtet.
7. Namazet disa herë janë farze, e disa herë sunete ose nafile. Kjo e fundit është shumë lloje.
8. Namazet farz falen me ikamet (thirrje për fillim të namazit farz), e disa herë pa ikamet (sunete dhe nafile); këtu kemi parasysh dallimin midis meshkujve dhe femrave.
9. Sunetet i paraprijnë farzeve, por ka raste kur sunetet i falim edhe pas namazit farz, si p.sh. pas namazit të drekës, akshamit dhe të jaciës.

10. Kemi sunete të konfirmuara dhe ato të pakonfirmuara (sunete muekkde dhe gajri muekkede).

11. Disa namaze i falim në xhami (farzet), e disa në shtëpi (sunetet dhe nafilet), disa nëpër sheshet e vendeve, siç është namazi i bajramit. I Dërguari s.a.v.s. thotë: *“Namazin që e falni në shtëpinë tuaj është më i vlefshëm se në xhaminë time, përveç atyre që janë farz.”* Albani thotë se hadithi është sahih)

*“Bëjeni që namazin ta falni në shtëpinë tuaj, e mos i shndërroni ato në varreza.”* (Muslimi)

12. Disa herë falemi në një xhami e disa herë në xhami tjetër, disa herë në pjesë të caktuar të xhamisë, e disa herë e ndërrojmë vendin e faljes. Është mirë që çdo namaz ta falim në vend tjetër të xhamisë: *“Kur dikush nga ju e fal namazin farz dhe dëshiron që pastaj të falet, le të ec përpara dhe të mos flet.”* Diku tjetër thuhet: *“Le të ec pak përpara ose mbrapa, djathtas ose majtas.”* (Ibn Abdu-l-Berri në *“Istidhkar”*)

13. Është mëshira e Allahut që lejoi shumëllojshmërinë në leximin e sureve që i lexojmë në namaz, disa janë të shkurtra, disa të mesme, e disa të gjata. Jemi të lirë që të zgjedhim se çfarë do të lexojmë për çdo namaz, ajo që i përshtatet kohës tënde dhe kohës së namazit, duke mos e çrregulluar elementin e përshpirshtmërisë. Vlerën e kësaj do të mund ta dimë vetëm atëherë kur të paramendonim sikur suret e Kuranit të ishin aq sa është surja el-Bekare (286 ajete), apo sa surja el-Vakia ose surja el-Kevther. S’ka dyshim se rastet për të zgjedhur suret e ndryshme të Kuranit për faljen e namazit na krijojnë qetësi dhe kënaqësi në namaz.

14. Në namaz vërejmë pozita konstante dhe të tjera të lëvizshme që pandërprerë ndodhin. Në çdo rekat vërejmë më së paku tetë lëvizje të ndryshme: ngritja e duarve për fillim (tek-biri ihram), qëndrimi në këmbë, përkulja, sexhdeja, ulja e parë e sexhdes, ulja e dytë, ngritja për herë të dytë në këmbë etj. Të mos harrojmë edhe përshëndetjen e fundit (selamin), duke kthyer fytyrën në të djathtë e në të majtë në fund të namazit.

15. Teksti i leximit ndryshon në çdo lëvizje që e bën falësi dhe në çdo pozitë që është, kur është në këmbë, sexhxde, ruku, ulur etj.

Qëndrimi në këmbë ka lexim të veçantë, rukuja po ashtu, sexhdeja, ulja, lutjet dhe dhikri, përshëndetja me selam etj.

Shumëllojshmëria e numrit të rekateve të namazit, e kohëve të tij, e natyrës së leximit, e pozitës së trupit dhe lëvizjet e gjymtyrëve në namaz, e leximit sipas ndryshimit të lëvizjeve të trupit etj, - të gjitha këto shmangin mundësinë e arratisjes ose shkujdesjes mendore ndaj asaj që jemi duke e bërë apo thënë në namaz, siç largon spontanitetin dhe lëvizjet mekanike. Që këtej na bën më të vetëdijshëm për atë që e themi, më të përshpirtshëm dhe më të lidhur me Allahun.

## Pjesa 2

### Shumëllojshmëria në numrin e rekateve... pse?!

Sikur të bëjmë një llogari të shpejtë të natyrës së shumëllojshmërisë me të cilat karakterizohen pesë namazet, do të kuptojmë qartë qëllimin e Krijuesit për kujdesin e kësaj shumëllojshmërie në të gjitha format e saj.

Ndryshimi i numrit të suneteve midis namazeve nënkupton një kapitull të kësaj shumëllojshmërie. Sunetet dhe farzet na japin një orar të ndryshëm të numrit të rekateve që gjithmonë ndryshojnë nga namazi në namaz. Le të qëndrojmë për pak kohë para numrit të rekateve të namazeve farz dhe suneteve:

- Namazi i sabahut: 4 (2+2)
- Namazi i drekës: 10 (4+4+2)
- Namazi i ikindisë: 8 (4+4)
- Namazi i akshamit: 5 (3+2)
- Namazi i jacisë: 13 (4+4+2+3)

- Njeriu ka të drejtë të pyet: pse ndryshojnë vendet e suneteve, disa herë janë para farzeve, e disa herë pas farzeve, ndërkaq disa herë para dhe pas? Këto janë vendet e suneteve në namazet farz:

- Namazi i sabahut: 2 rekate para sabahut.
- Namazi i drekës: katër rekate para namazit farz dhe dy rekate pas namazit.
- Namazi i ikindisë: katër rekate para namazit.
- Namazi i akshamit: dy rekate pas namazit.
- Namazi i jacisë: katër rekate para namazit dhe dy rekate pas namazit.

S'ka dyshim se ajo që vërejmë është fakti se çdo namaz ka specifikën e tij të veçantë në renditjen e suneteve.

Dikush mund të thotë: cili është dallimi midis suneteve para farzit dhe suneteve pas farzit? Cili është dallimi midis namazit farz dhe atij sunet? A nuk vlen i njëjtë lexim për të gjitha: a nuk janë të njëjtat lëvizje? A nuk i ngërthejnë të njëjtat detaje?

Bile mund të thotë: pse disa sunetet falen para farzit e disa pas farzit, siç është në namazin e drekës dhe të jacisë dhe sabahut, e renditja të jetë: sunet-farz-sunet, - pse të mos jetë: farz-sunet-sunet, ose: sunet-sunet-farz?

Përgjigja jonë njerëzore do të thoshte: asgjë nuk ka ndryshuar, është shumëllojshmëria. Kur falim drekën dhe fillojmë me faljen e suneteve, kuptojmë se pas kësaj do të falim katër rekate të tjera me emër tjetër dhe shkallë tjetër. Ai është i njëjtë në të gjitha detajet, por ndryshon për një gjë shumë të rëndësishme: shkalla. Shkalla e rekateve farz tek Allahu kanë vlerën e thelbit të riteve fetare, që nuk është kështu me rekatet sunet. Pastaj, falja e katër rekateve farz që ndryshojnë në emër, pozitë dhe rëndësi, na bën të përgatitemi shpirtërisht më shumë dhe të bëhemi më të përgatitur për kalim në faljen e dy rekateve pas këtyre katër farz.

Kjo "shumëllojshmëri e ndjenjave" na çon drejt shumëllojshmërisë në qëndrime dhe detyrime. Detyrimet dhe shumëllojshmëria e tyre rezultojnë shembjen e spontanitetit dhe lëvizjeve mekanike që ndodhen brenda nesh, gjëra që mund

të pengojnë rrugën dhe të shtrembërojnë rrugën e përsëritshmërisë, po edhe rrugën tënde për të arritur tek Allahu.

Shumëllojshmërinë e kohëve të namazit e përcjell shumëllojshmëria e përmbajtjes së namazeve, pastaj shumëllojshmëria e natyrës së rekateve dhe përbërja e tyre brenda çdo namazi, kjo shumëllojshmëri përputhet me përmasën e ballafaqimit dhe thellësinë e frontit ku qëndrojmë dhe përpiqemi ta kalojmë për të arritur në fund tek Allahu...

Është namazi i sabahut ai që është më i shkurtër se gjitha tjerat, ka vetëm katër rekate (2+2). Ndoshta themi se në këtë kohë të hershme të mëngjesit kemi kohë për më shumë rekate, sepse ende nuk kemi filluar punët e ditës, ende nuk jemi zhytur në oqeanin e preokupimeve, problemeve, takimeve dhe përgjegjësi, andaj pse të jetë namazi i sabahut më i shkurtër në përgjithësi?!

Mirëpo çështja është krejt ndryshe. Njeriu në këtë kohë të mëngjesit llogaritet i pastër, ai ende nuk është ndotur me ndyrësitat e jetës së përditshme, ai sapo është zgjuar nga bota e të vdekurve, bota e vdekjes së vogël: *“Allahu ua merr shpirtat atyre që u ka ardhur çasti i vdekjes dhe atyre që nuk kanë vdekur, por që janë në gjumë. Pastaj Ai ndal shpirtin e atij që i është caktuar vdekja, ndërsa të tjerëve ua lë deri në një kohë të caktuar.”* (Ez-Zumer, 42)

Djalli dhe joshjet e jetës ende janë larg nesh, ende nuk kanë filluar provokimet, ngritja e litarëve dhe mbjellja e minave në rrugën tonë.

Pastaj vijon namazi i drekës që ka më shumë rekate: katër rekate para farzit, katër farz dhe dy pas farzit. Është namazi që na jep energji të madhe, na mbush plot e përplot me antibiotikë që na ruajnë nga sherri i djallit, njerëzve, xhinëve, të cilët kundërshtojnë rrugën e mundimshme të punëve tona ditore që fillojnë në orët e para të mëngjesit dhe arrijnë kulmin në mes të ditës.

Me përfundimin e ditës dhe grumbullimin e provokimeve dhe zbrapsjes së veprimit të tërheqjes dhe shtyrjes midis djallit dhe neve, në këto orë të vonshme të druajtjes (nervozizëm) vjen koha e namazit të ikindisë, që na sjell një mbushje të re të nivelit të lartë, katër rekate sunet dhe katër farz. Është namazi i ikindisë ai që ruan energjinë tonë pozitive të ditës.

Nata nënkupton konakun e sprovave dhe joshjeve, prandaj vjen namazi i akshamit me rekatet e tij. Është ky namazi që shënon fundin e ditës, nuk është i shkurtë sikur namazi i sabahut, e as i gjatë sikur namazi i drekës dhe ikindisë, vjen në kohën e grumbullimit të presioneve të djallit që gjatë tërë ditës bien në shpirt, ky shpirt që ka shumë nevojë për një pastrim me ujë të fuqishëm që do të pastrojë ndyrësitat dhe joshjet e djajve dhe cytjet e tyre.

Namazi i akshamit me rekatet e tij të matura paralajmëron namazin që është shumë afër, namazin që bashkë me të përfundojnë ditën tonë, namazin e jacisë. Në fakt, ato janë dy namazet që janë shumë afër njëra me tjetrën. Vallë, pse kështu? S'ka dyshim se ky shpejtim, i mbështetur me rritjen e numrit të rekateve të namazit të jacisë, ka për qëllim ndihmën tonë në ngritjen e murit të lartë midis nesh dhe djajve të natës që shpërthejnë kundër nesh. Djajtë e natës janë shumë më të rrezikshëm dhe më joshës se djajtë e ditës...

Kështu vërejmë se çdo namaz ka shijen e tij të veçantë; namazi i sabahut të vendos në ambiente të falënderimit të Allahut, sepse je zgjuar nga vdekja e përkohshme, ke filluar jetë të re, ditë të re, ndaj shpreson suksesin, riskun, bekimin dhe shëndetin...

Namazi i drekës të shkëput nga kallaballëku i preokupimeve, falesh për të pastruar shpirtin nga jeta e ditës së zhurmshme të materies, për të mbushë shpirtin me më shumë energji shpirtërore që e ka harxhuar pjesa e kaluar e

ditës me plot zhurmë, vrap dhe kallaballëk, gati se nuk mbarojmë me të...

Namazi i ikindisë të përgëzon me kalimin e ditës, ndaj konfirmon pastrimin e shpirtin tënd, përtërinë pastrimin e shpirtit nga pluhuri i luftës së ditës dhe njollat e saj...

Namazi i akshamit të vendos në pozitën e atij që i thotë lamtumirë ditës së gjatë dhe materies së pamëshirshme, të dorëzon në duart e shpirtit, kohë që të ofron qetësi dhe prehje, të përgatitë ambient të këndshëm për t'i thënë lamtumirë fijeve të ditës dhe përqaimit të fijeve të para të errësirës që me vete bartin cytjet e djallit, që me hov të madh dhe në fshehtësi janë nisur kundër teje...

Namazi i jaciesë plotëson rolin e namazit të akshamit, ai shënon përgatitjen për praninë të vdekjes së përkohshme, korrigjim të punës së ditës, llogaritjen e fundit të vetvetes. Në këtë na ndihmon mbulesa e errësirës që përfshinë gjithçka dhe qetësia e plotë e cila nuk i lejon syrit, veshit dhe shqisave të tjera të qëndrojnë larg këtij korrigjimi dhe llogaritjes së shpirtit...

### Pjesa 3

#### **Elasticiteti i sunetit në shërbim të shumëllojshmërisë**

Deri më tani kemi biseduar për shumëllojshmërinë që përfshihet në namazet e një dite. Por, ekziston një kapitull tjetër i rëndësishëm i shumëllojshmërisë i shtrirë më gjerë, një pjesë e tij shtrihet gjatë tërë vitit, kurse një pjesë tjetër është e lidhur me ditët festive dhe raste të ndryshme.

Këtu kemi namazin e xhumasë, veçoritë e tij dhe ritet e posaçme që e shoqërojnë atë, pastaj namazin e teravisë, namazin e tehexhudit, namazin e bajrameve (bajramin e fitrit dhe bajramin e kurbanit), namazin e frikës (në raste lufte dhe rrethanave të vështira), namazin e xhenazes dhe nama-

zin e tesbihut. I Dërguari s.a.v.s. na thërret ta falim namazin e tesbihut qoftë edhe njëherë në vit ose njëherë në jetë. I Dërguari s.a.v.s. i tha xhaxhait të tij, Abbasit: *“O xhaxhai im, a të jap një dhuratë (privilegj)? A të lë pa dobi? A të lë pa të dashur? O xhaxhai im! T’i falësh katër rekate, në çdo rekat të lexosh Fatihan dhe një sure, kur të mbarosh leximin dhe para se të biesh në ruku, thuaj pesëmbëdhjetë herë: Allahu ekber, ve-l-hamdu lil-lahi ve subhanallahi ve la ilahe il-la-ll-llahu, pastaj bjer në ruku dhe thuaji këto dhjetë herë, pastaj ngrite kokën dhe thuaji dhjetë herë para se të biesh në sexhde, pastaj bjerë në sexhde dhe thuaji dhjetë herë, pastaj ngrite kokën dhe thuaji dhjetë herë, dhe përsëri bjerë në sexhde dhe thuaji dhjetë herë, pastaj ngrite kokën dhe para se të ngrihesh në këmbë thuaji dhjetë herë. Këto janë gjithsej 75 herë në çdo rekat, pra 300 në katër rekate. Nëse gjynahet e tua janë sikur shkuma e detit ose rëra e Alixhit (brigje rëre në Arabi), Allahu ka për të t’i falë, e nëse nuk mund ta falesh për çdo ditë, fale një çdo të premte, e nëse nuk mundesh, atëherë fale në çdo muaj, por nëse nuk mundesh, atëherë fale në çdo vit.”* Në transmetim tjetër thuhet: *“Nëse nuk e bën këtë, atëherë fale një herë në jetë.”* (Albani thotë se hadithi është sahih dhe është në *“Sahih el-Xhami’ të Sujutiut”*)

Këtu kemi edhe namazin e shiut, namazin e pendimit, namazin e nevojës, namazin e zënies së diellit, namazin e falënderimit, namazin e istihares etj. Këtë të fundit, pra namazin e istihares, e falim duke i shoqëruar lutje të posaçme me të cilën kërkojmë zgjidhje prej Allahut për punët tona, siç na mësoi i Dërguari s.a.v.s.: *“I Dërguari s.a.v.s. na mësonte istiharen në çdo punë (d.m.th. të kërkojmë prej Allahut zgjidhje adekuate për punët tona), ashtu siç na mësonte suren e Kur’anit, ai thoshte: “Nëse dikush dëshiron ta bëjë ndonjë punë, le t’i falë dy rekate namaz (jo farz) dhe pasi të falet le të thotë: “Allahu im! Unë kërkoj më të mirën duke u mbështetur në diturinë Tënde, mbështetem në fuqinë Tënde dhe kërkoj nga*

*mirësia Jote e madhe, se vetëm Ti mundesh, e unë nuk mundem, se vetëm Ti e di, e unë nuk e di, Ti je i Gjithëdijshmi (që i di të fshehtat); Allahu im! Nëse e di se kjo çështje e imja (dhe e emëron atë) është në dobinë time, për fenë time, dynjanë dhe ahiretin (ose thotë: për këtë botë dhe botën tjetër), atëherë bëje caktim për mua, ma lehtëso atë dhe më sjell bekim në të. Por, nëse e di se kjo çështje është dëm për mua, për fenë time, dynjanë dhe ahiretin tim, atëherë largoje nga unë dhe më largo mua nga ajo. Të lutem më cakto të mirën dhe dobinë kudo që të jetë, e pastaj më bën të kënaqem me të.” (Buhariu)*

Në udhëtim, haxh, në kohë me shi ose në rrethana të caktuara na lejohet bashkimi dhe shkurtimi i namazeve, ky namaz përfaqëson kulmin e elasticitetit dhe simetrisë në Islam. Ky lloj i namazit vlen për namazet farz, kështu që namazet që i falim katër rekate i shkurtojmë në dy dhe bëjmë bashkimin e namazit të drekës me ikindinë dhe të akshamit me jacinë.

Allahu i Madhërishëm, krahas këtyre llojeve të ndryshme të namazeve, falësit i jep edhe shumë raste tjera brenda namazit që begatojnë këtë shumëllojshmëri.

A ke provuar ndonjëherë t’i ndryshosh suret që zakonisht i lexon në namaze? Të zëvendësosh suret e namazeve të natës me suret e namazeve të ditës! Të lexosh ajete nga suret e gjata, si el-Bekare, Merjem, Jusuf, në namazet e natës ose ditës, në vend se të lexosh sure të shkurtra! Dalja nga zakonshmëria do ta bëjë namazin tënd më të gjallë e më të freskët dhe më të përsipirtshëm, kurse fjalët që i lexon do t’i bëjë më të ngrohta dhe më të sinqerta.

Shkolla e të Dërguarit s.a.v.s. na mëson gjëra të paharuaruara në fushën e elasticitetit dhe shumëllojshmërisë, qoftë në namaze ose gjëra tjera, veçmas në namazet nafile. Ky elasticitet përfaqëson shpirtin Islam që shquhet si tolerant, korrekt, simetrik, të përshtatshëm me kohën, mjedisin dhe rrethanat që na ndodhin çdo herë. Ishin shokët e të Dërgua-

rit s.a.v.s. ata që dolën nga kjo shkollë profetike tolerante, prandaj edhe treguan mësim të pasura, të dobishme e të frytshme, me horizonte të gjera të veprimit të shumëllojshmërisë dhe ndryshimit. Natyrisht se të gjitha këto gjëra konfirmoheshin nga i Dërguari s.a.v.s. dhe preferoheshin që ndiqen. Ai s.a.v.s. thotë: *“Përmbajuni sunetit (rrugës) tim dhe sunetit të hulefave të drejtë e të udhëzuar, shtrëngoni fort me dhëmballa.”* (Albani thotë se hadithi është sahih)

Shokët e të Dërguarit s.a.v.s. treguan kujdes të madh në të mësuarit e besimtarëve për mësimet e elasticitetit, maturisë dhe përshtatshmërisë me domosdoshmëritë dhe rrethanat ndryshuese. Ishte Aliu r.a. që me urtësinë e shkollës profetike kuptoi këtë të vërtetë; në një rast ai vërejti se Ebu Bekri dhe Omeri ecin para një xhenaze të një muslimani, në vend se të ecnin prapa saj. Ai komenton veprimin e tyre për të na dhënë mësim të lartë moral dhe programor: *“Isha duke ecur në një xhenaze ku ishin Ebu Bekri, Omeri dhe Aliu (Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë). Ebu Bekri dhe Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dytë) ecnin para xhenazes, kurse Aliu (Allahu qoftë i kënaqur me të) ecte prapa saj, ishim dorë për dorë. Atëherë Aliu (Allahu qoftë i kënaqur me të) tha: “Vlera e njeriut që ec pas xhenazes dhe atij që ec para xhenazes është sikur vlera e namazit që falet në xhemat ndaj namazit që falet vetë, këta (Ebu Bekri dhe Omeri) e dinë këtë, ashtu siç unë e di, por janë tolerant, u lehtësojnë njerëzve.”* (Tahaviu në “Sherh meani el-athar”)

Aisha, nëna e besimtarëve (Allahu qoftë e kënaqur me të) na prezanton shembuj të këtij elasticiteti dhe tolerance pejgamberike. Ajo e shoqëroi të Dërguarin s.a.v.s. më shumë se çdokush tjetër, këtë e përjetoi vetë ajo. Ta dëgjojmë atë për një kapitull të tolerancës që ndërkohë na flet për namazin e të Dërguarit s.a.v.s., pra namazin e Duhasë (paradites). Është e njohur se ky namaz nafile falet dy rekate, sipas transmetimeve të shumë haditheve.

*“Për çdo ditë duhet të ketë sadakë për çdo asht të vogël të birit të Ademit, këtë e kryen falja e dy rekateve të Duhasë.”* (Albani thotë se hadithi është sahih)

Aisha (Allahu qoftë e kënaqur me të) në një transmetim shpalos se i Dërguari s.a.v.s. namazin e Duhasë e falte katër e më tepër rekate, ajo thotë: *“I Dërguari s.a.v.s. e falte namazin e Duhasë katër rekate, e shtonte aq sa donte Allahu.”* (Muslimi)

Ajo bile transmeton një hadith tjetër ku shpalos se i Dërguari s.a.v.s. nuk e falte këtë namaz nafile, edhe përkundra asaj se pohon në vetë hadithin që e transmeton, bile ajo vetë e kishte falur, natyrisht duke ndjekur të Dërguarin s.a.v.s. dhe atë që kishte mësuar prej tij s.a.v.s.

*“Asnjëherë nuk e kam parë të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. të falte namazin e Duhasë, kurse unë e falja atë. I Dërguari s.a.v.s. ishte që linte punën që e donte ta bënte, nga frika se mos njerëzit punojnë me të, e pastaj u bëhet detyrë (farz).”*

Ndërkaq që Umu Hani flet se i Dërguari s.a.v.s. në një rast namazin e Duhasë e fali me tetë rekate: *“...se Umu Hani, bija e ebu Talibit kishte thënë se në vitin e çlirimit të Mekës kishte takuar të Dërguarin s.a.v.s. në një lartësi të Mekës. I Dërguari s.a.v.s. ishte ngritur për t’u pastruar, atë e mbulonte bija e tij, Fatimeja. Ai pastaj mori rrobat dhe u mbulua me to, e pastaj fali tetë rekate namaz të Duhasë.”* (Muslimi)

Kështu ishte mësuesi i parë në mësimet e nafiles që shënonin adhurimin e tij të veçantë: ndryshon numrin e rekateve të tyre, kohët, falet më herët ose më vonë, varësisht nga ndryshimi i rrethanave dhe situatave. Në vijim do t’i shqyrtojmë disa hadithe, përmes të cilave do të mund të mësojmë shpirtin e kësaj shkolle tolerante profetike.

*“Kush fle pa e lexuar pjesën e tij të Kuranit ose një pjesë të tij, e pastaj e lexon midis namazit të sabahut dhe namazit të drekës, llogaritet sikur ta kishte lexuar natën.”* (Muslimi)

*“Dy njerëz dolën në udhëtim, koha e namazit i zuri që nuk kishin ujë, andaj morën tejëmum të pastër dhe u falën. Por, pas pak ata gjetën ujë në kohë – d.m.th. para se kalonte koha e namazit që e kishin falur - , njëri prej tyre e përsëriti namazin dhe abdestin, kurse tjetri jo. Pastaj erdhën tek i Dërguari s.a.v.s. dhe ia përmendën këtë që e kishin bërë. Ai i tha atij që nuk e kishte përsëritur namazin: “E ke qëlluar sunetin dhe namazin e ke të plotë”, - kurse atij që e kishte përsëritur i tha: “Ti ke dy shpërblime.” (Ebu Davudi)*

*“Transmeton Abdullah ibn Kajsi dhe thotë se e ka pyetur Aishen për namazin e vitrit të Dërguarit të Allahut s.a.v.s., ndërsa ajo ka thënë: “Ndodhte ta falte në fillim të natës, e ndodhte ta falte në fund të natës.” Unë i thashë: “Si ishte leximi i tij, a lexonte me zë apo pa zë?” Ajo tha: “Të gjitha i bënte, ndodhte të lexonte me zë dhe pa zë, siç ndodhte të pastrohej dhe flinte, e ndodhte të merrte abdest e të flinte.” (Ebu Davudi)*

*“I Dërguari s.a.v.s. i tha Ebu Bekrit: “Kur e fal namazin e vitrit?” Ai tha: “Para se të flejë.” Pastaj iu drejtua Omerit dhe i tha: “Po ti kur e fal namazin e vitrit?” Ai tha: “Flej e pastaj e fali.” Atëherë i tha Ebu Bekrit: “Ti e ke marrë pra (faljen e namazit të vitrit) me vendosmëri apo detyrë, kurse Omerit i tha: “Ti e ke marrë me fuqi.” (Ibn Hazime, Albani thotë se hadithi është sahih)*

*“I Dërguari i Allahut s.a.v.s. e falte vitrin gjatë tërë natës; në fillim të natës, në mes dhe në fund, kështu e mbaronte vitrin deri në gdhirje të mëngjesit (syfyr).” (Muslimi)*

*“E pyeta Aishen: “Sa rekate e falte i Dërguari s.a.v.s. vitrin?” Ajo tha: “Katër rekate, gjashtë rekate, tetë rekate, dhjetë rekate, trembëdhjetë rekate, asnjëherë nuk e falte më tepër se trembëdhjetë rekate...” (Albain thotë se hadithi është sahih)*

*“Namazi i vitrit është detyrë e çdo besimtari, kush të dojë le ta bëjë atë shtatë rekate, e kush të dojë pesë, e kush të dojë tre, po kush të dojë le ta bëjë një...” (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih el-Xhami’)*

*“Dikush e kishte e kishte pyetur Enes ibn Malikun për kunutin në namazin e sabahut, ai kishte thënë: “Ne kunutin e bënim para rukusë – d.m.th. rukunë e rekatit të dytë – dhe pas tij.” (Ibn Maxhe, Albani thotë se hadithi është sahih)*

Sa i lehtë që është Islami, sa zemërgjerë dhe tolerant i Dërguari i tij, sa mësimë të lehta e të këndshme, sa madhështore që është elasticiteti i tij, matura dhe spontaniteti i tij për atë që vërtet kupton. Këto përfaqësojnë vlerat etike të pejgamberisë, realitetin dhe racionalizmin.

#### Pjesa 4

#### Ndërrimi i pozitave dhe lëvizjeve... pse?

Numri i madh i pozitave dhe shumëllojshmëria e tyre në namaz nuk është i kotë, përndryshe do të ishte e mundur që në namaz të lexonim çka të donim, e të jemi ulur, në këmbë, të mbështetur ose të shtrirë, të mos detyrohemi të bëjmë lëvizje.

Krahas rolit të lëvizjeve gjatë namazit në begatimin e elementit të “shumëllojshmërisë” dhe shmangies së rrezikut të spontanitetit, përsëritjes mekanike dhe bredhjes së mendjes, na mbetet të pyesim: pse ndodh ndërrimi i leximit në namaz me ndërrimin e pozitave të trupit, ku çdo pozitë ka leximin e ndryshëm? Pse është **tesbihu** (*subhane rabbije'l-adhim*) në ruku e jo në sexhde? Pse në sexhde është **tesbihu** (*subhane rabbije'l-a'la*)? Pse lexojmë Kur'an vetëm kur jemi në këmbë, ndërkaq që në ulje lexojmë tekste pejgamberike (*ettehijjatu li'l-lahi, ves-salevatu ve't-tajjibatu dhe salavatet ibrahimiane*)? Pse? Pse?

Ndërrimi i pozitave tona në namaz na ndihmon për vigjilencë më të madhe dhe vetëdije të plotë se jemi drejtuar kah Allahu dhe jemi bërë gati të fillojmë bisedën me Të. Ndërrimi i pozitave në namaz, të shoqëruara me lexim, sikur na stërvitin cilësinë e të kuptuarit të asaj që e lexojmë,

se ajo që del nga buzët tona vërteton besnikërinë e zbatimit tonë dhe lëvizjet tona. Kjo nënkupton konfirmimin tonë për përputhshmërinë e fjalëve tona me veprat tona, besimin e plotë dhe bindjen e sinqertë për atë që e themi.

Mund të themi gjithashtu se biseda me Allahun me fjalët e Allahut (Kur'anin), nuk është i njëjtë me fjalët e njerëzve, edhe nëse këto të fundit janë fjalë të të Dërguarit tonë s.a.v.s.! Lloji i parë i bisedës ngërthen rëndësinë e veçantë të tij, madhështinë dhe pozitën e lartë, është qëndrimi ynë i plotë para Allahut, ndërkaq që lloji i dytë nënkupton uljen para Atij; ulja ka për detyrë të na sigurojë pozitën më të mirë dhe nënshtrimin më të qetë për ta përshëndetur Allahun e Madhërisëm (*ettehijjatu lil-lahi...*), ta përshëndesim të Dërguarin e Tij fisnik (*esselamu alejke ejuhe'n-nebijju*), para se të përshëndesim vetveten dhe robërit e mirë (*ibadi'l-lahi's-salihin*). Pozita e shprehjes së falënderimeve (*ettehijjat*) nënkupton kulmin e pozitave (qëndrimeve) në namaz, siç nënkupton afërsinë dhe lidhjen më të ngushtë me Allahun, siç do të shohim në vijim. Ulja në namaz për falësin paraqet pozitën më të rehatshme, më të qetë dhe më të nënshtruar, sepse është ulur para Allahut duke iu drejtuar me përshëndetjet më të bukura.

Çfarëdo që të themi në këtë temë, përsëri do të mbetet e paqartë në përgjithësi, mendja jonë nuk do të arrijë ta kuptojë këtë plotësisht, sepse jemi njerëz, kurse urtësia e Allahut është absolute, ajo qëndron pas uljes sonë, lëvizjeve tona në namaz etj.

Por, a thua kemi menduar ndonjëherë se pse ne muslimanët falemi në këtë formë? A e kemi parë ndonjëherë veten kur jemi falur me sytë e të tjerëve që nuk janë muslimanë?

Vallë, cila pozitë do të habiste ata kur papritmas do të na shikonin duke u falur për herë të parë? A thua se do të mahniteshin kur ne do të ngrinin duart në tekbinin fillestar,

sikur dëshirojmë të aludojmë në diçka, por para tyre nuk duket fare diçka që duhet të aludohet? Apo do të mahniteshin kur përkulemi, në shenjë respekti për dikë që ata nuk e shohin para tyre? Ose kur biem në tokë dhe ballin tonë e përlyejmë me dheun e tij, sikur, sipas tyre, të na kishte ndodhur diçka, ndonjë sëmundje mos na godit? Apo kur ulemi dhe lëvizim gishtin për ta dëshmuar Allahun Një? Ose kur lëvizim kokën në të djathtë e në të majtë në fund të namazit, për t'i përhëndetur krijesat e padukshme?

S'ka dyshim se edhe shokët e të Dërguarit s.a.v.s. janë habitur kur për herë të parë e kanë parë atë duke u falur në këtë mënyrë, pas kthimit të tij nga udhëtimi i shenjtë në Mesxhidi Aksa dhe në hapësirat e qiellit, prej nga e solli dhuratën më të madhe për muslimanët, thesarin hyjnor të madhe që quhet NAMAZ. Mirëpo, a thua se shokët e tij e kundërshtuan atë?

Në vitin 1979 qeveria kineze më dërgoi thirrje për mësimdhënie në Universitetin e Pekingut. Plan-programi parashtoi vizitën e mauzoleut të Mao Ce Dungut, themeluesit të Kinës moderne, kishte tri vjet që kishte ndërruar jetë (1976).

Gjatë rrugës për në mauzole kaluam pranë një tempulli budist, kishte disa javë që ishte hapur, në kohën kur të gjitha xhamitë dhe kishat ishin mbyllur gjatë revolucionit kulturor që i kishte shpallur Republika e Kinës tridhjetë vjet rresht. E shikova tempullin, nuk kam fjalë të përshkruaj habinë time, shikoja grumbuj njerëz në tempull që ishin shtrirë përtokë, para statujës së Budës.

Arritëm në vendin e mauzoleut, në një hapësirë të madhe e të gjerë, ne duhej të rreshtoheshim në reshtin e gjatë të njerëzve që kishin ardhur për ta vizituar trupin e balsamosur të prezantuar në kafaz qelqi.

Pritja jonë nuk zgjati shumë dhe kur u afruam gati 100 metra pranë trupit të balsamuar, njëra nga rojet na u afrua

dhe na tregoi se tash e tutje nuk lejohet biseda me zë, respekt për njeriun e vdekur. Pas 50 metrave një tjetër roje gjithashtu na lajmëroi se prej tani nuk guxojmë të bëjmë zhurmo apo të nxjerrim zë me këpucët që ecnim, respekt për njeriun. Kur arritëm te muri i jashtëm që mbulonte mauzoleun, erdhi një roje tjetër për të na treguar se prej tani nuk guxojmë t'i kemi duart përpara të lidhura, as t'i lëmë të lëshuara e as t'i kemi përpara ose prapa. Kështu kërkonte respekti për atë që kemi ardhur ta vizitojmë. Më në fund, kur arritëm në sallën e mauzoleut, një roje tjetër na lajmëroi se duhet të kujdesemi të vazhdojmë të ecim ngadalë dhe për asnjë moment të mos ndalemi, e më shumë se kjo, shikimi ynë nuk duhet të jetë i drejtuar tërësisht drejt trupit të njeriut të balsamuar në kafaz, por atë duhet ta shikoni me cepin e syrit. E tërë kjo në shenjë respekti për të zotin e mauzoleut të shtrirë në kafaz qelqi.

Thashë më vete: vallë, për cilin janë caktuar të gjitha këto rregulla dhe detyrohemi t'i respektojmë, sikur të jemi në namaz? Për hir të një njeriu! Një rob i Allahut të cilin populli e shenjtëroi dhe i ndërtuan një mauzole të madh, për të shpikën rregulla respekti?!

Nuk munda të përmbahem duke parë këtë skenë e të mos e krahasoj qëndrimin tim para këtij robi të vogël, të burgosur në kafazin prej qelqi, i shtrirë pa ndjenja, pa jetë dhe pa lëvizje, me qëndrimin tim në namaz para Krijuesit të këtij robi dhe Krijuesit të qiejve dhe Tokës, Ringjallësit të eshtrave që bëhen pluhur, sa dallim i madh midis këtyre dy qëndrimeve.

Derisa i shikojta me habi budistët e shtrirë përtokë në tempull, e kuptova se lëvizjet tona në namaz bëjnë të njëjtën përshtypje për të tjetër që na shohin! E si të arrijmë që lëvizjet tona t'i vëmë në nivel të duhur e të konfirmojmë se ato nuk janë ashtu?

Le t'i analizojmë këto lëvizje, së paku disa prej tyre, e t'i shohim njëherë me sytë e të tjerëve, kurse herën tjetër t'i shohim me mendjen tonë, aftësinë tonë dhe logjikën tonë.

Paramendo sikur je grindur me një shok për ndonjë çështje, e ai fillon të të akuzoj rëndë dhe të fyejë me fjalë të rënda dhe kërcënime, por t'i tregohesh i përmbajtur dhe nuk dëshiron të ulesh në nivelin e diskutimit dhe armiqësisë, prandaj heq dorë duke shfaqur lëvizje që shpreh qëndrimin tënd refuzues ose të painteresuar. A nuk do të ishte ngritja e duarve tua deri mbi kokë duke u larguar prej tij dhe drejtimi i anëve të pasme të duarve kah ai, prova më e mirë që shpreh këtë qëndrim?

Kështu veprojmë kur ne ngremë duart në tekbinin filleshtar të namazit, provë se heqim dorë nga dynjaja, dëfrimet dhe joshjet e saj, që të deklarojmë se jemi drejtuar kah Allahu, Një e i Vetëm! Këtë e provon lëvizja e duarve tona në namaz, disa këtë e përsërisin më shumë herë gjatë namazit, me këtë ata realizojnë më shumë harmoni midis fjalës dhe punës, çdo lëvizje e vërteton gjuhën gjatë çdo tekbi.

A thua pse qeshim kur i shohim njerëzit se si përkulen para mbretërve, tërësisht ose pjesërisht? Apo na kujton se përkulja e madhe, e plotë dhe e pashmangshme duhet të jetë për Sunduesin absolut? Atij që ne i përkulemi në namazin tonë dhe prej Atij kërkojmë mëshirë dhe shpresojmë faljen e Tij?

Po ç'ndodh me njeriun e gjykuar me varje në litar? Ç'ndodh nëse i lejohej të hyjë te gjykatësi që ka lëshuar urdhrin për vrasjen e tij? A nuk do të ishte me vend nëse themi se edhe më tej shpreson faljen prej gjykatësit? Sapo të hyjë tek gjykatësi, ky i mjerë do të shtrihej përtokë dhe do ta vente kokën pranë këmbëve të gjykatësit, do të kërkonte falje dhe anulim të vendimit për varje, të jetonte edhe pak kohë? Kështu ne biem përtokë, të nënshtruar, të lavdishëm, të penduar, me ballin tonë përtokë kujtojmë se Ai tani ka në

dorë gjithë çështjen tonë, të ardhmen e të kaluarën, se vendimet e Tij zbatohen në ne!

S'ka dyshim se komenti ynë filozofik i këtyre lëvizjeve do të ishte i mangët në krahasim me komentin e plotë Hyjnor dhe të vërtetë të tyre. Këto lëvizje kanë për qëllim ruajtjen e përcjelljes së vijës në namaz midis lëvizjes dhe leximit. Kjo është çështje me rëndësi të madhe, sepse provon sinqeritetin tonë dhe besnikërinë tonë me Atë që flasim, siç do të shohim më vonë.

Nuk janë vetëm lëvizjet tona në namaz që tërheqin vëmendjen dhe shikimin e të tjerëve, por edhe pushimet gjithashtu. Ky përkushtim i potë i drejtimit kah kibla gjatë namazit, kujdesi që shikimi ynë të jetë gjithmonë drejt vendit të sexhdes, durimi i pathyeshëm në mos lëvizjen e trupit në të djathtë e në të majtë, mos guximi i bisedës apo shqiptimit të ndonjë fjale ndaj atyre që na flasin, çfarëdo që të jenë shkaqet, bile shpallja e hapësirës midis nesh dhe kibles si hapësirë e ndaluar qarkullimi, e gjithë kjo do t'i befasonte të tjerët, do t'i bënte të dallojnë atë se në namaz ne përjetojmë një "gjendje jashtëzakonisht të veçantë" dhe nuk lejojmë ndërhyrjen e ndonjë çështje të kësaj bote.

Është me rëndësi të kujtojmë se lëvizjet tona në namaz, duke marrë parasysh intimitetin e tij maksimal dhe shpirtëroren absolute, luajnë gjithashtu rol material dhe botëror, ato përfshijnë çdo nyje të trupit tonë, jo vetëm kryesoret, siç janë: gjoksi, shpina, krahët dhe këmbët, por të gjitha, të mëdha e të vogla, nyjet e gjunjëve, shputave, duarve dhe këmbëve.

Të kujtojmë se secila lëvizje e trupit tonë është kusht në namaz, kjo nënkupton se lëvizjet janë "*farz*", por për ne çdo gjë që është detyrë është e drejtë, mendja jonë njerëzore e njeh frytin e kësaj të drejte. Ndodh që ndonjëherë të injorohet një pjesë e kësaj të drejte, por muslimani duhet të besojë

plotësisht se çdo detyrë në Islam në fund është një lloj i të drejtës që Allahu ia dhuroi atij që e kryen këtë detyrë.

## Pjesa 5

### Shumë alternativa (zgjedhje) dhe parimi (atë që mundem)

Kujtoj se tani ke formuar pikëpamje të përafërt për llojin e shpërblimit që na pret kur falim namazin, së pari në këtë botë e pastaj në botën tjetër, sasitë e mëdha të kapitalit të shtuar në llogarinë tonë me çdo mi'raxh (udhëtim kozmik) që e bëjmë për tek Allahu.

Ndodh që procedimi i llogarive të përafërta të sasisë së kapitalit tonë për çdo namaz në këtë botë të jetë i mundur, por kurrë nuk do të mundemi, sado të përpiqemi t'i afrohem llogarive të vërteta të botës tjetër, të imagjinojmë sasinë e shpërblimit të botës tjetër që vlen për çdo namaz.

Krijuesi ynë mëton të na afrooj atë që është larg, të na kufizoj atë që është absolute që mendja e jonë njerëzore kurrë nuk mundet ta kuptoj. I Dërguari s.a.v.s. na përgëzoi me shpërblim për sunetet që i falim në namaz, e të mos flasim për farzet, me **“shtëpi në Xhenet”**. Imagjino, nëse mundesh të imagjinosh, çfarë shtëpie ose pallati mund të të pret në Xhenet.

*“Kush ngulmon (s'heq dorë) nga dymbëdhjetë rekate të sunetit, atij i ndërtohet një shtëpi në Xhenet: katër para namazit të drekës, dy pas tij, dy rekate pas namazit të akshamit, dy rekate pas namazit të jacisë dhe dy rekate para namazit të sabahut.”* (Ibn Maxhe, Albani thotë se hadithi është sahih)

Hadithi në fjalë përkufizon sunetet e caktuara, pra *sunetet muekkede*, kurse në transmetim tjetër vërehet hapësirë e hapur për të zgjedhë dymbëdhjetë rekate, që përputhen me rrethanat e tua: *“Secili musliman që për hir të Allahut i falë çdo ditë dymbëdhjetë rekate, me dëshirë e jo farz, le ta dijë se Allahu do t'ia ndërtojë një shtëpi në Xhenet.”* (Muslimi)

A edhe më tej je duke menduar për vështirësinë e realizimit të tyre? Ndoshta në fillim do të vëshesh pak vështirësi në plotësimin e kësaj, por mos u mërzit: merre këtë punë me ngadalësim, hap pas hapi. Fillo së pari me faljen e dy, katër e më tepër rekateve, që kur të mendosh se ato janë bërë pjesë e pandarë e jetës tënde dhe pjesë e programit tënd ditor, atëherë përpiku që në shpirtin tënd të depërtojnë gjërat hap pas hapi, kështu ato shndërrohen në tetë rekate e pastaj në dymbëdhjetë rekate. Ndiq mënyrën e shpejtë në përpilimin e orarit tënd, si p.sh. të shtosh diçka në orar çdo muaj ose çdo dy muaj ndonjë sunet ose nafile, po ndoshta edhe në çdo javë ose dy javë, e pse jo çdo ditë ose çdo dy ditë! Pse të mos kesh edhe zgjedhje dytësore, orar më pak të vështirë dhe më të ngadalshëm, kështu që në orarin tënd gjërat i shton çdo gjashtë muaj (sunetet), ndoshta çdo vit, p.sh. në muajin Ramazan, siç kemi theksuar më parë, që pastaj të vazhdosh deri në përmbushjen e këtyre dymbëdhjetë rekateve që të garantojnë shtëpi në Xhenet, inshaallah... e çfarë shtëpie se... çfarë shpërblimi se...

Mirëpo, a thua se shpërblimi përfundon vetëm me këtë shtëpi në Xhenet?

I Dërguari s.a.v.s. na mbuloi me përgëzime, duke na folur për shpërblimet e mëdha të çdo namazi të falur që na presin të shënuara në fletën e meritave tona.

Para teje është rasti i madh për kompensim të çdo shpërblimi që të ka kaluar nga sunetet ose nafilet, si dhe shumëllojshmërisë së këtyre suneteve dhe programimi i tyre sipas asaj që i përshtatet detajeve të jetës tënde. Këtu kemi namazin e natës, është namaz i hapur në kohë, midis namazit të jacisë dhe atij të sabahut, i hapur në numrin e rekateve, dy rekate e më lart, i hapur në kapital, aq më vonë, aq më mirë dhe aq më gjatë, aq më mirë, veçmas nëse edhe leximi është i gjatë, atëherë besojmë se edhe lutjet përgjigjen. Shpërblimet dhe kapitali rriten.

Megjithëkëtë, nëse plani yt parasheh faljen e këtij namazi, por ja që programi i të nesërmes nuk të lejon të zgjohesh natën, përsëri mos u mërzit. Mund ta kompensosh namazin e natës me faljen e namazit të vitrit në pjesën e fundit të natës; para teje janë shumë zgjedhje, çdonjëra ka shpërblim të madh dhe mahnitës:

I Dërguari s.a.v.s. thotë: *“Allahu ju ka furnizuar me namazin që është më i dobishëm se devet e kuqe (pasuri e asaj kohe), (që është) midis namazit të jacisë dhe agimit të mëngjesit: vitri, vitri, e tha këtë dy herë.”* (El-Ajni)

*“Kush e fal namazin e duhasë (paradites) dhe agjëron tri ditë në muaj dhe nuk e lë namazin e vitrit, qoftë në shtëpi apo udhëtim, le at dijë se i shkruhet shpërblimi i shehidit.”* (Shevkani në *“Fet’h er-Rebbani”*)

*“Kush ka frikë se nuk do të mund të zgjohet për ta falë namazin e vitrit në pjesën e fundit të natës, le ta falë në fillim, e kush shpreson të zgjohet në pjesën e fundit, le ta falë në pjesën e fundit, sepse namazi në pjesën e fundit të natës është namaz i dëshmuar dhe prezantues, e kjo është më mirë.”* (Muslimi)

*“Doemos të ketë namaz të natës, qoftë edhe për një kohë sa mjelet një dele, ajo që falet pas namazit të jacisë, ajo llogaritet e natës.”* (Mundhiri në *“Et-Tergib ve ‘t-terhib”*)

Janë raste dhe përjashtime të shumta që na i dhuroi Zoti i botëve, vetëm e vetëm të mos na ikin prej dore këto shpërblime të mëdha, edhe pse në moment menduam se vërtet na iken prej dore. Nëse e ke bërë nijet për të falë namazin e natës, e pastaj të ka kapluar gjumë i thellë dhe nuk je zgjuar për t’u falur, mos u mërzit fare, do të shpërblehesh sikur je falur, po edhe më tepër. Po, më tepër bile. Ky lloj i gjumit ka shpërblim sikur një sadaka që e ke dhënë.

*“Kushdo që falë namaz të natës, por e kaplon gjumi, le të dijë se Allahu i Madhërishëm do t’i shkruaj atij shpërblimin e namazit (sikur e ka falur), kurse gjumi i tij do të jetë sadaka për të.”*

(Albani thotë se hadithi është sahih, *“Sahih el-Xhami”*, nga Aisha r.a.)

Po çfarë ndodh nëse nuk mundem të fali namaze nate? Mos u mërzit, nuk të ka kaluar gjithçka. Këtu kemi namazin e lehtë të ditës që kompenson tërë këtë, është namazi i duhasë (paradites), vetëm dy rekate, ose më shumë nëse ti do, por sa shpërblim të madh që kanë këto dy rekate nëse i krahasojmë me lehtësinë e kryerjes së tyre:

*“Kush rri ulur në vendfaljen e tij pasi të mbarojë me namazin e sabahut deri sa të falë dy rekate të duhasë (namazit të paradites), dhe thotë vetëm mirë, le ta dijë se i falen gjynahet, qoftë të jenë më shumë se shkuma e detit.”* (Ebu Davudi)

Transmeton Ebu Dherr El-Giffariu se disa shokë i thanë të Dërguarit s.a.v.s.: *“O i Dërguari i Allahut, na kaluan pasani-kët me shpërblime, falen sikur që falemi, agjërojnë sikur që agjë-rojmë, por japin sadaka nga pasuria e tyre që e kanë tepër! Tha: “Po, a nuk e ka bërë Allahu për ju që të jepni sadaka? A nuk e dini se për çdo tesbih (që thoni subhanallah) keni shpërblim sadaka, për çdo tekbir (që thoni Allahu ekber) keni shpërblim sadaka, për çdo tehليل (që thoni la ilahe ilallah) keni shpërblim sadaka, se për çdo tahmid (që thoni elhamdu lil-lah) keni shpërblim sadaka, të urdhëruarat për të mirë dhe ndalimit nga e keqja është shpërblim sadaka, po edhe në marrëdhëniet intime me gratë e juaja keni shpërblim sadaka. Të pranishmit thanë: “O i Dërguari i Allahut, a ndodh që dikush nga ne të kënaq epshin e vet, e pastaj për të shpërblehet? Ai tha: “E çfarë ndodh nëse ai e kënaq epshin e vet në haram, a do të ndëshkohet? Njashtu është nëse e kënaq epshin e vet në hallall, ai do të shpërblehet për këtë, e ndërsa gjithë këtë e kompensojnë dy rekate namaz të duhasë.”* (Muslimi)

*“Namazin e duhasë e kanë kujdes vetëm penduesit, ai është namazi i të penduarve.”* (Albani thotë se hadithi është hasen, transmeton Ebu Hurejre)

E çka nëse të kalon jeta dhe për asnjë moment nuk ishte i aftë për të falë kësi namaze nafile, se shëndeti të pengoi gjatë gjithë kohës? A ka zgjidhje tjetër? Prapa po të them: mos u mërzit, atë mund ta falësh ulur, e gjithashtu edhe shtrirë dhe kurrë nuk do të privohesh nga shpërblimi inshaallah: “E pyeta të Dërguarin s.v.s.v. për namazin e njeriut ulur, e ai më tha: *“Kush falet në këmbë është më mirë, e kush falet ulur ai ka gjysmën e shpërblimit të atij që është falur në këmbë, ndërsa kush falet i shtrirë, ai ka gjysmën e shpërblimit të atij që është falur ulur.”* (Buhariu, transmeton Imran ibn Husajn)

S’ka dyshim se stina e dimrit sjell raste më të volitshme e më të lehta, sesa stina e verës, sidomos në faljen e namazit të natës. Netët e dimrit janë të gjata, andaj zgjohemi kur të duam. Pse të mos e shfrytëzojmë këtë rast të volitshëm të kësaj stine që gjërat janë me çmim të lirë, stina e dimrit quhet “pasuri e ftohtë” në disa hadithe, apo “pranverë e besimtarit” në disa hadithe tjera. Ai është sezoni i lirimeve, ku rrobat me kualitet të lartë blihen me çmim të përgjysmuar: *“Dimri është pranvera e besimtarit, nata është e gjatë dhe ai falet, kurse dita e shkurtër dhe ai agjëron.”* (Sa’ di)

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. transmeton fjalët e Zotit të Lartëmadhërisëm që thotë: *“O biri i Ademit, depono nga thesari yt tek Unë; (tek Unë) nuk digjet, nuk fundoset, nuk vidhe, ta kthej atëherë kur do të jesh më se i nevojshëm për të.”* (Bejhëkiu)

Më thuaj: a edhe më tej të duket shumë dhe vështirë? Përsëri të them: mos u mërzit, sepse lista e rasteve të volitshme edhe më tej qëndron para teje, shumëçka ka dhe janë të lehta, fitime të mëdha dhe të shumta, zgjedhje pafund dhe të shumëllojshme, shpërblime të mëdha, me çmime shumë të lira:

*“Midis ezanit dhe ikametit ka namaz (falet namaz), midis dy ezanëve ka namaz, midis dy ezanëve ka namaz, e për të tretën herë tha: për atë që do.”* (Buhariu dhe Muslimi)

*“Kush e fal namazin e jacistë me xhemat, llogaritet sikur është falur gjysmën e natës, kurse kush e fal namazin e sabahut me xhemat, llogaritet sikur është falur tërë natën.” (Muslimi)*

*“Kur njeriu zgjohet natën dhe e zgjon gruan e tij dhe i falin bashkë dy rekate, do të shkruhen pjesëmarrës në grupin e atyre që e përmendin Allahun shumë dhe që e përmendin (gra).” (Ibn Maxhe, Albani thotë se hadithi është sahih)*

*“Dy rekate të namazit të sabahut – sunet – janë më të vlefshme se e gjithë dynjaja dhe çka ka në të.” (Muslimi)*

*“Kur të Dërguarit s.a.v.s. i kalonin dy rekatet e namazit të sabahut – sunetet – i falte pas lindjes së diellit.” (Tahaviu)*

*“A t’ju tregoj për sulmin më të shpejtë se të muxhahidinëve dhe më fitimprurës? Njeriu që merr abdest dhe atë e bën për bukuri, pastaj niset për në xhami dhe e fal sabahun, e pastaj e fal edhe namazin e duhasë, ky është më i shpejtë në sulm dhe më fitues.” (Albani thotë se hadithi është sahih)*

*“Katër rekate para namazit të drekës janë të barabartë me namazin që falet në pjesën e fundit të natës.” (Albani thotë se hadithi është sahih)*

*“Kush kujdeset për katër rekatet para namazit të drekës, dhe katër pas tij, Allahu do t’ia bëjë të ndaluar Xhehenemin.” (Albani thotë se hadithi është sahih)*

*“Kush merr abdest dhe atë e bënë për bukuri, e pastaj i fal dy rekate me koncentrim (nuk habitet pra), le ta dijë se i falet gjynahu i kaluar dhe ai i ardhshëm.” (Albani thotë se hadithi është sahih)*

O Allah, çfarë raste të volitshme dhe të bukura, çfarë zgjedhje të mrekullueshme që na ke dhuruar, vetëm e vetëm të fitojmë shpërblime të mëdha, për punë të pakta e të thjeshta! A thua se mund dikush të lejojë që këto raste t’i shkojnë huq? E çfarë ndodh nëse puna jote është natën apo në ditët e pushimit, ku paga është dyfish më e madhe se ditëve të tjera? A thua kërkon arsye për të mos punuar? Nuk mendoj se e bën këtë! Atëherë si do t’ia bësh me shpër-

blimin që është i barabartë me qindra herë më i madh, thuaj mijëra, e pse jo miliona herë?!

*“Çfarëdo mirësie që bëni për shpirtin tuaj, me siguri që do ta gjeni tek Allahu. Ajo do të jetë më e mirë dhe më e shpërblyer.”*  
(El-Muzzemmil, 20)

Nuk mendoj se do të jepje dorëheqje nga puna e cila të shpërblen për çdo ditë, pasi ke filluar të shijosh ëmbëlsinë e lumturisë së saj dhe rehatinë e papërsHKruar që të mbulon ditë e natë? Siç nuk mendoj se do të refuzosh pagat e dy-fishta që derdhen në llogarinë tënde bankare?

Prandaj, mos hiq dorë nga këto rekate dhe mos lejo të dalin nga dora jote e të humbësh fitime të mëdha që do të pasurojnë kapitalin tënd. Vazhdo të punosh aq sa mundesh, jo vetëm për shkak të garancisë së vazhdimësisë së derdhjes së kapitalit të madh në ahiret dhe lumturisë së madhe dhe qetësisë shpirtërore në dynja, por sepse Allahu dëshiron që njeriu të vazhdojë të punojë dhe Allahu i do punët që bëhen në vazhdimësi. I Dërguari s.a.v.s. thotë: *“O njerëz! Punoni aq sa mundeni, sepse Allahu nuk mërzhitet derisa ju të mërzhiteni, se puna më e dashur për Allahun është ajo në të cilën ka vazhdimësi, edhe nëse është pak.”* (Buhariu dhe Muslimi)

*“...asnjërin nuk do ta fusë puna e tij në Xhenet. Të pranishmit thanë: “Edhe ty, o i Dërguari i Allahut?” Ai tha: “Edhe mua, përveç që Allahu të më mbulojë me mëshirën e Tij, dijeni se puna më e dashur për Allahun është ajo që është e vazhdueshme, edhe nëse është pak.”* (Muslimi)

Çështja e vazhdimësisë në punë nuk është çështje delikate e pazgjidhur. Vërtet fillimi është i vështirë, por kjo çështje zgjat vetëm disa ditë, e nëse tregohemi të suksesshëm dhe fillojmë realizimin dhe ditët e para kalojnë me sukses, atëherë shumë shpejt e gjejmë rrugën e qartë dhe të shtruar që na çon drejt qëllimit të caktuar. Por, nëse qysh në fillim i parashikon vështirësitë e suneteve dhe nafileve dhe

ndien frikë se mos vallë do të heqësh dorë pas një kohe, mos u mërzit, mos e detyro veten të bësh atë që nuk mundesh, se këtë nuk e do as Allahu i Madhërishëm: *“Zoti ynë, mos na ngarko barrë të rëndë...”* (El-Bekare, 286) – e as i Dërguari s.a.v.s., që u dërgua për të lehtësuar e jo për të vështirësuar. Ai s.a.v.s. na mësoi parimin, së cilit do t’i përmbahe mi gjithmonë në jetë, **“aq sa mundemi”**. Ky parim do të na shoqërojë gjithmonë, në secilën punë ose adhurim që kemi premtuar se do ta bëjmë.

*“I Dërguari s.a.v.s. u thoshte njerëzve që ia jepnin besën (zotoheshin): “aq sa mundesh.”* (Albani thotë se hadithi është sahih)

*“Zotëria i istigfarit: Allahu im, Ti je Zoti im, nuk ka zot tjetër përveç Teje, Ti më krijove e unë jam rob i Yt, dhe unë në besën Tënde dhe premtimin Tënd qëndroj aq sa mundem...”* (Buhariu)

*“Ke drojë Allahun, aq sa mundesh përmende Allahun pranë çdo druri e guri, për çfarëdo të keqe që ke bërë pendohu, e fshehta me të fshehtë, e dukshmja me të dukshme.”* (Albani thotë se hadithi është sahih)

*“Kur i Dërguari s.a.v.s. i urdhëronte ata (shokët e tij), i urdhëronte për punë që mund t’i bënin. Disa thanë: “Ne nuk jemi si ti, o i Dërguari i Allahut – d.m.th. Allahu do të na llogarisë me llogari të vështirë, që nuk vlen për ty, sepse Ai t’i ka falur ty gabimet e mëparshme dhe të ardhshme- ” I Dërguari s.a.v.s. u zemërua, saqë u pa në fytyrën e tij zemërimi, e pastaj tha: “Më shumë që ia kanë frikën Allahut dhe më shumë që e njohin Atë jam unë.”* (Buhariu)

Islami u dha leje të posaçme atyre që detyrohen t’i falin namazet jo në kohën e tyre, për shkak të punëve të ngarkuara ditore ose të papritura, që të mund të përputhin punët e tyre me namazet.

*“I Dërguari s.a.v.s. bashkoi namazin e drekës me të ikindisë dhe atë të akshamit me atë të jacisë në Medinë, nuk kishte arsye frike ose shiu (pa arsye udhëtimi ose frike).”*

*“I thanë Ibn Abbasit: “Po pse e bënte këtë (çfarë e shtynte ta bënte këtë ose çfarë deshi të tregonte me këtë)? Ai tha: “Deshi të mos e mundonte Umetin e tij.” (Muslimi)*

*“Nëse dikush nga ju ka një punë të rëndësishme dhe ka frikë se mos i kalon namazi, atëherë le ta falë atë namaz, d.m.th. le t’i bashkon dy namaze.” (Albani thotë se hadithi është sahih)*

*“Një ditë Ibn Abbasi na ligjëroi pas namazit të ikindisë e deri në perëndim të diellit dhe filluan të duken yjet. Njerëzit filluan të thonë: “Namazi, namazi.” Atëherë erdhi një njeri nga fisi beni Temim dhe i tha: “Namazi, namazi!” Ibn Abbasi tha: “A po më mëson për sunetin!” E pastaj tha: “E kam parë të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. që bashkoi namazin e drekës dhe të ikindisë, të akshamit me jacinë.” Abdullah ibn Shekiku tha: “Diçka më ngacmoi në gjoks nga kjo që tha dhe shkova tek Ebu Hurejra dhe e pyeta, e ai ma vërtetoi thënien e tij (Ibn Abbasit).” (Buhariu)*

*“Kush e harron namazin ose e zë gjumi, le ta dijë se shpëgim i kësaj është që ta falë kur t’i kujtohet.” (Muslimi)*

*“Kush e zë një rekat të namazit të sabahut para se të lindë dielli, ai e ka zënë namazin e sabahut, e kush e zë një rekat të namazit të ikindisë para se të perëndojë dielli, ai e ka zënë namazin e ikindisë.” (Muslimi)*

*“Kush e zë një rekat të namazit me imam, ai e ka zënë tërë namazin.” (Muslimi)*

Në fund, nëse ndodh që krahas gjitha këtyre lehtësimeve dhe lejimeve që ndonjëri të mos mund t’i kryejë gjërat e duhura, le të mos mërzetet, mjafton që ai t’i falë namazet farz, siç pohon i Dërguari s.a.v.s., i cili në bisedë e sipër me fshatarin që këmbënguli të mos e rriste numrin e farzeve e as të mos e pakësonte, tha fjalinë e njohur: *“Ka shpëtuar nëse tregohet i sinqertë.”*

Në fund, gjithë këtë që deri tani e thamë, Kur’ani famëlartë e pohon duke thënë: *“Frikësojuni Allahut sa të mundeni.” (Et-Tegabun, 16)*

## TRIBUNJA E KATËRT PËRGATITJA PËR UDHËTIMIN MADHËSHTOR

### Pjesa 1

#### Ezani dhe nëntë çudirat e tij

Adeti dhe zakonshmëria gati se i mbytnë ndjenjat dhe të vërtetat që duhet të mbeten të gjalla në shpirtin tonë! Ato rizbulohen dhe rifreskohen gati çdoherë që i përsërisim.

**E para: Ezani dhe ikameti** janë viktimë e adetit dhe zakonshmërisë, përkundër asaj që ngërthejnë në vetvete, në formën e tyre, rolin e tyre dhe çudirat që do të përpiqemi t'i shtrojmë para nesh e që janë më së paku nëntë, aq sa mundësojnë aftësitë njerëzore apo aftësia ime së paku të zbulojë:

**Ezani dhe ikameti** përbëjnë rrëfimin e një lindje të çuditshme në jetën e të Dërguarit s.a.v.s., e që ngrihet në shkallën e përafërt me shkallën e Shpalljes, nëse nuk është vetvetiu shpallje, por me metoda të ndryshme dhe persona të ndryshëm. Metoda e ezanit dhe ikametit dhe tekstit të tyre erdhi në ëndërr, e jo në zgjim, kurse personat ishin shokët e të Dërguarit s.a.v.s., e jo vetë ai.

Ishin dy shokët e të Dërguarit s.a.v.s. që panë të njëjtën ëndërr, me të njëjtat fjalë (tekst), me të njëjtat detaje, por elementi më i rëndësishëm dhe më i çuditshëm në ngjarje është se njëri nga këta dy shokët e të Dërguarit s.a.v.s. ishte Omer ibn el-Hattabi (Allahu qoftë i kënaqur me të), Kalifi i dytë i drejtë i muslimanëve.

Le ta dëgjojmë rrëfimin e ezanit dhe ikametit që na e transmeton shoku tjetër i të Dërguarit s.a.v.s.:

“Atëherë kur urdhëroi i Dërguari i Allahut s.a.v.s. që t'i bihet kabanës për t'i tubuar njerëzit për namaz, duke

qenë se në ëndërr m'u paraqit një njeri i cili barte një kambanë në dorën e vet dhe i thashë: "O rob i Allahut, e shet këtë kambanë? M'u përgjigj: E çdo të bësh me të? I kam thënë: Të ftojë njerëzit për në namaz. Ka thënë: A nuk dëshiron që të udhëzoh diç më të vlefshme se kjo? I kam thënë (atij): po si jo. Ai më tha që të them: Allahu është më madhi, Allahu është më i madhi. Dëshmoj dhe deklaroj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut. Dëshmoj dhe deklaroj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut. Dëshmoj se Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Dëshmoj se Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ejani në namaz. Ejani në namaz. Ejani në shpëtim. Ejani në shpëtim. Allahu është më i madhi. Allahu është më i madhi. Nuk ka zot tjetër përveç Allahut. Pastaj u largua nga unë, por jo shumë larg, e tha: Kur të ngritësh për namaz, thuj: Allahu është më madhi, Allahu është më i madhi. Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut. Dëshmoj se Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ejani në namaz. Ejani në shpëtim. Namazi po falet. Namazi po falet. Allahu është më i madhi. Allahu është më i madhi. Nuk ka zot tjetër përveç Allahut. Kur u zgjova shkova te i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe e informova për ëndrrën që e pashë. Atëherë i Dërguari s.a.v.s. më tha: *"Ajo është ëndërr e vërtetë, nëse do Allahu. Atëherë ngrihu merr Bilalin dhe mësoja atij atë që e ke parë dhe le të thirr me të. Sepse ai e ka zërin më kumbues se tëndin."* Unë u ngrita me Bilalin dhe fillova t'ia mësojë e ai e thirte atë që ia mësova. Tha: këtë e dëgjoji Omeri, i biri i Hatabit, ishte në shtëpi dhe menjëherë doli duke e tërhequr xhyben e tij, thoshte: "Pasha Atë, që me të drejtë të ka dërguar, o i Dërguar i Allahut, edhe unë e kam parë ashtu siç e ka parë ai. I Dërguari s.a.v.s. tha: *"Allahut i qoftë falënderimi (hamdi)."*

E **dyta**: Ezani dhe ikameti zënë vend të posaçëm dhe të rëndësishëm në fenë tonë, siç kuptuam nga hadithi i lartë-theksuar, pozita e tyre vërtetohet me ëndrrën e parë nga dy

shokët e të Dërguarit s.a.v.s., në të njëjtën kohë, por edhe konfirmimi i të Dërguarit s.a.v.s. për këtë. Prandaj, e drejtë e jona është të pyesim: Pse ishte ezani? Pse e tërë kjo rëndësi dhe vlerë? A është domosdoshmëri e namazit? A nuk ishte e mundur që muslimanët të kishin ndonjë metodë tjetër? A thua sot, kur i kemi të gjitha mjetet elektronike dhe kompjuterike, ta zëvendësojmë me gjë tjetër, siç është zilja e orës së murit, zilja e telefonit, orës pranë dyshemesë etj, gjëra që na i mundëson teknologjia moderne?

A thua ezani ka qenë vetëm alternativë e kabanës (zëvendësim) apo vetëm metodë akustike fillestare për t'i zgjuar njerëzit nga gjumi për namaz natën dhe ditën, që bënë të nënkuptojmë se metodat tjera moderne dhe më të zhvilluara dhe më efikase mund të jenë alternativë që do ta zëvendësonin atë sot?

Ndoshta dikush mendon se ezani është praktikë gjuhësore marginale që nuk meriton vëmendjen që e ka namazi i rëndomtë, prandaj nuk e vlerësojnë atë siç duhet para namazit. Mirëpo, i Dërguari s.a.v.s., ai që na dëshiron të mirën, besniku i Shpalljes, që Allahu e cilësoi se është: *"...i butë e i mëshirshëm me besimtarët."* – na tregon të kundërtën.

Në vijim do të përpiqemi që para nesh të shtrojmë një dialog tematik që zhvillohet midis të Dërguarit s.a.v.s. dhe ezanit dhe myezinit:

- Transmeton Malik ibn El-Huvejrith dhe thotë: "Ishim disa djem të ri që shkuam tek i Dërguari s.a.v.s., aty qëndruam njëzet net. I Dërguari i Allahut ishte shumë i butë dhe i mëshirshëm, mendoi se mos vallë jemi mërëzitur për familjet tona, ndaj na pyeti se kë kemi lënë nga familjet tona, e ne i treguam. Ai tha: *"Kthehuni te familjet e juaja, qëndroni me ata dhe mësoni ata, urdhëroni që kur të vjen koha e namazit dikush nga ju le ta thërret ezanin dhe për imam le të bëhet ai që nga mesi juaj është më i madh."* (Nesaiu, Albani thotë se hadithi është sahih)

- *“Nëse janë tre vetë dhe nuk thërrasin ezan, dhe nuk falet namazi, le ta dinë se djalli i ka vënë poshtë.”* (Ahmedi)

- Transmeton Abdullah ibn Abdurrahman ibn ebi sa'sa' se ebu Seid El-Huderi i ka thënë babait të tij: *“Shoh se i do bagëtitë (delet) dhe shkretëtirën, andaj nëse ndodh të jesh me bagëtinë ose në shkretinë dhe e thërret ezanin, atë thirre me zë të lartë; sepse nuk ndodh që dikush ta dëgjojë largësinë e zërit të myzinit, xhind ose njeri e ndonjë send, përveçse do të dëshmoj për të Ditën e Kiametit.”* (Buhariu)

- *“Kur thërret ezani, djalli ia mbath larg, të mos e dëgjoj ezanin, e kur të mbaroj ezani, ai kthehet. Por kur thërret ikameti, ai përsëri ik larg, e kur të mbarojë, ai kthehet duke ia sjell ndërmend njeriut gjësendet (futet midis njeriut dhe shpirtit të tij), i thotë: kujtoje këtë, kujtoje këtë, gjëra që nuk i ka kujtuar më parë, gjëra që para namazit nuk i kanë shkuar ndërmend, derisa njeriu të habitet se sa rekat ka falë, e nëse dikush nuk e di se sa rekate ka falë, atëherë le t'i bëjë dy sexhde duke qenë ulur...”* (Muslimi)

- *“Zoti i juaj çuditet (mahnitet) me bariun në maje të kodrës, thërret ezan dhe falet, e Allahu thotë: “Shikojeni robin Tim, thërret ezan dhe fal namaz nga frika Ime, ia kam falë robin Tim dhe e kam futë në Xhenet.”* (Ebu Davudi)

Janë këto disa qëndrime profetike që shënojnë rëndësinë e veçantë të këtij adhurimi që ka tek Allahu, shpërbliimet e namazit fillojnë qysh me fillimin e ezanit. Ai, në fakt, është lloj i namazit, ai ngërthen mënyrën e tij të veçantë, kushtet, rregullat, valët reaktive, pagën e paraparë për myzin, gjëra që i japin karakter dhe aromë të veçantë. Bile edhe zbrazëtira kohore midis ezanit dhe ikametit luan rol të rëndësishëm adhurues, është rast i shtrenjtë midis njeriut dhe Allahut, hapësirë kohore që nuk mbeten të paplotësuara lutjet e besimtarit: *“Duaja midis ezanit dhe ikametit nuk kthehet.”* (Ebu Davudi)

Që këtej edhe myezini në Islam ka pozitë të veçantë, ai ka kushtet e tij dhe përgjegjësitë që e bëjnë ta zë këtë vend të veçantë.

I Dërguari s.a.v.s. thotë: *“Imami është dorëzan, kurse myezini i besueshëm. Allahu im, udhëzoi imamët dhe fali myezinët. Të pranishmit thanë: “O i Dërguari i Allahut, na ke lënë që pas teje të bëjmë gara midis vete për ezanin. Atëherë i Dërguari i Allahut s.a.v.s. tha: “Pas meje do të ketë (apo pas juve) njerëz, fundërrinë (horr) e tyre do të jenë myezinët.”* (Muslimi)

*“Myezinit i falet aq sa hidhet larg zëri i tij, për të kërkojnë falje çdo vend i thatë e i lagët...”* (Ibn Maxhe, Albani thotë se hadithi është sahih)

*“Allahu dhe engjëjt e Tij luten për safin e parë (ata që falen përpara), myezinit i falet aq sa hidhet larg zëri i tij, fjalët e tij i vërtetojnë të gjithë që i dëgjojnë, kudo që janë në të thatë e të lagët...”* (Nesaiu, Albani thotë se hadithi është sahih)

Kjo pra është pozita e ezanit dhe pozita e myezinit në Islam, prandaj mos humb rastin që ta dëgjosh me vëmendje atë dhe t'i përsërisësh fjalët e tij, mos u trego i shkujdesur kur atë e thërret në shtëpinë tënde, kur namazin e fal me familjen tënde apo në zyrë me kolegët e tu. Nëse ke frikë se i zgjon të tjerët apo i shqetëson, atëherë vendosni në ndonjë skaj të shtëpisë tënde, mjafton të të dëgjojnë muret, pajisjet, lulet, bimët, trëndafilat, pemët etj, e të kërkojnë falje për ty tek Allahu, siç na premton i Dërguari s.a.v.s.

Nëse ezani është vetëm paralajmërim, atëherë çfarë kanë bagëtitë, shkretëtira dhe gjërat e ngurta ta dëgjojnë atë? Si e mposht djalli atë që nuk thërret ezan? Si ia mbath djalli larg kur e dëgjon ezanin? Porositë e shtrenjta pejgamberike ishin kandil ndriçues dhe udhëzim për muslimanët e parë që dëshmonin vlerën e ezanit dhe ikametit si dhe rolin e tyre adhurues në jetë. Përpiqu që të mos shkojë huq ky adhurim në jetën tënde.

**E treta:** Ezani, përbërja e tij, e vërteta dhe domethëniet e tij llogariten namaz i shkurtër parapërgatitor që përgatisin besimtarin për namazin e tij të gjatë që vijon, tamam siç është sunet që foshnjës së porsalindur t'i thirret ezani në veshin e djathtë; për të është namaz i shkurtër parapërgatitor që do t'ia hap derën e namazit të tij të gjatë, që do të vazhdojë tërë jetën.

Jeta jonë, me të gjitha ato që i ka, është një lloj namazi, por me mënyra të ndryshme dhe rrugë të shumëllojshme. A nuk thotë Kur'ani famëlartë se jeta jonë, nga lindja e deri në vdekje, është adhurim që ne e kryejmë? Ai thotë: *“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të më adhurojnë.”* (Edh-Dharijat, 56)

Le t'ju hedhim një vështrim studiues fjalëve të ezanit, e të zbulojmë se fjalët e tij janë vërtet namaz i shkurtër që na përgatisin rrugën për namazin tonë të gjatë që na pret.

**Allahu ekber (Allahu është më i madhi):** shprehje që të thotë dhe vazhdon pa rresht të të thotë: hiq dorë tani nga çdo gjë dhe drejtohu kah Allahu, se Allahu është më i madh se çdo gjë që të largon prej Atij, hiq dorë nga çdo gjë... nga çdo gjë.

**Eshhedu en la ilahe ilallahu, ve eshhedu enne Muhammeden resulull-llah (dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhammedi është i Dërguar i Tij):** janë shtylla e parë e Islamit, andaj doemos tani ta konfirmosh këtë shtyllë themelore para Allahut, me gjuhë dhe zemër, para se të fillosh kryerjen e shtyllës së dytë.

**Hajje ale's-salah':** përderisa plotësove shtyllën e parë të Islamit, eja bëhu gati për të kryer shtyllën e dytë: namazin.

**Hajje ale'l-felah:** pasi u bëre gati dhe bashkove shtyllën e parë dhe të dytën, dije se ke shpëtuar dhe fituar shumë në dynja. Shqyrto bukur lidhshmërinë praktike midis namazit dhe shpëtimit: **hajje ale's-salah** dhe **hajje ale'l-felah**, d.m.th: fale namazin, sepse ai është shpëtim.

**Allahu ekber:** eja pra, çfarë të interesojnë vogëlsirat e dynjasë? Eja, drejtohu kah Ai që është më i madhi se çdo send.

**La ilahe il-lallahu:** esenca e ezanit, esenca e namazit, esenca e Islamit.

Është vërtet lloj namazi buçitës, informues, motivues, që deklaron para njerëzve, jo vetëm para muslimanëve, e t'u thotë me pak fjalë: O njerëz! Ky është Allahu, ky është Islami, çfarë jeni duke pritur? Hiqni dorë nga çdo gjë dhe kthehuni kah Allahu.

E **katërta:** Supozo se nuk ke dëgjuar kurrë për ezanin më parë, e as për fjalët e tij. Paramendo se për herë të parë dëgjon fjalën **Allahu ekber**, edhe pse shprehja e tillë është më e hershme se vetë ezani, se muslimanët e dinin këtë para se ta dinin namazin; mendo për kuptimin e saj, përbërjen gjuhësore të veçantë, është fjalë e paplotë për nga aspekti gramatikor, megjithatë është e hapur për të gjitha mundësitë që mund ta plotësojnë atë, qoftë imagjinata jote ose realiteti yt: **Allahu ekber** – Allahu është më i madhi – se e tërë dynjaja që më preokupon tani, **Allahu ekber**, më i madh se pasuria që e kam në duar, **Allahu ekber**, më i madh se brenga që ma ngushton jetën, **Allahu ekber**, më i madh se armiku me të cilin ballafaqohem, **Allahu ekber**, më i madh se tiranët dhe zullumqarët që më persekutojnë e torturojnë... etj.

Dëgjo me vëmendje të plotë shprehjen **Allahu ekber**, dëgjoje me veshë të ri dhe do të vëresh se ajo të thotë – bile para se të dëgjosh shprehjen **hajje ale's-salah** (ejani në namaz): hiq dorë nga çdo gjë dhe kthehu kah Allahu, se Allahu është më i madh se çdo gjë që ke para duarve. E nëse djalli të vihet mbrapa dhe ta kthen fytyrën te gjërat që i ke para duarve dhe gjërat e dynjasë, përsëri dëgjon fjalën **Allahu ekber**, që kokën tënde me ngulm e kthen kah Allahu, kësh-tu herë pas here...

**Allahu ekber:** shprehje që vërtet ngërthen tërë ezanin, është boshti i kësaj thirrje të çuditshme me të cilën veçohet Islami, bile është shprehje që ngërthen tërë Islamin. Ne muslimanët sikur deklarojmë nënshtrimin tonë dhe përkuljen tonë dhe dëshminë se Allahu është më i madh se çdo gjë tjetër, ne i nënshtrohemi dhe i dorëzohemi Atij. Thënë shkurt është “shprehja Islam”..(**Allahu ekber = Islam**). Rëndësia e saj vërehet në përsëritjen e saj plotë gjashtë herë në ezan, në namazet tona përsëritet pesë herë, shëmbëllen me zilen paralajmëruese që paralajmëron hyrjen e djallit në lidhjen midis neve dhe Allahut, prandaj themi Allahu ekber, që ta dëbojmë larg neve dhe t’i kthehemi Allahut.

**E pesta:** Ezani, me fjalët e tij të pakta e të caktuara, përbën një lloj të veçantë e të re të metodës gjuhësore për arabët dhe jo arabët. Kujtoj se sikur linguistët arabë të kishin rast të përpilonin fjalët e ezanit, me siguri se nuk do të mund t’i përpilonin kështu siç janë.

Ezani për arabët ishte shpirti i thirrjes së re, që për hir të saj ata hoqën dorë nga idhujt e tyre, besimi dhe injoranca e tyre.

**E gjashta:** Që edhe më tepër të çuditemi është ajo se gjuha e këtij namazi të shkurtër akordohet plotësisht me gjuhën e pjesës më të rëndësishme të namazit tonë të gjatë, **Fatihën**. Është surja Fatiha që na përjashton natyrën e thjeshtë e të zakonshme gjuhësore me të cilën jemi mësuar! Kujtoj se sikur çështja e kësaj sureje të mbetej në duart e gjuhës sonë njerëzore, surja në fjalë do të ishte e pakuptimtë. S’ka dyshim se këto dy namaze, e shkurtra dhe e gjata, janë në harmoni të plotë mes vete. Ezani, pra, konfirmon pozitën e tij të shenjtë në Islam dhe gjithashtu edhe teksti i tij është i shenjtë, siç vërehet në sunetin e të Dërguarit s.a.v.s., që nuk i lejuan vetes me shtesë ose pakësim të ndonjë shprehjeje.

**E shtata:** Pikërisht për shkak të kësaj pozite që zë ezani në adhurimin tonë, ai ngërthen rregulla dhe kërkesa, andaj na mbetet, siç kërkon suneti pejgamberik, të përshtatemi me fjalët e tij, fjalë për fjale, të tingëllojmë me jehonën e këtyre fjalëve, por jo vetëm kaq, në fund të tyre të shqip-tojmë fjalë të tjera profetike që i përsërisim pas myezinit.

*“Kur myezini thotë: Allahu ekber, Allahu ekber, e ndonjëri nga ju thotë po ashtu: Allahu ekber, Allahu ekber; e pastaj ai thotë: eshhedu en la ilahe ila-llah, e ky përsëri thotë: eshhedu en la ilahe ila-llah; e ai thotë eshhedu enne Muhameden resulullah, e ky thotë: eshhedu enne Muhameden; pastaj (muezini) thotë: hajje ales-sala’, e ky thotë: la havle ve la kuvvete ila bil-lah; muezini thotë: hajje al-el-Ifelah, e ky thotë: la havle ve la kuvvete ila bil-lah, e pastaj (myezini) thotë: Allahu ekber, Allahu ekber, kurse ky thotë: Allahu ekber, Allahu ekber, pastaj thotë: La ilahe ila-llah, e ky thotë: la ilahe ila-llah, me zemër - do të hyjë në Xhenet.”* (Muslimi)

*“E kam dëgjuar Muavijen, të birin e ebu Sufjanit, që teksa ishte ulur në minber myezini e thirri ezanin. Ai përsëriste fjalët e myezinit një pas një. Kur myezini tha: Allahu ekber, Allahu ekber, edhe ky tha: Allahu ekebr, Allahu ekber, kur ai tha: eshhedu en la ilahe ila-llah, Muaviju tha: edhe unë. Kur muezini tha: eshhedu enne Muhameden resulullah, Muaviju tha: edhe unë. Kur mbaroi ezani, ai tha: “O njerëz, unë e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut në këtë tubim, kur thirri muezini, ai thoshte atë që e dëgjuat prej meje që thoja.”* (Buhariu)

Reaksioni i çuditshëm midis ezanit dhe dëgjuesit nuk përfundon me shprehjen e fundit (**la ilahe il-lallah**), por pasojnë valët e tjera refleksive që i Dërguari s.a.v.s. i vë në gjuhën e besimtarëve që i përsërisin ato. Fjalët e tilla nënkuptojnë “lëkundje reaktive” të ezanit, që vërtetojnë ndodhjen e influencës ose reaksionit të kërkuar midis fjalëve të tij dhe shpirtit të besimtarit.

*“Kur ta dëgjoni myezinin, atëherë thoni ashtu siç thotë ai, pastaj çoni salavat për mua, se kush çon salavat për mua, Allahu do të çon për të dhjetë herë salavat, e pastaj luteni Allahun për mua për pozitën e lartë, se është pozitë në Xhenet, që i takon vetëm një robi nga robërit e Allahut, e unë kam shpresë të jem ai, kush lutet për mua për pozitën, atij i takon shefati.” (Muslimi)*

*“I Dërguari i Allahut s.a.v.s. më mësoi të them në prag të ezanit të akshamit: “Allahu im, ky është momenti i fillimit të natës Tënde dhe mbarimit të ditës Tënde, dhe zërave të atyre që të thirrin (luten), andaj më fal mua.” (Ebu Davudi)*

*“Kush thotë kur e dëgjon ezanin: “Allahumme rabbe hadhihi ‘d-da’veti ‘t-tammeti, ves-salati ‘l-kaimeti, ati Muhammedeni‘l-vesilete ve‘l-fadilete, veb’ath’hu mekamen mahmuden el-ledhi vead’tehu – atij i takon shefati im në Ditën e Kiametit.” (Buhariu)*

*“Kush thotë kur e dëgjon myezinin: eshhedu en la ilahe ilallahu, vahdehu la sherike lehu ve enne Muhameden abduhu ve resulu-luhu, redijtu bil-lahi rabben ve bi Muhammedin resulen ve bi‘l-islami dinen (i kënaqur jam me Allahun për Zot, me Muhammedin për peygamber dhe me Islamin për fe) – i falet gjynahu.” (Muslimi)*

**E teta:** Element çuditës në ezan paraqet edhe përsëritja harmonike e fjalëve, gjë që edhe më tepër përforcon esencën e tij të pavarur, por edhe përforcon platformën e përgjithshme të namazit.

Numri **dy** nuk është numër bosht i përhapur në adhurime dhe lutje e dhikër, aty zakonisht përmenden numrat: tre, shtatë, dhjetë, shtatëmbëdhjetë, njëzet e shtatë, tridhjetë e tre, nëntëdhjetë e nëntë, njëqind etj. Megjithatë, shprehjet e ezanit përsëriten vetëm dy herë; ekziston një harmoni e plotë e kësaj dysheje me përbërjen e namazit tonë; në fillim ngremë dy duar, ulemi pas dy rekateve, në çdo rekat kemi dy sexhde, që në fund të namazit të përsëritim me fytyrën dy herë. Kjo na bën të ndiejmë se me përsëritjen e ezanit, ne në fakt jemi duke përsëritur namazin e shkurtër.

**E nënta:** a keni vërejtur ndonjëherë se si shprehjet e ezanit tingëllojnë me gjuhë asnjane, pa përemër të caktuar, njëjës ose shumës! Nga kjo përjashtohet vetëm dëshmia se Allahu është Një dhe Muhammedi i dërguar i Tij, që nënkuptojnë përgjegjësinë individuale dhe rëndësinë e vërtetimit të kësaj përgjegjësie me gjuhën e atij që e përsërit (unë dëshmoj). Shprehjet asnjane të ezanit akordohen me shprehjet e sures Fatiha, shtyllës së namazit.

A nuk vërejmë se pjesa e parë e sures Fatiha është e tillë? Ajo është plotësisht e zhveshur nga përemrat vetorë që zakonisht ne i përmendim ose shkruajmë. Lexo bashkë me mua:

**Bismi'l-lahi'r-rrahmani'r-rrahim, el-hamdu li'l-lahi rabbi'l-alemin, er-rrahmanir-rrahim, maliki jevmi'd-din..**

(Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit! Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit, Sunduesit të Ditës së Gjykimit...)

A i vëreni pra shprehjet asnjane me të cilat formohet kjo pjesë e Fatihës? Natyrisht se surja Fatiha më pas do të shndërrohet në përemër vetor (Ne), për shkaqe esenciale: **ne të adhurujmë, ne kërkojmë ndihmë, na udhëzo neve...!**

Dëgjimi i ezanit kërkon ndjenja të veçanta, sikur e dëgjojmë për herë të parë, të mos lejojmë që zakonshmëria të na i mbytë ndjenjat madhështore dhe rolin e ezanit dhe fjalët e tij në jetë.

Përsëri, paramendo sikur e dëgjon ezanin për herë të parë, edhe pse e dëgjon pesë herë në ditë, se vetëm kështu do të rizbulosh madhësitinë e shprehjeve, lëkundjen e fjalëve madhështore që ngacmojnë ndjenjat e besimit tënd, fjalët që ngërthejnë Islamin dhe tevhidin, sidomos akordimi i tyre me namazin, dhikrin, tesbihun dhe ajetet.

Ezani është projekt i vogël investues, që i paraprinë projektit investues gjigant: namazit.

## Pjesa 2

### Dy lloje abdesti

*“Sikur të mos tregohesha i rëndë për Umetin tim, do t’i urdhëroja që për çdo namaz të marrin abdest dhe me çdo abdest të përdorin misvakun.”* (Ahmedi, Albani thotë se hadithi është sahih)

Më ka ndodhur që shumë herë të qëndroj para këtij hadithi e të pyetem: pse për çdo namaz?! Përderisa jam me abdest e i pastër, që është bazë e sunetit, pse i Dërguari i Allahut s.a.v.s. të dëshiroj që unë të marr abdest për çdo namaz?! Po a thua se marrja e abdestit për çdo namaz nuk është teprim në harxhim të ujit? Si e kuptojmë këtë porosi profetike që doli nga zemra e shkretëtirës e jo nga vendet e lumenjve të mëdha ose ujëvarat e Nijagarës?!

Në vitin 1977 me bashkëshorten time vizitua qytetin Larnaka të Qipros. Bashkëshortja ime ishte shoqëruar me një vajzë në universitet, babai së cilës ishte kryetar i komunës së qytetit. U takuam dhe morëm rrugën për të vizituar monumentet më të rëndësishme të qytetit. Ndër monumentet e qytetit ishte edhe xhamia e sahabijes madhështore, Umu Haram. Gruaja e ndershme ishte varrosur aty pasi kishte vdekur në prag të luftës së parë detare që e zhvilluan muslimanët në kohën e Muaviut. Rrëfimi i saj është i njohur për të gjithë muslimanët, ngase shpresoi tek i Dërguari s.a. v.s. të ishte pjesëmarrëse në këtë luftë, e ai s.a.v.s. u lut për të. Ajo tregon se i Dërguari s.a.v.s. kishte thënë: *“Ushtria e parë e Umetit tim që do të lufton në deti do të jetë i shpërblyer me Xhenet. Umu Haram tha: “O i Dërguari i Allahut, a jam unë në mesin e tyre? Ai tha: “Po, ti do të jesh në mesin e tyre.” Pastaj ai s.a.v.s. tha: “Ushtria e parë që do të lufton qytetin mbretëror do të jenë të falur.” Unë thashë: “o i Dërguari i Allahut, a do të jem në mesin e tyre?” ai s.a.v.s. tha: “Jo.”* (Buhariu)

Grekët pas ndarjes së Qipros e kishin shndërruar këtë xhami në muze. Me të arritur në xhami, hapa derën dhe shikova brenda, nuk arrita të përmbahem dhe nga unë doli një *Ah* e çuditshme dhe thashë: “Sa i pastër qenka ky vend!! Kryetari i komunës më dha një përgjigje që për mua dhe bashkëshorten time ishte grusht i madh, që sot e kësaj dite e ndiej: “Natyrisht që të jetë kështu kur është nën pushtetin grek”.

I kam lexuar të tri librat e shenjtë qiellorë, kam lexuar shumë hadithe, por nuk kam gjetur fe që besimin e tij, namazin, adhurimin dhe civilizimin e lidh me pastërtinë dhe abdesin, siç është Islami, nuk kam gjetur profet që ka porositur popullin e tij për pastërti dhe zbukurim me rroba dhe pamje të bukur, siç porositi Muhamedi s.a.v.s. popullin e tij. Megjithatë, ku është Umeti islam dhe ku janë mësimet islame?

Po, abdesi për çdo namaz nuk është farz, por hadithet e më lartë-shënuara dhe hadithet tjera janë vërtetim pejgamberik dhe thirrje për rëndësinë e pastërtisë fizike dhe mirësinë e përtëritjes së tij çdo herë, edhe nëse bëhet fjalë për abdestin.

*“I Dërguari s.a.v.s. merrte abdest për çdo namaz. Unë thashë: “E ju si vepronit? Tha: “Ne mjaftoheshim me një abdest, përderisa nuk e prishte atë.” (Buhariu, Enes ibn Maliku)*

Përsëritja e abdestit nuk nënkupton pastërtinë vetëm si fenomen shëndetësor, kulturor dhe civilizues, por edhe pastrim të brendshëm shpirtëror. Pastërtia e plotë fizike që nënkupton trup dhe rroba të pastra në fakt është rezultat i pastërtisë së brendshme që doemos të reflektojë. Disa drejtime juridike islame mendojnë se gibeti (përgojimi) llogaritet nga gjërat që e prishin abdestin.

Që këtej, na mbetet të themi se kemi të bëjmë me dy lloje të abdestit: i brendshëm dhe i jashtëm, i pari është më i rëndësishëm, i dyti nuk ka dobi pa të parin. A thua si do të merr abdest ai që është zhytur në një gropë plehrash?

Doemos t'ia vërtetosh vetes se gjatë pastrimit të gjymtyrëve të jashtëm ke qenë i kujdesshëm për pastrimin e gjymtyrëve të brendshme, pastrim që nuk bëhet me ujë ose tejemum, por me shpëtim prej njollave të shpirtit që janë grumbulluar brenda teje; prej zilisë, smirës, mashtrimit, zemërimit, përgojimit, egoizmit, rrenës, mosrespektit, mohimit, keqbërjes, ligësisë së gjuhës, shpirtit të poshtër, gjynahut, mendimit të keq, qëllimit të keq...

Bëhu i sinqertë dhe vendos se do të pastrohesh nga gjithë këto ndyrësira, hap pas hapi, deri në çastin kur të arrih të bëhesh i aftë për t'u pastruar plotësisht, të jesh i pastër në fytyrë, zemër, fjalë etj. Kujto se do të jesh para Allahut, do të shqiptosh fjalë që do të shkojnë tek Ai, e Ai i pranon, i lutesh e Ai të dëgjon, i kërkon falje e Ai të falë.

*"Një njeri erdhi tek i Dërguari s.a.v.s. dhe tha: "Filani falet natën e kur zgjohet në mëngjes vjedh." Ai tha: "Ai (namazi) me siguri do ta ndalojë (nga vjedhja)." (Mishkat 'ul-Mesabih, Albani thotë se hadithi është sahih)*

*"A e dini kush është i falimentuar? Të pranishmit thanë: "I falimentuar në mesin tonë është ai që nuk ka dirhem e as pronë (pasuri)." Ai tha: "I falimentuar i vërtetë i Umetit tim është ai që në Ditën e Kiametit do të vjen me namaz, agjërim dhe zekat, por vjen që ka sharë këtë, ka shpif këtë, ka ngrënë pasurinë e këtij, ka vrarë këtë, e ka rrahur atë dhe, ju jep nga të mirat e tij që i ka atij e atij, e kur t'i mbarojnë të mirat para se të përfundon gjykimi kundër tij, iu merren të këqijat që i kanë të tjerët dhe ia japin këtij, e pastaj hidhet në zjarr." (Muslimi)*

Vallë, sa prej nesh ka që janë të falimentuar? Sa prej nesh nuk bëjnë dallim midisi adhurimit dhe adetit? Sa njerëz ka që i shohim duke u falur, në ruku e sexhde, në ballin e tyre kanë shenjën e sexhdes, por kur merr të bashkëpunosh me ata, vëren se në ballin e tyre nuk është shenja e sexhdes, në ballin e tyre nuk ka asnjë gjurmë. Namazi i tyre

është në anën tjetër, kurse jeta e tyre në anën tjetër. Nëse namazi nuk arrin të të pastrojë njoilat e jetës tënde, sëmurdjet e mjedisit tënd, shtrembërimet e marrëdhënieve që i ke me veten, familjen, fqinjët, shokët dhe shoqërinë, bile edhe me armiqtë e tu, atëherë dije se ti nuk ke marr abdestin e parë që duhet për namaz. S'ka dyshim se namazi i tillë është i padobishëm, ka vetëm trupin e namazit, por është i paralizuar, i paaftë për të qëndruar në këmbë për të të ngrihtë në qiell apo për të ndryshuar diçka në ty.

*“Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar.”* (El-Ankebut, 45)

Dukuria e ndarjes midis adhurimit dhe punës është bërë gjëja më e rrezikshme që sot shtrembëron pasqyrën e shëndoshë të Islamit para botës. Muslimanët sot lejuan këtë ndarje të rrezikshme në jetën e tyre. I Dërguari s.a.v.s. nuk e ndante adhurimin nga puna, ai i mësonte të tjerët për shpalljen dhe punën me të. *“Transmeton Ebu Abdurrahman es-Selemi, Othmani, Ibn Mes’udi dhe Ubejj ibn Ka’bi se i Dërguari s.a.v.s. ua lexonte dhjetë ajete dhe nuk kalonte te dhjetë të tjerat përderisa nuk mësonin se çfarë pune kërkonin ato ajete të bëjnë, kështu mësuam Kur’anin dhe punën përnjëherë.”* (Tefsir el-Kurtubi, 1/139)

Hasen ibn Aliu thotë: *“Lexo Kur’an sa ndien se ai të ndalon (nga të shëmtuarat), e nëse nuk të ndalon, dije se nuk është lexim.”* (Ibn Tejmije, Kaide fi fadail ‘il-Kuran, fq. 59)

Hasen El-Basriu thotë: *“Dikush thotë: “E kam lexuar tërë Kur’anin, nuk kam lënë shkronjë pa e lexuar (nuk më ka shkruar huq), por pasha Allahun ai s’e ka lexuar fare (i ka shkruar huq i tërë leximi), Kur’ani për të nuk ka bërë dobi në sjellje e as në punë.”* (El-Bejheki, Shu’bu ‘l-Iman, 2/541)

Zakonshmëria dhe adeti i kanë shndërruar adhurimet tona, siç është abdesti, në gjëra të zakonshme, rutine, që nuk kanë shumë ndryshim nga punët e tjera që i bëjmë çdo

ditë, siç është veshja e rrobave, rroja, larja e dhëmbëve etj. Doemos t'i rizbulojmë adhurimet tona, namazin tonë, të rizbulojmë abdestin tonë dhe të mos lejojmë që rutina dhe adeti të na mbysin ndjenjat për madhësitinë e këtij rituali fetar që nuk e kanë fetë e tjera.

A ke provuar ndonjë ditë të marrësh abdest sikur për herë të parë ke dëgjuar për abdestin dhe për herë të parë je duke e bërë këtë veprim? Provo ta bësh këtë e pastaj kthehu në vetvete: çfarë zbulova? Doemos të parashtrosh shumë pyetje në vetvete: pse abdesti: pse janë këto gjëra që e prishin e jo të tjerat? Pse quhet abdest (**vudu'**)? Pse është para namazit? Pse themi bismilah para se të marrim abdest? Pse është i domosdoshëm nijeti, qoftë edhe me zemër? Pse këto gjymtyrë? Pse disa i pastrojmë e për disa vetëm marrim mes'h? Pse përsëritja? Pse me këtë renditje? Pse i themi këto lutje në fund të abdestit?

*“Çdo musliman që merr abdest dhe atë e bënë në mënyrë të përkryer, e pastaj thotë: “eshhedu en la ilahe ila-llahu ve eshedu enne Muhameden abduhu ve resuluhu (dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është rob i Tij dhe i dërguar i Tij) – le ta dijë se i hapen tetë deyr e Xhenetit, të hyjë nga e cila do.” (Ibn Maxhe, Albani thotë se hadithi është sahih)*

*“Kush merr abdest dhe atë e bënë në mënyrë të përkryer, e pastaj thotë: “eshhedu en la ilahe ila-llahu ve eshedu enne Muhameden abduhu ve resuluhu, Allahume ixh'alni mine et-tevva-bine ve mine-l-mutetahhirine (dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është rob i Tij dhe i dërguar i Tij, Allahu im, më bën nga të penduarit dhe më bën nga të pastrit) – le ta dijë se i hapen tetë dyert e Xhenetit, të hyjë nga cila do.” (Tirmidhiu, Albani thotë se hadithi është sahih)*

Sikur të kontemplojë, më shumë do të zbulojë se abdesti në fakt është sikur namazi: sistem i jetës.

Ai së pari nënkupton pastërti, me këtë dallohen të arsimuarit dhe intelektualët; së dyti nënkupton kujdes, saktësi dhe rifillim; së treti nënkupton rend, sistem, rregull, kujdes për kohën e caktuar, plotësim i kushteve, me këtë dallohen të civilizuarit; ai së pesti, gjashti e dhjeti nënkupton rishqyrtim (inspektim) të pandërprerë dhe këmbëngulës të shpirtit; pastërti e ndyrësirave që ndoshta kanë ndotur ndonjë periudhë të jetës midis dy abdesteve, me këtë dallohen besimtarët nga jobesimtarët, të devotshmit nga jo të devotshmit, të penduarit nga ata që kanë humbur rrugën, të dallohen fytyrat e këtyre nga fytyrat e të tjerëve, fytyra e ndritur me fytyrën e errët.

Është gabim dhe humbje e madhe të besohet se abdesti është vetëm proces i larjes dhe pastërtisë së trupit. Pastërtia dhe përsëritja e saj në banjo disa herë ose larja në deti ose lum me orë të tëra, nuk nënkuptojnë abdestin dhe nuk mund të falesh, nëse nuk e ke bërë nijet abdestin në vete, vetëm atëherë bëhet namazi.

Pastrimi i trupit nuk është bazë, por pastrimi i shpirtit dhe i zemrës, e ai realizohet vetëm me nijetin që fshihet në zemër. Nijeti nënkupton adhurimin që e bëjmë vetëm për Allahun, kah Ai kthehemi dhe ndaj Atij tregohemi të sinqertë, i përmbahemi rregullave dhe hapave të këtij adhurimi. Po, abdesti ndërthen pastërtinë, por pastërtia nuk ndërthen abdestin. Sikur çështja të ishte e lidhur me pastrimin dhe pastërtinë, nuk do të ishte tejemumi.

Tejemumu është sikur mesazhi që përçohet përmes radiotelegramit në zemër, në këtë rast është joujorë; përgatitu zemër për takim me Allahun, pastrohu dhe çlirohu nga çdo gjë që mund ta ndotë takimin tënd me Atë, Ai është i Gjithëdijshtëm dhe i di fshehtësirat e tua, Ai di çdo gjë që fsheh në shpirt dhe që e tregon. Abdesti në këtë kuptim është mesazh joujorë që bart sinjalet në zemër, por në mënyrë tjetër.

Abdesti në gjuhën arabe ka kuptimin e dritës në fytyrë dhe në zemër (*vudu'- ndriçim*), drita e fytyrës është reflektim i dritës së brendshme të shpirtit dhe zemrës.

Përpiqu që gjatë abdestit të paramendosh rrëfimin e Hasen bin Aliut r.a., që e kishin pyetur për sekretin e zbeh-tësisë së tij të tmerrshme dhe dridhmës së trupit kur merrte abdest, e ai kishte thënë: “Po, a e dini se para Kujt bëhem gati të dal tani?!”

Nëse fytyra nuk të zbehet, e trupi nuk dridhet, atëherë së paku le të dridhet zemra, le të zbehet shpirti dhe ndjenjat, se nuk je duke qëndruar para ndonjërit që është i zakonshëm, ai është Allahu, pas pak çastesh do të takohesh me Krijuesin tënd.

Kujtoj se tani e kuptuam rolin e abdestit, të abdestit të përkryer, apo të përafërt, të sistemit të jetës sonë. Pas kësaj na mbetet të sigurohemi për trupin tonë, për pamjen e bukur, për aromën e trupit, për pastërtinë e dhëmbëve, të gojës, që të mos i dëmtojmë engjëjt që pas pak do të na presin në namaz:

*“Kur robi përdor misvakun e pastaj falet, një engjëll vjen nga mbrapa për ta dëgjuar leximin e tij, i afrohet afër, derisa gojën e tij e vë në gojën e lexuesit; çdo gjë që del nga goja e lexuesit të Kur’anit kalon në brendinë e engjëllit, prandaj pastroni gojën tuaj për Kur’an.”* (Albani thotë se hadithi është sahih, Ali ibn Ebi Talibi)

Abdesi në këtë kuptim është pjesë përbërëse dhe e pandashme e namazit, bile është lloj i namazit. Roli i tij i shëmbëllen rolit të madh të tekbitit fillestar, ai është sikur gyp ose derë që hap rrugën për të qëndruar para Zotit të Madhërishtëm. Ne nuk shkojmë në gjumë menjëherë pas lojës së futbollit ose vrapimit, por kujdesemi që për një kohë të qetësohemi e të pushojmë, që pastaj të bëjmë gjumë të rehatshëm.

I tillë është abdesti, periudhë esenciale parapërgatitëse, e domosdoshme për namazin e shëndoshë. Ai ndodh të llo-

garitet namaz tek Allahu, edhe nëse pas abdesit je ulur dhe nuk falesh: *“Ndodh që një karakteristikë e mirë të jetë te njeriu, e me të Allahu t’ia përmirësojë gjithë punën e tij; pastrimi i njeriut për namaz nënkupton atë që Allahu ia shlyen me këtë pastrim gjynahet e tij, namazi i mbetet nafile – shtesë.”* (Hejthemiu)

*“Njeriu që ngritët për të marrë abdest me qëllim që të falet, e pastaj i lan duart, (le ta dijë) qysh me pikën e parë të ujit i bien të gjitha gjynahet, e kur e lan fytyrën, atëherë gjynahet i bien nga dëgjimi dhe shikimi me pikën e parë të ujit; e kur i lan duart deri në bërryla dhe këmbët deri në nyje, shpëton nga çdo gjynah që e ka dhe nga çdo gabim, bëhet sikur ditën që nëna e ka lindë, e kur ngritët për të falë namazin, Allahu i Lartëmadhëruar e ngre me të një shkallë, e nëse ulet – nuk falet – le ta dijë se është ulur i shpëtuar.”* (Albani thotë se hadithi është sahih)

Sa kohë, mund dhe para harxhojmë në haxh, që vetëm të kthehemi në shtëpi të falur sikur nëna që na ka lindur? Kështu na ka premtuar i Dërguari s.a.v.s.! E ç’mendon pra për haxhin e shpejtë e të vogël, të lehtë e të butë, që nuk kushton para e as udhëtim dhe mund, largim nga familja e as rrezik, e që të garanton Xhenetin? Pa mund të veçantë, vetëm pak ujë dhe kohë: “Ukbe ibn Amir thotë: “E kam takuar të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. që u fliste njerëzve në këmbë dhe i dëgjova fjalët e tij: “Çdo musliman që merr abdest dhe atë e bën në mënyrë të përkryer (bukur), e pastaj ngritët dhe i fal dy rekate, i përkushtohet atyre me zemër dhe fytyrë, le ta dijë se i bëhet obligim Xheneti. Thashë më vete: sa mrekulli qenka kjo! Kur një njeri që ishte para meje më tha: “Ajo që e tha përpara është më mrekulli! E lakova fytyrën dhe e pashë Omerin. Ai tha: “Të pashë se erdhe tani, i Dërguari i Allahut para se vije ti, tha: “Kushdo që merr abdest dhe atë e bën në mënyrë të përkryer (përsosur), e pastaj thotë: *“eshhedu en la ilahe ilallahu ve eshedu enne Muhammeden abduhu ve resuluhu* (dëshmoj se nuk ka zot tjetër

*përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhammedi është rob i Tij dhe i dërguar i Tij) – le ta dijë se i hapen tetë dyert e Xhenetit, të hyjë nga e cila do.” (Muslimi)*

Ky hadith na vë para një segmenti shumë të rëndësishëm të këtij adhurimi: përkryerja e abdestit, bukuria e tij. A ka ndodhur që dikush nga ne të korrigjoj veten duke i dhënë abdestit të tij shkallën e përsosurisë dhe bukurisë?!

Kujtoj se nuk të kushton shumë nëse harxhon vetëm pak kohë më shumë dhe ca pika uji më shumë për të qenë abdesti yt i shkallës së lartë, e shpërblimi të jetë shumë më i madh. Përkryerja e abdestit është pikë dalluese e duarve të besimtarëve, këmbëve dhe ballit të tyre në Ditën e Kiametit. Në këtë Ditë ata do të vijnë me shenja dalluese, sikur kuajt që kanë shenja të bardha në trup e që dallohen dukshëm. I Dërguari s.a.v.s do t'i thërret që ta shoqërojnë në pirjen e ujit të Havdit (burimit të të Dërguarit s.a.v.s.), kurse ata që devijuan nga rruga e tij s.a.v.s., ata do të largohen nga burimi i shenjtë dhe do të humben sikur devet e humbura që nuk dinë kah shkojnë.

“Transmeton Ebu Hurejre se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. erdhi te varrezat dhe tha: *“Paqe e shpëtim qofshin mbi ju, shtëpi e njerëzve besimtar, ne, dashtë Allahu, do t’ju bashkëngjitemi, kisha dashtë me i pa vëllezërit tanë. Të pranishmit thanë: “O i Dërguari i Allahut, a nuk jemi vëllezërit e tu?” Ai tha: “Ju jeni shokët e mi.” Vëllezërit tanë janë ata që ende nuk kanë ardhur.” Ata thanë: “Po si do ta njohësh atë që ende nuk ka ardhur (nuk e ke parë) nga Umeti yt, o i Dërguar i Allahut?” Ai tha: “A ke parë njeriun që ka një kali me shenjë të bardhë në ballë, këmbëbardhë... a nuk e njeh ai kalin e tij? Ata thanë: “Gjithsesi, o i Dërguar i Allahut.” Atëherë ai tha: “Ata do të vijnë këmbëbardhë dhe shenjë të bardhë në ballë nga abdesti.” (Muslimi)*

*“Duke u kthyer me të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. nga Meka në Medinë u ndalëm pranë një vendi që kishte ujë. Disa shpejtuan*

dhe morën abdest me shpejtësi. Kur ne arritëm pamë se shputat e këmbëve të tyre sikur nuk i kishte prekur uji mjaftueshëm. Atëherë i Dërguari i Allahut s.a.v.s. tha: “Mjerë për shputat nga zjarri, përkryeni abdestin.” (Muslimi)

“Ebu Hazimi thotë: “Isha pas Ebu Hurejres që po merrte abdest për namaz, ai e shtrinte dorën – kur e pastronte me dorën tjetër – derisa arrinte tek nënsjetulla e tij. Unë i thashë: “O Ebu Hurejre, ç’është ky abdest kështu?” Ai më tha: “Jeni këtu? Sikur ta dija se jeni këtu nuk do të merrja abdest kështu. E kam dëgjuar të dashurin tim s.a.v.s. duke thënë: “Zbukurimi (stolia) e besimtarit do të arrijë deri në pjesët që i ka arritur abdesti.” (Muslimi)

Nëse përsosja e abdestit ngërthen këtë shpërblim të madh dhe dhuron veçori dalluese për besimtarin në Ditën e Kiametit, atëherë pse të mos përpiqemi të hulumtojmë për aspekte tjera të investimit në këtë projekt të mrekullueshëm tregtar? Këtë e zbuloi Bilali – Allahu qoftë i kënaqur me të – kur pas çdo abdesti që e merrte falte namaz nafile. Këtë e kishte fryt të projektit me të cilin e kishte përgëzuar i Dërguari s.a.v.s.

“Transmeton Ebu Hurejre - Allahu qoftë i kënaqur me të – se i Dërguari s.a.v.s. i ka thënë Bilalit në prag të namazit të sabahut: “O Bilal, më trego për punën më shpresëdhënëse që e ke bërë në Islam, sepse unë i dëgjova hapat e nallaneve tua në Xhenet.” Ai tha: “Nuk kam bërë ndonjë punë më shpresëdhënëse, përveç që çdoherë që kam marrë abdest, natën ose ditën, me këtë abdest kam falur namaz nafile sa kam mundur.” (Buhariu)

Përkryerja e abdestit dhe përsëritja e tij nuk nënkupton harxhimin e tepër të ujit dhe derdhjen e tij pa nevojë. Abdesti, përveçse që është sistem me të cilin ne ngremë jetën tonë humane, shëndetësore, kulturore dhe civilizuese, ai gjithashtu është shkollë ekonomike që vendos rregulla të përgjithshme të bashkëveprimit material me begatinë e pasurisë, ushqimit dhe mjedisit. Shkolla pejgamberike e cila

thërret në përkryerjen e abdestit dhe përsëritjen e tij aq sa mundemi, është po ajo shkollë që thërret në parandalimin e përdorimit të tepër të ujit për të. Shumë njerëz nuk e dinë se, duke marrë abdest ata i kanë duart nën çezmën që rrjedh pandërprerë. S'ka dyshim se një veprim i tillë dëmton këtë adhurim dhe vepron kundër rregullave të tij. Kujtoj se njeriu duhet herë pas here ta mbyll çezmën, që të mos harxhojë ujë pa nevojë. Ky rregull i artë islam nuk bënë dallimin midis lumit dhe çezmës, e as midis vendeve shkretinore dhe atyre që kanë lumenj e dete. Kështu i mësoi i Dërguari s.a.v.s. shokët e tij: *"I Dërguari s.a.v.s. kaloi pranë Sa'dit që ishte duke marrë abdest, dhe i tha: "Ç'është ky harxhim i tepërt? Ai tha: "A edhe në abdest ka teprim? Ai tha: "Po, bile edhe nëse je në lum që rrjedh."* (Ibn Maxhe, Albai thotë hadithi është sahih).

Në kohën që i Dërguari s.a.v.s. na thërret për përkryerjen e abdestit, ai s.a.v.s., na i caktoi kufijtë midis përkryerjes dhe teprimit, edhe atë përmes veprimit të tij praktik të këtij adhurimi të përsëritur: *"I Dërguari s.a.v.s. merrte abdest me kupë (gotë për të pirë ujë), kurse pastrohej me pesë kupa (gota)." (Nesaiu, Albani thotë se hadithi është sahih)*

Abdesti në këtë kuptim është mjet i utë pejgamberik që me saktësi cakton kriteret që dallojnë teprimin dhe kursimin. Ai s.a.v.s. na mësoi për elasticitetin që është karakteristikë e Islamit për çdo gjë, edhe në adhurime. Me fjalë të tjera, abdesti është sistem i jetës, çelës i personalitetit të atij që merr abdest, pra, më thuaj si merr abdest, të të them kush je.

Më kujtohet haxhi im i parë para më shumë se tridhjetë vjetëve, çasti kur isha në Muzdelife së bashku me pesë të tjerë. Ne nuk kishim ujë të mjaftuar që të merrnim abdest të zakonshëm, ne kishim vetëm një litër ujë me një shishe plastike. Me të merrnim të gjithë abdest, por të gjithë ishim të qetë shpirtërisht, ndjenjat tona ishin përplot kënaqësi, ndjenim se abdesti ynë shpërndante shpirtin islam në ne, ai nuk

ishte një veprim mekanik i thjeshtë. Tregohet se i Dërguari s.a.v.s. i pastronte gjymtyrët e tij në disa raste të abdestit nga një herë, disa herë dy herë, e në dis të tjera tri herë: *“I Dërguari s.a.v.s. merret abdest duke i pastruar gjymtyrët vetëm një herë, dy herë dhe tri herë, të gjitha këto i bënte.”* (Albani thotë se hadithi është sahih)

*“Një njeri i tha Abdullah ibn Zejdit, gjyshit të Amër ibn Jahja: “A mund të më tregosh se si merrte abdest i Dërguari i Allahut s.a.v.s.? Abdullah ibn Zejdi tha: “Po. thirri që t’i sillnin ujë dhe atë e derdhi në duart e tij dhe i pastroi dy herë, pastaj futi ujë në gojë dhe hundë tri herë, pastroi fytyrën tri herë, e pastaj pastroi duart deri në bërryla dy herë, fërkoj kokën me dy duart e tij, duke filluar prej përpara kokës e deri në qafë dhe anasjelltas, e pastaj i pastroi këmbët.”* (Buhariu)

Abdesti është mësim praktik islam i maturisë, elasticitetit dhe tolerancës, në përgjithësi ai është projekt investues dhe shkollë e përsosur që për ne vendos rregulla për çdo punë dhe për çdo mirësi që e bëjmë në jetën e përditshme. Ai nuk është vetëm ritual i veçantë për namazin, por sferë e veprimeve dhe adhurimeve jetësore që nuk mund t’i paramendojmë. A ke menduar ndonjëherë të marrësh abdest, por jo për namaz? Dëgjo këtë mësim pejgamberik për sistemin e jetës sonë të përditshme:

*“Kur i Dërguari s.a.v.s. ishte i papastër (xhunub) dhe dëshiron të hante ose të flinte, ai merret abdes sikur për namaz.”* (Muslimi)

*“Erdha tek i Dërguari s.a.v.s. që po merrte abdes, e përshëndeta e ai nuk më përshëndeti, e kur mbaroi me abdesin, tha: “Nuk më pengoi diçka tjetër që të të përshëndes (ta kthej selamin), por vetëm se isha pa abdes.”* (Ibn Maxhe, Albani thotë se hadithi është sahih)

*“Kush merr abdes dhe atë e bën për bukuri dhe e viziton një vëlla të tij musliman – që është i sëmurë, pra vetëm me qëllim vizite – do të largohet prej Xhehenemi gjashtëdhjetë pranvera rrugë.”* (Ibn Haxheri, Tahrixh Mishkat el-Mesabih)

Përpiqu që në jetë të mos jesh pa abdest. Vërtet do të ndjesh se në punë je duke shkuar sikur duke fluturuar në ajër, do të ndjesh se gjatë përshëndetjes me njerëzit je duke i përshëndetur engjëjt për dore, do të ndjesh se puna jote është plot besim dhe vëmendje, do të ndjesh se ke bërë punë të mira në jetë, dita të ka kaluar me amanet të plotë, mbrëmja të zë në krevat i qetë dhe me ndjenja se jam pranë Allahut, të Sigurtit, Bujarit, Mëshiruesit, Mëshirëplotit, Falësit.

### Pjesa 3 Xhamia... pse?

Pse xhamia? Pse në xhami? Çfarë është xhamia?

A thua vallë se Allahu i urdhëroi besimtarët të ndërtojnë xhami dhe aty t'i falin pesë kohët e namazit vetëm për të harxhuar paratë e tyre për ndërtim? Të humbin kohën në vajtje e kthim? Të harxhojnë mjetet për këtë qëllim? Të mundohen ditën e natën duke vajtur në xhami, punë dhe vendbanim?

A thua se kjo është pa kuptim? Pa dobi? Ai që për vete thotë se është i Gjithëmëshirshëm, Mëshirëplotë? Ky për të Cilin ne falemi, qetësohemi në pranë të Tij, pranë të Cilit ne derdhim brengat dhe shqetësimet tona, tek i Cili paraqesim kërkesat dhe nevojat tona?

Askush nuk mund të pohojë se i di shkaqet e vërteta e të plota Hyjnore të namazit tonë në xhami. Ne këtu mund vetëm të përpiqemi, është detyrë e jona të përpiqemi, edhe nëse jemi të kufizuar me aftësi njerëzore, të dimë urtësinë e xhamisë dhe faljes së namazit në xhami.

Nëse pyesim: Pse xhamia është "Shtëpi e Allahut"? Përgjigja do të ishte numërim i disa shkaqeve që i japin këtë pozitë të veçantë të faljes së namazit në xhami.

Vëreni, ju lutem, së pari kuptimin e ngrohtësisë, nxitjen e ndjenjave të sigurisë, qetësisë dhe lehtësisë që xhamia të jetë “Shtëpi e Allahut”, e jo pallati, kalaja, zyra, qendra zyrtare, shtabi i përgjithshëm etj. Xhamia është “Shtëpi” që të bën të kuptosh se është mbështetja jote, pushimi yt, vendstrehimi yt, pas lodhjes në punë dhe betejës së ashpër materiale dhe ashpërsisë së jetës dhe padrejtësive të përditshme.

Vëreni ju lutem faktin se ne zakonisht në shtëpi i falim sunetet dhe nafilet, por kurrë nuk shndërrohen në “Shtëpi të Allahut”! Cilat pra janë veçoritë me të cilat karakterizohet xhamia nga ndërtesat tjera? Pyesim: a është e mundur që çfarëdo ndërtese tjetër e pajisur me këto veçori të jetë “Shtëpi e Allahut”?

Le të përpiqemi që në vijim t’i shtrojmë disa nga këto veçori:

1. Ai është vendtakim i parë i besimtarëve, aty takohen duke qenë të pastër fizikisht: me abdest, dhe të pastër shpirtërisht: shpirtpastër, larg dynjasë, të kthyer kah Allahut dhe të mbështetur në Atë.
2. Është vend i posaçëm i përmendjes së Allahut, leximit të Kur’anit, para dhe pas namazit, aty nuk ka biseda të kota, përveç të atyre që tangojnë Islamin dhe muslimanët.
3. Aty nuk ngritët zëri, nuk lejohen lëvizje të paparamendura, bëhet punë që afron njeriun tek Allahu: dhikri, leximi i Kur’anit, i fesë, diturisë, njohjes së saktë dhe udhëzimit.
4. Çdo pjesë e xhamisë mbetet e pastër dhe e përkryer.
5. Është vendi i vetëm që askush nuk mund të pretendojë pronësinë e tij, askush nuk thotë se është e tij dhe aty hynë vetëm ata që unë dua. Është vend i lirë dhe i mbrojtur, pa mure të larta dhe pasaporta për të hyrë, njerëzve nuk u kushhtëzohet raca, gjuha ose diç tjetër.
6. Në fund ajo është “Shtëpi”, jo shtëpi e rëndomtë, por “Shtëpi më e madhe” ku siguria, paqja, qetësia e rehatia janë në kulm, janë në kulmin e domethënies së tyre, vetëm që mund t’i ëndërrojë njeriu.

Pra, megjithëse këto qenkan veçoritë e xhamisë, atëherë doemos të dimë se kur hymë në të, nuk hymë në shtëpi të rëndomtë, por në shtëpi të jashtëzakonshme, aty ku takohemi me Allahun, ku i lutemi, ky jemi mysafirë të Tij, se strehimi ynë në Shtëpinë e Allahut na kujton strehimin politik, atëherë kur ne ikim nga padrejtësia e jetës dhe ashpërsia e saj, për të shkuar drejt mëshirës së Allahut, drejtësisë dhe qetësisë së Tij, atje ky minaret e Shtëpisë bëjnë dritë për banorët e qiellit, ashtu siç bëjnë dritë yjet për banorët e tokës.

*“Xhamitë janë Shtëpitë e Allahut në tokë, bëjnë dritë për banorët e qiellit, ashtu siç bëjnë dritë yjet e qiellit për banorët e tokës.”* (Hejthemiu)

Sikur kryetari i vendit të të thërriste për drekë në ndonjë restorant të madh, a nuk do të ishte lavd i madh për ty dhe krenari? A nuk do të ishte krenari për atë se sa njerëz të njohin e sa nuk të njohin? Po sikur të të thërriste ky në shtëpinë e tij? Cila ftesë do të ishte më madhështore? Në cilin vend do të ishe më i dëgjuar dhe më me vëmendje dhe më i gostitur? Prandaj, lexo me mua këtë hadith të të Dërguarit s.a.v.s.: *“Kush merr abdest në shtëpinë e tij dhe atë e bën për mrekulli, e pastaj shkon në xhami, le ta dijë se është vizitues i Allahut, kurse e drejtë e të vizituarit është ta nderojë vizitorin.”* (Albani thotë hadithi është hasen, Sahih et-Tergib)

Pastaj, lexo me mua këtë përshkrim të ngrohët e të çuditshëm pejgamberik për pranimin e hareshëm e të buzëqeshur me të cilën Zoti i Madhërishëm i pret çdo ditë mysafirët e Tij në shtëpinë e Tij: *“Ndodh që njeriu të ketë shkuar shumë shpesh në xhami, por ta ketë preokupuar një kohë të mos shkonte ndonjë punë ose sëmundje, por pastaj kthehet përsëri aty ku ka qenë (pra vazhdon të shkoj në xhami), (kur ndodh kjo) Allahu i buzëqeshet atij sikur që i buzëqeshin familjarët njeriut të tyre që vjen pasi një kohë nuk ka qenë në mesin e tyre.”* (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih et-Tergib)

Nëse ndodh të dëgjosh zilen e derës së shtëpisë, se të ka arritur letër e çmuar në shtëpi, e hap letrën për ta lexuar, ose për ta dëgjuar, e aty lexon rreshtat që vijojnë:

O rob i Allahut:

Nëse e di se Allahu është më i madh, pra më i madh se çdo gjë që të preokupon nga vizita e Tij, bëhu gati dhe përgjigju thirrjes së Tij;

Nëse e di se Allahu është më i madh, pra më i madh se çdokush që mund të të sjellë dobi ose dëm, të të jep jetë ose vdekje, pse pra vonohesh dhe nuk i përgjigjesh Atij?

Nëse je i sigurt se Allahu është më i madh, pra më i madh se çdo thirrës që të thërret, çdo bujar që të nderon, atëherë mos lejo që ndonjë send të jetë pengesë nga pranimi i Tij në shtëpinë e Tij.

Nëse beson se Allahu është më i madh, pra më i madh se t'i refuzohet thirrja apo të shpërfillet thirrja e Tij, atëherë lëviz dhe qëndro para Tij në kohë të caktuar.

Nëse ndodh ta pranosh këtë thirrje të çmuar, a thua se gjen arsye ose punë që do të të pengojë nga përgjigja? Vetëm nëse ka diçka absurde që mund të ndodh, e këtu bëjnë pjesë gjërat absurde që shquhen pengesa paaftësie që arrijnë shkallën e verbërisë!

Dëgjo përgjigjen e të Dërguarit s.a.v.s. dhënë Abdullah ibn Ummi Mektumit, të verbrit që erdhi për të kërkuar leje që namazin ta falte në shtëpi, sepse rruga për në xhami, sidomos natën, është e mbushur me egërsira dhe insektet!? A do t'i lejon i Dërguari s.a.v.s. që namazin ta falë në shtëpi?

*“O i Dërguari i Allahut, në Medinë ka shumë kafshë dhe insekte të natës (egërsira), tha- a e dëgjon ezanin hajje ale es-salah, hajje ale-l-felah? Tha: “Po. ai tha: “Atëherë shko në namaz, - e nuk i lejoi.” (Nesaiu, Albani thotë se hadithi është sahih).*

Si të mos shkojmë në Shtëpinë e Allahut kur ne dëgjojmë thirrjen e qartë e të pastër që na thërret për tek Ai! Nuk është thirrje për ta vizituar ndonjë njeri, kushdo që të jetë, por thirrje për ta vizituar Allahun... në Shtëpinë e Allahut, shpërblimi është i madh, më shumë seç mund të paramendojmë, për ata që gjithmonë i përgjigjen thirrjes dhe zemrat e tyre janë të lidhura për Shtëpinë e Allahut: *“Janë shtatë persona që Allahu do t’i strehojë nën hijen e Arshit të Tij, ditën kur nuk do të ketë hije tjetër, përveç hijes së Tij: Udhëheqësi i drejtë, i riu i formuar në adhurim të Allahut, njeriu që përmend Allahun kur është vetëm dhe sytë i lotojnë dhe, njeriu zemra e të cilit është e lidhur në xhami...”* (Buhariu)

Brezi i parë i të Dërguarit s.a.v.s. ishin ata që ditët e para të Islamit i jetuan me vëmendje të plotë, me mendje të ndritur dhe të freskët, jetuan me zemër të mbushur plot ndjenja të ngrohta, iu përgjigjën thirrjes me dinjitet dhe ashtu siç duhet; a thua është e mundur që me veshët e tyre ta dëgjojmë këtë thirrje, sikur që e dëgjojmë për herë të parë? Dëgjo shpjegimin e një sahabiu të ndershëm për atë që nuk i përgjigjet thirrjes dhe mbetet të falet në shtëpi:

Transmeton Abdullah ibn Mes’udi dhe thotë: *“Kush dëshiron që me kënaqësi ta takojë nesër Allahun, si musliman (i vërtetë), le të kujdeset për namazet kur thirret për t’i falur, sepse Allahu porositi të Dërguarin e juaj për mësimet e udhëzimi, se namazet janë pjesë e këtij udhëzimi; sikur të faleni në shtëpi, siç falet ky që nuk shkon në xhami në shtëpinë e tij, të dini se keni hequr dorë nga ky udhëzim i të Dërguarit, e sikur të hiqni dorë nga suneti i të Dërguarit tuaj, të dini se keni devijuar. Çdokush që pastrohet dhe atë e bën për bukuri, e pastaj ia mësynë ndonjë xhamie nga xhamitë, le ta dijë se Allahu do t’ia shkruan për çdo hap që ka bërë një të mirë, do ta ngritë një shkallë më lartë dhe do t’ia fshijë një të keqe; ne kemi besuar se xhamisë nuk i përgjigjen vetëm hipokritët që dihen se janë hipokritë. Kishte ndodhur që dy*

*njerëz ta binin një tjetër duke e mbajtur për krahu, e të vendosje në saf.” (Muslimi)*

Vallë, cili është dallimi i faljes së namazit në xhami dhe atij që falet në shtëpi? A është i barabartë ai që falet në xhami dhe që ushqehet në sofrën e Allahut dhe ushqehet me ushqim shpirtëror me atë që falet në shtëpi, larg sofrave të mbushura përplot? Ai që është larg vëllezërve besimtarë që rrinë krah për krahu në sofrën e Allahut?

Çfarë ndjenja do të kaplonin sikur ndonjëri të të bënte thirrje në shtëpinë e tij dhe të caktonte vend të posaçëm me njerëz të mëdhenj? Vendi yt të mbante emrin tënd, ai të pret në prag të derës për të të përshëndetur ty dhe të tjerët që janë me ty? Të ulësh me ata dhe të bisedosh me kënaqësi me ata? Çfarë ndjenja janë këto? Po si do të ishte puna nëse kësaj thirrjeje i përgjigjesh duke thënë: nuk mund të prezantoj, nuk kam kohë për t’u ulur me ty apo me mysafirët e tu, ma dërgo pjesën time të ushqimit që ta ha në shtëpi?!

A arrita që me këtë shembull para teje të sjell pasqyrën e duhur?

I Dërguari s.a.v.s. në një hadith përkufizoi arsyet për ata që nuk i përgjigjen thirrjes për faljen e namazit në xhami. Janë vetëm dy arsye: frika dhe sëmundja. Ai përmend edhe shiun dhe baltën. Ibn Abasi thotë: *“Kush e dëgjon ezanin për namaz dhe nuk i përgjigjet, ai nuk ka namaz, përveç me arsye. Të pranishmit thanë: “O i Dërguari i Allahut, çfarë është arsyeja? Ai tha: “frika ose sëmundja.” (Neveviu)*

“Ibn Abasi i tha myezinit të tij ditën që ishte me shi: *“Kur të thuash: eshhedu enne Muhameden resulullah, mos thuaj hajje ale essalah, por thuaj: faluni në shtëpi. Njerëzit sikur nuk e pëlqyen këtë, por Ibn Abasi tha: “Kështu ka bërë ai që ishte më i mirë se unë, namazi i xhumasë është i domosdoshëm, por unë nuk desha t’ju mundoj e të ecni në baltë dhe tokë të rrëshqitur.” (Buhariu)*

Shtëpia e Allahut i shëmbëllen aeroportit, ai është aeroport Hyjnor. Nuk është aeroport i zakonshëm, aeroplani që të pret nuk është i zakonshëm, edhe udhëtimi nuk është i zakonshëm. Aeroporti zakonisht nuk është larg shtëpisë tënde, nuk ke nevojë për pasaportë, e as për çantë dore, do të nisesesh duke qeni i lirë dhe jo i ngarkuar, udhëtimi yt ka filluar nga dalja prej shtëpisë. Çdo hap që e ke bërë drejt këtij aeroporti është pjesë e pandashme e udhëtimit esencial dhe e rolit tënd madhështor drejt së cilit je nisur: *“Shtëpitë tona ishin larg xhamisë, andaj deshëm t’i shesim ato e të afrohemi afër xhamisë, por i Dërguari s.a.v.s. na ndaloi dhe tha: “ju për çdo hap që e bëni, shpërbleheni me një shkallë.”* (Muslimi)

*“Ai që është më larg xhamisë, ai shpërblehet më shumë.”* (Ibn Maxhe, Albani thotë se hadithi është sahih)

Ubej ibn Ka’bi thotë: *“Ishte një njeri që nuk e di se kishte dikush që ishte më larg se ai prej xhamisë, por nuk e huqte asnjë namaz. I thashë: “Sikur ta kishe blerë një gomar, të vish me të kur bën natë dhe vapë!” Ai tha: “Nuk dua që xhaminë ta kem afër xhamisë, unë dua që të më shkruhen (sevapet) hapat deri në xhami dhe hapat e kthimit në shtëpi.” Atëherë i Dërguari s.a.v.s tha: “Allahu ta ka mundësuar gjithë këtë.”* (Muslimi)

Thirrja për namaz do të dekoron me dekorimin më të lartë dhe diplomën më madhështore, me të cilën njeriu krenohet. Nuk është dekorim shtetëror i shkallës së parë, e as diplomë doktorature i universitetit më të njohur, e as shpërblim shtetëror i kreut të shtetit, është shpërblim që i tejkalon të gjitha këto, vjen nga ai që është më i madh se të gjithë këta, është diploma e imanit: *“Kur ta shihni njeriun se i viziton xhamitë, dëshmoni se ai ka besim. Allahu i Madhërishëm thotë: “Faltoret e Allahut i vizitojnë dhe i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e fundit.”* (Albani thotë se hadithi është sahih, Rijadu’s-Salihin, Ebu Seid El-Hudëriu)

Nuk ka kryetar shteti, ministër e as mbret që të thërret në shtëpinë e tij e ta shtron rrugën nga shtëpia jote deri te shtëpia e tij, në të djathtë e në të majtë, me qilim të kuq ose të gjelbër, me lule të gjelbra e të këndshme, me dhurata madhështore, thesare të shtrenjta, të zgjedhësh çka të duash. Bile, nuk ke nevojë që diçka të marrësh me dorë, vetëm kalimi pranë tyre dhe shikimi i tyre, dhe mahnitja me ato bëjnë që të mbështillen dhe menjëherë të dërgohen të mbështjella në adresën tënde: *“Këto dy namaze (i sabahut dhe i jacisë) janë namazet më të rënda për hipokritët, sikur ta dini vlerën e tyre, do të shkonit këmbadoras, safi i parë i shëmbëllen safit të engjëjve, sikur ta dini vlerën e tij, do të bënit gara për atë.”* (Albani thotë se hadithi është hasen li gajrihi, Sahih et-tergib)

*“Namazi në xhemat ia shkon namazit në shtëpi... për njëzet e pesë shkallë. Kur dikush nga ju merr abdest dhe atë e bën për bukur, dhe vjen në xhami vetëm për t’u falë, le ta dijë se nuk ka bërë një hap e të mos e ketë ngritur Allahu me të një shkallë, e t’ia kishte hequr një gabim, deri sa të hyjë në xhami, e kur të hyjë në xhami, le ta dijë se është në namaz, engjëjt luten për të derisa qëndron në vendin ku do të falet, thonë: “O Allah, fale, o Allah mëshiroje, kështu deri sa të mos bëj diçka.”* (Buhariu)

*“Përgëzoi ata që shkojnë në xhami në errësirë me dritë të plotë në Ditën e Kiametit.”* (Ebu Davudi)

*“Njeriut në varr do t’i vjen dënimi nga koka, por atë do ta zbraps leximi i Kuranit, kur t’i vjen nga duart, atë e zbraps sadakaja, e kur t’i vjen nga këmbët, atë e zbraps shkuarja në xhamitë.”* (Albani thotë se hadithi është sahih)

A ka shpërblime më të mëdha dhe më të çmuara se këto? Pikërisht kjo është arsyeja që i Dërguari i Allahut s.a.v. u tregua i kujdesshëm të na mësonte se si të fitojmë më shumë shpërblime gjatë rrugës sonë për ta takuar Zotin në shtëpinë e Tij. Ai s.a.v.s. i shkurtonte hapat për në xhami, që t’jua bëj me dije besimtarëve se llogaritë e tyre nga udhëtimi tek

Ai nuk janë aspak më të vogla se llogaritë që i presin në fund, pas kryerjes së namazit: *“Isha duke ecur me të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. për të falë namazin, e ai i shkurtonte hapat, dhe tha: “A e dini se përse jam duke e shkurtuar hapin?” I thashë: “Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri.” Ai tha: “Robi llogaritet të jetë në namaz përderisa është në kërkim të namazit.” Në një transmetim tjetër thuhet: “E bëra këtë që të më shtohen hapat në kërkim të namazit.”* (Mundhiri në Et-Tergib ve’ t-terhib)

A të kujtohen ndjenjat kur për herë të parë hyre në shtëpinë e të fejuarës tënde? Sa herë u rregullove para se të hysh? Po zemra, sa herë të rrihte? Po fytyra dhe sytë e tu? Po kujdesi që të dukesh i dashur, modest, të përfitosh dashurinë dhe kënaqësinë?!

Po si është pra kur ti bëhesh gati ta vizitosh Zotin tënd dhe Zotin e të fejuarës tënde? Zotin e botëve. Zotin e Hyri-ve të Xhenetit, bukurosheve symëdha? Zotin e Xhenetit, aty që ka gjëra që syri kurrë nuk i ka parë, veshi nuk i ka dëgjuar e as mendja nuk të ka shkuar?!

Shkuarjen për në xhami bëje të bukur dhe elegante, ec i qetë, me maturi, dinjitet dhe madhështi. Edhe një herë: mos harro se qysh nga momenti që je nisur për në xhami, ti je në namaz! Qysh nga dalja prej shtëpisë e deri në xhami, ti je në namaz. Prandaj, vishu me rrobat e përsipirtshmërisë, modestisë, përuljes etj.

*“Kush merr abdest dhe atë e bënë për bukuri, e pastaj del duke pasur për qëllim namazin – do të thotë niset drejt për namaz – le ta dijë se ai është namaz përderisa është bërë gati për namaz, se për çdo hap që e bënë i shkruhet një e mirë dhe me hapin tjetër i hiqet një e keqe; kur ta dëgjoni ikametin, mos shpejtoni, më shumë shpërblehet ai që e ka shtëpinë më larg... kur ndonjëri merr abdest në shtëpinë e tij dhe shkon në xhami, le ta dijë se është në namaz deri sa të kthehet.”* (Albani thotë se hadithi është sahih)

Tani je bërë gati për të hyrë në xhami, kujto se je i thirrur në Shtëpinë e Bujarit, përgatitu për dhuratat më të mëdha dhe më të bukura, kujto se je duke hyrë në Shtëpinë e të Dashurit, emri më i bukur i Allahut të Madhërishëm, që në shpirtin tënd ngjallë ndjenjat e besimit, paqes dhe qetësisë, kujto se tani je duke hyrë tek Ai, gati je duke u ulur pranë Tij, do të flasësh me Të dhe të kërkosësh prej Tij, kurse Ai do të të dëgjojë dhe do t'i përgjigjet kërkesave tua..

Në fund, a ke arritur me kohë në vendin e duhur? Natyrisht se kjo është shumë me rëndësi, nënkupton respektin e të zotit të çdo thirrjeje. Por, në këtë rast thirrësi është tjetërkush, është Allahu, andaj nuk ke përse të bren-gosësh, Ai nuk lejon që të shkon ndonjë gjë huq, nëse të ndodh diçka e papritur, siç mund të ndodh të vonohesh pak apo të krijohen rrethana të padëshiruara, kështu një pjesë e namazit të kalon, e ndoshta edhe i gjithë namazi të kalon, por dije se shpërblimi për ty është i ruajtur, përderisa ke shkelur pragun e Allahut, Bujarit dhe të Pasurit, vizita jote do të llogaritet qysh nga çasti që ke shkelur pragun e Shtëpisë e deri në çastin e daljes nga Shtëpia, dhuratat do të vijnë në adresën tënde, të plota e aspak të pakësuar: *“Kush merr abdest dhe atë e bënë për bukuri, e pastaj del me qëllim të faljes së namazit në xhami, por i gjen njerëzit që janë falur, le ta dijë se Allahu do t'ia shkruajë shpërblimin e njëjtë me atë që ka qenë prezent në namaz, duke mos ia pakësuar prej shpërblimeve të tyre asgjë.”* (Nesaiu, Albani thotë se hadithi është sahih)

“Një njeriu nga ensarët i kishte ardhur vdekja dhe tha se do t'ju tregoj për një hadith që nuk ju kam treguar më parë nga frika e përgjegjësisë: “E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. të thotë: *“Kur dikush merr abdest dhe atë e bënë për bukuri, e pastaj del për në namaz, nuk ndodh që ta ngre këmbën e djathtë e të mos ia shkruaj Allahu i Lartëmadhërishëm një të mirë, e as ta lëshojë të majtën, e të mos ia heq Allahu i Lar-*

*tëmadhërishëm një të keqe, qoftë të jetë afër ose larg; e kur të vijë në xhami dhe falet në xhemat, i falet atij (gjynahet), e nëse vjen në xhami, por ata i kanë falur disa rekate e kanë mbetur disa, e ky i falë ato që i kanë mbetur dhe i plotëson ato që i kanë kaluar, gjithashtu i falet (gjynahet), e nëse vjen në xhami dhe njerëzit janë falur, e ky e plotëson (vetë) namazin, gjithashtu i falet (gjynahu)."* (Ebu Davudi, Albani thotë se hadithi është sahih)

Tani jemi pranë derës së Zotit të thirrjes, cila derë, cila shtëpi dhe cili Zot i thirrjes! Ka kaluar kohë që ka filluar llogaria e shpërblimeve, në adresën tonë veçse më kanë arritur shumë dhurata dhe shpërblime të panumërta, janë fshirë shumë gjynahe dhe të këqija. Po cilat janë rregullat e hyrjes në xhami? Si të hymë në këtë Shtëpi madhështore e të lartë të Bujarit, të Dashurit? Po si të dalim?

- *"O bijtë e Ademit, vishuni përshtatshëm kudo dhe kurdo që të faleni (shkoni në xhami)".* (EIA'raf, 31)

- *"Kur dikush merr abdest dhe atë e bënë për bukuri, e pastaj del me qëllim të shkojë në xhami, të mos i kryqëzojë gishtat (gërshetojë gishtat), sepse ai është në namaz (pra rruga për në xhami llogaritet sikur jemi në namaz)."* (Tirmidhiu, Albani thotë se hadithi është sahih)

- *"Kur njeriu del nga shtëpia e tij për të shkuar në xhami dhe thotë: "Allahu im, të lutem me të drejtën e plotë që të luten Ty lutësit, me të drejtën e të ecurit tim që jam duke ecur, se unë nuk kam dalë i dalldisur e as fodull, nuk kam dalë për syfaqësi e as lavd, por kam dalë nga frika e zemërimit Tënd, për të kërkuar kënaqësinë Tënde, prandaj të lutem më shpëto nga zjarri, dhe mi fal gjynahet, se gjynahet i fal vetëm Ti; (nëse e thotë këtë) – Allahu do t'ia caktojë 70 mijë engjëj që do të kërkojnë falje për të, kurse Allahu me fytyrën e vet do të jetë i kthyer kah ai deri sa ta mbarojë namazin."* (Ibn Haxher El-Askelani)

- *"Kur dikush të hyjë në xhami le të çoj salavat mbi të Dërguarin, e le të thotë: "Allahu im, mi hap dyert e mëshirës Tënde, e kur të del, përsëri le të çoj selam të Dërguarit, e le të thotë: "Allahu im, kërkoj të mirën Tënde."* (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih el-Xhami')

- *"Kur i Dërguari s.a.v.s. hynte në xhami, thoshte: "Mbrohem me Allahun e Madhërishëm dhe mbrohem me Fytyrën e Tij Bujare, Sundimin e Tij të përjetshëm, nga djalli i mallkuar." Tha: "Nëse thotë kështu (ndonjëri), djalli thotë: "Është mbrojtur nga unë tërë ditën." (Përmbledhje e fetvave të Ibn Bazit, transmeton Abdullah ibn Amër)*

Tani je brenda Shtëpisë së Allahut, nën kuben e Shtëpisë së Allahut, si do ta përshëndesësh të Zotin e Shtëpisë dhe ta falënderosh për thirrjen e ndershme që ta ka bërë? Si do ta shprehësh mirënjohjen e lartë dhe falënderimin?

Transmeton Katade el-Ensariu e thotë: *"Hyra në xhami, kurse i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ishte i ulur në mes të njerëzve. Unë u ula, tha Katade. Atëherë i Dërguari i Allahut s.a.v.s. tha: "Çfarë të pengoi t'i falësh dy rekate para se të ulesh? Thashë: "O i Dërguari i Allahut, të pashë ulur ty dhe njerëzit ishin gjithashtu ulur." Ai tha: "Kur dikush nga ju hyn në xhami, le të mos ulet përderisa t'i falë dy rekate." (Muslimi)*

Tani jemi nën kulmin e Shtëpisë së të Zotit të thirrjes. Shtëpia e Tij ka karakter të veçantë dhe veçori të jashtëzakonshme, prandaj edhe normat dhe rregullat e kësaj Shtëpie kanë karakter dhe veçori të jashtëzakonshëm, ashtu siç i ka hije nderit të Shtëpisë dhe madhësisë së të Zotit të Shtëpisë. I Dërguari s.a.v.s. na mësoi shumë nga këto rregulla e norma, disa prej tyre kanë të bëjnë me uljen, qëndrimin, kalimin, lëvizjen, hyrjen, daljen, me qëllim që të përfitojmë sa më shumë të mira dhe të vjelim të mira nga kjo vizitë e veçantë dhe e vetme.

Transmeton Ebu Dhubjani dhe thotë: *"Omeri, i biri i Hatabit kaloi pranë xhamisë, fali një rekat dhe shkoi. Dikush i tha: "Po ti e fale vetëm një rekat! Ai tha: "Ishte nafile, kush të dojë le të falet më shumë, e kush të dojë më pak, nuk desha që xhaminë ta kaloj si rrugë (pra të kaloj pranë xhamisë e të mos falem)." (Sujuti, el-Xhami' el-Kebir)*

*“Prej shenjave të Kiametit është që njerëzit do t’i marrin xhamitë si rrugë për të kaluar (pra do të kalojnë nëpër xhami) dhe se vdekja do të paraqitet (ndodhë) papritmas.” (Albani thotë se hadithi është sahih)*

*“Kur të kaloni pranë kopshteve të Xhenetit, kënaquni. Unë thashë: “O i Dërguari i Allahut s.a.v.s., po cilat janë kopshtet e Xhenetit?” Ai tha: “Xhamitë.” Thashë: “E cila është kënaqësia me ato, o i Dërguari i Allahut?” Ai tha: “(të thoni) Subhanallah, velham, du lilah, ve la ilahe ilallahu, vallahu ekber.” ( Tirmidhiu)*

*“Kur të kaloni në xhamitë tona ose në tregjet tona e me vete keni shigjeta (luftarake), atëherë mbyllni majën e tyre – ose tha: “Le ta shtrëngojë me dorë, se mund ta godasë dikë nga muslimanët me të.” (Buhariu)*

*“Kush ha hudhër (njëherë tjetër tha: kush ha qepë, hudhër dhe presh) të mos i afrohet xhamisë sonë, sepse engjëjt shqetësohen me atë që shqetësohen edhe njerëzit.” (Muslimi)*

*“Kur të del gruaja për të shkuar në xhami, le të pastrohet (të heq) aromën e miskut, ashtu siç pastrohet nga papastërtia (e marrëdhënieve bashkëshortore).” (Sujutiu në El-Xhami’ us-Sagir)*

*“M’u paraqitën shpërblimet e Umetit tim; edhe për grimcën e pluhurit (që e heq njeriu prej xhamisë), do të shpërblehet...” (Ebu Davudi)*

*“Largoni nga xhamitë fëmijët dhe të çmendurit.” (Sa’di në En-Nevafih El-Atereh)*

*“Radha më e mirë e burrave është radha e parë, kurse më e keqja ajo e fundit; kurse radha më e mirë e grave është ajo e fundit, e më e keqja është ajo e para.” (Muslimi)*

*“Sikur ta dinte ai që ec para atij që është duke u falur se çfarë gjynahu është duke bërë, do të ishte më mirë për të të qëndronte dyzet vjet se sa të kalonte para tij. Ebu Nadri thotë. “Nuk e di, a tha dyzet ditë, muaj apo vjet.” (Buhariu)*

*“Kush ngritët nga vendi i tij (duke qenë në xhami dhe del për ndonjë nevojë) – ditën e xhuma – e pastaj kthehet, ai e meriton vendin (të ulet).” (Muslimi)*

Le të shohim më thellësisht çfarë na mëson shkolla profetike nga këto rregulla, veçmas për ngritjen e zërit në xhami dhe për atë që sot xhamitë janë bërë klube për biseda të kësaj bote, e të shohim se si duhet bashkëvepruar me Shtëpitë e Allahut:

*“Amër ibn Asi transmeton se i Dërguari s.a.v.s. ka ndaluar shitblerjen në xhami, të kërkohet sendi i humbur në të, të recitohet poezi dhe ndaloj nga tubimi në hallka para namazit të xhumasë.” (Ebu Davudi)*

*“Kur ta shihni ndonjërin që bën shitblerje në xhami, thoni: “Mos ta shtoftë Allahu tregtinë”, e kur ta shihni atë që kërkon sendin e humbur në xhami, thoni: “Mos ta ktheftë Allahu sendin e humbur.” (Albani thotë se hadithi është sahih)*

*“I Dërguari s.a.v.s. ka ndaluar të ekzekutohen masat ndëshkuese në xhami.” (Albani thotë se hadithi është sahih, shih Sahih ‘ul-Xhami’)*

Amër ibn Rahbet ndërtoi një fushë në anën e xhamisë që quhej Butejhau, dhe tha: *“Kush dëshiron të bërtasë, të recitojë poezi ose ta ngrejë zërin, le të del në këtë fushë të gjerë.” (Ibn Haxheri në Tahrixh Mishkat ‘ul-Mesabih)*

*“Në kohën e fundit të botës do të ketë njerëz që bisedën e tyre do ta bëjnë në xhamitë e tyre, Allahu nuk do të ketë nevojë për ata.” (Albani thotë se hadithi është hasen)*

*“Kur Umeti im do t’i veprojë 15 cilësi, atëherë do t’i zë fatkeqësia! Të pranishmit thanë: “Cilat janë ato, o i Dërguari i Allahut?” Ai tha: “...kur të ngrihen zërat në xhami... kur burri do ta respektojë gruan e tij, kurse do ta shpërfillë nënën... kur do ta respektojë shokun, kurse prindin jo...” (Mundhiri në: Et-Tergib ve ‘t-terhib)*

*“Isha në xhami dhe një njeri më shtrëngoï. E pashë se ishte Omer ibn Hatabi, që më tha: “Shko dhe sjelli këta dy.” Unë shko-*

*va dhe ia solla." Ai tha: "Prej nga jeni ju?" Ata thanë: "Jemi nga Taifi." Ai tha: "Sikur të ishit prej qyteti, do t'u kisha rrahur, po ngrini zërin në xhaminë e të Dërguarit s.a.v.s.?" (Buhariu)*

*"Kush hynë në këtë xhaminë tonë për të mësuar të mirën ose për t'ua mësuar të tjerëve, llogaritet të jetë si luftëtari në rrugë të Allahut, e kush hynë për diçka tjetër, llogaritet si njeri që shikon atë që nuk i takon." (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih 'ul-Mevarid)*

Përkundër thirrjes këmbëngulëse të Islamit për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e xhamive, zgjerimit të tyre për të zënë sa më shumë njerëz që falen, ai përsëri shpreh kujdesin e veçantë për thjeshtësinë e tyre, për sasinë minimale të harxhimeve që do të shpenzohen për ndërtim dhe për gjëra të tjera, që xhamia të jetë simbol shpirtëror e jo material, simbol i modestisë e jo i mendjemadhësisë, i thjeshtësisë e jo i ndërlikimit dhe komplikimit. S'ka dyshim se këto veçori ndikojnë në rritjen e përshtatshmërisë në njeriun që falet, e me këtë ai arrin sa më shumë qetësi dhe shprehësi. Islami tërhoqi vërejtjen nga harxhimet e tepërta në ndërtimin e xhamive, siç tërhoqi vërejtjen nga zbukurimi dhe ngjyrosja e tepërt e tyre. Në këtë kontekst janë disa hadithe që flasin:

*"Kush e ndërton një xhami sa një strofull të dallëndyshes, Allahu do t'ia ndërtojë një shtëpi në Xhenet." (Albani thotë se hadithi është sahih)*

*"Kush e ndërton një xhami, Allahu do t'ia ndërtojë një shtëpi më të gjerë në Xhenet." (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih 'ut-tergib)*

*"Prej shenjave të Kiametit do të jetë mburrja e njerëzve në xhami – do të mburren me luksin e saj, ngritjen e saj dhe harxhimet për të." (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih el-Xhami)*

*"Ibn Abasi thotë: "I Dërguari i Allahut s.a.v.s. tha: "Nuk jam urdhëruar që xhamitë t'i ndërtoj të larta. " Ibn Abasi thotë:*

*“Do t’i zbukurojnë ato siç i zbukurojnë hebrenjtë dhe të krishterët – kishat e tyre.” (Ibn Hazmi, El-Muhala)*

*“Në ditët e fundit të botës do të ketë nga Umeti im njerëz që do t’i zbukurojnë xhamitë e do t’i prishin zemrat e tyre; do të ketë prej tyre që më shumë ka kujdes për rrobat e veta se sa për fenë e tij; nuk do të kenë dert nëse diçka ju vjen nga dynjaja për çështjen e fesë.” (Hakimi)*

Ibn Hazime thotë se Omeri urdhëroi të ndërtohen xhamitë, dhe atyre që e ndërtonin u tha: *“Mbroni njerëzit prej shiut – pra, ndërtoni ato sa për t’i mbrojtur prej shiut – mos i ngjyrosni kurrsesi me të kuqe ose të verdhë – pra, mos i ngjyrosni fare – që njerëzve t’ua prishni qetësinë e namazit.” (Buhariu, Albani mbron këtë hadith dhe e transmeton)*

*“O Allahu im, mos e bën varrin tim idhull, e mallkoftë Allahu popullin që varret e të dërguarve të tyre i morën për xhami.” (Ahmedi, Albani thotë se hadithi është sahih)*

## Pjesa 4

### Në pritje të namazit

*“Seancë” e rëndësishme me Allahun, e ku? Në Shtëpinë e Allahut, jo në shtëpinë e filan ministrit apo filan kryetarit! A thua se jemi përgatitur për këtë vizitë të jashtëzakonshme? A thua i kemi bërë përgatitjet e duhura për këtë takim të rëndësishëm, ashtu siç përgatitemi për ndonjë eveniment të natyrës së kësaj bote, siç është p.sh. procedura e dekorimit me poste të larta, pranim në fakultet ose delegacione zyrtar?*

*Si të përgatitesh për takim me kryetarin, udhëheqësin ose mbretin? A mendon se ai do të gëzohet kur të sheh se po hynë tek ai me rroba të përlyera? Duke e ditur se ke mundësi t’i pastrosh ato? Po nëse hynë tek ai me pamje të çrregulluar? Kur ai e di se ke mundësi të rregullohesh! Po nëse hynë me flokë të pakrehura? Kur ai e di se ke mundësi ato*

t'i krehësh! Ose vjen me vonesë, jo në kohë të caktuar, e që ke mundësi të ishe në kohë të caktuar!? Kur ai e di se thirrjen e ke marrë me kohë, por ti nuk je përgjigjur siç duhet! Mos vallë nuk di për rëndësinë e takimit, prandaj nuk i ke marrë parasysh punët me kohë dhe je marrë me punë të kota?

Praktikisht, nëse mendon pak më thellë, do të shohësh se namazi nuk fillon me tekbirin fillestar! Është me rëndësi që para çdo namazi të kemi një parapërgatitje fillestare, një periudhë kalimtare që ndan midis stacionit tonë tokësor që bëhemi gati ta lëshojmë dhe, stacionit të lartë hapësinor, drejt të cilit bëhemi gati të nisemi e të lëshohemi. Qëllimi i kësaj mbledhje kalimtare nuk është vetëm dyfishimi i shpërblimit, edhe pse është gjë që nuk mohohet, siç do të shohim më vonë, por të kënaqemi me Allahun, në Shtëpinë e tij të veçantë dhe ndryshe nga të gjitha shtëpitë e tjera që i njohim, të kënaqemi me kohën më të ëmbël dhe më të bukur të jetës sonë. Është periudha e qetësisë dhe arritjeve të mëdha, e rastit të zhveshjes nga preokupimet dhe sëmundjet e jetës së përditshme të grumbulluara mbi kokën tonë, i pushimit të vogël për pastrimin e shpirtit nga lodhjet, brengat dhe njollat e saj.

Këto çaste të këndshme që i paraprijnë namazit i shëmbëllezjnë "festës së bajramit", çaste që mund të zgjasin dhjetë minutë ose gjysmë ore, më shumë ose më pak. Janë çaste të vetmisë, vetmi që në ty krijon qetësi të lartë shpirtërore, kënaqësi me ndjenja të veçanta dhe ndjenja për shpërblimin që do ta marrësh për pritjen e bërë. Tani përgatitesh për çastin që afrohet, ku do të qëndrosh para Krijuesit tënd, vetëm pas pak do të ndodhë kjo. I Dërguari s.a.v.s. na mëson në shumë hadithe se pritja e namazit është namaz:

*"Namazi në xhemat ia shkon namazit në shtëpi... për njëzet e pesë shkallë. Kur dikush nga ju merr abdest dhe atë e bën për bukur, dhe vjen në xhami vetëm për t'u falë, le ta dijë se nuk ka bërë një hap e të mos e ketë ngritur Allahu me të një shkallë, e t'ia*

*kishte hequr një gabim, deri sa të hyjë në xhami, e kur të hyjë në xhami, le ta dijë se është në namaz, engjëjt luten për të derisa qëndron në vendin ku do të falet, thonë: “O Allah, fale, o Allah mëshiroje, kështu deri sa të mos bëj diçka.” (Buhariu)*

*“I Dërguari s.a.v.s. doli një natë që e kishte vonuar namazin e jacistë aq sa kishte kaluar një orë nga nata, e njerëzit pritnin në xhami. Ai tha: “Çfarë po pritni?” Ata thanë: “po presim namazin.” Ai tha: “të dini se jeni në namaz përderisa jeni duke e pritur atë.” Pastaj tha: “Është ky namaz që nuk e kanë falur asnjë nga popujt e mëparshëm. Pastaj ngriti kokën lart drejt qiellit, dhe tha: “Yjet janë siguria e qiellit, kur të shuhen yjet, atëherë qiellit do t’i vjen ajo që është premtuar (kiameti), unë jam siguria e shokëve të mi, kur unë nuk do të jem në mesin tuaj, atëherë juve do t’ju vjen e premtuara, kurse shokët e mi janë siguria e Umetit tim, kur ata nuk do të jenë më, atëherë Umetit tim do t’i ndodh ajo që iu është premtuar, o Bilal, thirre ikametin.” (Hejthemiu, Mexhme’ ‘uz-Zevaid)*

Mos harro se koha e përgatitjes për dalje nga shtëpia, rruga për në xhami dhe koha e pritjes së namazit është namaz. Të kujtojmë se rruga për në xhami është e mbushur plot falje dhe mirësi. Nëse është natë dhe errësira ka kapluar gjithçka apo është ditë me vapë të madhe, atëherë të mirat dhe shpërblimet dyfishohen. Pastaj, mbi të gjitha, shtohen edhe llogaritë hyjnore, varësisht nga pritja e namazit, qëndrimin në xhami dhe qëndrimin pas namazit. E gjithë kjo llogaritë namaz, shpërblim dhe dritë në errësitat e Ditës së Kiametit:

*“Sikur ta dinin njerëzit se çfarë shpërblime kanë në thirrjen e parë dhe safin e parë, e pastaj nuk do të gjenin tjetër përveç se të kujdesen për atë, do të kujdeseshin tepër; sikur ta dinin se çfarë shpërblime kanë që më herët të jenë në namaz të drekës, do të vraponin për të shkuar më herët; po sikur ta dinin se çfarë shpërblime kanë në namazin e jacistë dhe të sabahut, do të shkonin këmbadoras.” (Buhariu)*

*“Përgëzoi ata që shkojnë në xhami në errësirë me dritë të plotë në Ditën e Kiametit.” (Ebu Davudi)*

*“Tri gjëra llogariten që shkatërrojnë, tri të tjera që shpëtojnë, tri të tjera që shpaguajnë, kurse tri të tjera që ngrenë në shkallë; ato që shkatërrojnë janë: koprracia e kultivuar (që respektohet), pasioni që ndiqet dhe vetëmashtrimi i njeriut me vetveten; ato që shpëtojnë janë: drejtësia kur jemi në çaste të kënaqësisë dhe zemërimit, maturia në varfëri dhe pasuri dhe frika e Allahut të Madhërishëm në vetmi dhe publik; ato që shpaguajnë janë; pritja e namazit pas namazit, përsosja e abdesit në ditë të ftohta dhe shkuarja në tubime; ato që ngrenë njeriun në shkallë janë: ngopja e njeriut me ushqim, përhapja e selamit dhe falja e namazit natën kur të tjerët janë në gjumë.” (Albani thotë hadithi është hasen, Sahih el-Xhami’)*

*“Kush ndalet me imamin deri sa ai të largohet, llogaritet të ketë falur namaz të natës.” (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih el-Xhami’)*

Me siguri se përshkrimi më i bukur pejgamberik i atyre që rrinë ulur në xhami dhe mbirëmbajtësit e tij është ai që na tregon për “miqtë” e jashtëzakonshëm që çdoherë na presin, që na kërkojnë nëse vonohemi për vizitë, që na vizitojnë kur ne sëmuremi dhe nuk mund të shkojmë në xhami, na ndihmojnë nëse na ndodh ndonjë e papritur ose vështirësi, kështu kur ne jemi “myshteri” të përhershëm të xhamisë dhe vizitorë të përhershëm të shtëpisë së Allahut: *“Xhamitë kanë shtylla, engjëjt janë bashkëbisedues të tyre, nëse ata mungojnë, i kërkojnë, nëse sëmuren, i vizitojnë, e nëse kanë nevojë për diçka, i ndihmojnë. Pastaj tha: “Ai që është në xhami përfiton tri veçori: një vëlla që i sjell dobi, fjalë të urtë ose mëshirë që është duke e pritur.” (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih et-Tergib)*

O Allah! Po çfarë miq qenkan këta që i ftojnë njerëzit që falen në xhami, të cilët janë si shtylla të forta të xhamisë!?

S'ka dyshim se këta sillen shumë nëpër xhami dhe presin namazin. Është kënaqësi e pakundshoqe! Kënaqësi që vjen pas tërheqjes së papritur nga beteja e jetës, pluhurit dhe zhurmës së saj, plagëve shpirtërore, të ulesh me engjëjt, pranë atyre që shërojnë plagët, pastrojnë shpirtin, kërkojnë falje për gabimet, pastrojnë zemrat, aty ku presim të na hapen dyert e takimit dhe lutjes, pushimit shpirtëror, ngritjes shpirtërore, kënaqësisë me burimet e mëshirës që derdhen në zemër, ndjejmë se si pikat e kësaj mëshire bien pa ndalur mbi ne. Kënaqësi e ëmbël është dalja nga xhamia dhe ndjenja se dolëm të pastër nga gjynahet, ashtu siç kemi lindur, të gatshëm të jemi në prani të Allahut në Ditën e Kiametit: *“Allahu do të thërret në Ditën e Kiametit: “Ku janë fqinjët e Mi, ku janë fqinjët e Mi? Engjëjt do të thonë: “Zoti ynë! Po kush duhet të jetë pranë Teje? Ai do të thotë: “Ku janë mirëmbajtësit (ndërtuesit) e xhamive.”* (Albani thotë se hadithi është sahih, Silsiletu 's-sahiha)



# NËN KUBEN E DYTË

## Fshehtësitë e namazit





**TRIBUNNA E PARË  
FSHEHTËSITË E NAMAZIT TË XHUMASË  
DHE FALJES ME XHEMAT**

**Pjesa 1**

**Falja e namazit me xhemat: fshehtësi e civilizimit**

A e keni pyetur vetveten ndonjëherë, siç e kam pyetur unë veten time: cili është definicioni i civilizimit? A është mjeti, fabrika, atomi, kompjuteri, raketa bërthamore, nëndetësja, anija luftarake detare, qiellore, anija kozmike, bomba atomike? Të gjitha këto janë fryte të civilizimit, kurse civilizimi që solli këto fryte përkufizohet në dhjetë fjalë, ato janë:

pastërtia  
saktësia dhe koha  
përsosmëria  
disiplina  
modestia  
puna ekipore  
përgjegjësia individuale apo specializimi  
toleranca dhe butësia  
drejtësia dhe barazia  
ambicia dhe vullneti

A e keni pyetur vetveten ndonjëherë, siç e kam pyetur unë veten time: pse namazi të falet me xhemat? Pse të stolisemi me rroba të bukura kur dalim nga shtëpia, zyra, dyqani ose fabrika për të shkuar në xhami? Pse në kohë të caktuar? Pse nuk lejohet vonimi qoftë edhe për pesë apo dhjetë minuta? Pse ndërpresim kërkimin e riskut, thënë më mirë pse ndërpresim tërësisht të menduarit për riskun? Po puna? Studimi? Familja? Të tjerët? Pse të gjitha këto i lëmë anash

dhe i heqim nga koka jonë? Preokupimi i tyre nuk na intereson më, jemi të drejtuar për në Shtëpinë e Allahut, për ta falur namazin me xhemat, bashkë me të tjerët që kanë ardhur nga të gjitha anët në kohë të caktuar, pa vonesë, pa arsyezim, pa përjashtim nga ndonjëri?! A ka në këtë civilizim?

A e keni pyetur vetveten ndonjëherë, seç e kam pyetur unë veten time: pse të jemi me rroba të bukura në xhami? Pse të pastrohemi para kësaj? Pse abdesi? A thua se çështja ka të bëjë vetëm me respektin e Shtëpisë së Allahut, vetëm me pastrimin që na bënë të prirë të qëndrojmë para Allahut, apo se çështja ka të bëjë me çështje civilizuese të pastërtisë, abdesit, rrobave të bukura etj.

A e keni pyetur vetveten ndonjëherë, siç e kam pyetur unë veten time: pse xhamia quhet **mesxhid** (vendi i sexhdes), e nuk quhet **merka'** (vendi i rukusë), sepse namazin e numërojmë me numrin e rekateve e jo të sexhdeve? Them: i falëm dy ose katër rekate! Pastaj, pse është emri tjetër i zgjedhur **el-xhami'** (vendtubim)? Pse shprehja **Allahu ekber** është simbol i xhamisë dhe simbol i namazit? Pse është shprehja më e përsëritur dhe më e njohur në Islam, bile më e përsëritur se disa adhurime të tjera, kurse nuk është e Kur'anit? Pyetje të shumta që vazhdimisht na bien ndërmend, që kërkojnë përpjekje të pathyer për përgjigje të sakta, edhe pse përgjigjet tona janë të karakterit njerëzorë, që në fund të fundit nuk nënkuptojnë njohjen e plotë të së vërtetës së plotë të lartë.

Falja e namazit me xhemat dhe në kohë të caktuar është shkolla më e vlefshme nga e cila del besimtari i prirë dhe i aftë për ta bartë pishtarin e civilizimit. Vetëm pesë minuta vonesë në namazin me xhemat nënkupton humbjen e shumë vlerave të mëdha që nuk ke të drejtë të kërkosh kompensim për shpërblim. A nuk është ky mësim i shkëlqyeshëm që përsëritet pesë herë në ditë në jetën e besimtarit

musliman? A nuk mjafton ky mësim për të edukuar një musliman që të mësojë vlerën e kohës, minutave, sekonda-ve, vlerën e humbjes nëse nuk i përmbahet saktësisë së duhur me të tjerët?

Po pastërtia, abdesti, rrobat e bukura?! A nuk janë këto përgatitje për hyrje në xhami dhe përgatitje për të qëndruar para Allahut? Janë këto gjëra që na pastrojnë nga fëlliqësira e injorancës, mbeturinat e paditurisë, pluhuri i çmendurisë, kaosi i vonësës, shkujdesit etj, për të na bërë të aftë të hymë në klubin e civilizimit i cili i mbyll dyert e tij para çdokujt që nuk i plotëson kushtet esenciale civilizuese të pastërtisë, pamjes së bukur dhe rregullimit, jo vetëm në aspektin fizik, të trupit dhe rrobave, por edhe në xhamitë e tyre, shtëpitë e tyre, zyrat e tyre, shkollat e tyre, spitalet e tyre, rrugët e tyre, shërbimet publike dhe shumë aspekte të ndryshme të jetës së tyre.

Tani jemi në xhami. Është emër i ri i Shtëpisë së adhurimit. Emri **mesxhid** – na kujton pozitën në të cilën robi është më afër Zotit të tij, pozita e sexhdes. Sexhdeja nënkupton vënien e kokës, ballit dhe hundës në shkallë të barabartë me tokën (dheun), është shkalla më e lartë e modestisë dhe përuljes, aq sa kokën e kemi të përulur përtokë, aq jemi më afër Zotit dhe më të ngritur në shkallë tek Ai.

Ky ushtrim ditorë i modestisë që gati çdo dy orë e më tepër kryhet nga besimtarët, ditën e natën, siç i përshkruan Zoti i Madhërishëm këta dhe engjëjt e Tij: *“Nuk ngurrojnë për ta adhuruar Atë.”* – një ditë bëhet pjesë e pandashme dhe e pashkëputshme e natyrës së tyre, ata më nuk ndjejnë mendjemadhësi e as mosmarrëveshje, këto gjëra nuk zënë vend në jetën e tyre, sepse midis vete janë, siç i përshkruan Allahu i Madhërishëm: *“..të përulur ndaj besimtarëve..”*, dhe siç porosit të Dërguarin e Tij besnik: *“Me besimtarët sillu*

*butë.*" Vetëm kështu do të dimë se kemi bërë hapin e parë për të hyrë në tokat territoriale të civilizimit.

Hyrja në xhami doemos duhet të na kujtojë se jemi duke hyrë për të ushtruar modestinë, kur jemi në xhami doemos të kujtojmë se jemi në vendin e tubimit dhe barazisë, bashkimin e zemrave, aty nuk ka i vogël e i madh, i rëndësishëm e i rëndomtë, kryetar e i varfer. Aty mësojmë sjelljen e butë me vëllezërit tanë, si të jemi modest me të tjerët, me zemër të përkulur para tyre: *"Drejtoni safet, sepse ju radhiteni sikur që engjëjt radhiten, afroni shpatullat, mbushni zbrazëtirat, bëhuni të butë me vëllezërit e tu, mos lini zbrazëtira për shejtanin, kush e mbush safin, Allahu e afron atë, e kush e këputë, Allahu e largon atë."* (Albani thotë se hadithi është sa-hih, Sahih 'ul-Xhami')

Allah! Sa herë e kemi lexuar këtë hadith apo e kemi dëgjuar në biseda të ndryshme dhe mësimë javore të ditëve të xhumasë, sa herë e kanë përsëritur imamët e xhamive në çastin e fillimit të faljes së namazit, por kush nga ne është ndalur tek domethëniet e tij dhe shprehjet e tij t'i analizojë një nga një?! Jo t'i lexojë ato në shpejtësi, por çdonjëren ta analizojë, të lexojë atë që është pas këtyre fjalëve dhe të lexojë midis rreshtave, se vetëm kështu do të kuptojë se ky hadith peygamberik nuk është vetëm rregull i drejtimit të safëve, por kushtetutë e drejtimit të shpirtit, sistem i përkryer i ndërtimit të shoqërisë civilizuese, të barabartë, plot drejtësi dhe barazi, që përfshinë gjithë Umetin.

Gjatë leximi të këtij hadithi, pyesim: pse **"drejtoni safet"** dhe **"afroni shpatullat"**? Pse kjo rëndësi e veçantë dhe e madhe për drejtimin e safeve dhe afrimin e shpatullave dhe këmbëve? Cili është ky dallim i madh midis drejtimit të safit dhe jo drejtimit të tij, midis afrimit të shpatullave dhe mos afrimit të tyre? Përgjigja e thjeshtë: sepse civilizimi fillon prej këtu. Është një farë tjetër e farave të civilizimit.

Së pari, ti je i ftuar për këtë takim të namazit, sepse civilizimi ngritët mbi shtyllat e punës kolektive e jo individuale, është ndjenjë e shpirtit kolektiv. Civilizimi është xhemati.

Së dyti, ti je i ftuar t'i përmbahesh kohës së caktuar, jo një herë, por pesë herë në ditë, për t'i takuar vëllezërit e tu, se vetëm kështu do të mund të vëresh saktësinë, përkushtimin, përmbushjen e takimeve në kohë etj, sikur saktësia është pjesë e karakterit tënd ,nga i cili nuk heq dorë asnjëherë. Civilizimi nënkupton saktësinë, përkushtimin, besueshmërinë dhe respektin e kohës sonë dhe kohës së të tjerëve.

Së treti, ti je i ftuar për drejtimin e safeve në këtë takim të rëndësishëm me individët e tjerë të grupit, sepse radhitja e juaj në radhë dhe drejtimi i safeve do të reflektohet vetvetiu në drejtim dhe rend të jetës dhe shpirtit, radhitje e të menduarit, përsosje e punës, takim i zemrave, që të formohet një shoqëri e suksesshme, solidare, integruese dhe civilizuese. Civilizimi nënkupton rregullimin, drejtimin, përsosjen, integrimin, solidaritetin. Drejtimi i safit nuk është punë individuale, secili musliman detyrohet që të shikon në të djathtë e në të majtë, para dhe pas tij, me qëllim të rregullimit të safeve. Rregullimi i safeve është punë kolektive që kryhet me përpikëri, është ushtrim i përhershëm për zhvillimin e shpirtit ekipor brenda nesh.

Është me rëndësi të kujtojmë se Allahu nuk e lë këtë rregull në pakujdes, që me të të luan dobësia dhe shkujdesi ynë njerëzor siç dëshiron, por Ai e lidh menjëherë me qiellin, të mos mendojë ndonjëri të heq dorë nga ai ose ta shtrembërojë ose korrigjojë: kujtoni o robër të Allahut se safet e juaja në namaz në tokë janë skicë e safeve të engjëjve në qiell, **“sepse ju radhiteni sikur që engjëjt radhiten në qiell”**. Është lidhshmëri e çuditshme dhe e urtë midis kushteve të civilizimit dhe elementeve të tij në tokë dhe asaj që ndodh në qiell. Kjo vërteton se rendi i përsosur nuk është

veçori vetëm e civilizimit, por është pjesë e pandashme e adhurimit tonë gjithashtu. Hadithi me pak fjalë na thotë që adhurimi i shëndoshë është civilizimi i shëndoshë, ashtu sikur që është në qiell, ashtu duhet të jetë në tokë.

Pas gjithë kësaj, ti je i ftuar t'i përmbahesh një kushti tjetër: "*mbushni zbrazëtirat, mos lini zbrazëtira për shejtanin*". Kjo nënkupton përgjegjësinë individuale në ndërtimin e civilizimit. Secili nga ne mbush një zbrazëti në Umet, secili nga ne ka rolin e tij, punën e tij individuale dhe specializimin e tij në ndërtimin e civilizimit të Umetit, çdo zbrazëti (vrime) në këtë godinë nënkupton shkujdesin e individit për përgjegjësinë e tij në mbushjen e kësaj vrime. Që këtej, vrimat në fjalë bëhen rrugë për të depërtuar të tjerët që trupin e Umetit dhe për të bërë çmos. Ndoshta unë jam ai që lejova të tjerët të hynë nga vrima që unë duhej ta mbylloja! Civilizimi nënkupton specializimi dhe përgjegjësi individuale, shtrëngim i fortë mes vete dhe godinë e fortë.

Allahu i Madhërishëm për ty dytën e herë na kujton rregullin e lidhshmërisë së tokës me qiellin, prandaj, keni kujdes, o robër të Allahut: nëse e mbushni safin, Allahu do t'ju afrojë (thënë ndryshe: nëse ju lidheni në tokë, Ai do t'ju bashkojë në qiell), e nëse e këputni, Ai do t'ju largojë (nga qielli): "*kush e mbush safin, Allahu e afron atë, e kush e këputë, Allahu e largon atë.*" Sa lidhje e bukur dhe e qartë midis kushteve të civilizimit këtu në tokë me atë që ndodh në qiell, lidhje midis kushteve të adhurimit dhe kushteve të civilizimit.

Mbi të gjitha, ti je i ftuar t'i shmangesh arrogancës, të bëhesh i butë dhe i sjellshëm me vëllezërit e tu në namaz, në shoqëri, në jetë: "*...bëhuni të butë me vëllezërit e tu.*" Butësia dhe afrimi i shpatullave shfaqet në përpjekjen e vëllezërve për të na ndihmuar t'i drejtojmë safet, më para ose më mbrapa, në mbushjen e safeve dhe, e gjithë kjo, do

të reflektohet në fund në zemrat tona dhe karakterin tonë. Ne kurrë nuk do të kemi sukses me të tjerët me arrogancë, ne kurrë nuk duhet të mbështetemi në arrogancë me të tjerët, e as të bëhemi ekstremistë dhe të ashpër e të ngurtë në të menduarit tonë dhe bashkëveprimin dhe drejtimit të punëve tona. I Dërguari s.a.v.s. është shembulli më i përkryer i sjelljeve të buta, në çdo detaj të jetës së tij, siç thotë Aisha (Allahu qoftë i kënaqur me të): *“(I Dërguari s.a.v. s.)... kurrë nuk e ka goditur shërbëtorin, e as gruan, i Dërguari s.a.v.s. kurrë nuk ka goditur diçka me dorën e tij, përveçse kur ishte në luftë në rrugë të Allahut; ai kurrë nuk bëri zgjedhje midis dy gjërave, përveçse ta kishte zgjedhur më të dashurën për të dhe më të lehtë, nëse nuk ishte mëkat, e nëse ishte mëkat, ai ishte njeriu që qëndronte më larg se gjithë të tjerët, ai kurrë nuk u hakmor për vete - për gjërat që iu drejtuan në jetë – përveçse nëse kishte ndodhë që urdhrat e Allahut të Lartëmadhërishëm të nëpërkëmbeshin, në këtë rast hakmerrej për hir të Allahut të Lartëmadhërishëm.”* (Albani thotë se hadithi është sahih, Silsiletu es-sahiha)

Cili nuk do të kishte dashtë t’i afrohet veçorive morale të të Dërguarit s.a.v.s., në butësi, tolerancë, korrektësi, maturi, modesti dhe mëshirë për besimtarët? Cili nuk e ka kuptuar ende të vërtetën e **“dersit të mesxhidit”**, dersit të **“namazit me xhemat”**, madhështinë e modestisë, tolerancës dhe butësisë me vëllezërit tanë? S’ka dyshim se çasti i hyrjes në xhami dhe shqiptimi i shprehjes **“Allahu ekber”** do të shpalojë dyshimin e atij që dyshon në këtë të vërtetë. **Allahu ekber**, fillimi i namazit.

Kujto se sado që të jesh i pasur, me post të lartë, me famë të madhe, trup të gjatë e të bukur, ti nuk je më tepër se një trup i pavlerë që nuk shihet me sy, bile as me mikroskop, nëse krahasohet me madhështinë e krijesës, kozmosit dhe planetëve gjigante, që i dimë dhe që nuk i dimë. Megjithatë, shprehja **Allahu ekber** që buron nga brendia jote provon se

Allahu është më i madh se ti dhe çdo krijesë tjetër: *“Ata nuk e kanë vlerësuar siç duhet fuqinë e Allahut. në Ditën e Kiametit, e tërë Toka do të jetë në grushtin e Tij, ndërsa qiejt do të mbështillen nën të djathtën e Tij. Qoftë i lavdëruar Ai...”* (Ez-Zumer, 67)

Qoftë i lavdëruar Allahu! Sa i kujdesur ishte i Dërguari s.a.v.s. të jemi modest, kurse ne u bëmë mendjemadh, të jemi të butë, e ne u bëmë arrogant, të jemi të matur e tolerant, e ne u bëmë ekstremist dhe të ashpër, të kemi mirëkuptim dhe të afrohemi midis vete, e ne u larguam dhe u përçamë, të jemi të bashkuar e të fortë, e ne u ndamë dhe u dobësua. Ai s.a.v.s. e deshi këtë për ne duke përshkruar namazin si pikënisje të kësaj të vërtete: *“I Dërguari s.a.v.s. i prekte (lëmonte) shpatullat tona në namaz, dhe thoshte: “Drejtohuni e mos u përçani, kështu që zemrat e juaja të përçahen, le të më pasojnë (le të jenë pas meje) mua të zgjuarit dhe të maturit nga ju, pastaj ata që pasojnë pas tyre, e pastaj ata që pasojnë pas tyre.” Ibn Mes’udi thotë: “Ju sot jeni shumë më të përçarë.”* (Muslimi)

Tani na bëhet e qartë lidhja e të Dërguarit s.a.v.s. midis drejtimit të safit në namaz dhe drejtimit të zemrave! Është e vërtetë profetike dhe edukative e pamohuar: nëse përçaheni në rendin fizik të trupit), do të përçaheni në rendin shpirtëror (në zemra), bashkohuni në safe, do të bashkoheni në zemra dhe shpirt, në ju do të ndizet flaka e shpirtit kolektiv. I Dërguari s.a.v.s. u tregua i kujdesshëm që ky rregull civilizues të mbretërojë në të gjitha gjendjet dhe të përforcohet në shpirtin e besimtarëve: *“I Dërguari s.a.v.s. i drejtonte safet tona ashtu sikur bëhej që i drejtonte shigjetat, derisa e pa se ne e kuptuam atë që donte ai. Një ditë doli dhe posa u ngrit për t’u falur dhe për të thënë Allahu ekber, e pa një njeri fshatar që gjoksin e kishte nxjerrë jashtë safit, dhe tha: “Gjithsesi që do t’i drejtoni safet e juaj, ose Allahu do t’jua ndryshojë fytyrat e juaja.”* (Muslimi)

*“Drejtoni safet, sepse unë shoh edhe mbrapa meje. Ne i ngjisnim shpatullat me tjetrin dhe këmbët tona me tjetrin.” (Buhariu)*

*“Drejtohuni në safe, ngjeshuni me njëri-tjetrin, sepse unë shoh edhe mbrapa meje. Shuxhai dhe Hasani thonë se Enesi tha: “E shihja se si dikush nga ne e ngjiste shpatullën e tij me atë të shokut, këmbën me këmbën e tij, sikur të mendoja sot ta bëja këtë, do të ikte ndonjëri nga ju sikur të ishte mushkë kokëfortë.” (Dhe-hebiu në Sijer ‘ul-A’lam en-Nubela)*

Përkushtimi i besimtarit në faljen e namazit me xhemat pesë herë në ditë, nënkupton platformën nga e cila dalin ambiciet dhe vendosmëritë, që janë shtyllë e civilizimit njerëzor. Ambicia e zgjimit herët në mëngjes për namazin e sabahut, dalja në xhami, afër ose larg, ambicia e ndërprerjes së punës në mesditë, sado që ajo të jetë e rëndësishme, përsëritja e kësaj në namazin e ikindisë, bashkimi me muslimanët në mbrëmje në xhami, pas ditës së lodhshme për kërkim të riskut, e më në fund ambicia e ndarjes nga familja, nga ngrohësia e shtëpisë, e ndarjes sonë nga pushimi dhe çlodhja për të dalë në namazin e jacisë. E tërë kjo është shkollë që edukon njerëz me ambicie dhe vendosmëri të larta, njerëz me vullnet për të bartë përgjegjësitë e mëdha të civilizimit.

Sikur sot të studiojmë popujt e botës dhe të mëtojmë të bëjmë dallim midis atyre që janë civilizuar dhe atyre që kanë ngecur, me siguri se do të përfundonim në dy veçori të rëndësishme që dallojnë këta dy grupe; do të vërenim se ata që u civilizuan u bënë modest, tolerant, të bashkuar, të fortë, të specializuar, punuan bashkë në ndërtimin e atdheut, u bënë një grusht, një zemër, kurse ata që ngecën u treguan mendjemadh, arrogant, egoist, ekstremist, u ndanë e u përçanë mes vete, çdonjëri shkoi në rrugë të vet, takimi tyre nënkuptonte vetëm për luftë dhe zjarr mes vete. A nuk është kjo pasqyra e muslimanëve në shumë çështje të tyre

dhe vende të tyre? Civilizimi nënkupton butësinë, modestinë, tolerancën, afrimin dhe bashkimin.

Sa mirë do të ishte sikur çdonjëri nga ne ta vendoste këtë hadith para syve, t'i studionte fjalët e tij një nga një, e ta praktikonte vetë dhe familja e tij dhe ata që i ka përreth, vetëm atëherë do të bëhej e qartë se i Dërguari s.a.v.s. nuk deshi që vetëm të vërtetonte rëndësinë e faljes së namazit me xhemat pa mos e shpjeguar fshehtësinë e kësaj: uniteti, fuqia, bashkimi dhe solidariteti, përndryshe do të jemi sikur delet që ndahen nga tufa dhe bëhen gjah i lehtë për ujkun. Sot përreth nesh ka shumë ujë në këtë botë: *“Në çdo fshat që jetojnë tre vetë apo shkretëtirë e nuk falet namazi (me xhemat), do t'i dominojë djalli; kujdesu që të falesh me xhemat, sepse ujku e han atë (dele) që shkëputet nga (tufa) xhemati.”* (Ebu Davudi)

A e kuptuat tani fshehtësinë e faljes së namazit me xhemat? I Dërguari s.a.v.s. ju thotë: *“Nëse nuk faleni me xhemat, qoftë nëse jeni edhe tre vetë, dijeni se do t'ju ha ujku që ju vëzhgon, e sa shumë ujë që ka.*

A e ke paramenduar veten sikur jeton në një fshat që banojnë vetëm dy vetë dhe ti je i treti i tyre? A e ke paramenduar ndonjëherë gjendjen e këtij fshati të vogël ku jeta gjallëron vetëm me tre vetë? Vallë, si do të ishte që ata të përçaheshin mes vete dhe të largoheshin? Sikur asnjëri të mos jetonte me tjetrin? Sikur asnjëri të mos fliste me tjetrin, e të mos kishte askush që qan hall me dikë? Ku askush nuk e këshillon askënd? As që ndihmojnë njëri-tjetrin? Çdonjëri jeton i vetëm në këtë botë?

Pastaj, përpiqu të krahasosh këtë jetë me një jetë tjetër, aty ku këta tre vetë çdo ditë takohen, shkëmbejnë biseda dhe lajme e mendime, përvojë të përditshme dhe shprehi; njerëz shpirtmirë, shpirt-qetë, jetë të pasur, fshat me plot begati dhe lulëzim. Cila do të ishte jetë më e preferuar? Cila

do të ishte jetë më e sigurt, më e lumtur, më produktive, më lulëzuese dhe e pasur?

Ky shembull i një fshati ku banojnë vetëm tre vetë, na shfaq në formë karikature gjendjen e shoqërisë islame ku namazi nuk falet me xhemat. Bashkimi i njerëzve, i zemrave, i përvojave, i qëllimeve dhe shpresave, janë gjërat që krijojnë të ardhme të sigurt e të lulëzuar.

A e ke parë atë që në xhami vjen me vonesë, gati se nuk i ka kaluar rekati i parë, e pastaj posa ta mbarojë atë del me vrap nga xhamia, duke mos e çarë kokën për asnjërin, as që i përshëndet ata që janë falur me të, e as që i lë të tjerët ta përshëndesin për dorë, nuk i pyet për hallin që kanë, e as nuk i lë që ata ta pyesin për hallin si e ka, ky nuk merr pjesë në problemet e tyre të përditshme, dhe nuk i lë që ata të merren me problemet e tij. Prandaj, çfarë namazi është ky? Çfarë xhemati i civilizuar është ky? Çfarë kontributi civilizues japin muslimanët gjatë namazit?

Më pëlqen shumë tradita e vëllezërve pakistanez në Britani, imami pas namazit qëndron afër mihrabit dhe përshëndet për dore secilin njeri, kështu bëjnë edhe të tjerët, ndalen dhe përshëndeten mes vete një nga një. Është pra sunet i mirë i vogël, por me rëndësi të madhe për faljen e namazit me xhemat, përkundër asaj që ndodh në disa xhami të vëllezërve tanë pakistanez, aty ku ndizet lufta për shkak të një përgjigje të pyetjes më të rëndësishme që e kanë: kush do të dominojë në xhami? Ka ndodhur që grindjet e tyre të marrin viktimë, andaj çfarë namazi do të falë para Allahut kur para meje është trupi i vëllait tim që e kanë mbytur për shkak të këtij namazi që po e fali?

Sikur të ishin të edukuar me kuptimin e faljes së namazit me xhemat, me siguri do të shkëmbenin dashuri dhe paqe mes vete dhe mirëkuptim, e jo urrejtje, luftë e vrasje!

Përndryshe, namazi i tyre nuk është namaz me xhemat e as tubimi i tyre nuk është tubim (xhemat).

Përpigu të falesh me xhemat, qoftë edhe me anëtarët e familjes tënde, nëse jeton larg xhamisë apo për shkaqe shëndetësore nuk je në gjendje të shkosh në xhami, sidomos nëse jeton në vende që nuk janë islame. Ju jeni sikur tre vetë që banojnë në fshat, por me këtë bashkim ju i afroni zemrat, shpirtrat, i zbehni urrejtjet dhe grindjet, djalli largohet nga ju, përderisa ndjeni se në këtë vetmi të pashembullt Allahu është me ju, se engjëjt ju mbulojnë me mëshirë, se ju mbulon qetësia hyjnore dhe kujdesi i lartë hyjnor dhe mëshira e Tij.

Rritja e numri të banorëve të fshatit nënkupton rritjen e xhematit dhe bashkimit, e me këtë edhe rritjen e shpërblimeve të atyre që janë të tubuar: *“Dy vetë janë më të mirë se një, e tre vetë janë më të mirë se dy, po katër janë më të mirë se tre; kujdesuni të jenë bashkë (xhemat), sepse Allahu e bashkon Umetin tim vetëm në udhëzim.”* (Sujutiu)

*“Namazi i dy vetëve që njëri bëhet imam për tjetrin është më i denjë tek Allahu se namazi i katër vetëve që falen veç e veç; namazi i katër vetëve që njëri i bëhet imam të tjerëve është më i denjë tek Allahu se namazi i tetë vetëve që falen veç e veç, kurse namazi i tetë vetëve që njëri i bëhet imam të tjerëve, është më i denjë tek Allahu se namazi i njëqind vetëve që falen veç e veç.”* (Albani thotë se hadithi është hasen, Sahih el-Xhami’)

Shpërblimi i madh për faljen e namazit me xhemat nuk është i thënë kot, si dhe nuk është e kotë përmendja e njëzet e pesë apo njëzet e shtatë shkallëve për ata që falen me xhemat! S’ka dyshim se urtësinë e kësaj e di i Urti që e ka krijuar njeriun, që këtë e njeri e armatosi me armën e madhe civilizuese (faljen e namazit me xhemat) që e la para tij, në kohën kur shumë njerëz nuk çajnë kokën për të: *“Namazi me xhemat ia kalon namazit që falet vetëm me njëzet e shtatë shkallë.”* (Buhariu)

Ebu Hurejre thotë: *“E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. të thotë: “Namazi me xhemat ia kalon namazit që falet i vetëm me njëzet e pesë pjesë, se engjëjt e natës takohen me engjëjt e ditës në namaz të sabahut.”* Pastaj Ebu Hurejra thotë: *“Lexoni po të doni: “...me të vërtetë, falja e mëngjesit është e dëshmuar (nga engjëjt).”* (Buhariu)

*“Kush dëshmon faljen e namazit të jacisë me xhemat, llogaritet sikur të jetë falur gjysmën e natës, kurse kush e falë namazin e jacisë dhe të sabahut me xhemat, llogaritet sikur të jetë falur tërë natën.”* (Tirmidhiu, Albani thotë se hadithi është sahih)

Ata që i përgjigjen këtij kushti civilizues dhe i përmbahen kushteve të tilla dhe faljes me xhemat, këta doemos të kuptojnë qëllimin e madh hyjnore të këtij tubimi të përditshëm e të përsëritur. Këta e dinë se bashkimi i tyre nuk nënkupton bashkimin e trupave, por bashkimin e zemrave, shpirtrave, ambicieve, mendimeve, qëllimeve dhe ndjenja-ve për përgjegjësi individuale.

Ne jemi në xhami në kohë të saktë – kjo nënkupton se respektojmë orarin e saktë të takimeve në jetë dhe gjithmonë jemi të saktë. Kjo nënkupton pastërtinë, rrobat e bukura, rregullimin, që reflektohet në vetë xhaminë. Xhamia na mëson mësimin e modestisë, tubimi ynë në xhami nënkupton bashkimin tonë për çështjet tona dhe pjesëmarrjen tonë të përbashkët në një ndërtim, falja e namazit me xhemat nënkupton bashkimin tonë për qëllimin që e kemi, mirëkuptimin dhe unitetit, drejtimi i safeve në namaz nënkupton se kemi rend dhe program, vazhdimësi dhe edukatë, afrimi i shpatullave nënkupton se jemi bërë gati të jemi të saktë dhe të përsosur dhe të mëtojme superioritetin dhe përkryerjen, ne jemi të butë me njerëzit në xhami, e kjo nënkupton tolerancën, mëshirën, modestinë e butësinë, ne mbushim zbrazëtitrat, e kjo nënkupton se ndjejmë përgjegjësinë

individuale, rëndësinë e specializimit dhe rolit tonë në ndërtimin e një Umeti të bashkuar.

Kur zemrat të bashkohen në namazin me xhemat, e jo vetëm trupat, atëherë doemos të reflektohen në të gjitha sferat e jetës sonë dhe mendimit tonë, vetëm atëherë veprojmë bashkërisht, mendojmë bashkërisht, pranojmë ose refuzojmë bashkërisht, punojmë bashkërisht, ndërtojmë bashkërisht, gëzohemi bashkërisht, dëshpërohemi bashkërisht. Vetëm kështu muslimanët arritën të shndërrohen nga injoranca dhe prapambeturia në civilizim islam, në mendim islam, në dituri islame, të bashkuar në një tokë dhe të unifikuar, bashkuan tokën dhe qiellin kur para tyre u bashkua xhemati dhe Xheneti: *“Keni kujdes bashkimin, ruajuni nga përçarja, sepse djalli është me atë që është një (i vetëm), kurse me dy është më larg, ai që e dëshiron kënaqësinë e Xhenetit le të kujdeset për xhematin (bashkimin).”* (Albani thotë se hadithi është sahih)

*“Ju urdhëroj për pesë gjëra: për xhemat (të jenë të bashkuar), të dëgjoni e respektoni, të bëni hixhret dhe xhihadi në rrugë të Allahut, se ai që del vetëm një pëllëmbë nga xhemati, e ka heq nga vetja garancën e Islamit, përveç se nëse kthehet, e kush thërret me thirrjen e injorancës – fanatizëm, nacionalizëm etj – ai do të jetë gurë i Xhehenemit, edhe nëse agjëron dhe falet dhe mendon se është musliman.”* (Ibn Haxher el-Askelani)

Sa ka prej tyre që pretendojnë se janë muslimanë, kurse thërrasin me thirrjen e injorancës? Fise që duan të ndahen nga fiset e tjera e të jetojnë në shtete, njëri jugor e tjetri verior, ky kurd e ai berber ose persian?! Njëri arab e tjetri persian?! Pastaj këmbëngulin se janë muslimanë?!

Sikur të gjithë ta kuptonin rolin e bashkimit në islam dhe faljen e namazit me xhemat, me siguri se nuk do të bënin kështu, dikush do të thoshte me zë të lartë: **“...të bashkuar e jo të ndarë...!** do të dëgjonin të Dërguarin e tyre s.a.v.s. që ua tërheq vërejtjen nga Xhehenemi: *“Ju nuk jeni*

muslimanë nëse dikush nga ju thërret në injorancë, ndarje, përçarje, racizëm, nacionalizëm etj: “..edhe nëse agjëron e falet dhe mendon se është musliman! “ ..edhe nëse agjëron e falet dhe mendon se është musliman!

Xhemati (uniteti) është fshehtësia e civilizimit të muslimanëve, ditën që ata hoqën dorë nga ky unitet, atë ditë ngecën në civilizim, nga duart e tyre rrëshqiti ky civilizim për të shkuar në duart e të tjerëve që e kuptuan vlerën e qëllimit madhështor që realizohet me unitet, modesti, tolerancë, butësi, sistem, saktësi, rend, përgjegjësi individuale, mirëkuptim, bashkim, punë kolektive, ambicie dhe vullnet.

## Pjesa 2

### Namazi i xhumasë: pastrim i trupit dhe shpirtit

Ditë e xhuma (e premte). Ditë madhështore për besimtarët, pastrim i trupit dhe i shpirtit. Reformim thelbësor i qenies muslimane. Po çka nëse ndodh që pas faljes së namazit të xhumasë dhe daljes nga xhamia kthehemi në shtëpi dhe vërejmë se jemi të njëjtë, unë dhe ti, të pandryshuar?! Atëherë kuptojmë se ne nuk jemi falur, nuk kemi qenë prezent në namazin e xhumasë. Vërtet na ka huqur një e mirë e madhe.

Shumë njerëz nuk e dinë se çfarë rasti madhështor fshihet në namazin e xhumasë, se pranë tyre kalon një adhurim i çmuar dhe fisnik, por përsëri them se vrasësi i këtij adhurimi është falja mekanike dhe spontane. Shumë njerëz janë të zhveshur nga ndjenjat për vlerën e ditës së xhumasë dhe madhështisë së tij dhe ndikimit të tij të madh në orientimin e shëndoshë të jetës sonë. Është ditë që na dhuron qetësi shpirtërore të paparë, siguri dhe paqe në jetën e kësaj bote dhe botës tjetër.

Nëse ndodh ta vizitojmë ndonjë qytet apo qendër tregtare, e para që na bie ndërmend të pyesim është: cilat janë gjërat më interesante që mund t'i shoh dhe të kënaqem me këtë vizitë? Cilat janë gjërat më të mira, më të lira e më të bukura që mund t'i blejë e t'i sjell në vendin tim?

Janë këto pyetje të cilat duhet t'ia parashtrojmë vetes sonë në çdo mëngjes të ditës së premtë. Jemi në ditën e pazarit të xhumasë hyjnore, mallrat janë hyjnore, ka më shumë seç mund të paramendojmë, çdo gjë është e kualitetit të lartë dhe më elegante, gjëra që nuk janë në vendet e tjera, çmimet janë shumë të lira, bile thuajse falas, prandaj si të mos blejmë dhe shesim sot në këtë Pazar të veçantë, e t'i lëmë pazaret tjera: *“O besimtarë, kur të thirreni për (të falur) namazin (e xhumasë) në ditën e premtë, nxitoni për ta përmendur Allahun dhe pezulloni tregtinë! Kjo, që ta dini, është më mirë për ju!”* (El-Xhumua', 9)

Kur të them unë apo nëna jote, babai, mësuesi e hoxha: kjo, që ta dish, është më e mirë për ty se kjo, se ky pazar është më i mirë se ky pazar, ndodh të gabojmë apo ta qëllojmë, por kur Zoti yt dhe i botëve të thërret ty dhe gjithë besimtarët – e Ai e flet të vërtetën – ***Kjo, që ta dini, është më e mirë për ju!*** – kjo pa dyshim nënkupton se aspak nuk ka mundësi gabimi, se vërtet është më e mirë për ne. Xhumaja është mbi të gjitha pazaret e botës dhe mbi të gjitha tregtitë e botës, pazar që blejmë e shesim dhe tregtojmë për Ahiret. Është pazar ku fitojmë lehtë, nëse duam, dhe sa fitim i madh që është, por edhe humbim lehtë, nëse duam, e sa mjerim i madh që është.

Faqet në vijim do të jenë përpjekje për ta ndihmuar vetveten dhe të tjerët që të zhvishen nga adaptimi dhe përsëritja spontane e namazit të xhumasë, heqje e mbulesës së trashë që ka mbuluar xhevahirin e kësaj “feste bajrami” se “pazari hyjnor” që quhet ditë e premtë.

“Më erdhi Xhibrili alejhi selam me një pasqyrë të bardhë që e kishte në dorë, aty ishte një pikë e zezë; unë i thashë: “Ç’është kjo, o Xhibril?” Ai tha: “Është dita e premtë, Zoti yt po ta prezanton ty, që të jetë festë për ty dhe për popullin tënd pas teje, ti do të jesh i pari, hebrenjtë dhe të krishterët do të jenë pas teje. Thashë: “Po ç’kemi ne në të?” Ai tha: “Aty ka mirësi për ju, është një çast që kush i lutet Zotit të tij në të për ndonjë të mirë, që do të ketë pjesë në të, Allahu do t’ia jep, por nëse nuk ka pjesë në të (nuk e ka nasib), atëherë Allahu do t’ia ruajë atij atë që është më e mirë për atë dhe më e rëndësishme, e nëse i kërkon Allahut mbrojtje nga ndonjë e keqe që e ka të caktuar (t’i ndodhë), Allahu do ta mbrojë, e nëse nuk e ka të caktuar, Allahu do ta mbrojë nga një më e madhe se ajo.” Thashë: “Po, ç’është kjo pikë e zezë në të?” Tha: “Është çasti i Kiametit, do të ndodhë ditën e premtë, është dita e parë për ne, ne e thërrasim këtë ditë në Ahiret **Dita e Shtimit.**” Thashë: “po pse e quani Dita e Shtimit?” Ai tha: “Zoti yt në Xhenet ka marrë një luginë që fryn aromë nga misku i bardhë, kur është ditë e premtë Ai i Lartëmadhëruar qoftë, zbret nga lartësitë më të mëdha në kursijën e Tij, e pastaj kursija e Tij rrethohet me minbere nga nuri, vijnë pejgamberët dhe ulen nëpër ato minbere, ato minberet stolisen me karrige prej ari, e pastaj vijnë besnikët dhe shehidët, e ulen nëpër ato, e pastaj vijnë banorët e Xhenetit dhe ulen grumbull; atëherë Zoti yt shfaqet para tyre, derisa ta shohin fytyrën e Tij, kurse Ai ju thotë: “Unë jam që ju thashë të vërtetën dhe premtimin Tim e bëra të vërtetë, ua plotësova begatitë e Mia, ky është vendi i nderit Tim, andaj kërkon. E ata kërkojnë kënaqësinë. Allahu i Madhërishëm thotë: “Kënaqësinë Time ua dha shtëpia Ime, atë ua dhuroi bujaria Ime, kërkon.” Ata do të kërkojnë derisa të përfundojnë dëshirat e tyre; atëherë para tyre do të hapen dyert e gjërave që kurrë nuk i kanë parë, e as që i kanë dëgjuar, po as që u ka ra ndërmend se mund të jenë, kjo do të vazhdojë kështu derisa njerëzit përfundojnë me namazin e xhumasë. Pastaj Zoti yt ngritët lartë mbi kursin e Vet, me të ngritën

*besnikët e shehidët, kurse banorët e Xhenetit kthehen në vendet e tyre (banorët e dhomave të larta): gurë xhevahiri i bardhë (përshkrimi i dhomave të tyre), pa asnjë të metë, rubinë të kuq, apo beril i gjelbër, prej të cilit janë bërë dhomat dhe dyert, lumenjtë rrjedhin pandërprerë, frytet janë të lëshuara përtokë, aty ka gra e shërbëtore, nuk janë të nevojshëm për asgjë tjetër më shumë se ditën e premtë që të shtojnë bujarinë, të shtojnë sa më shumë shikimin në fytyrën e Zotit të tyre të Lartëmadhëruar, për këtë është quajtur: Dita e Shtimit.” (Albani thotë se hadithi është hasen, Sahih et-tergib)*

*“Dita e premtë është dita më e mirë që lind dielli, atë ditë u krijua Ademi, atë ditë hyri në Xhenet, po atë ditë doli nga Xheneti, Dita e Kiametit do të jetë në ditën e premtë.” (Muslimi)*

Në këtë ditë madhështore ndodhin gjëra madhështore, sa që banorët e qiellit e quajnë “Ditë të Shtimit”, kurse për banorët e tokës është “Ditë e ditëve”. Prandaj, si të mos bashkëveprojmë me këtë ditë të veçantë që na viziton një herë në javë? Çfarë na sjell kjo ditë çdo javë? Çfarë dhurata dhe veçori hyjnë në shtëpinë tonë pa e hapur derën, apo pa e parë?

A thua se pritja jonë e këndshme e kësaj dite dhe mikpritja jonë e përshtatshme për të do të na bëj të denjë për fitimin e dhuratave të vlefshme të tij, e që janë dhurata që nuk krahasohen me asnjë dhuratë tjetër që na sjellin njerëzit e mëdhenj në tokë?

Dhurata më e çmuar e kësaj dite që kryeson në listën e dhuratave të tij nuk është vetëm namazi i xhumasë, por edhe çasti i rrallë e fatlum, çasti i linjës së shpejtë të kuqe telefonike që lidhet drejtpërdrejt me qiellin, e që pezullon çdo pengesë që mund të del midis robit dhe Zotit të tij; robi kërkon, e Zoti përgjigjet: “Dita e xhuma ka 12 orë, një orë e saj është që çdo send që kërkon muslimani prej Allahut, Allahu ia jep, ndaj kërkonti atë në orën e fundit pas ikindisë.” (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih ‘ul-Xhami’)

*“Në xhuma ka një orë (çast) që nëse robi i kërkon Allahut diçka, nuk ndodh që Ai të mos i përgjigjet.” Të pranishmit thanë: “O i Dërguari i Allahut, po cili çast është ai?” Ai tha: “Kur thirret ikameti për ta falë namazin, e deri sa ta mbarojmë atë.” (Tirmidhiu)*

Përkundër faktit se ky çast ka vlerë të çuditshme dhe veçori të lartë, përsëri mbetet e pacaktuar, ndoshta kjo është edhe fshehtësia e këtij çasti, fshehtësia e ndikimit dhe efektit të tij. Është e saktë se ky çast është një nga çastet e kësaj dite, pra është një hapësirë e gjerë dhe e madhe për lutjet tona, namazin, istigfarin dhe pendimin.

Janë, pra, dy çaste të pashmangshme të rëndësishme të ditës së premte, ai i faljes së namazit të xhumasë dhe i përgjigjes së lutjes, dy çaste të pandara, efektive dhe të ndërthura.

Si të përgatitemi për këtë ditë të veçantë? Për këto çaste të vlefshme e të shtrenjta? Si të investojmë në të? Si ta kryejmë atë me përpikëri, që të arrijmë të fitojmë dhurata të këndshme dhe shpërblime të mëdha? Dita e premte është manifestim që na jep po aq sa ne japim, vallë çfarë mund t'i japim ne? E çfarë na jep ajo ditë?

Qysh në mëngjes ndodhin gjëra të bukura në këtë ditë. Zgjimi ynë herët na kujton këtë ditë madhështore dhe bukuritë e pazakonshme. Kjo ditë kërkon adaptim të veçantë për të, ky adaptim i ri do të na shoqërojë deri në perëndim të diellit.

Kujto se çdo ditë e javës ka përshtatshmërinë e caktuar që mbaron me mbarimin e saj, përveç ditës së premte. Pas-trimi dhe larja e trupit, fizike dhe shpirtërore, në ditët e tjera të javës është pastrim i zakonshëm, efikasiteti i të cilit mbaron për disa orë, përveç ditës së premte, efikasiteti i tij bart efikasitetin që zgjat shtatë ditë: *“Kush pastrohet ditën e premte, mbetet i pastër deri në të premten e ardhshme.”* (Albani thotë se hadithi është sahih)

Dita e premte është ditë feste për muslimanët, në këtë ditë ata shkojnë në xhami të pastër, me rroba të pastra, trupi i tyre është i pastër e me aromë, shpirti i tyre është i pastër, të veshur me rroba të bukura janë të gjithë, të pas-truar nga çdo aromë e jashtme që mund t'i shqetësojë besimtarët që i takojnë, të pastër nga çdo grindje dhe mos-marrëveshje të brendshme, nga çdo qëllim i keq, smirë e ur-rejtje, mendjemadhësi etj. Të gatshëm të fitojnë shpërblimet e ditës më të shtrenjtë, shpërblime efikasiteti i të cilave shtrihet deri në të premtën e ardhme, vërtet është ditë feste: *“I Dërguari s.a.v.s. ligjëroi në ditën e xhuma dhe pa se disa ishin veshur me rroba tigrri (rroba nga stofi i pambukut me ngjyra si të tigrin, të zezë e të bardhë), dhe i Dërguari i Allahut s.a.v.s. tha: “Çka e pengon dikë që për ditën e xhuma të ketë dy palë rroba të veçanta, përveç rrobave të punës.”* (Ibn Maxhe, Albani thotë se hadithi është sahih)

*“Kush pastrohet ditën e xhuma, dhe pastrohet (pastrim shpirtëror) aq sa mundet të pastrohet, e pastaj lyhet me aromë misku, e pastaj shkon në xhami dhe gjatë shkuarjes nuk futet midis dy vetave (pra nuk futet në kallaballëk), dhe e falë atë që është e caktuar, e pastaj kur imami del (në hutbe), e dëgjon dhe hesht, i falen gjynahet që i ka midis dy xhumave.”* (Buhariu)

*“Pastrohuni ditën e premte, qoftë edhe me një qese dinari.”* (Sujuti, Albani thotë se hadithi është i dobët (daif).

*“Pastrimi në ditën e premte është obligim për çdo të rritur, përdorimi i misvakut dhe të përdorë aromën e miskut aq sa mundet.”* (Nesaiu, Albani thotë se hadithi është sahih)

Kujto se nuk është “larje”, por është “pastrim”. Doemos këtë ta kuptojmë në mënyrë të veçantë, siç është çështja e abdesit, që nuk është sikur pastrimet tjera që i bëjmë çdo ditë. Dy pastrime e jo një pastrim.

Kujto se “pastrohesh”, e me këtë pastron çdo gjymtyrë fizike të trupit, por edhe çdo gjymtyrë të brendshme që

gjendet nën gjymtyrët fizike. A të ka ndodhur ta pastrosh veturën në lajtores? Pas pastrimit të duket se është veturë e re, por nëse shikon brenda vëren se pluhuri ka mbuluar gjithçka dhe kudo është, pastrimi nuk ka depërtuar aty?!

Mos e fut trupin tënd në banjon e xhumasë, përveç nëse e ke futur edhe brendinë tënde shpirtërore:

- Pastroje kokën, e me këtë pastro edhe çdo qëllim të keq apo mendim të keq që e ke,
- Pastroi sytë, e me këtë pastro çdo haram që e ke parë,
- Pastroi veshët, e me këtë pastro çdo gjë të ndaluar që e ke dëgjuar,
- Pastro gojën dhe hundën, e me këtë pastro çdo gjë që goja flet nga gjërat e këqija,
- Pastro gjoksin, e me këtë pastro nën të të keqen e fshehur e që zemra mund të shkojë,
- Pastroi duart, e me këtë pastro nën to haramin që drejt tij i ke shtrirë ato,
- Pastroi këmbët, e me këtë pastro nën këmbë haramin me të cilat ke ecur drejt tij.

A mendon se efikasiteti i një pastrimi të tillë përfundon me mbarimin e javës? Apo do të jetë efikas deri në javën e ardhshme, por edhe javët në vijim, kapital që të ndihmon në ballafaqimin me joshjet e jetës dhe mposhtjen e djallit që të sulmon pandërprerë?

Efikasiteti i këtij pastrimi do të shtrihet më shumë seç mendon ti, nëse e kryen ashtu siç duhet, nëse ia jep hakun kësaj dite; përgatitjen, respektin, pastrimin e shpirtit: zgjimi herët nga gjumi, falja e namazit të xhumasë, pastrimi, lyrja me aromë misku, zbukurimi, leximi i sures El-Kehf me familjen, dalja nga shtëpia dhe shkuarja në xhami herët, duke shqiptuar gjatë gjithë rrugës hamdin, tekbirin, fjalën e shehadetit, leximin e kuranit, bashkëngjitja me të tjerët në gositinë e madhe hyjnore: *“Kush e lexon suren el-Kehf në ditën e*

*premtë, do t'i shndritë dritë deri në të premtën tjetër.*" (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih el-Xhami')

*"Kush pastrohet ditën e premtë, e pastaj shkon në xhuma dhe falet aq sa mundet, e pastaj hesht (dëgjon me vëmendje) derisa imami të mbarojë hutben e tij, e pastaj falet me të, i falen gjynahet midis dy të premtëve, bile edhe më shumë."* (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih el-Xhami')

Nuk e di nëse fjala **xhemat** rrjedh nga fjala e **xhuma**, apo fjala **xhuma** rrjedh nga fjala **xhemat**, por është e qartë se rëndësia e xhumasë vjen nga "**tubimi**" i muslimanëve në një vend, se përsëritja e këtij tubimi të madh çdo javë simbolizon rëndësinë e ruajtjes së takimit të muslimanëve dhe bashkimit të zemrave të tyre.

Në këtë kuptim, pesë namazet që i falim në xhami nënkuptojnë pesë namazet që falen me xhemat të vogël, kurse falja e xhumasë nënkupton tubimin madhështorë të muslimanëve. Është rast i volitshëm javor që mbledh të gjithë besimtarët pa dallim pozite e shkalle, midis tyre ka shumë të tillë që rëndë se janë falur ditëve të tjera me xhemat, por edhe të tillë që i kanë shtëpitë larg xhamive dhe rrethanat nuk i lejojnë të shkojnë në xhami. Prezantimi në këtë tubim madhështor ose jo prezantimi në të, sipas hadithit të të Dërguarit s.a.v.s., është shenjë dalluese prej Allahut që dallon besimtarin dhe dyfytirëshin: "*Kush i lë tre xhumaja pa ndonjë arsye, do të shkruhet në radhët e hipokritëve.*" (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih el-Xhami')

Nuk ka ndodhur që i Dërguari s.a.v.s. ta përfronte rrugën e llogarive tona e të shpërblimeve, e pastaj t'i prezantonte para nesh në formë konkrete e të qartë dhe të thjeshtë, siç bëri me shpjegimin e asaj se çfarë mund të fitojmë nëse shkojmë herët në xhami në ditën e premtë, uljen në të para namazit, ose sipas një shpjegimi tjetër të hadithit, shkurtimin e zbrazëtirës kohore që ndan pastrimin për këtë

ditë dhe daljen nga shtëpia për të shkuar në xhami, që atje të arrijmë para se të djersitet trupi ynë, e të mos ketë në xhami erë të pakëndshme, por vetëm aromë të këndshme: *“Ai që lahet ditën e xhumasë, ashtu siç lahet pas marrëdhënieve seksuale, e pastaj niset për në xhami në orën e parë të mëngjesit, i llogaritet shpërblim sikur të ketë prerë kurban një deve, ai që niset në orën e dytë sikur të ketë prerë kurban një lopë, ai që niset në orën e tretë sikur të ketë flijuar një dash me brinjë, ai që niset në orën e katërt sikur të ketë prerë kurban një pulë, kurse ai që niset në orën e pestë, i llogaritet sikur të ketë flijuar një vezë. Kur del imami në minber, edhe engjëjt kuqen të dëgjojnë hutben.”* (Buhariu)

*“Në ditën e xhuma engjëjt qëndrojnë para dyerve të xhamisë, i shkruajnë emrat e njerëzve dhe pozitat e tyre - sipas kohës së ardhjes - , erdhi filani në këtë kohë, erdhi filani në këtë kohë, erdhi filani e imami ishte duke ligjëruar hutben, erdhi filani që e zuri namazin (e fali namazin e xhumasë), por nuk e arriti xhumanë, sepse nuk arriti ta dëgjonte hutben.”* (Ahmedi)

*“Në Ditën e Kiametit njerëzit do të ulen afër Allahut po aq sa kanë shkuar herët në xhuma -, i pari, pastaj i dyti, i treti e i katërti...”* (Mundhiri)

*“Prezantoni në xhuma, afrohuni afër imamit, sepse njeriu do të jetë banorë i Xhenetit, por nëse vonohet për xhuma, do të vonohet edhe për Xhenet, kurse është nga banorët e tij.”* (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih et-Tergib)

Ky është roli i rëndësishëm i xhumasë, i hapave që i bëjmë për të shkuar në xhami, janë hapa të veçanta e të dal-luara, prandaj pse të mos e shfrytëzojmë rastin e të ecim, në vend se të shkojmë me veturë?! I Dërguari s.a.v.s. ka prem-tuar se ai që niset për të shkuar në xhami: *“Allahu do ta ngrit një shkallë me çdo hap që ai e ngrit, dhe ia heq një të keqe.”* Nëse xhamia është larg, atëherë gjysmën e rrugës le ta bëjë me automjet, e gjysmën tjetër duke ecur. Kujtoj se është e pane-vojshme që në rrugët përreth xhamisë dhe trotuaret e xha-

misë të grumbullohen veturat e atyre që kanë ardhur për t' u falur, e pastaj njeriu të mos dijë se nga të kalojë!

Shpërblimet e xhumasë llogariten me hapat e bëra për në xhami, më shumë ose më pak. Prandaj, dije se hapat e bëra për këtë namaz madhështor janë shumë më të vlefshme se hapat e bëra për namazet e tjera: *“Kush lahet ditën e xhuma, i pastron rrobat dhe gjëra e tjera, dhe vjen herët në namaz – ia kalon tjetrit – dhe afrohet afër imamit, dëgjon me vëmendje dhe hesht, le ta dijë se për çdo hap që ka bërë ka shpërblim një viti (përfshirë në këtë shpërblim agjërimin e vitit dhe faljen e namazit të natës në atë vit”* (Tirmidhiu, Albani thotë se hadithi është sahih).

O Allah! Për çdo hap që e bëjmë për në xhami në këtë ditë na llogaritet një vit i plotë, sikur ditën e kemi agjëruar e natën jemi falur?! A mundemi t' i numërojmë të mirat tani, qoftë edhe për afërsisht?! Sa hapa i kemi bërë në xhumanë e fundit që ishim në xhami? Po sa xhumaja kam falur deri tani? Vallë sa llogari kam në botën tjetër, agjërim dhe namaz? Çfarë pazari i çuditshëm! Çfarë malli i shtrenjtë! Çfarë çmime të lira? Çfarë shpërblime që nuk përshkruhen!

Nëse ky pazar i çuditshëm hyjnor ka këtë karakter të veçantë, këtë shkallë të lartë të veçantisë dhe superioritetit, atëherë çfarë lloji i të ecurit do të duhej të ishte për atë ditë dhe për atë pazar? A thua se të ecurit tanë në këtë ditë është i njëjtë sikur të ecurit e ditëve të tjera dhe vendeve të tjera?

Tesbiu, dhikri dhe leximi i Kur'anit gjatë shkuarjes në xhuma, bile edhe në namaze tjera, do të jetë për ne mburojë nga shkarjet e rrugës, e ato sot janë shumë. Dhikri, leximi dhe istigfari gjatë rrugës na përkujton, ndalon dhe pengon nga gjërat e shëmtuara, që nëse ndodh të mendojmë keq ose të tregojmë dobësi, i themi shpirtit tonë: *“Mos u ligështoj dhe mos u dorëzo, sepse me ty tani është Allahu. I themi syrit: mos shikon andej e këndej. I themi veshit: mos dëgjo gjepura. I themi gjuhës: mos fol kot e keq. I themi dorës: hi-*

qu nga padrejtësia. I themi këmbës: mos ec në rrugë të gjynahut e gabimit.”

Tani kujtoj se arrite shëndosh në xhami, i shpëtuar nga pengesat e djallit, vendet e rrjetave të tij të shpërndara kudo! Ja pra, më në fund i shpëtuar e i shëndoshë në xhami, i pastër në trup dhe shpirt, me Allahun në shtëpinë e Tij, ulu pranë Tij dhe zgjate bisedën me Të sa të mundesh, duke e përmendur Atë, duke iu lutur Atij, duke menduar, adhuruar, lexuar Kur'an me zë të përshpirtshëm, të ulët, para se të vjen koha e ezanit.

Vetëm në xhami ke rast të lexosh Kur'an me lexim të vërtetë, rast që nuk përsëritet në ndonjë vend tjetër. Në xhami nuk e lexon me leximin e atyre që nguten dhe që garojnë se sa faqe do t'i lexojnë, edhe pse elementi i të kontempluarit mungon dukshëm për atë që e lexojnë. Janë çaste që i ke ndarë për Allahun, ndaj lexo ngadalë dhe ndalu në çdo ajet, mendo thellë për çdo fjalë, e pastaj mendo në vete, sepse i kupton domethëniet e tij, sa je larg prej atyre ajeteve dhe sa je afër atyre.

Çastet kanë kaluar, me siguri ke lexuar, ke përmendur Allahun dhe je lutur, ke vlerësuar veten për shumëçka, tani, disa minuta para ezanit mundohu ta korrigjosh veten, vlerësoi llogaritë e tua me Allahun:

- A kam bërë ndonjë të padrejtë këtë javë? Si të pendohem e ta rregulloj këtë të padrejtë?
- Kush më ka bërë të padrejtë këtë javë? Si të bëhem prej atyre që do të jap mësim për tolerancë dhe butësi e falje?
- Cilat i kam bërë ndonjë të keqe këtë javë dhe ia kam ngushtuar gjoksin dhe e kam shtyrë të më urrejë? Si t'ia bëj që ta qetësojë e t'ia heq nga gjoksi këtë të keqe?
- Kush më ka bërë keq mua këtë javë? Si t'ia bëj që në gjoksin tim të mos ketë njolla të urrejtjes për të, e në vend të urrejtjes të vendosi dashurinë?

- A jam këtë javë më i mirë dhe më i dobishëm se javën e kaluar? Apo më i keq dhe më i padobishëm? Si t'ia bëjë të korrigjohem e të bëhem më i mirë javën që vjen?

- A thua namazi im, lutja ime, leximi dhe dhikri im ishin në nivel të duhur? Apo kam ngecur? Si t'ia bëjë që javën që vjen të jem më i vyeshëm dhe më i përshpirtshëm?

- A thua... a thua... a thua... si... dhe si... dhe si...

Është kjo ulje me vetveten dhe me Allahun, andaj rishikoi llogaritë e tua më saktë, vë një pikë kujdesi dhe cakto një plan të saktë e më të mirë për javën e ardhshme. Është "pastrim" javor i shpirtit tënd, që pastron veten nga vështirësitë e javës, brengat, gjynahet dhe njollat, nga xhamia dil vetëm duke qenë i pastër, me ndjenja se vërtet ke lindur përsëri.

Trup yt, rrobat e tua, shtëpia dhe vetura kanë nevojë të pastrohen një herë në javë, a nuk e meriton shpirti yt të pastrohet po ashtu një herë në javë? Shpirti yt, brendia jote dhe raporti yt me Allahun?

E gjithë kjo ndodh para se të fillojmë namazin. Tani je midis atyre të ftuarve në klubin e xhumasë, kujdes normat e klubit dhe rregullat e hyrjes, qëndrimit, lëvizjes, daljes etj, që të jesh sa më i vlerësuar për atë që është përgatitur për ty në këtë gosti.

Ç'mendon për ftesën për takim me ndonjë kryetar shteti në pallatin e tij, a nuk kërkojnë t'i përmbahesh kodit të pallatit, rregullave të vizitës, normave të hyrjes, mënyrës së qëndrimit para tij dhe bisedës me të? E si mendon, pra, për takimin me Sunduesin absolut, Pronarin e qiejve dhe të tokës?

Më duket se i mësuam disa rregulla të hyrjes në xhami, pritjes në të dhe daljes nga xhamia. I Dërguari s.a.v.s. na i mëson këto rregulla të larta, norma "mbretërore" hyjnore të veçanta për namazin e xhumasë. Ai s.a.v.s. në shumë hadithe përmend gjëra të bukura lidhur me këto rregulla:

Transmeton Xhabir ibn Abdullahu se i Dërguari s.a.v.s. ligjëroi dhe tha: *“Kur dikush vjen në ditën e xhuma e imami ka dalë – pra është në minber -, le t’i falë dy rekate namaz para se të ulet.”* (Muslimi)

*“Nëse i thua shokut tënd derisa imami ligjëron hutben: hesht! – ke bërë gabim!”* (Ahmedi)

*“Nëse dikush dremit gjatë hutbes në ditën e xhuma, le ta ndërrojë vendin.”* (Tirmidhiu)

Transmeton Malik ibn Amir El-Esbehi se Osmani r.a. thoshte në hutbe, e rrallë herë e linte pa e thënë: *“Kur imami të ngritët për të mbajtur hutben ditën e xhuma, dëgjojeni me vëmendje dhe heshtni, sepse dëgjuesi me vëmendje që nuk dëgjon – pra është i shurdhër – ka shpërblim sikur ai që ka dëgjuar me vëmendje, e kur të thirret ikameti për të falë namazin, drejtoni safet, afroni shpatullat, sepse drejtimi i safeve është pjesë përbërëse e plotësimit të namazit. Ai pastaj nuk merrte tekbir, derisa nuk vinin njerëzit që i kishte caktuar për drejtimin e safeve, që e lajmëronin se safet janë rregulluar, ai atëherë merrte tekbir.”* (Neveviu në El-Hulasa)

Thirrja e ikametit për fillimin e faljes së namazit duhet të na kujtojë për rregullat e xhematit, drejtimin e safit, sjelljen e butë, afrimin e shpatullave dhe mbushjen e zbrazëtirave; kujto rolin e mrekullueshëm civilizues që përfaqësojnë këto rregulla. Pas mbarimit të namazit, është për bukuri, nëse ke kohë, që nga ky manifestim i mrekullueshëm javor të ndahesh me falje të dy ose katër rekateve, para daljes nga xhamia, duke ndjekur sunetin e të Dërguarit s.a.v.s: *“Nëse faleni pas xhumasë, atëherë falni katër, e nëse nguteni atëherë falni dy rekate në xhami dhe dy rekate kur të ktheheni.”* (Muslimi)

I Dërguari s.a.v.s. na mëson elasticitetin në faljen e këtyre nafileve, ai s.a.v.s. e lë derën e hapur për këtë nafile, ta falim në shtëpi në vend se ta falim në xhami, apo t’i falim dy rekate në vend të katër rekateve.

*“Ibn Omeri e zgjaste faljen e namazit para xhumasë, kurse pas xhumasë i falte dy rekate në shtëpinë e tij, dhe thoshte se i Dërguari s.a.v.s. kishte vepruar kështu.” (Ebu Davudi)*

*“Abdullah ibn Omeri përshkruan namazin vullnetar të Pejgamberit s.a.v.s. dhe thotë: “Ai nuk falej pas namazit të xhumasë derisa largohej, e atëherë në shtëpi i falte dy rekate.” (Muslimi)*

Le të jetë dita e premtë pastrim javor i jetës tënde, festë e madhe për ty dhe për ata që i ke përreth, pastrim i trupit dhe i shpirtit. Dil nga shtëpia i pastër, pasi i ke bërë të kënaqur familjen (gruan), i kënaqur je me pamjen tënde, rrobat, elegancën dhe pastërtinë, ec rrugës duke menduar se e ke kënaqur Zotin tënd, ke heq dorë nga gjërat e pahijshme, i heshtur për gjërat e pakëndshme, ke bërë mirë, e pastaj hynë në shtëpinë e Allahut, i përgatitur në vetvete se një ose dy orë nuk do të dalë nga shtëpia e Tij, e aty përsërit pastrimin e dytë, pastrimin e brendshëm, që pas kësaj të kthehesh në jetë, në familje dhe punë si njeri i ri, tjetër.

Deh pak para daljes nga xhamia, në një minutë, në kujtesën tënde regjistroi shpejt fitimet dhe humbjet: Çfarë fitove? Çfarë ke lëshuar? Çfarë ke humbur? Çfarë ke arritur?

Përsëri, sido që të jenë rezultatet përfundimtare, shiko edhe një herë veten në pasqyrën tënde, vërtetoju para se të kthehesh në shtëpi se ti nuk je ai që ishe para se të dalësh nga shtëpia dhe para se të falësh namazin. Se tani je tjetër. I porsalindur. Jetë e re.

### **Pjesa 3**

#### **Hytbeja e xhumasë**

##### *Seancë javore progresive e muslimanit*

Në një xhami të Oksfordit ndodhi që disa muslimanë të protestojnë për shkak se imami në ligjërimin e të premtës,

nuk kishte shqiptuar dot një fjalë në gjuhën arabe: hytbeja e xhumasë nuk është e vlefshme, e shprehur në gjuhë tjetër, e jo në arabisht, namazi i xhumasë është i pa vlefshëm, për shkak se hytbeja nuk ishte në arabisht!!

Ne që jetojmë në Britani shumë herë ballafaqohemi me kësisoj gjërash, sidomos me këtë të fundit. Shumë herë ndodh të vërejmë se si të tjerët respektojnë dhe vlerësojnë shumë gjuhën tonë arabe, se si në shpirt fshehin dashurinë, shenjtërinë dhe respektin për këtë gjuhë, respekt që në ne ndez turpin dhe na bënë t'i korrigjojmë disa gjëra dhe t'i vëmë në rrugë të drejtë. Kujtoj se përditshmëria dhe spontaniteti apo zakonshmëria vrasëse kanë bërë që të ndihemi të tillë ndaj gjuhës arabe dhe të na ndihmojë ta rizbulojmë atë.

Kemi lindur me këtë gjuhë, jemi mësuar me të, kështu që kemi humbur ndjenjat e pozitës së saj të veçantë fetare dhe historike, kemi harruar se është gjuha e Kur'anit dhe gjuha e të Dërguarit bujar s.a.v.s., ndaj e treguam të shkujdesur dhe e lamë anash, u interesuam për gjuhë të huaj, kurse vëllezërit tanë muslimanë, që nuk flasin gjuhën arabe, i privojnë fëmijët e tyre nga loja ditën e diel vetëm e vetëm të shkojnë në xhami për ta mësuar gjuhën arabe.

Është ky një aspekt i shndritshëm i vëllezërve tanë, që neve, arabëve, na bënë të ndiejmë gjynah dhe na kujton detyrën tonë kundrejt gjuhës sonë. Habitemi kur shohim këta vëllezër që këmbëngulin në atë që fjalimi i ditës së xhuma të jetë në gjuhën arabe, e jo në tjetër, edhe nëse nuk e kuptojnë. Ky është problemi që sot e vërejmë te disa muslimanë, e që ka shkaktuar një ndarje të rrezikshme midis fesë dhe jetës: ligjëro në gjuhën e Kur'anit dhe të Dërguarit, mos u brengos se çfarë thuhet dhe çfarë do të thuhet; fali pesë kohët e namazit, nuk ka gajle nëse pastaj vjedh, mashtron apo bënë kurvëri; ha mish hallall, e pastaj bënë sa të duash gjynahe!! Kjo solli në shtrembërimin e Islamit para syve të

perëndimorëve, shkak ishte keqkuptimi i Islamit nga ana e muslimanëve dhe vëmendja e tyre në gjëra dytësore, duke i humbur shtyllat e fesë dhe bazat e tij.

Sa të padrejta i bëri Islamit injoranca e muslimanëve dhe mosnjohja e tyre e Islamit.

Këta vëllezër kushtëzuan imami që hytbeja e tij të jetë në gjuhën arabe, e jo në gjuhën e tyre lokale apo në ndonjë gjuhë tjetër. Hytbeja në fjalë nuk do të kishte ngërthyer më shumë se disa ajete dhe hadithe, disa fjalë dhe urtësi të zakonshme që ligjëruesi i thotë çdo jave, pa ndonjë të re, e që pastaj të dalin nga xhamia ashtu siç kanë hyrë: asgjë të re, pa kuptim, pa këshillë, pa dobi, pa kujtim, as sqarim e as urtësi, pa ndonjë zgjidhje të ndonjë problemi, të ndonjë çështje kohe, duke vrarë shpirtin e hytbes së xhumasë, nga ajo mbeti vetëm skeleti i gjuhës.

Shumë herë ndodh që këtë ligjërim të rëndësishëm javorë ta zhveshim nga shpirti i tij, e ta shndërrojmë në rit mekanik shqiptues, pikërisht ashtu siç shumë muslimanë i zhveshin adhurimet e tyre nga kuptimi i tyre esencial, kur bëjnë ndarjen midis ibadetit dhe jetës. Ndodh që këta të falen e të vjedhin, të agjërojnë e të gënjejnë, të kryejnë haxhin e të mashtrojnë, të bëjnë të padrejtë, të përgojnë, të bëjnë gjynahe të mëdha dhe të bëjnë vepra që i kanë bërë edhe para se ta kryejnë haxhin! Pse ndodh kjo? Sepse kanë bërë ndarjen midis ibadetit dhe jetës.

Ndodh që ndonjëri të paraqitet se është musliman më i madh se ti, e në anën tjetër të vjedhë, mashtrojë, tradhtojë, dëmtojë, dëshmoj rrejshëm, bile edhe të shpërndajë lëndë narkotike etj.

Kujtoj se një gjë e tillë është bërë zakonshmëri e disa muslimanëve: falu, e pastaj bëjë çka të duash, thuaj çfarë të duash në hytbe, me rëndësi është të jetë në gjuhën arabe,

punë çfarë të duash në jetë, sillu si të duash me njerëzit dhe Zotin, me rëndësi është të hash mish hallall!

Ka shumë muslimanë që injorojnë rolin esencial të hytbes së xhumasë në jetën shoqërore islame, rolin e saj progresiv dhe zhvillimor. Namazi i xhumasë dhe hytbeja e kësaj dite shumë herë na bëjnë të kujtojmë se vetëm duhet të ndodhin: ja, arritëm me kohë në xhami, e dëgjuam hatibin, u radhitëm në safe, e falëm namazin, esselamu alejkum ve rahmetullah, esselamu alejkum ve rahmetullah... përfundoi riti fizik dhe shqiptues dhe kaq.

Është e udhës që të pyesim vetveten: a thua jemi të detyruar nga ana e të Dërguarit s.a.v.s. që të heshtim gjatë hytbes së xhumasë, edhe atë në shenjë respekti dhe edukate, e jo më tepër? A thua se hytbeja e xhumasë do të jetë vetëm rit lëvizës fetar dhe rit fizik i parëndësishëm ose i pakuptimtë, që nuk paraqet ndonjë gjë në jetën tonë?! Imami ngjitet në minber, lëviz gojën e tij duke shqiptuar fjalë, ajete, hadithe, i kuptojmë ose nuk i kuptojmë, nuk është me rëndësi, me rëndësi është që ne e shikojmë atë, edhe nëse kjo ndodh me shkujdes dhe pakuptimësi, ai nxjerr zëra që ne, nuk është me rëndësi se a i kuptojmë apo jo, ndoshta edhe nuk na interesojnë fare, me rëndësi është se ne jemi të qetë dhe ruajmë qetësinë, heshtim, kurse ai mbaron hytben duke e lutur Allahun për falje të gjynaheve për ne, zbret nga atje dhe e fal namazin, i falim dy rekate namaz dhe me këtë kemi përfunduar farzin?!

A e kemi pyetur ndonjëherë vetveten: pse hytbeja e xhumasë është e lidhur me namazin? Pse nuk ka një kohë për hytbe dhe një kohë për namaz, por janë të lidhura ngushtë? S' do mend se lidhshmëria e namazit të xhumasë me hytben është prova më e saktë që provon lidhshmërinë e ngushtë midis ibadetit dhe punës në Islam. Nëse namazi na largon nga të këqijat, hytbeja e xhumasë ka për qëllim që të na e konkretizojë këtë largim, të na e shpjegojë dhe të na orientojë

në rrugën e drejtë, d.m.th. të na e sqarojë rrugën praktike të këtij largimi, lidhshmërinë midis ibadetit dhe praktikës.

Namazi është ibadet, kurse hytbeja e xhumasë është plani i punës. Hytbeja e xhumasë është pjesë e pandarë e namazit të xhumasë, aq sa nëse dikush nuk arrin ta dëgjojë hytben e xhumasë në tërësi, është në pyetje çështja e namazit të xhumasë!

*“Në Ditën e xhuma engjëjt qëndrojnë pranë dyerve të xhamisë, i shkruajnë emrat e njerëzve sipas shkallës së tyre; filani erdhi në këtë kohë, filani erdhi në këtë kohë, erdhi filani derisa imami ligjëronte, erdhi filani që e arriti namazin, por nuk e arriti xhumanë, sepse nuk e arriti hytben.” (Ahmedi)*

Hytbeja e xhumasë nuk është vetëm rit dhe lëvizje, dhe fjalë që shqiptohen pa qëllim, ajo luan rol të rëndësishëm në jetën e besimtarit, është rol që përputhet me rolin e namazit të xhumasë, me qëllimin e takimit të muslimanëve në këtë namaz. Hytbeja e xhumasë zë vendin e analizës politike të çështjeve të muslimanëve që kanë ndodhur gjatë javës, është propozim i një plani të punës që pason në ditët që vijojnë.

Namazi i xhumasë dhe hytbeja e kësaj dite janë sikur institucioni që herë pas here cakton seanca progresive dhe zhvillimore për punëtorët e tij; seanca edukative, informative, arsimore, etike etj. Besimtari musliman kujdeset për këtë dhe për rolin e tij pozitiv në shoqëri, ai është organ aktiv dhe frytdhënës në shoqëri, ai kujdeset për harmoninë e tij, unitetin dhe mirëkuptimin.

Që këtej na bëhen të qarta disa urtësi hyjnore, jo të gjitha, për faktin se Allahu e bëri këtë namaz farz për muslimanët që qëndron mbi të gjitha farzet, që për hir të tij ata heqin dorë nga puna, shitblerja dhe shumëçka tjetër që ka të bëjë me aktivitetet e tyre të ndryshme, vetëm e vetëm të marrin pjesë në këtë eveniment javor, të dëgjojnë, të konsultohen dhe këshillohen, t'i shqyrtojnë ndodhitë e shoqërisë së tyre,

e të këshillohen, të afrohen, të marrin përsipër zgjidhjen e çështjeve që vijojnë, t'i studiojnë planet e tyre, të orientojnë hapat në rrugë të drejtë, të unifikojnë fjalën, mundin dhe qëllimin, deri në javën e ardhshme. Kjo thirrje e fuqishme dhe e rëndësishme hyjnore për mobilizim të përgjithshëm në kohë të caktuar të ditës së premtë, nuk është pjesë e shkaqeve të tërthorta: *"O besimtarë, kur të thirreni për (të falur) namazin (e xhumasë) në ditën e premtë, nxitoni për ta përmendur Allahun dhe pezulloni tregtinë!"* (El-Xhumu'a, 9)

Hytbeja e xhumasë është analizë informative dhe permanente e çështjeve të njëpasnjëshme, është plan pune e përhershme e muslimanëve, përkujtim dhe udhëzim i përhershëm javorë i mendjes së muslimanit, garanci e integritetit të tij me shoqërinë dhe përgjigje për zgjidhjen e problemeve të shoqërisë dhe ruajtjes së lidhshmërisë me atë.

Zhveshja e domethënies së hytbes nënkupton pezullimin e rolit esencial që e luan këtë ditë, sidomos kur atë e themi në gjuhën që muslimanët nuk e kuptojnë, ose e themi në gjuhën e tyre, por pa ndonjë rol esencial. Ndodh që hytbeja të prezantohet me gjëra të përsëritura e të vjetra, ndodh të jetë e bezdisshme, siç ndodh sot me shumë imamë, që pastaj të jetë e ndarë nga çështjet e jetës sonë të përditshme, të përtërirë, të ndryshme, që vazhdimisht kërkojnë studim, shqyrtim, analizë, progres, zhvillim dhe zgjidhje.

Imami detyrohet që hytben e tij ta analizojë në bazë të kritereve të muslimanëve që falen në xhami dhe në bazë të nivelit të tyre kulturor, natyrës së rrethanave dhe ambicieve, nëse dëshiron që popullata të del nga xhami me diçka të vlefshme. Hytbeja para punëtorëve duhet të jetë ndryshe nga hytbeja para njerëzve të arsimuar, para nxënësve të shkollave, studentëve universitar, profesorëve dhe atyre që tani kanë përqafuar Islamin.

I Dërguari s.a.v.s. lexonte ajete para muslimanëve, ajete që trajtonin zgjidhjen e gjërave të reja që vazhdimisht ndodhnin në Islam. Ajetet zbritnin nga qielli sipas ngjarjeve që zhvilloheshin në tokë dhe sipas asaj që e kërkonte thirrja e re; sqarime, bindje, nxitje e bukur, frikë, paralajmërim, vërejtje, lajmërim, vendim.

I Dërguari s.a.v.s. nuk i lexonte këto ajete vend e pa vend, siç bëjnë sot imamët, që hytбет e tyre nuk përmbajnë më shumë se disa ajete ose hadithe të përsëritura, që para njerëzve i shqiptojnë sikur papagaj, duke mos u munduar t'i lidhin me aktualitetin që ndodh në tokën e realitetit, në kohë dhe vend. Kjo ka bërë që njerëzit të mos interesohen fare se në çfarë gjuhe ligjëron hatibi, në arabishte apo në gjuhë tjetër, përderisa ligjërimi nuk ka fare lidhje me realitetin e përditshëm dhe botën që vazhdimisht ndryshon. Më duket se njerëzit në xhami kanë arritur të krijojnë ndjenja se Kur'ani dhe hadithi nuk kanë të bëjnë fare me realitetin e jetës sonë, bile disa herë ndiejnë bezdisje dhe painteresim për ajetet dhe hadithet që përsëriten, e pse jo? A nuk ke dëgjuar për njeriun e mjerë që kërkoi ndihmë nga udhëheqësi, e kur vendosi t'i jepte diçka, ministri i tij u kollit dhe tha subhanallah (vërejtje që të mos i jepte asgjë). Njeriu doli duke thënë: "Nuk e kam ditur se në tesbih (pra në fjalën subhanallah) paska gjynah, derisa e dëgjova këtë ministër duke thënë subhanallah."

Ne bëjmë gjynah në hak të ajeteve kur ato i përsërisim vend e pavend, në shkallë të bezdisjes, kështu që ato kthehen negativisht në shpirtin e njerëzve dhe, në vend se t'ua dashurojmë ajetet dhe hadithet në zemrat e tyre, ndodh e kundërta, ata heqin dorë dhe largohen prej tyre!

Nëse pesë kohët e namazit me xhemat, siç kemi thënë më parë, janë ndërtim i shtyllave të civilizimit, atëherë hytbeja e xhumasë është inspektim i këtyre shtyllave, zhvillim i tyre, siç e kërkon realiteti, gjendja dhe rrethanat që vazhdi-

misht ndryshojnë përreth nesh. Tani na bëhet e qartë integrimi i rolit të namazit të xhumasë me rolin e namazeve të përditshme me xhemat për të ndërtuar civilizimin njerëzor.

Hytbeja e xhumasë nuk është ushtrim fizik dhe organik i gjuhës dhe buzëve dhe veshëve, ajo është progres permanent i dispozitave, analizë e palodhshme e ngjarjeve dhe jetës, trajtim i sigurt i tyre dhe zgjidhje e tyre. Ura midis muslimanit dhe jetës së tij duhet gjithmonë të ngel e lidhur dhe e pashkëputur. Hytbeja e xhumasë është koment i ri dhe bashkëkohor javor i sheriatit, që kurrë nuk ndalet nga zhvillimi dhe lëvizë me muslimanin, ashtu siç lëvizë jeta.

Nuk guxojmë të lejojmë që gjuha e hytbes të jetë çështje dytësore në jetën tonë, kurse mishi hallall të jetë parësorë dhe themelues i mësimave esenciale etike islame?!

Allahu ka premtuar se në çdo 100 vjet do të dërgojë dikë që do t'ua përtërijë muslimanëve fenë e tyre, siç thotë i Dërguari s.a.v.s.: *“Allahu i Madhërishëm i dërgon këtij Umeti çdo 100 vjet ndonjë që do t'ua përtërijë fenë.”* (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih 'ul-Xhami')

Roli i hytbes së xhumasë është përtëritje javore e dispozitave fetare dhe analizë e thellë e problemeve dhe ngjarjeve me të cilat ballafaqohet Umeti islam.

Nëse çdo institucion ka program zhvillimor, progresiv, aftësues për punëtorët e tij, atëherë themi se hytbeja e xhumasë është institucion islam dhe jetësor që ka program progresiv, zhvillimor, aftësues, orientues për jetën e muslimanit dhe është lidhja javore zyrtare, shkencore, praktike, arsimore, kulturore, edukative dhe stërvitëse e muslimanit dhe jetës së tij.

### *Prej këtu fillojmë*

Kishte gjatë kohë që nuk e shihja në xhami. Një ditë pyeta disa njerëz për atë, kurse ata më thanë se nuk falet më

në këtë xhami, falet në një xhami tjetër, sepse është grindur me njërin që falej në këtë xhami. Pastaj takova një tjetër që nuk e kisha parë një kohë të gjatë, e pyeta: “pse nuk po të shoh në xhami”? Tha: “nuk falem në xhaminë ku hatibi në minber thotë se njeriu është i krijuar nga pika e farës së fëlliqur, si bëhet ai ta thotë këtë”? Pastaj me një tjetër u takuam në rrugë për në xhami dhe biseduam gjatë, por kur arritëm në xhami, ai më përshëndeti dhe u largua. I thashë se përse nuk falet me ne? Tha duke e lëkundur kokën në të djathtë e në të majtë: “Unë nuk falem në xhaminë ku falen selefite.”

Thashë më vete: “Imagjino sikur Umeti islam të ishte i ndarë në këto tri grupe: njëri nuk falet në xhami ku është ai me të cilin është grindur; tjetri nuk ia fal hatibit gabimin njerëzor, nëse e quajmë gabim, kurse tjetri nuk dëshiron të bashkohet në xhami me tjetrin, i cili e kundërshton në mendim. A mendoni se një Umet i tillë do të ishte i aftë për ta udhëhequr botën një ditë?”

Çfarë jemi duke bërë me rregullat etike të xhamisë, kushtet e namazit me xhemat në të, rolin e tij historik në përgatitjen e ushtrive të mëdha që përhapën Islamin anekënd botës, civilizimin islam, moralin islam, në një kohë shumë të shkurtër!

Në prill të vitit 2012, akademia e thirrësit bashkëkohor kërkoi nga unë të marrë pjesë në seancën e saj që mbahej në Kajro, me qëllim të “demonstrimit të diplomuarve të universitetit Al-Az’har, djem dhe vajza, student të jashtëzakonshëm, shembullor, profesionist, të edukuar tejmase në aspektin shkencor dhe moral, që do të bashkëpunonin me brezat e ri të rinjve dhe që do ta përcillnin mesazhin islam, atë mesatar dhe objektiv.”

Pas provave të shumta, përfundova se akademia e tillë do të duhej të shtrihej në shumë vende tjera të botës, me qëllim të promovimit të thirrjes së drejtë islame.

## TRIBUNA E DYTË MË'RAXHI TEK ALLAHU

### Pjesa 1

*“O besimtarë! Mos u falni kur jeni të dehur, prisni të kthjelloheni e të dini se ç’flasini...” (En-Nisa’, 43)*

Sa herë e kemi lexuar dhe përsëritur këtë ajet, por pastaj nuk i kemi lexuar mësimet pas rreshtave të ajetit. Nëse shohim dikë në rrugë që flet, lëvizë me dorë e lëkundë kokën, por pranë tij nuk ka asnjë tjetër, menjëherë do të na shkonte mendja se ndoshta në kokë ka dëgjueset e telefonit celular dhe flet me dikë, por pas një kohe shohim se njeriu nuk ka në gojë asgjë, e as në vesh dëgjuese, e as në dorë ose xhep ndonjë celular. S’na mbetet veçse të mendojmë se është i çmendur, i dehur ose i dalldisur. A thua se po e teproj për këtë që po e them?

Ky është tamam përshkrim i gjendjes së disave që sot falen. I shohim që pranë tyre nuk ka njerëz me të cilët flasin, në dorë nuk kanë celularë, por ata megjithatë, janë më të çuditshëm se kjo, sepse flasin në mënyrë që të bënë me dije se flasin me dikë, apo ata, sipas ajtetit të theksuar, nuk dinë se ç’flasini.

Ky është dallimi i rëndësishëm midis asaj se ti flet dhe në fytyrën tënde dhe formën tënde dukesh se je duke thënë diçka, se ka dikush me të cilin ti flet dhe, asaj se ti flet pa bërë me dije se i flet dikujt, apo se je duke thënë diçka. Rasti i dytë është pra gjendje e çuditshme e sëmure dhe shumë e rrezikshme.

Biseda e këtyre është citim i shpejtë i fjalëve që në thelb kanë kuptim, por që nuk duket, fytyra e tyre dhe forma e daljes së fjalëve nga goja e tyre nuk tregojnë se bartin ndonjë kuptim, sepse do të dukej në mënyrën e të biseduarit të tyre, do të reflektohej në fytyrën e tyre, në ndryshimin e melodisë së kësaj bisede dhe ngjyrosjes së saj me ngjyrën e kuptimit që e shoqëron, sikur çështja e bisedave tjera që i bëjmë me të tjerët në telefon.

Provo tani, merr telefonin dhe zhvillo një bisedë me shokun tënd, dhe kërko nga gruaja jote ose nga ndonjë anëtar i familjes të regjistrojë se sa herë kanë ndryshuar tiparet e fytyrës tënde, theksi i zërit dhe mënyra e të folurit gjatë kësaj bisede?

Gjatë një bisede të rëndomtë ndodh që dhjetëra herë të ndryshojnë dhe lustrohen intonacioni i zërit tonë, tiparet e fytyrës sonë, skajet e buzëve tona, po ndoshta edhe lëvizja e duarve dhe pozita e trupit; kërkesë, këmbëngulje në kërkesë, shpresë, humbje shprese, protestim, habi, refuzim, qortim, kujdes, dëshirë, lutje, mirënjohje, falënderim, vlerësim, pyetje, përgjigje, habi, frikë, tmerr, lakmi, vendim, gjykim, vërtetim, mohim, përjashtim, pritje, përcjellje, njohje, mëdyshje...! Nëse nuk bëjmë kështu atëherë jemi njeri robot.

A jemi përpjekur të vërtetojmë se gjatë faljes së namazit ne nuk jemi "robot" apo të dehur e të çmendur? Se ne nuk flasim me vetveten apo me "asnjërin", dhe njerëzit nuk na akuzojnë se jemi robot, të dalldisur, të dehur e të çmendur? Se jemi duke biseduar me atë që është i gjallë?!

Nëse vërtet jemi të bindur dhe besojmë se Allahu është me ne në anën tjetër të linjës, i flasim e Ai dëgjon, e kujtojmë dhe Ai na kujton, i kërkojmë e Ai na përgjigjet, atëherë çfarë e bënë Atë të na shikojë e dëgjojë se ç'flasim? Bile si mund t'ia vërtetojmë vetë Allahut, Atij që dëgjon theksin e zërit tonë, që i njeh të rrahurat e zemrave tona, që mbikë-

qyrë detajet e fytyrave tona dhe lëvizjet e trupave tonë, Atij që lexon fletët e ndërgjegjes sonë, Atij që i di të fshehtat e shpirtit dhe kraharorit, se ne jemi duke biseduar me Atë e jo me “asnjë”?

A mendoni se vërtet fjalët e juaja arrijnë tek Ai, e mirënjohjet e juaja vërtetohen, ankesat regjistrohen, kërkesat plotësohen, namazi juaj mirëpritet për bukuri, nëse në trupin juaj, formën e juaj, qëndrimin e juaj, tiparet e fytyrës suaj, theksin e fjalëve (intonacionin), nuk shfaqet ajo se ju vërtet flisni me Atë e jo me vetveten? Se ju nuk e humbni kohën kot? Se nuk jeni të shkujdesur për atë që e thoni? Se nuk luani e dalldiseni? Se ju nuk i thoni fjalët vetëm përmendësh? Se gjuha e juaj lëvizë në bazë të rrahjeve të zemrës, i përgjigjet asaj që i flet ndërgjegjja, se ju flisni atë që e kuptoni, të bindur për atë që e përsëritni, serioz për atë që e kërkonit?!

*“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përlulur në namazin e tyre.”* (El-Mu’minun, 1-2)

*“Mjerë për ata që falen, e janë të pakujdesshëm për namazin e tyre.”* (El-Maun, 4-5)

Rëndësia e gjuhës së trupit është shumë me rëndësi kur jemi duke biseduar me Allahun. Doemos që në fytyrën tënde dhe lëvizjet e tua të reflektohen dhe vërtetohen ato që i thua me gjuhë. Provo, p.sh. të shqiptosh këtë lutje të Dërguarit s.a.v.s. Përpiku që ky lexim të jetë stërvitje për mënyrën se si duhesh të flasësh me Allahun në namaz, të mësosh si duhet të flasësh me Atë: si duhet të qëndrosh para Atij, si duhet t’i ndërrosh tiparet e fytyrës, si të lëvizësh pozitën e kokës, si të ndryshon theksi i gjuhës tënde me domethëniet e ajeteve që i lexon, intonacioni apo melodia e bisedës tënde të ndryshon me fjalët e lexuara etj.

“Transmeton Abdullah ibn Mes’udi se i Dërguari s.a.v.s. ka thënë: *“Çdonjërin që e godet mërzia ose brenga, e ai thotë: “Allahu im, unë jam rob i Yt, biri i robit Tënd, biri i robëreshës*

*Tënde, balli im është në duart e Tua, vendimi Yt për mua është i zbatuar, i drejtë është për mua vendimi Yt, të lutem me çdo emër Tëndin që e ke, apo që e ke shpallur në librin Tënd, apo ia ka mësuar ndonjërit nga robërit e Tu, ose e ke mbajtur për Vete në diturinë e gajbir tek Ti; (të lutem) ta bësh Kur'anin pranverë të zemrës sime, dritë të gjoksit tim, heqje e brengës sime, largim të mërzhisë sime" – (nëse e thotë këtë) – Allahu do t'ia largojë mërzhinë e tij dhe në vend të mërzhisë do t'i sjell gëzim (lumturi)." Të pranishmit thanë: "O i Dërguari i Allahut, a duhet t'i mësojmë këto fjalë?" Ai tha: "Gjithsesi, duhet t'i mësojë ai që i dëgjon ato." (Albani thotë se hadithi është sahih)*

Përpiqu ta thuash këtë lutje profetike, të shikosh fytyrën tënde në pasqyrë: a thua e nënshtrove veten para Allahut? A u dridh zemra? A ndryshoi theksi i gjuhës? A u trembën pak sytë kur i shqiptoje para Allahut fjalët: "**Unë jam robi Yt dhe i biri i robit Tënd?**" A e ule kokën kur fillove të pohosh se vërtet je robi i Tij? Se fati yt është në duart e Tij: "**Balli im është në duart e Tua... vendim Yt për mua është i zbatuar..**"? A u shfaqën përgjërimi, shpresa dhe dëshira në shkëlqimin e syve të tu, tiparet e fytyrës dhe pjesët e trupit tënd kur luteshe dhe i kërkoje me shumë përsëritshmëri: "**Të lutem me çdo emër Tëndin që e ke**"?

Namazi nuk është vetëm lëvizje trupore rutine që përsëriten, fjalë që shqiptohen pa kuptim, është gjuha e zemrës para se të jetë e gjuhës, është shpirt para se të jetë trup. Nëse falesh duke mos lexuar asgjë nga Kur'ani (për shkak se ndoshta nuk di), namazi është i plotë, me kusht që orientimi yt drejt Allahut dhe biseda e jote me zemër, para bisedës me gjuhë, të jetë e saktë dhe e mirëfilltë. Nuk është thënie e ime, por e të Dërguarit tim dhe të Dërguarit tënd s.a.v.s: "*Kur dikush bëhet gati për t'u falë, le të merr abdest siç e ka urdhëruar Allahu i Madhërishëm, e nëse nuk di të thotë asgjë*

nga Kur'ani, atëherë le ta falënderojë Allahun dhe le ta madhërojë (le të thotë elhamdulillah, Allahu ekber).” (Ibn 'ul-Mulekkin)

“Kur të bëhesh gati për namaz, merr abdest siç të ka urdhëruar Allahu, e pastaj ngrihu dhe drejtohu kah kibla, pastaj thuaj Allahu ekber, nëse ke nga Kur'ani diçka, lexo, e nëse nuk ke nga Kur'ani, atëherë falëndero Allahun, madhëroje dhe dëshmoje për një; kur të biesh në ruku, bjerë aq sa të jesh i qetë, e pastaj ngrite kokën dhe drejtohu mirë në këmbë, pastaj bjerë në sexhde dhe drejtohu mirë në sexhde, pastaj ngrite kokën dhe ulur mirë, kështu derisa ta përfundosh namazin, nëse kështu vepron, atëherë e ke plotësuar namazin, e nëse ke lënë mangët diçka, ta dish se ke lënë mangët nga namazi yt.” (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih el-Xhami')

Më duket se ke vërejtur se hadithi i fundit përqendrohet në trupin tënd para gjuhës tënde, në lëvizjet e tua para fjalëve të tua. Çdo moment i namazit është lidhje me Allahun, edhe nëse nuk thuhet asgjë prej fjalëve. Kujtoj se kjo është më mirë sesa leximi i disa faqeve që i përsërisim pa ndonjë ndjenjë pohimi ose lidhjeje. Allahu i shikon zemrat tona e jo gjuhët tona, që të flasim me Allahun me zemër pa thënë ndonjë fjalë, është më mirë dhe më madhështore se të flasim me Atë gjatë kohë me fjalë pa zemër. Kështu, nëse duam vërtet të arrijmë tek Allahu, me lidhjen tonë ta rikthejmë programin e vetvetes, me dritën e Tij dhe mirësinë e Tij ta shohim rrugën e lumturisë sonë, me mirësitë e namazit tonë, siç na premtan Ai, t'i shlyejmë të këqijat e zemrës sonë, gabimet dhe njollat e shpirtit tonë: “Fale namazin në mëngjes e mbrëmjes dhe në një kohë të natës, sepse veprat e mira i shlyejnë veprat e këqija.” (Hud, 114)

Namazi nuk është ushtrim sportiv i trupit, edhe pse nuk përjashtohet ky segment nga namazi, ai nuk është vetëm kohë e rëndomtë që e veçojmë për ta kryer atë, e pastaj të kalojmë në punë tjera, ai nuk është fjalë që i pëshpërit

goja jonë dhe buzët tona! Në fakt, namazi i vërtetë që e kryen robi i vërtetë shpërmdahet midis pesë vijave të sinkronizuara, ndërlidhura dhe integruese, të pandara njëra me tjetrën, nëse duam që të kemi lidhje të vërtetë me Allahun e Madhërishëm. Këto vija nuk përmenden në ruknet e namazit, por janë shtylla e shtyllave të namazit, pa të namazi nuk do të ishte fare namaz:

**1- Koha:** Mos u përpiq të më bindësh apo ta bindësh veten se për pesë ose gjashtë minuta e falë farzin e drekës ose të ikindisë apo namazeve të tjera. Koha e ndarë për namaz është çështje thelbësore në vërtetimin ose jo vërtetimin e namazit, ndodhjes së “lidhjes” me Allahun në këtë namaz. S’ka dyshim se pjesa më e rëndësishme e vijës kohore janë çastet e heshtjes që ndajnë ajetet njëri-njëri prej tjetrit, ndoshta edhe fjalën prej fjalës. Mos i grumbullo fjalët në gjuhë të gjitha përnjëherë, sikur dëshiron të bëjnë gara njëra me tjetrën. Shijimi i fjalëve duhet të jetë sikur shijimi i mjaltës kur dikush e provon atë, për t’u siguruar për kualitetin e tij, shkallës së lartë që e ka, prodhimit, që në fund të merr vendim të duhur për të. Çdo shprehje dhe çdo fjalë në namazin tënd meriton hapësirë të heshtjes, analizë në mendje, parafytyrim i kuptimit, shijim me shije të veçantë, reflektim në shpirt i freskisë së tij, ndërtim i sferave shpirtërore që gatohen përreth tij e lëshohen në brendinë tënde. Bëj që gjysma e namazit tënd të jetë heshtje, kurse gjysmën tjetër lutje e qetë, e heshtur, e singertë, që ka vetëm një burim nga i cili burojnë fjalët; është zemra, kurse ka vetëm një orientim kah i cili kthehet: është Allahu: *“Falësi i lutet Zotit të vet (flet), prandaj keni kujdes dhe shikoni atë me çka po i luteni..”* (Ibn Haxheri)

*“Prej të Dërguarit s.a.v.s. mësova dy pushime të vogla: një pushim kur thoshte Allahu ekber dhe një tjetër kur përfundonte leximin (gajri’l-magdubi alejhim ve le’d-dal-lin)”* (Ibn Kajjimi, Zad el-Mead)

*“I Dërguari s.a.v.s. ndante leximin e tij: thoshte “elhamdu li'l-lahi rabbi-l-alemin”, pastaj ndalej, pastaj thoshte: “er-rrahmani’r-rrahim” dhe ndalej.”* (Ibn Haxher El-Askelani)

Shumë herë zgjatja e shkronjave në lexim është faktorë i rëndësishëm që falësit i jep rast kohor për të kuptuar dhe analizuar atë që e lexon. I Dërguari s.a.v.s. me qëllim zgjaste disa fjalë, edhe nëse ato nuk përfshiheshin në rregullat e texhudit, me qëllim që çdo fjalë të merr hakun e vet të kohës që i mundëson shijimin adekuat dhe përjetimin e duhur: “Dikush e pyeti Enesin: *“Si qe leximi i të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.?”* Ai tha: *“Ishte i zgjatur, - e pastaj lexoi: “bismi’l-lahi’r-rrahmani’r-rrahim”, (i Dërguari) e zgjaste bismil-lahi, e zgjaste er-rrahmani, e zgjaste er-rrahim.”*

Në këtë kontekst transmetohet se Aliu – Allahu i Madhërishëm qoftë i kënaqur me të - shprehjen **“na’budu”** (..të adhurojmë..) gjegjësisht shkronjën **“d”** e lexonte me mbushje të plotë (kënaqësi, ngopje) saqë prej saj dilte shkronja **“v”**, siç do të shohim në bisedën tonë për suren Fatiha. Këtë e bënte ngase zgjatja e tillë sikur i jepte kohë që të mund t’i përgjigjej kalimit të rëndësishëm në pjesën e dytë të sures në fjalë, gjysma e së cilës është hamd, madhështi dhe mirënjohje për Allahun e Madhërishëm, kurse gjysma tjetër kërkesë, lutje dhe përgjërime ndaj Atij. Është ky një kalim që kërkon ndryshime (transformime) të mëdha në tiparet e fytyrës, theksit të zërit, pozitës së kokës dhe shkëlqimit të syve.

**2- Gjuha** – Lexojmë fjalët e Zotit në bazë të mësimave të të Dërguarit s.a.v.s.. Secila fjalë e lexuar merr të drejtën e merituar, kuptimin e duhur të theksit, intonacionit, melodisë, ngritjes, uljes etj. Leximi i tillë na kujton rëndësinë e përsëritshmërisë, pa të cilën namazi nuk do të ishte i plotë.

**3- Trupi** – Forma dhe pozita e trupit tonë, e sidomos karakteristikat e fytyrës sonë janë shpjegimi i vërtetë dhe i saktë i asaj

që e flet gjuha jonë. Kështu trupi, fytyra dhe sytë shprehin kuptimin e asaj që e flet gjuha jonë, edhe nëse gjuha nuk e shqipton atë. Si i shqipton fjalët e Zotit ai që ka humb aftësinë e të folurit? S'ka dyshim se ai i vë në fuqi të gjitha forcat e tij të shprehjes në sytë e tij, në trupin e tij dhe në fytyrën e tij, që ta kompensojë me atë shqiptimin e vërtetë. Mësoje namazin nga memeci, që namazi yt të jetë para së gjithash namaz i atij që nuk mund të flet, e pastaj mbështete atë me mirësitë që Allahu t'i ka dhënë, aftësinë e të folurit, shqiptimit dhe shprehjes.

**4- Zemra** – Të rrahurat e zemrës sonë tregojnë atë që gjuha jonë e shqipton, sikur vërtetojnë njëra-tjetrën. Nuk është e mundur që shpirti dhe mendimet të jenë në një anë, kurse gjuha në anën tjetër. E ç'ndodh sikur nga i tërë ky reaksion midis trupit dhe zemrës të lindin dridhmat e trupit, zbehet e fytyrës, dridhjet e zërit, lotët që vërshojnë në thellësitë e syve!?

**5- Puna** – Gjatë kohës që e falim namazin në ne lind nijeti dhe vendosmëria se jeta jonë e përditshme do të jetë realizim praktik i çdo gjëje që e flet gjuha dhe zemra, se punët tona do të jenë në përputhje me fjalët tona, se jeta jonë do të jetë prezantim shpjegues i gjithë asaj që e themi në namaz, se ky namaz nuk është vetëm rit formal i ndarë nga obligimet e përditshme dhe marrëdhëniet tona me të tjerët dhe me Allahun. Kjo, nëse duam që namazi të luajë rolin e tij të vërtetë me të cilin jemi detyruar; të na shtojë dashurinë për Allahun, dashurinë për urdhrat e Tij, vendimet dhe ndalesat, dëgjueshmërinë e plotë ndaj Tij, respektin e evlijave të Tij dhe të zgjedhurve të mirë e të veçantë. Nëse abdesti ishte dy abdeste, atëherë ta bëjmë edhe namazin dy namaze; të brendshëm dhe të jashtëm. Të kujtojmë se në bazë të Kur'anit dhe Sunetit namazi është gjithmonë i lidhur me punën dhe zbatimin e të urdhëruarit për të mirë dhe ndalimit nga e keqja: *"O djali im, kryeje namazin, urdhëroje të mirën, pengoje të keqen.."* (Lukman, 17)

*"Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar.."* (El-Ankebut, 45)

*"Pas atyre erdhën brezni, që e braktisën faljen e namazit dhe ndoqën epshet e veta.."* (Merjem, 59)

*“Ne i bëmë ata udhëheqës që udhëzonin sipas urdhrit Tonë dhe i frymëzuan që të bënin vepra të mira, të kryenin faljen e namazit...” (El-Enbija’, 73)*

*“Atë që namazi nuk e pengon nga shthurja dhe veprat e shëmtuara, le ta dijë se prej Allahut vetëm se e kanë larguar më shumë.” (Sefarini El-Hanbeli, në Sherh Kitab esh-Shihab)*

*“Atë që namazi nuk e urdhëron për të mirë dhe nuk e pengon nga shthurja dhe e shëmtuara, le ta dijë se e ka larguar prej Allahut më shumë.” (Hejthemiu, Mexhmeu ez-Zevaid)*

Më ndodhi njëherë që dikush më kërkoi të ndërhyjë midis dy vëllezërve që njëri kishte ngrënë pasurinë e tjetrit, ndërkaq që të dy ishin që faleshin me xhemat në xhami. Pyeta atë që e kishte ngrënë pasurinë e tjetrit: “a është e lejuar ngrënia e mishit të derrit?” Ai u ngrit në këmbë dhe i trishtuar tha: “Më ruajtë Allahu, po cili musliman e ha mishin e derrit?!” Thashë: “Por është i lejuar në rrethana të caktuara, siç është frika nga vdekja. Por, dije se në asnjë rast nuk është e lejuar ngrënia e pasurisë së vëllait tënd dhe i hakut të tij!” E ku është pra namazi i këtij besimtari dhe puna e tij?

A e kuptove vlerën e hyrjes tek Allahu, uljes para Tij dhe bisedës me Të?

Ai nuk është njeri, sado që të jetë shkalla e lartë e këtij njeriu, e as xhind, sado që këto krijesa të kenë aftësi dhe fuqi të jashtëzakonshme, e as engjëll, sado që të kenë shkallë të lartë dhe të kenë aftësi mbi aftësitë e njeriut, e as pejgamber, sado që këta të kenë mrekulli dhe sado që të kenë rang të lartë dhe madhështi e afërsi tek Allahu. Ti tani je me vetë Allahun, Krijuesin e gjithë këtyre, Ai që ua jep dhe që ua merr jetën, Ai që i pyet në Ditën e Kiametit, dije pra madhështinë e Atij me të cilin flet dhe para të Cilit je në namaz, përpiqu që me të gjitha fuqitë mendore ta paramendosh qëndrimin e veçantë në të cilin gjendesh tani: “Kur banorët

*Xhenetit të hynë në Xhenet, Allahu i Lartëmadhëruar thotë: “A dëshironi diçka tjetër t’ju shtojë?” Ata thonë: “Po, a nuk na i zbardhe fytyrat tona? A nuk na fute në Xhenet dhe na shpëtove nga Xhehenemi?” Në atë çast hiqet perdja, e nuk ka gjë më të mirë e më të dashur për ata se shikimi në Zotin e tyre të Lartëmadhëruar.” Në transmetim tjetër qëndron: “E pastaj e lexoi këtë ajet: “Për ata që besuan ka të mirë po edhe më shumë diçka.” – më shumë diçka nënkupton shikimin e Allahu të Lartëmadhëruar. (Muslimi)*

Allah! Sikur të jemi fatlumë, e të na jepet rasti të flasim me këtë fuqi të lartë shpirtërore dhe madhështore, mbikëqyrëse e superiore, që ka në dorë gjithçka që shohim e që nuk shohim, fatin tonë dhe të gjithë të tjerëve, fatin e gjithësisë dhe gjithë asaj që është në të, që e dimë e që nuk e dimë, a thua çfarë bisede do të ishte biseda jonë? Cilat ti-pare do të përshkonin fytyrën tonë? Cilat lëvizje do t’i shfaqnin trupat tonë?

- Falu me karakteristikat e trupit tënd, sikur nuk ke fare fytyrë,

- Falu me karakteristikat e fytyrës tënde, sikur nuk ke gjuhë,

- Falu me intonacionet e zërit tënd, sikur nuk ke trup,

- Falu me rrahjet e zemrës tënde, sikur të jenë të rrahurat e fundit,

- Falu sikur të jenë minutat e fundit të jetës tënde...

A ke dëgjuar për njeriun që i erdhi ftesa për të marrë pjesë në një manifestim të madh, në një qytet larg vendi të tij, e ai veshi rrobat më të bukura, u ngarkua mirë për rrugë të gjatë, harxhoi para, humbi kohë e pasuri, dhe bëri çka nuk bëri. Kur arriti në vendin e duhur, tregoi ftesën dhe i lejuan të hyjë, zuri vend në sallën e madhe, zuri një karrige midis masës së gjerë, u ul për të pritur fillimin e manifestimit. Nuk kaluan disa minuta e atë e kaploi dremitja në kar-

rige, ende pa filluar shfaqja mirë. Pas një kohe befaz dikush e zgjoi nga gjumi dhe kërkoi ta lëshonte vendin, meqë duhej të pastrohej. Drama teatrale kishte filluar e mbaruar, njerëzit ishin ndarë për në shtëpitë e veta, kurse kishte mbetur vetëm ky që po flinte në sallë?!

Kështu është çështja e atij që planifikon namazin e tij, merr ftesë nga Zoti i lartë, përgatitet me abdes, shkon në xhami, harxhon kohë, ndoshta edhe para, e pastaj kalon një kohë në xhami, pak ose shumë, por del nga namazi pa u kënaqur me ndonjë veprim shpirtëror, pa ndonjë reaksion me qëndrimet e namazit dhe kuptimet e tij sublime, pa ndier lidhjen me Krijuesin e tij, pa arritur ndonjë shpërblim të shpresuar!!

Çfarë rasti i humbur dhe shkuar huq! Çfarë kënaqësia ka humbur? E çfarë prezantimi qiellor i ka kaluar pa parë?!

Sikur falësi të dinte të vërtetën e kësaj kënaqësie, madhështinë e këtij qëndrimi, sasinë e asaj që e fiton apo humbë nga shpërblimi, nuk do t'i lejonte zemrës të shkujdesej nga Allahu, e as mendjes të bredh poshtë e lartë, qoftë për një çast të vetëm.

I Dërguari s.a.v.s. i vëllazëroi muslimanët në Medinë. Kishte ndodhur që njëri të ishte vrarë, kurse tjetri të kishte pësuar të njëjtën pas një jave. Muslimanët thanë: *“O Allah, fale atë dhe bëje bashkë me shokun e tij.”* I Dërguari s.a.v.s. tha: *“Po ku është namazi i tij në krahasim me namazin e këtij... puna e tij në krahasim me punën e këtij? Midis tyre ka dallim sikur midis qiejve dhe tokës.”* (Ebu Davudi, Albani thotë se hadithi është sahih)

O Allah... Nëse vetëm një javë namaz më shumë se tjetri shkaktoi këtë dallim të madh sa midis qiejve dhe tokës, atëherë sa qenka pra distanca e vetëm një namazi?

Pas çdo namazi pyete veten: Në çfarë distance më ka ngritë namazi im? Ndoshta mbi hënë? Apo mbi mjegulla?

Mbi kulmin e shtëpisë tënde? Mbi kokën tënde vetëm? Dy gishta ndoshta? Një gisht?

Pas çdo namazi që e falim në xhami duhet të jemi të bindur se nuk jemi të njëjtit që ishim para ca çasteve para se të hymë në të, dhe para se të falemi. Jemi të tjerë, të posalindur.

## Pjesa 2

### **Rreziku më i madh për përshpirtshmërinë (hushu’): adaptimi**

Në verën e vitit 1981 Universiteti Islamik në Medinë më bëri ftesë për mësimdhënie. Ishte hera e parë që po e vizitoja Mbretërinë Saudite Arabe, nuk më kishte ndodhur më parë të bëja haxhin ose umren. Natyrisht se ishte hera e parë që më jepej rasti ta vizitoja të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. e ta përshëndesë në vendin ku është i shtrirë. Edhe pse nuk jam larg Medines, prapëseprapë kjo ishte hera e parë.

Çudi, a thua çfarë takimi do të jetë ky!! **Salallahu alejke ja resulallah...**

Aeroplani na zbriti në aeroportin e Medines, u hap dera e daljes, udhëtarët u radhitën në radhë të gjatë dhe të gatshëm për ta lëshuar aeroplanin. Erdhi radha që edhe unë të bëhesha gati për të dalë. Sapo e vura këmbën në derë të aeroplanit, ndjeva sikur një derë e Xhehenemit mu hap para meje, më besoni se nuk po ekzagjeroj. Nuk e kisha ditur se ka një erë përvëlues të tillë diku. Atëkohë kisha dyzet vjet dhe një gjë të tillë po e përjetoja për herë të parë. U frikësova shumë dhe u ktheva mbrapa për t’u freskuar me ajrin e kondicionerit, me të cilin isha kënaqur brenda në aeroplan. Kështu duheshka të jetë, o Besam, i thashë vetes, pas teje ka udhëtarë që presin të dalin, lëviz më shpejtë para se të shtyjnë me duar e të nxjerrin jashtë. U bë si u bë, era përvëluese e nxehtë më kaploi nga të gjitha anët, edhe pse ngu-

shëllimi im ishte se do ta freskoj zemrën me të parë xhaminë e të Dërguarit s.a.v.s.

Në aeroport do të më priste profesori im i cili kishte kohë të gjatë që banonte në Medinë dhe jepte mësim në universitet. Do të qëndroj në shtëpinë e tij një kohë derisa të gjejë banesë për mua dhe familjen time të vogël. Pas takimit të ngrohtë midis nesh dhe përshëndetjeve të ngrohta, morëm rrugën për në shtëpi. Profesori im kishte gati 80 vjet, andaj nuk desha ta mendoj që së pari të kalonim pranë xhamisë së Pejgamberit s.a.v.s. e të falim nga dy rekate në shenjë përshëndetjeje për xhaminë. I thashë që të m'i tregonte minaret e xhamisë që së paku ta përshëndesja prej së largu, ndoshta edhe kjo ma zbut etjen time të madhe për këtë takim. Paramendo Besam, më në fund do ta shohësh xhaminë e të dashurit tënd me sytë e tu e jo me fotografi. O Allah! Sa çast i mrekullueshëm.

Sa herë që rrugës shihja minare e pyesja profesorin tim se a janë këto minaret e xhamisë së Pejgamberit s.a.v.s.?

Jo, më thoshte ai, edhe pak.

Unë pyesja, e ai vazhdonte të më përgjigjej njëjtë. Më erdhi turp më të pyesja dhe heshta. Pas dhjetë minutave fillova të ndiej se rruga mori kahe të gjatë, supozimi ishte se në shtëpi duhej të arrinim për pak minuta e jo më shumë (shtëpia ishte në lagjen e xhamisë Kuba), megjithatë minaret e xhamisë së Pejgamberit s.a.v.s. nuk duken ende. Pasi më humbi durimi, e pyeta profesorin tim: "A ende kemi rrugë të gjatë për t'i parë minaret e xhamisë së Pejgamberit s.a.v.s.?"

Xhamisë së Pejgamberit?... oho... ato i kemi kaluar qysh moti...!!

M'u përgjigj me pakujdes të madh. Ishte një goditje e madhe për mua kjo, jo më pak se goditja e erës përvëluese kur dola nga aeroplani. A thua kështu bën adaptimi me njeriun? A kështu e zhvesh nga ndjenja për madhështinë e

vendit dhe të zotit e vendit? E me këtë humb pastërtinë e shikimit të parë?! Jo..jo... unë nuk dua ta humb pastërtinë e shikimit të parë, i kam premtuar vetes se gjithmonë do të shikoj me syrin e parë e të pastër xhaminë e madhe, do të shikoj vendin madhështor, të zotit e këtij vendi madhështor, nuk lejoj përzierjen e syve të mi me shikim tjetër, edhe pse e dija se kjo nuk do të jetë lehtë, nëse nuk kërkoj ndihmë prej Allahut dhe me të gjitha forcat shpirtërore të përpiqem të shpëtoj nga ndikimi i adaptimit gjatë kohës që do të jetoj në Medinën e pastër, do të kujdesem për dashurinë, respektin dhe modestinë time për të Dërguarin s.a.v.s., për familjen e tij, shokët, paqja e Allahut dhe shpëtimi i tij qofshin për të gjithë.

Disa thonë që fillimi i Ramazanit është mundim, kurse fundi adaptim, se ne e fillojmë agjërimin me zor, deshëm apo nuk deshëm, andaj duhet të durojmë, se është i vështirë, por pastaj mësohemi dhe ditët e fundit adaptohemi e na duket i lehtë, bile kënaqemi dhe pushojmë ditëve të fundit.

Është bukur që me kalimin e kohës detyra të shndërrohet në adaptim, por rreziku më i madh që na pret në kthesë është: adaptimi dhe zakonshmëria.

Namazi ynë do të humb çdo vlerë atëherë kur ai shndërrohet në punë rutinë, themi çka themi, lëvizim sa lëvizim, por pa e kuptuar rëndësinë e fjalëve të thëna dhe lëvizjeve që ngërthejnë kuptim e domethënie të mëdha! Nga namazi ynë mbetet vetëm emri i tij!

Është e mundur që nga shumë gjëra që i bëjmë në jetë, të vogla apo të mëdha, të fitojmë shpërblime të panumërta, sikur të dalim nga sfera djallëzore dhe të shpëtojmë nga ndikimi i adaptimit dhe rutinës.

Ndodh të kisha blerë një shtëpi të bukur për banim. Mos e humb kënaqësinë e shtëpisë pas pak çastesh, kujdesu

për këtë bukuri shpirtërore tërë jetën, sikur e ke blerë atë para një ore.

Kujdesu për gruan/burrin që të bënë të lumtur e të përsos, mos e humb këtë lumturi dhe kënaqësi të jashtëzakonshme pas një apo dy muaji, pas një apo dy viteve, (ti vëlla e motër) përpiqu ta ruash fotografinë e parë që e ka vizatuar ai/ajo në kujtesën dhe shpirtin tënd.

A të kujtohet çasti i diplomimit në universitet dhe filimi i arritjes së suksesit të parë? Rrëmbeje atë çast të paharuar dhe fshihe në qesen e ndërgjegjes tënde, që vazhdimisht të të ndihmojë që në të ardhmen të arrish sa më shumë suksese të tjera në jetë dhe të kënaqesh me realizimin e tyre.

Mirëpo, vetëm kur të mbizotërojmë sëmundjen e adaptimit dhe të mos i lejojmë të na mbizotërojë dhe të fshihet në venët tona e të na trullosë. Vetëm kur të arrijmë që atë ta largojmë dhe të kemi sukses ta shndërrojmë nga element vrasës në element kënaqësie, bukurie, ëmbëlsi të suksesit, ekstazë të përshpirtshmërisë (hushuasë) etj, vetëm atëherë do t'i shijojmë frytet e kësaj bote të namazit dhe të dimë se frytet e botës tjetër janë duke na pritur, atëherë themi se jemi kapur për fijen e parë që na dërgon drejt përshpirtshmërisë së plotë në namaz, në fundin e fijes.

### Pjesa 3

#### **Përshpirtshmëria: punishte e fuqisë magjepsëse**

*“Gjëja e parë që do të ngrihet nga ky Umet do të jetë përshpirtshmëria (hushuaja), saqë nuk do të shihet në mesin e tyre ndonjë i përshpirtshëm.”* (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih et-Tergib)

Le të pyet çdonjëri veten pas leximit të këtij hadithi: A jetojmë në këtë kohë? A ka ardhur kjo kohë? A jam unë prej atyre pre të cilëve është ngritë përshpirtshmëria? Nëse jam,

e mos e bëftë Allahu të jem, a thua ka rrugëdalje për kthim në të që të jem nga grupi i të përshpirtshmëve, dhe sa të rrallë që janë në këtë kohë të përmendur?

Namazi nuk do të mund të ketë këtë fuqi efektive e të aftë për të pastruar njollat e yndyrës në rrobat tona si dhe të mund që “të mirat e tij” t’i fshijnë “të këqijat tona”, nëse nuk e përziejmë me elementin e çuditshëm kimik, i cili na ngritë nga toka dhe na lidh me Krijuesin në qiell?! Kësaj here namazi nuk do të jetë përsëritje e fjalëve pa kuptim, nuk do të jetë veprim rutinë dhe tradicional i lëvizjeve. Ky element i çuditshëm kimik është përshpirtshmëria: *“Nuk ka njeri musliman që e arrin koha e namazit farz, e ky merr abdes për bukuri, e bënë atë me përshpirtshmëri të bukur dhe plotëson rukunë për bukuri, le të dijë se ai (namaz) do të jetë shlyerje e gjynahëve të kaluara, nëse nuk bënë ndonjë gjynah të madh; kështu do të jetë tërë jetën.”* (Muslimi)

Vlera e namazit fshihet në këtë fuqi efektive, sepse reaksioni ynë me atë që e themi në të vërtetë është raporti ynë me Allahun. Fjala namaz në arabisht quhet **“salat”**, që nënkupton **“lidhje”**. Që namazi të jetë namaz i vërtetë, doemos të ekzistojë lidhja efektive me Allahun, e cila do të na jep fuqi të jashtëzakonshme dhe shumëdimensionale. Kujtoj se namazi është bërë farz për këtë qëllim, përndryshe pse falemi?

Cila është natyra e kësaj fuqie që na çon përpjetë dhe shumë lart, fuqi apo motor i raketës bërthamore?

Të lidhemi me Allahun, pra të jemi me Allahun dhe Allahu të jetë me ne, të fitojmë dynjanë dhe ahiretin, e jo vetëm njërën. Po, është e vërtetë se të tjerët të japin nga kjo botë shumëçka, por çka mund të të jep ky dhënës i vogël nga kjo botë, në krahasim me atë që mund të të jep Dhënësi i Madh në jetën e kësaj bote dhe në jetën tjetër?

Nëse të japin në këtë botë gjithçka që dëshiron apo që dëshirojnë; pasuri, para e post që mbaron; Allahu do të jep

kënaqësinë e ndjenjave për pasurinë e të mirave të Ahiretit të përjetshëm,

E nëse të japin post të lartë në dynja, Allahu do të jep bindjen dhe qetësinë e plotë se ti je duke shkuar drejt një posti shumë më të madh, atje në Xhenetin firdeus, inshaallah,

Po nëse të japin shtëpi apo ndërtesë që një ditë rrënohet, Allahu do të jep banim dhe siguri në tokë, shtëpi të përjetshme të lumturisë dhe paqes në mirësinë e qiellit,

Nëse të japin kënaqësinë trupore që shumë shpejt mbaron, Allahu do të jep kënaqësinë e shpirtit dhe ëmbëlsinë e imanit, që nuk krahasohet me asnjë kënaqësi të kësaj bote, kënaqësi që kurrë nuk mbaron, e as nuk mbarojnë frytet e saja në Ahiret,

Nëse t'i japin burimet e fuqisë tokësore të kufizuara, Allahu do të jep fuqinë e kënaqësisë së nënshtrimit para Atij, që me fuqinë e tij të të ngritë në qiell, pranë dyerve të pranisë së Tij dhe mirësisë së përherëshme,

Nëse t'i japin krahët e aeroplanit që të fluturosh mbi retë, Allahu do t'i jep krahët e shpirtit që me to t'i tejkalosh qiejt, yjet dhe galaktikat.

*“I Dërguari s.a.v.s. lexoi këtë ajet kuranor: “Atij që dëshiron shpërblim në jetën tjetër, Ne do t’ia shtojmë atë”, dhe tha: “Allahu thotë: “O biri i Ademit, përkushtoju adhurimit Tim, do ta mbush kraharorin pasuri dhe do të siguroj nga varfëria, e nëse nuk bën kështu, atëherë do ta mbush kraharorin tënd me preokupim (punë) dhe nuk do të siguroj nga varfëria (nuk do ta pengoj varfërinë).” (Albani thotë se hadithi është sahih)*

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. thotë: *“Kush i afrohet Allahut të Lartëmadhëruar një pëllëmbë, Ai i afrohet një krah, e kush i afrohet një krah, Ai i afrohet një hap, po kush shkon tek Allahu i Lartëmadhëruar duke ecur, Ai do të shkon tek Ai duke vrapuar, e Allahu është më i Lartë dhe më Madhështor, Allahu është më i*

*Lartë dhe më Madhështorë, Allahu është më i Lartë dhe më Madhështorë.”* (Mundhiriu, Et-Tergib ve et-Terhib)

Ç’është përsheptshmëria? Si mund ta arrijmë këtë materie? Si mund ta kapim e ta shndërrojmë në fuqi? Shprehja **hushu’** nënkupton përluljen dhe nënshtimin.

A kemi menduar për këtë kuptim kur jemi duke u falur? A jemi të përlulur e nënshtuar në namaz? Apo vetëm me trup nënshtrohemi kurse shpirti mbetet mendjemadh, i dalldisur, egoist, urrejtës, lakmues, hakmarrës, mashtrues, çrregullues etj?

Përpiqu që në namaz të parafytyrosh çdo fjalë që e thua, mos lejo që adaptimi dhe përsëritja e pakuptimtë të mbytë ndjenjat për kuptimin e fjalëve. Çdoherë përpiqu që fjalët që i thua të kenë kuptim tjetër, edhe pse janë të njëjta...

Paramendo leximin e sures **Fatiha**, ku lexon **“Elhamdu li’l-lahi rabbi’l-alemin – falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve”** - sikur tani të ka shpëtuar nga një rrezik i madh që gati nuk të morri ty dhe familjen tënde, sikur i thua: fale-minderit o Shpëtues i fuqishëm, që me diturinë Tënde të madhe dhe mirësinë e plotë më shpëtove mua dhe familjen time, kurrë nuk kam për ta harruar këtë të mirë, kurrë, kurrë; paramendo që kur thua **“Ijjake nestein – vetëm prej teje ndihmë kërkojmë”** – se i flet Atij që sapo të shpëtoi nga fundosja në mes të detit, kur ti bërtisje: shpëtim, shpëtim, ndihmë, ndihmë, të lutem më shpëto, më jep një litër të kapem, po fundosem; pastaj paramendo kur je ulur dhe thua **“Ettehijjatu li’l-lahi – përshëndetjet i takojnë Allahut”** – sikur i thua në çastin e takimit me atë që nuk e ke parë kohë të gjatë, kurse ke menduar se kurrë nuk do të kthehet, mirëserdhe o i dashur i shtrenjtë...!

Mos u ngushto që të veprosh kështu me Allahun, përdërisa ky shkëmbim gjuhësor që zhvillohet në imagjinatën tënde të ndihmon parafytyrimin e madhësisë së Allahut

dhe madhërisë së Tij. Kujtoj se kjo gjë nënkupton suksesin e të kapurit të fijes së parë që të çon drejt zbulimit të reaktorit magjik që kam emrin **“përshpirtshmëri”**: *“Përhape selamin, jep ushqim, turpërohu prej Allahut të Madhërishëm ashtu siç turpërohet njeriu nga farefisi yt me nam, ke moral të mirë dhe, nëse bënë keq, atëherë bënë mirë, sepse të mirat e fshijnë të këqijat.”* (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih el-Xhami’)

*“Ihsan është: ta adhurosh Allahun sikur je duke e parë, se nëse ti nuk e sheh, Ai të sheh ty.”* (Buhariu)

Po, është e vërtetë se kjo kërkon mund të jashtëzakonshëm, kohë shtesë, veç kohës që e harxhon njeriu i rëndomtë që falë namaz të rëndomtë e prej tij del vetëm me shpërblime të rëndomta, ndonëse mund edhe pa asnjë shpërblim! Shpërblimi i madh të pret pranë daljes nga dera e pallatit të namazit, veç mirësisë së kënaqësisë së madhe të cilën e shijon në këtë përvojë të veçantë e të rrallë.

Për fat të keq, shumë nga ne e harrojnë këtë aspekt të rëndësishëm në namaz, më të rëndësishmin bile, e të pyesin: sa rekat i fale? E shumë pak janë që pyesin: si e fale namazin? Janë mësuar që namazin ta llogarisin me **“sa”** e jo me **“si”**. Me këmbëngulje pyesin: a e fale sunetin? E nuk pyesin: si e fale farzin? Sikur t’i faleshim vetëm farezet, por me përshpirtshmëri të plotë, do të mjaftonte që të kemi çelësin e Xhenetit, siç na premtan i Dërguari s.a.v.s.: *“Një njeri nga banorët e Nexhdit erdhi tek i Dërguari i Allahut s.a.v.s., ishte flokëprishur, dëgjonim zhurmën e zërit të tij por nuk e kuptonim se çfarë thotë, derisa u afrua tek i Dërguari i Allahut s.a.v.s., dhe ja që po pyeste për Islamin. I Dërguari i Allahut s.a.v.s. tha: “Pesë namaze që falen ditën dhe natën.” Ai tha: “A duhet të bëj diçka tjetër përveç tyre?” Ai tha: “Jo, përveç nëse do vullnetarisht.” “Agjërimi i muajit të Ramazanit (tha i Dërguari s.a.v.s.)” Ai tha: “E diçka tjetër përveç këtij muaji?” Jo, përveç nëse do vullnetarisht, tha i Dërguari s.a.v.s.” I Dërguari s.a.v.s. e përmendi*

zekatin, e ai tha: “E diçka tjetër përveç kësaj?” Jo, përveç nëse do vullnetarisht, tha i Dërguari s.a.v.s.” Njeriu ia kthehu shpinën duke thënë: “Për Allahun, as nuk do të shtojë e as nuk do të pakësojë prej tij.” Atëherë i Dërguari i Allahut s.a.v.s. tha: “Ka shpëtuar, nëse është i sinqertë.” (Muslimi)

Kur të falesh mos lejo asgjë që të ta shmang mendjen nga ai. Nëse je i uritur dhe dëshiron të falesh, atëherë së pari ha ushqim, e pastaj falu, gjithashtu nëse para se të falesh ke ndonjë punë të vogël, siç është thirrja telefonike, shkuarja në banjo, kërkimi i ndonjë sendi, bisedë me ata që i ke përreth, atëherë bëji këto punë, e pastaj fillo të falesh, edhe nëse këto punë të vonojnë pak. Por, nëse ke ndërmend të fillosh namazin e ke frikë se mos të të kalojë një pjesë e programit televiziv, qoftë të jetë 15 minuta, atëherë shtrëngo veten dhe thuaj se nuk do ta shikojë këtë program që sapo është duke filluar, edhe nëse pas namazit të ka kaluar i tërë programi, dije se ke ngulfatur djallin dhe cytjet e tij, se ai të thërret në përshpejtim të namazit, që të mund ta shikosh programin në fjalë.

Me këtë pengojmë rrugën e djallit dhe nuk lejojmë që mes nesh dhe namazit të futet ndonjë punë që do të na shkujdes.

Forma është treguesi më i mirë i përmbajtjes, bile ndihmon formësimin e përmbajtjes dhe shëndoshmërinë e tij. Për këtë përshpirtshmëria ka formën e saj që e merr trupi ynë gjatë namazit. I Dërguari s.a.v.s. i tha një njeriu që u fal: “*Kthehu dhe falu, sepse nuk je falur.*” Ai s.a.v.s. nuk e kish-te dëgjuar se çfarë kishte lexuar ky njeri, por e kishte parë vetëm trupin e tij dhe lëvizjet. Ishte kjo provë e mjaftuar për të provuar përmbajtjen e namazit, pa marrë parasysh fjalët e thëna në të.

Është shumë me rëndësi që t'i luftojmë përpjekjet e djallit derisa jemi duke u falur në xhami. Ndodh që djalli të

cytë në ne se kinse njerëzi janë duke na vëzhguar me sytë e tyre, andaj faluni mirë sa të mundeni. S'ka dyshim se kjo është rruga më e shkurtë e humbjes së namazit tonë dhe humbjes së përsheptshmërisë sonë. Ka diçka që është edhe më e rrezikshme se kjo, që i Dërguari s.a.v.s. e numëroi në shirk të fshehur (**shirkun hafij**): *“I Dërguari i Allahut s.a.v.s doli e ne po e përmendnim Mesihu Dexhallin, dhe tha: “A t’ju tregojë për gjënë që më shumë kam frikë për juve sesa që kam frikë për Mesihun Dehxall?” Gjithsesi, thamë ne. Ai tha: “Shirku i fshehur; që njeriu të falet e ta zbukurojë namazin e tij me shkak se njerëzit janë duke e shikuar.”* (Ibn Maxhe, Albani thotë hadithi është hasen)

Nëse ka dikush që na vëzhgon në namaz, Ai është Allahu, vetëm Allahu e askush tjetër.

Mos e harro rregullin: kur ndjenjat e tua arrijnë nivelin që ndien se namazi yt është më shumë e “drejtë” sesa “de-tyrë”, më shumë kënaqësi sesa barrë, që shpreson të jesh në namaz e të mos ndahesh kurrë prej tij, atëherë vërtet ke realizuar kriterin peygamberik të namazit të vërtetë: **Na pusho me atë, o Bilal.**

#### Pjesa 4

#### Jashtë dominimit të shqisave

A ju kujtohet udhëtimi i fundit që e keni bërë me aeroplan? A ju kujtohen instruksionet e dhëna në aeroplan dhe procedurat e duhura gjatë përgatitjes për fluturim; fikjen e dritave, që aeroplani të ketë fuqi për fluturim, mos përdorimin e kompjuterit, telefonit celular, ngase mund të ndikojnë në lidhjet midis aeroplanit dhe aeroportit, urdhrit për lidhjen e rripit të sigurisë, që t'i shmangemi rrezikut të rrëzimit ose dëmtimit gjatë fluturimit në ajër dhe aterimit në tokë?

Këto procedura dhe shumë të tjera i paraprijnë një fluturimi të rëndomtë nga toka në tokë, aeroplani fluturon disa kilometra e mila, një kohë qëndron në qiell, para se të aterojë në tokë dhe kaq. E çfarë mendoni për udhëtimin hapësinor që na çon drejt Allahut, e që kalojmë yje, planetë, galaktika dhe të gjitha ato orbitat kozmike të panumërta?

Cilat organe duhet t'i çaktivizojmë gjatë hipjes sonë në avionin e namazit që të mos ndikojnë në sigurinë e lidhjes sonë dhe arritjes sonë tek Allahu? Cila fuqi mendore dhe shpirtërore, perceptuese dhe përgatitëse duhet të akumulohet dhe investohet për të fluturuar nga aeroporti i dynjasë drejt kozmosit të Allahut? Cili rrip sigurie dhe cila qetësi, siguri dhe prehje e përhershme do të duhet të na shoqërojë dhe t'i përmbahemi me qëllim që të mos rrëzohemi nga kurrizi i namazit, kurse kemi hipur në mjetin shpirtëror të çuditshëm që udhëton drejt qiejve të lartë?

S'do mend se së pari nevojitet përgatitja e pesë shqisave për fluturim, shkëputja e tyre aq sa është e mundur nga bota e jashtme, që të mos pengojë procesin e nisjes (operacionin).

Është i Dërguari s.a.v.s. që na jep instruksione të duhura për këtë udhëtim hapësinor, ai na porosit përdorimin e misvakut para çdo namazi, që të mos ndikojë negativisht në shqisën e shijes, të mos pengojë udhëtimin tonë, ndodh që në gojën tonë të kenë mbetur mbeturina të ushqimit etj. Ai s.a.v.s. kujdeset për organet e të menduarit tonë dhe koncentrimin tonë të plotë, lidhjes sonë me Allahun e Madhërishëm.

*"Sikur të mos e shqetësoja Umetin tim, apo njerëzit, do t'i kisha urdhëruar ta përdorin misvakun pranë çdo namazi."* (Buhariu)

*"Xhibrili përherë më këshillonte për misvakun, saqë kisha frikë për dhëmballët e mi."* (Buhariu)

I Dërguari s.a.v.s. na nxit që nëse koha e namazit dhe koha e ushqimit janë pranë njëri tjetrit, atëherë së pari të hamë ushqim, e pastaj të falemi, se uria apo shqisa e nuhatjes

ka ndikim në lëvizjet tona që i bëjmë gati për udhëtim drejt qiellit: *“Nëse është shtruar darka dhe është thirr për namaz, filloni me darkën...”* (Albani thotë se hadithi është sahih)

*“Kur të thërret ikameti për namaz, ndërsa jeni agjërues, atëherë filloni me darkën para namazit të akshamit...”* (Albani thotë se hadithi është sahih)

*“E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. të thotë: “Nuk ka namaz në prezencë të ushqimit...”* (Albani thotë se hadithi është sahih)

*“Nëse dikush është duke ngrënë, të mos shpejtojë derisa të përfundojë nga ai, edhe nëse është thirr ikameti për namaz.”* (Buhariu)

E çfarë mbeti për shqisat e tjera? Është me rëndësi të madhe të konfirmojmë përputhshmërinë e ritmit të namazit me të gjitha që na rrethojnë nga gjëra e jetës. Namazi i sabahut falet me fijen e parë të agimit. Drita e mëngjesit mund të pengojë lëvizjen e shpirtit që udhëton drejt lartësive në kohë të caktuar: *“I Dërguari s.a.v.s. e urrente dritën e diellit në mëngjes.”* (Hejthemiu, Mexhmeu ez-Zevaid)

Fillimi i namazit na bënë të mendojmë se veten e kemi vendosur brenda sferës orbitare, aty ku shikimi ynë nuk guxon të lëvizë me liri absolute, me të cilën është mësuar jashtë namazit. Orientimi i shikimit tonë drejt vendit të sexhdes në tokë dhe mos-lëvizja e tij djathtas e majtas, na kujton aktivizimin e motorëve të fluturimit dhe orientimit të fuqive dhe përkufizimit të tyre në drejtim të qiellit që të jemi sa më afër Allahut.

Ngritja e duarve në kokë (**tekbiri ihram**), na bën me dije se kemi vendosur veten në tërësi para Allahut, se kemi lënë pas nesh gjithçka, me tërë qenien dhe çështjen tonë jemi para Tij, e si pra të lëvizim me kokë, shikim ose zemër? Cila gjë mund të jetë më e rëndësishme se kjo e Allahut, e të mund të lëvizim e të lëkundemi?

*“Shikimin tënd vendose në vendin e sexhdes.”* (Sujuti, Xhami' es-Sagir)

*“Të ndalen njerëzit nga ngritja e shikimit të tyre në lutje – lexim – në namaz drejt qiellit, ose do t'u rrëmben shikimet.”* (Muslimi)

*“Allahu është para robit të Tij në namaz derisa nuk lëvizë, e kur ta lëvizë fytyrën, Ai largohet prej tij.”* (Ibn Hazmi në El-Muhala, Albani thotë se hadithi është sahih, Sifetu salati Nebijj)

Është e domosdoshme marrja parasysh e të gjitha masave paraprake të mundshme të namazit që të mund ta ruajmë shikimin tonë, dëgjimin tonë dhe të gjitha shqisat e tjera, sepse është e mundur të na largojnë prej Allahut dhe udhëtimit drejt Tij.

A jemi vërtetuar se vendi ku do të falemi është i zbrazët nga gjërat që mund të na çorientojnë shikimin dhe dëgjimin? Apo aty nuk është televizori ose radioja, ose bile edhe bisedë e mundshme mes njerëzve që mund të zhvillohet përreth nesh, qoftë të jemi në xhami ose jashtë xhamisë? Po vendi i sexhdes, si është? A ka diçka që mund të na tërheq shikimin dhe vëmendjen tonë, e me këtë të shkujdesemi për lidhjen me Allahun, kam për qëllim zbukurimet dhe ngjyrat e llojllojshme që mund të na shkujdesin nga ky udhëtim shpirtëror drejt Allahut: *“Abdullah ibn Serxhes thotë se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. një ditë u fal me një gunë (mantel) prej leshi dhe duke iu drejtuar njërit prej shokëve të tij, i tha: “Ma jep gunën tënde e ti merre timen.” Ai tha: “O i Dërguari i Allahut, guna jote është më e mirë se guna ime”. Po, tha i Dërguari s.a.v.s. por në gunën time ka një vijë (fije) të kuqe dhe kam frikë ta shikoj se mos më shkujdes nga namazi im.”* (Hejthemiu)

*“I Dërguari s.a.v.s. u fal me mantel prej leshi që kishte shenja (fije), i shikoi shenjat e tij me një shikim, e kur u largua tha: “Shkoni me këtë gunën time tek Ebu Xhehmi e ma sillni një rrobe të trashë pa shenja (Ebu Xhehmi ishte ai që ia dhuroi të Dërguarit s.a.v.s. këtë gunë me qëllim ta gëzonte), sepse pak më parë më*

*humbi mendjen nga namazi.” Thotë Hisham ibn Urve se Aisha – Allahu qoftë i kënaqur me të – tha: “I Dërguari s.a.v.s. tha: “Isha duke shikuar në shenjën e saj duke u falur, e kam frikë se mos më ngacmoj.” (Buhariu)*

*“Aisha r.a. kishte një pëlhurë të hollë që mbulonte një pjesë të shtëpisë së saj – murin e shtëpisë së saj - , e i Dërguari s.a.v.s. i tha: “Hiqe këtë pëlhurë nga shtëpia jonë, sepse ende po më parafytyrohen fotografitë e saj në namazin tim.” (Buhariu)*

Për fat të keq, në shumë xhami të vendeve tona vërejmë sexhade me plot fije zbukurimi dhe lule të ndryshe që na ngacmojnë në namaz. Doemos të çlirohemi nga çdo ndikim i botës së jashtme kur jemi në namaz, të mos lejojmë që shqisat tona të na çojnë larg Allahut, të mos i lejojmë askujt të na pengojë, qoftë send ose njeri, qoftë edhe që lexon Kur’an pranë nesh e na çrregullon namazin me zërin e tij ose leximin: *“I Dërguari s.a.v.s. ishte në i’tikaf në xhami dhe i dëgjoi disa që lexonin me zë, e hoqi perden dhe tha: “E di se çdonjëri është duke iu lutur Zotit të tij, por mos e shqetësoni njëritjetrin, mos e ngritni zërin ndaj njëritjetrit në lexim, ose tha në namaz.” (Ebu Davudi)*

*“I Dërguari s.a.v.s. i dërgoi letër Othman ibn Talhas dhe i tha: “Unë pashë bririn e dashit kur hyra në shtëpi dhe harrova të të urdhëroj ta heqësh – në transmetim tjetër thuhet: harrova të të urdhëroj t’i fermentosh brirët – sepse nuk është e duhur që në shtëpi të ketë diçka që e preokupon falësin.” (Dhehebiu, Albani thotë se hadithi është sahih, ai bënë të qartë se për shtëpi ka për qëllim Qaben)*

Sa bukur do të ishte sikur njeriu t’i caktonte vetes një kënd të veçantë në shtëpi për faljen e namazit, të jetë si një xhami e vogël, e veçantë për anëtarët e shtëpisë dhe mysafirët, larg burimeve të zhurmës, po edhe larg erërave të gatimit në shtëpi. S’ka dyshim se kalimi në këtë kënd, do t’i duket sikur kalim nga shtëpia në xhami. I Dërguari s.a.v.s. na porosit për këtë kënd të rëndësishëm në shtëpitë tona,

siç na porositë për pastrimin dhe rregullimin e tij: *“I Dërguari s.a.v.s. urdhëroi ndërtimin e xhamive në shtëpi, të pastrohen dhe parfumohen (rregullohen bukur).”* (Tirmidhiu)

*“Evs ibn el-Meafiri i tha Abdullah ibn Amër ibn Asit: “Ç’mendon për atë që merr abdes për bukuri e pastaj falet në shtëpinë e tij?” Ai tha: “Punë e bukur dhe e mirë.” Tha: “Po nëse falet në xhaminë e familjes së tij (farefisit)?” Tha: “Pesëmbëdhjetë namaze!” Tha: “Po nëse shkon në xhaminë kur falet me xhemat?” tha: “Njëzet e pesë”.* (Ibn Haxher el-Askelani)

Koha moderne dëshmon se shtëpitë tona mezi na nxënë neve, e lëre më të veçojmë kënd për falje të namazit?! Shtëpitë tona janë mbushur plot me gjëra që na çorientojnë nga namazi! Mjaftojnë cingërimat e telefonit të na çrregullojnë lidhjen me Allahun dhe këtë vetmi të mrekullueshme me Atë. Cingërima e telefonit të shkëputë nga kjo lidhje e mrekullueshme, sepse fillon të preokupohesh me të menduarit e thellë: a thua kush ishte në telefon? A mos ishte filani? Çfarë dëshiron tani prej meje? Pse në këtë kohë? A thua për çfarë thërret? Cytje djalli që pandërprerë ngacmojnë shpirtin e na largojnë nga namazi... nga Allahu.

Ndodh në namaz të hymë me kokën e mbushur plot gjëra shpërfillëse të kësaj bote të gatshme për të na larguar nga Allahu dhe lutjet e Tij. Është e domosdoshme një përpjekje e vështirë për këtë, përderisa i ngremë duart lart në tekbir (kur themi Allahu ekber) dhe hymë në hapësirën e shenjtë të Allahut. Të mundohemi që nga koka jonë të largojmë çdo gjë nga këto gjëra shpërfillëse, qysh me tekbinin e parë që e marrim: *“Le të më pasojnë (le të jenë pas meje) mua të zgjuarit dhe të maturit nga ju, pastaj ata që pasojnë pas tyre, e pastaj ata që pasojnë pas tyre, e mos u përçani e të përçahen zemrat e juaja, kujdes (ruajuni) nga llomotitjet e pazarit – ajo që ju shqetëson në kujtesë kur jeni në namaz nga çështjet e shitblerjes.”* (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih el-Xhami’)

*“Kush merr abdes sikur ky abdesi im, e pastaj i fal dy rekate e nuk flet në ato asgjë (pra, nuk e preokupon mendjen me gjëra tjera), Allahu do t’ia falë gjynahun e kaluar.”* (Buhariu)

*“Shenjë e mençurisë së njeriut është të merret me punën e tij sa më saktë dhe në mënyrë të përkryer, që kur të hyjë në namaz, mendja (zemra) e tij është e papreokupuar.”* (Buhariu)

Është lehtë t’i kujtojmë gjërat, edhe pse disa herë e kemi të vështirë këtë, por është vështirë t’i harrojmë, prandaj domos të mbizotërojmë kujtesën tonë me qëllim të shkëputjes së saj nga vetvetja jonë kur jemi duke u falur. Është shumë më e vështirë çështja pas fillimit të namazit, sepse përreth nesh mund të ndodhin gjëra joshëse, që para namazit as që na ka shkuar mendja.

Ajo që ndihmon koncentrimin dhe përshtetshmërinë e plotë në namaz është falja e namazeve vullnetare (nafile) në kopshte dhe fusha, larg godinave industriale që i ndërtoi dora e njeriut. Natyra ndihmon zemrën të orientohet me përkushtim dhe sinqeritet të plotë drejt Allahut, Krijuesit të gjithësisë, pa brengë se ndonjë send do të mund ta largoj nga qetësia e cila e ngrit lart drejt qiellit: *“Muadh ibn Xhebeli thotë se i Dërguari s.a.v.s. e pëlqente faljen e namazit në kopshte.”* (Tirmidhiu)

*“Namazi i njeriut në xhemat e rit namazin e tij njëzet e pesë shkallë, e nëse atë e falë në tokë të shkretë (shkretinë), e përsos abdestin, rukunë e sexhden, ai namaz arrin pesëdhjetë shkallë.”* (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih el-Xhami’)

*“Namazin që e fal njeriu aty ku askush nuk e sheh është i barabartë me namazin e tij që e fal para njerëzve njëzet e pesë shkallë.”* (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih el-Xhami’)

Gjatë namazit edhe gjymtyrët e trupit pushojnë nga lëvizja, që asnjëra të mos rrëmbejë fuqinë e tjetrës, fuqi që na duhet për të plotësuar aktin e fluturimit dhe sigurisë së fluturimit të shpirtit larg në lartësitë e qiellit. Të përpiqemi, aq

sa mundemi, të frenojmë lëvizjen e duarve në namaz, nëse nuk ka ndonjë gjendje të jashtëzakonshme që kërkon lëvizjen e tyre. Ka shumë njerëz që në namaz hynë të papërgatitur, kështu që kur bien në sexhde lëvizin me duar duke fshirë guralecët ose lecat nga vendi i sexhdes, pastrojnë sexhadet etj.

*“Kur dikush nga ju bëhet gati për t’u falë, përballë tij qëndron **rahmeti** (mëshira), prandaj mos fshini guralecët e as mos i lëvizni.”* (Begaviu)

*“Mos fshij duke u falur, e nëse është patjetër, atëherë bëje vetëm një herë.”* (Ebu Davudi, Albani thotë se hadithi është sahih)

Në këtë bëjnë pjesë ata që Allahu u ka dhënë flokë të gjata dhe detyrohen që flokët e tyre t’i shtien në dorë çdo herë që bien në sexhde, e sikur t’i zënë ose mbulojnë me diçka, nuk do t’i krijonin vetes këtë kundërshtim rrugor në udhëtimin e tyre drejt qiellit. Njëjtë ndodh edhe me ata që detyrohen që pantallonat e tyre t’i kapin me dorë sa herë që bien në sexhde, sepse i kanë të ngushta. Sikur të vishnin pantallona më të gjera, me siguri se nuk do të kishin nevojë për këto lëvizje që dëmtojnë udhëtimin shpirtëror në namaz, udhëtimin sublim drejt Allahut: *“Jam urdhëruar në sexhde të bie me shtatë gjymtyrë, të mos grumbulloj flokët e as të tkurri rrobat: ballin, hundën, duart, gjunjët dhe këmbët.”* (Muslimi)

Lëvizja e trupit përputhet me lëvizjen e shpirtit; kur njëri pushon, tjetri niset, e kur i pari lëviz, tjetri pushon. Tregohet se Seid ibn Musejebi kishte parë një njeri që po luante me mjekrën e tij në namaz, dhe tha: *“Sikur zemra e këtij të përulej, me siguri se edhe gjymtyrët e tij do të përuleshin (pushonin me pëshpirtshmëri).”* E çfarë të themi për këtë lëvizje të përçmuese dhe të pakujdesshme, është edukatë e ulët me Atë me të cilin flet ai! E çfarë të themi nëse bëjmë lëvizje të pahijshme, ndërkaq që jemi në këtë qëndrim madhështorë dhe para Allahut të Madhërisëm?

Sikur ta kemi para syve tonë dhe në çdo çast të namazit Allahun, me siguri se nuk do t'i lejonim vetes për ndonjë lëvizje të papërshtatshme. A mendon se i takon madhërisë së Allahut që gjatë namazit të hapim gojën? Si do të ishte çështja nëse para teje dikush ta hapte gojën, e ti je kryetar vendi e i flet për gjëra të rëndësishme? Si pranon pra ta bësh këtë me Allahun?

*“Hapja e gojës në namaz është prej djallit, e nëse dikujt i hapet goja, atëherë le ta hesht (ndaloj) atë sa të mundet.”* (Tirmidhiu, Albani thotë se hadithi është sahih)

I Dërguari s.a.v.s. na thërret të jemi të kujdesshëm gjatë faljes së namazit, të mos qëndrojmë para Allahut duke luf-tuar me dremitjen, sepse çfarë respekti do të mund të shfaq-nim para Allahut kur jemi midis gjumit dhe zgjimit dhe nuk dimë se çfarë themi: *“Nëse dikush dremit duke u falë, atë-herë le të shtrihet deri sa t'i kalojë gjumi, sepse ndodh që dikush të falet në gjendje të dremitur dhe nuk di, ndoshta kërkon falje por e shanë veten.”* (Buhariu)

Në fund, mbaj mend se gjatë faljes së namazit do të du-het të dalësh jashtë kufijve të kohës dhe vendit. Përpiqu që vendin ta adaptosh ashtu që t'i përshtatet namazit tënd, e jo e kundërta. Mundohu që orari i ditës tënde t'i përshtatet orarit të namazit, ashtu që koha dhe vendi i namazit të të çlirojnë nga çfarëdo lidhje tjetër kohore, vendore dhe men-dore. Ndiej se je duke notuar në hapësirë (kozmos), nuk ka kohë e as vend... asgjë përveç Allahut..

## Pjesa 5

### Udhëtim i shenjtë

**“Namazi është mi'raxhi i besimtarit.”** (hadith apo fjalë e thënë, transmeton Raziu në tefsirin e tij se është hadithi sherif, 1-266. Nuk kam hasur sened të këtij hadithi)

Pa marrë parasysh se a është hadith apo thënie e transmetuar, kjo në vete ngërthen të vërtetën e udhëtimit tonë drejt Allahut. Po si ta përgatisim veten tonë për këtë udhëtim të jashtëzakonshëm drejt qiellit dhe si të pajisemi me të gjitha gjërat që na ndihmojnë në kalimin e disa fazave të këtij udhëtimit me siguri, kënaqësi dhe sukses?

A ke bërë përgatitje për këtë mi'raxh para se të falesh? A ndien se vërtet je i përgatitur për të? A je vërtetuar se i ke plotësuar të gjitha kushtet për këtë udhëtim qiellor: pastërtinë, formën e trupit, erën e bukur të parfumit, kushte që të shoqërojnë në rrugë për ta takuar dhe për të biseduar me Allahun? A i ke marrë rrobat e bukura? A mendon se roja e kryetarit tënd, që në këtë botë është shumë i vogël, do të lejon të hysh tek ai i parregulluar dhe i pakrehur? E si pra do të jetë çështja kur ti bëhesh gati për të hyrë tek Sundimtari absolut, Zoti i botëve?

Pse, a për këtë shkak gruaja është e detyruar ta vë shaminë mbi kokë kur falet? Po, mbulesa është pjesë esenciale e trupit të gruas, formës së saj dhe elegancës së saj, bile femërisë së saj. Mbulesa e saj nënkupton turpin, e turpi nënkupton butësinë, dhembshurinë dhe femërinë, nënkupton shkallën më të lartë të bukurisë, elegancës dhe mirëpritjen e femrës e cila refuzon të shndërrohet në burrë.

Fillimi i namazit të kujton atë se tani ka filluar shëtitja jote në kopsht të gjerë plot fruta, plot thesare e xhevahire, dhuratë e çmuar për ty, andaj mos harro t'i këpusësh sa të mundesh, para se të përfundojë rruga e të mbetesh duarthatë...

Para teje është **xhevahiri Allahu ekber (Allahu është më i madh)**, mos e kalo derisa nuk e kapë me dorën e mendjes tënde, e ta analizosh kuptimin e tij me imagjinatën tënde, të shijosh ëmbëlsinë e tij dhe ngrohtësinë e tij në shpirt.

Pastaj, menjëherë vijon xhevahiri i lutjes dhe mirënjohjes, e pastaj xhevahiri i xhevahireve, më i shtrenjti: **Fatihaja**, xhevahiri i leximit, xhevahiri i tekbitit të dytë, e kështu me radhë, xhevahiret e tesbihut, tahmidit, tekbitit (**subhane rabbijje'l-a'la – semi'Allahu limen hamideh – rabbena leke'l-hamdu – Allahu ekber – subhane rabbijje'l-a'la – Allahu ekber**).

Orientimi drejt Kibles dhe ngritja e duarve gjatë tekbitit ihram na kujton faktin se kemi hyrë në “haremin – hapësirën e shenjtë” të Allahut; tekbiti fillestar është vetëm se lajmërim për ne se kemi kaluar nga dynjaja në ahiret, në botën engjëlllore (të krijesave të Allahut), botë kjo e veçantë dhe e rrethuar me mure të shenjta dhe shpirtërore (**kudsijje dhe ruhijje**), plot dritë që na mbrojnë shikimin në namaz, të mos bëhemi siç kemi qenë jashtë namazit. Ne tani jemi në hapësirën e shenjtë të Allahut, në ujërat e Tij territoriale, e Allahu është më i Madh dhe më i Lartë, doemos t’u përmbahemi ligjeve dhe rregullave të posaçme të hyrjes dhe notit në këto ujëra, nga fillimi i hyrjes e deri në çastin e daljes nga uji, kur japim selam.

Tekbiti fillestar ka rëndësi shumë të madhe dhe të veçantë, është pika kufitare ku bëhet kontrolli i udhëtarit dhe vërtetimi se me vete bart pasaportë ligjore me afat kohor që i mundëson hyrjen në mbretërinë Hyjnore, se udhëtari ka plotësuar zbrazëtitrat e duhura në fletëparaqitjen për hyrje:

- A je i pastër në trup?
- Po.
- A je me abdest?
- Po.
- A i ke rrobat e pastra?
- Po.
- A e ke zemrën e pastër?
- Po.

- A i ke marrë stolitë dhe zbukurimet e përshtatshme që përputhen me qëndrimin para Allahut?

- Po.

- A e ke kuptuar se ngritja e duarve dhe orientimi drejt Kibles nënkupton se ti ke lënë pas gjithçka që të preokupon dhe intereson nga gjërat e dynjasë? Se tani je orientuar vetëm drejt Allahut? A e di se lëvizja e duarve për tekbinin fillestar i shëmbëllen timonit që drejton anijen tënde kozmike që udhëton drejt Allahut?

- Po.

- A ndien se vërtet je duke i thënë lamtumirë dynjasë tani? Se je nisur për botën e ahiretit?

- Po.

- A je i sigurt se Ai që është para teje tani është “më i Madh” dhe çdo “kush” që e ke lënë pas teje?

- Po.

Hapet pra dera e parë e hyrjes...

Procedurat vazhdojnë të kalojnë nga një nivel në tjetrin, më të lartë dhe më të rëndësishëm. Tani je i kthyer kah Kibla, është shenjë e qartë që shënon njetin e vërtetë për këtë vizitë të jashtëzakonshme, për vendosmërinë për fluturim në drejtim të duhur. Tani i ke ngritur duart drejt qiellit, balli yt është në drejtim të Bejtu-l-haramit (Qabes), ke hyrë në çastin e shkëputjes nga bota e parë dhe kalimin në botën e re, Qabeja është simbol i të Zotit të shtëpisë, Allahut të Madhërishëm. Ngritja e duarve mbi kokë të kujton heqjen dorë nga dynjaja dhe gjithçka që ke lënë pas, se duart i ke vënë në kapistër që të mundëson nisjen dhe ngritjen lartë, drejt pikës së ardhshme.

Tani je në vijën e ngritjes drejt hapësirës hyjnore, tani bëhesh gati për të depërtuar në shtresat e një pas njëshme, do të ketë kalim të kores hapësinore që rrethon tokën, toka e cila me fushën e saj magnetike të tërheq vazhdimisht tek ajo! S’ka dyshim se një gjë e tillë është shumë e vështirë, por

edhe e rëndësishme, dalja nga fusha magnetike e tokës, kalimi në hapësirë, i lirë. Po ç'të bëjë? Lexo Fatihanë, thuaj subhanallah, Allahu ekber, elhamdulillah, kërko ndihmë prej Allahut, se janë gjëra që të ndihmojnë të fluturosh deri sa të arrish të hapen dyert e shenjta...

Tani bëhesh gati për të hyrë në shtresën e dytë, të tretë, të katërt, e të pestë të qiellit; lexo ndonjë sure të Kuranit apo disa ajete të tij, se janë lëndë e fuqishme që të jep hov të madh të ngjitesh drejt shtresave që kanë mbetur para teje...

Pastaj vijon **tekbiri i rukusë** (të thënë **Allahu ekber** në përkulje), vijojnë menjëherë **tesbihët** (*subhane rabije-l-adhim*), forma e trupit është e përkulur 90% shkallë, formë që shfaq nënshtrimin e plotë për Atë që bëhemi gati ta përshëndesim; pastaj vijon **tesmiu** (*semiallahu limen hamideh* – Allahu e dëgjoi atë që e falënderoi), **tahmidi (rabbena leke-l-hamdu** – O Zoti ynë, Ty të takon falënderimi), **tekbiri**, e pas kësaj sexhdeja që të mundëson nënshtrimin më të madh të mundshëm, të arrish në lartësitë më të larta të mundshme, sa më afër Allahut të jesh.

Hapat e tilla përsëriten edhe në rekatën e dytë, njëjtë sikur në të parin, për të fituar mbushje ose energji të dyfishtë që na ndihmon të depërtojmë në shkallët e hapësirave të mbetura, që edhe më tej na ndajnë nga kozmosi i madh Hyjnor. Jo shumë larg do të ndodhë përshëndetja e Zotit të botëve, Sunduesit absolut, Zotit të të gjitha qenieve, që i shohim e që nuk i shohim.

Sexhdeja e fundit e rekatit të dytë dhe pushimi për një kohë të shkurtë ulur, na jep shenjë se jemi afër pragut të portës Hyjnore, se dyert e sallës së madhe Hyjnore kanë filluar të hapen, është sallë pa mbarim, pa kulm, pa mure që kufizojnë hapësirën e tij, e Allahu është më i lartë dhe më i madh...

Vetëm këtu, pas gjitha atyre hapave që i ke bërë, transformimeve shpirtërore dhe psikologjike që ke hyrë, do të të

lejohet hyrja te Zoti absolut, fuqia absolute, sundimtarit absolut, mëshirës absolute, që më në fund, me kënaqësi, qetësi dhe siguri të pafund t'i thuash: **“Ettehijjatu leke ja Allah – për Ty është përshëndetja, o Allah – ettehijjatu lilahi).**

Falësi i namazit tani ka hyrë në botë të re e të gjerë, krejt ndryshe nga bota e dynjasë që para pak çastesh e la pas vete dhe u përshëndet me të.

Sikur ju dëgjoj që më vete thoni: “Ç’është kjo shprehje?! Të heq dorë nga bota e dynjasë së tij?! A thua është kjo vdekje?! Po, është lloj i vdekjes me dëshirë. Falësi i namazit i shëmbëllen të vdekurit: dëgjon, por nuk flet, nuk ia kthen fjalën atij që i flet, sepse ai flet vetëm me Allahun, e me asnjë tjetër. Natyra e namazit nënkupton udhëtimin sikur atij të vdekjes, por është udhëtim që vetë e zgjedhim dhe është i këndshëm, udhëtim me anije të veçantë kozmike me të cilin hymë në mbretërinë e mrekullueshme Hyjnore, ku kënaqemi me fshehtësitë e tij, vjelim nga frutat e tij, marrim nga thesaret e tij të papara, që pastaj të kthehemi në botën tonë tokësore duke bartë me vete aromën e atyre thesareve, miskun e këndshëm dhe kënaqësitë e shpirtit.

Namzi është sikur haxhi: udhëtim drejt Allahut, stërvitje, manovër e shkurtër praktike për takim me Allahun. Takimi me Allahun në namaz nuk ndryshon shumë nga takimi i Tij në haxh, apo ndoshta nga takimi i Tij në vdekje. Takimi i shkurtër i namazit dhe vazhdimisht i përsëritur, krijon raporte të përhershme midis neve dhe Allahut, raporte që na japin mundësinë e përhershme e vetë-llogarisë dhe përmirësimit, kërkimit të faljes dhe arsyes, kërkimit të gjërave të kësaj bote dhe të botës tjetër, ndërkaq që takimi pas vdekjes nuk na e mundëson këtë përmirësim dhe vetë-llogari, vetëm nëse do Allahu. Ky edhe është dallimi midis takimit të Tij në namaz dhe takimit të Tij pas vdekjes.

*“Kjo është një ditë, kur ata nuk do të mund të flasin dhe nuk do t’u jepet leje për t’u shfajësuar.”* (El-Murselat, 35-36)

Ti e di se Allahu është **“Gafur – Falës i madh”**, andaj zhytu thellë në namaz, në detin e rahmetit dhe magfiritit të Tij, e di se është **“Vedud – i Dashur”**, emri më i bukur i Allahut, më i ngrohtë dhe më i afërt në zemrat tona, pra shfrytëzo rastin që në namazin tënd të jesh i lidhur me këtë të Dashur, të fitosh dashurinë e Tij dhe mirësinë, është **“Kerim – Bujari i madh”**, dije pra se ke hyrë tek Ai që është më bujar se çdokush tjetër, i gatshëm të të dëgjojë dhe t’i përgjigjet lutjeve tua, të pranon shfajësimet dhe t’i plotësoj nevojat që i ke.

Paramendo tani dallimin midis hyrjes tënde te njeriu që më parë kurrë nuk e ke përshëndetur e as që ke folur me të dhe Atij me të cilin pesë herë në ditë flet dhe e përshëndet, çdo ditë me dashuri, respekt, shfajësim... cili raport do të duhej të jetë më i këndshëm, më i ngrohtë dhe më i vazhdueshëm e më besnik, më shpresëdhënës dhe më i sigurt në përgjigje?

Namazi është haxh me dimension të shkurtër, ai ngërthen takimin me Allahun dhe përshëndetjen e Tij (**ettehijjatu li’l-lah**); kërkimin e zbritjes së mëshirës së Tij (**esse-lamu alejna**), pohimin e teuhidit dhe imanit për Allahun, si Zoti i yni dhe pohim për Muhamedin si i dërguari i Tij (**eshehdu en la ilahe ilallahu ve eshedu enne Muhameden abduhu ve resuluhu**)... ai gjithashtu është pezullim i dynjasë, mirëpritje dhe kënaqësi me takimin e ahiretit. I Dërguari ynë s.a.v.s., deshi të na kujtojë këtë të vërtetë atëherë kur na ndihmoi ta ndërtojmë anijen kozmike, ai s.a.v.s. i tha tri fjalë të shkurtra, por kuptimplote: **“Fal – namaz – lamtumirës”**.

*“Erdhi një njeri tek i Dërguari s.a.v.s. dhe tha: “O i Dërguari i Allahut, më mëso dhe le të jetë shkurt: “Ai tha: “Kur të falesh, fale namazin në mënyrë lamtumirës, mos fol fjalë që pastaj të pendohesh*

– pse i thashë -, dhe hiqe shpresën nga atë që e kanë në duar njerëzit (mos lakmo).” (Ibn Maxhe, Albani thotë se hadithi është sahih)

Ky hadith hapë para nesh dyert e perceptimit, ilustrimit dhe imagjinatës në namaz: imagjinoni sikur thoni lamtumirë dhe ndaheni përgjithmonë... a nuk nënkupton ky perceptim se ne duhet t’i përdorim të gjitha forcat tona mendore për të sjellë para nesh dhe për t’i jetuar të gjitha dimensionet e asaj që e themi në namaz?! Ky hadith konfirmon se namazi është lloj i vdekjes ku takohemi me Allahun, vdekje që nuk mbaron, që na stërvitë për ballafaqim me vdekjen e përhershme. A do të kishim pritur nga ai që e ndajnë pak çaste nga vdekja ta kishte pyetur familjen e tij për gjëra të pavlera të kësaj bote që mund t’i vijnë ndërmend, ndërkaq që është duke i jetuar çastet e fundit të mbetura nga jeta e tij?! P.sh.: a thua kush do të fitojë këtë ndeshje futbollistike? A thua do të bie çmimi i sheqerit shpejt? Sa janë çmimet e shtëpive tani?

I Dërguari s.a.v.s. na mëson për afrimin e kohës së namazit, se ai i përkushtohet namazit në tërësi dhe ndahej nga çdo gjë që përreth dhe nuk komunikonte fare me anëtarët e familjes: “Aisha r.a. tregon se i Dërguari s.a.v.s. fliste me ne dhe ne flisnim me të, por kur vinte namazi, ai largohej sikur nuk na njihite e as nuk e njihnim.” (Es-Subkiu në Tabekat esh-Shafiijetu el-kubra)

Po, namazi është udhëtim lamtumirës i jetës së Tokës, bashkëngjijtje me karvanin e qiellit në anijen e veçantë të shenjët që emrin e ka “**namaz**”.

“Kujtoje vdekjen në namaz, se kur njeriu e kujton vdekjen në namaz, kjo e shtynë ta bëj atë më bukur, dhe falu sikur njeriu që falet i bindur se nuk ka për të falë namaz tjetër pas këtij namazi...” Albani thotë se hadithi është hasen)

“Fale namazin lamtumirës, sikur je duke e parë, se nëse ti nuk e sheh, Ai ty të sheh.” (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih el-Xhami’ es-sagir)

## TRIBUNA E TRETË

### PANEL I APARATURAVE DHE I FLUTURIMIT

#### Pjesa 1

#### Çelësat dhe kopsat

Kushtet për fluturim janë plotësuar, gjithashtu leja për hyrje në aeroport, i hipur je në avionin tënd të posaçme, ke zënë ulësen e pilotimit, je në cilësi të pilotit të parë e të fundit në këtë avion, bile udhëtari i vetëm në të. Prandaj, përgjegjësia bie vetëm mbi ty, vetëm ti je ai që kap timonin e pilotimit dhe di të veprosh bindshëm me kopsat dhe çelësat e tij, vetëm ti mund të zhytësh e notosh në mbretëritë e hapësirës Hyjnore, rolin tënd do ta kryesh me besnikëri, kënaqësi dhe sukses. Arritja jote do të realizohet me arritjen në stacionin përfundimtar hapësinor, te Krijuesi i Madhërishëm, e pastaj kthimi me thesaret e mëdha që Ai i përgatiti në fund për ty për këtë udhëtim: “...një hap që e bën i llogaritet shpërblim, kurse një hap tjetër që e ul i shlyhet një e keqe, kështu deri sa të kthehet.” (Albani thotë se hadithi është sahih)

Është me rëndësi të dimë se çdo kopsë e kopsave që i kemi përpara kanë rol të veçantë, ato janë shumë dhe llojlloj, rëndësia e çdonjëres prej tyre duket në drejtimin e anijes dhe lëvizjes së saj.

Aty ka kopsa kryesore dhe të tjera anësore, vëmendje të posaçme meritojnë çelësat kryesor, sepse ato janë lëvizësi kryesor dhe më të rëndësishmit për procesin e nisjes drejt lartësive dhe arritjes në fazën e takimit dhe përshëndetjes me Allahun e Lartëmadhëruar.

Mbaj mend gjithmonë se çdo pjesë e Tokës ku jetojmë, pa marrë parasysh se ku është vendi yt, edhe nëse është në veturë, aeroplan, vapor ose nëndetëse, qoftë edhe në shtratin tënd nëse je i sëmurë, të gjitha mund të jenë aeroport i udhëtimit tënd.

Kujto gjithashtu se në gjoksin e çdonjërit nga ne është një aeroplan që gjithmonë rri i përgatitur për këtë udhëtim, është në zemrën tonë, nuk ka nevojë për pasaportë, rezervim, biletë, pritje të gjatë të aeroplanit, zbritje të udhëtarëve që kanë ardhur, përgatitje të aeroplanit që të pranon udhëtarë të ri etj.

Megjithatë, ekzistojnë aeroporte shumë të posaçme për këso udhëtimesh, të përgatitura me pajisje më të mira, me mjetet më komfore, lëndë djegëse të llojit të parë, shenja rrugore që të ndihmojnë fluturim të suksesshëm, udhëtim në destinacion shumë të largët, më të sigurt dhe më të suksesshëm. Allahu i Madhërishëm e përgatiti këtë në mënyrë të posaçme, për ata që duan ta vizitojnë Atë, i quajti "Shtëpia të Tij": "*..dhe pastroje Shtëpinë Time (nga idhujtaria), për ata që vijnë rrotull saj dhe për ata që rrinë në këmbë, përkulen dhe bien në sexhde duke u falur.*" (El-Haxh, 26)

"Në shtëpitë (xhamitë), që Allahu ka urdhëruar të ngrihen e të përmendet aty emri i Tij..." (En-Nur, 36)

O Allah! Çfarë udhëtimi historik do të jetë ky? Sikur nisem nga shtëpia e Allahut drejt shtëpisë së Allahut! Nga shtëpia e tij në Tokë drejt shtëpisë së Tij në qiell! Nisem i bartur nga një dorë bujare dhe e mëshirshme që më pret në xhami, që të më merr një dorë bujare dhe e mëshirshme që më pret në qiell!

## Pjesa 2

### Çelësi i kuq numër 1

#### **Allahu ekber**

**Tekbiri ihram** (tekbiri fillestar): është lëvizje mendore që e regjistron gjuha kur shqipton fjalën (**Allahu ekber**), në çastin kur ndahemi nga jeta jonë e zakonshme për të hyrë në botën e çuditshme që quhet “**Es-salat**” (namaz). Tekbirin fillestar e shoqëron një lëvizje e rëndësishme dhe esenciale fizike; është ngritja e duarve në kokë, që ta ndihmoj lëvizjen mendore për nisje dhe fluturim drejt botës së re.

Shprehja **Allahu ekber** ngërthen një veçori që është mbi të gjitha veçoritë; ajo nënkupton hyrjen në hapësirën kohore “të ndaluar” (nuharrem-ihram), njëjtë siç hynë haxhiu në ihram në fillim të haxhit. Me **ihram** (tekbiri ihram) ne hymë në një botë tjetër, ndryshe nga ajo e jona, aty ka rregulla tjera të lëvizjes, të menduarit, mjedis tjetër, pasion tjetër, ushqim tjetër. Hyrja e tillë na bënë të ndjemi se jemi në botën e shpirtit, larg botës së materies dhe trupit.

Tekbiri fillestar është dera jote më e madhe për të hyrë në avionin magjepsës kozmik. Ki kujdes të mos e shqiptosh atë siç e shqiptojnë shumë njerëz. Kujdes nga spontaniteti dhe përsëritja e lodhshme, ajo që mbyl ndjenjat e brendshme të vërteta e që mbyl edhe esencën e kësaj shprehje. Kujto se kjo shprehje nuk është fjali e thjeshtë që e njohim, ajo nuk është “**Allahu kebir**” (Allahu është i madh), e as “**Allahu huve el-ekber**” (Allahu është Ai që është më i madh), por “**Allahu ekber**” (Allahu është më i madhi)...

Duhet të pranojmë se shumica e njerëzve e shqiptojnë këtë shprehje thelbësore në Islam, duke paramenduar se kuptimi i saj nuk është më tepër se “Allahu është i madh” apo “Allahu është Ai që është më i madh”! Doemos të

mbajmë mend se shqiptimi i kësaj shprehjeje duhet të jetë me ndjenja të ngrohta, sikur e themi për herë të parë në jetë.

Lexoje pra me mua përsëri, sikur e dëgjon për herë të parë:

**Allahu ekber..**

A nuk ndien tani, pas leximit të ri dhe pasi u zhveshe nga zakonshmëria e rëndomtë, se nuk ishte shprehje e rëndomtë, se në gjuhën tonë po edhe në gjuhë tjera siç e di, nuk ka shprehje që i shëmbëllen kësaj shprehje në formimin e saj gjuhësor?

Nëse dikush thotë: “armiku më i dobët”, e pastaj hesht, çfarë do të jenë parashikimet e tua? Do të thuash më vete: “pse nuk e përfundon fjalinë?” Ose do të thuash: “me siguri nuk flet se ju kujtua diçka” -, apo ndoshta dëshiron ta ndryshojë fjalinë për ndonjë arsye?! Mos vallë i ka ndodhur ndonjë pengesë në gjuhë që nuk e lë të flet e ta plotësojë fjalinë, apo ai dëshiron që unë ta plotësojë fjalinë?! Këto shpjegime të bëjnë t’i kuptosh parashikimet e tua që i pret nga fjalia në fjalë, por edhe nga çdo fjali tjetër e thjeshtë. Kjo fjali do të kishte këtë formë të kuptimit:

- Armiku është shumë i dobët, nuk mund të na fitojë,
- Armiku është i dobët, nuk mund të na sulmojë,
- Armiku është shumë më i dobët seç mendojmë ne,
- Armiku është armiku më i dobët me të cilin jemi ballafaquar ndonjëherë...

Shprehja e çuditshme islame **Allahu ekber** nënkupton fjali të hapur, pas së cilës qëndron gjithçka që na bie ndër-mend, atë që mendja jonë nuk e paramendon ndonjëherë. Ajo nuk është shprehje e mbyllur, që mbyll paramendimet tona që mund t’i imagjinojmë. Sikur na pyet: “Më i madh se çka?!”

Shprehja **Allahu ekber** është bërë e hapur për mundësi të panumërta që pasojnë, mundësi të pasura që zgjerojnë hapësirën para atij që e thotë, ato janë dhjetëra, qindra, e ndoshta edhe mijëra mundësi:

Allahu ekber (Allahu është më i Madh) – se çdo gjë...

Allahu ekber (Allahu është më i Madh) – se ti, o djall..

Allahu ekber (Allahu është më i Madh) – se çdo brengë që e kam..

Allahu ekber (Allahu është më i Madh) – se fqinji im që më shqetëson...

Allahu ekber (Allahu është më i Madh) – se pasuria që e kam humbur...

Allahu ekber (Allahu është më i Madh) – se çdo gjë që mund të më pengon ose largon nga biseda me Atë..

Allahu ekber (Allahu është më i Madh) – se problemi me të cilin ballafaqohem... se programi ose seriali që do të filloj... se filmi që i kam premtuar shokëve se do ta shohim së bashku... se ndeshja futbolistike që gati sa nuk ka mbaruar nëse nuk e shpejtoj namazin... se orari i takimeve të mia që me këmbëngulje më thonë që sa më shpejtë ta përfundojë namazin... se... se... se...!

Kujtoj se përkthimet e kësaj shprehjeje në gjuhët e ndryshme të botës kanë ndikuar që ajo të merr kuptim të rëndomtë e të thjeshtë (në anglisht përkthehet (great), disa herë (greatest), por përkthimi i vërtetë është (greater).

Dëgjo myezinët e xhamive tona dhe ata që thërrasin ikametin, me siguri do të vëresh se si bashkojnë dy tekbirot, sikur të jenë një tekbr (Allahu ekber Allahu ekber!), me këtë ata humbin karakterin e tekbitit të parë, ndërkaq që dëgjuesi doemos duhet t'i paramendoj tri pika ndarëse pas tekbitit të parë (Allahu ekber...!).

Kjo përzierje midis dy tekbirove shënon të vërtetën që e kemi humbur, atë që zakonshmëria dhe spontaniteti e kanë mbytë, një ndjenjë e shenjtë dhe e dalluar për këtë shprehje islame e kemi bërë shprehje të zakonshme e të thjeshtë, pa ndonjë element parësor që e dallon nga shprehjet tjera.

Vallë, a do të mund ta paramendojmë goditjen e kësaj shprehje në veshët e atyre që e dëgjuan për herë të parë? Në vitet e para të Islamit? Përpiquni të jeni në rrobat e tyre, në rrobat e arabit të parë që e dëgjoji këtë shprehje, ta dëgjoni me veshët e tu sikur që e dëgjoni për herë të parë nga Bilali; a thua do të mund ta paramendoni goditjen gjuhësore që e ndjeu ai arab, duke e dëgjuar atë shprehje të re me veshët e tij? Do të ndalje në vend, nëse ka qenë duke ecur, do të ngrihej në këmbë, nëse ka qenë i ulur dhe do të ngrihej në këmbë, nëse ka qenë i shtrirë përtokë!

Përpiquni ta paramendoni veten tuaj midis banorëve të Medines kur dëgjuan për herë të parë ezanin, si ishin ndjenjat e tyre, çfarë ndjenë kur u befasuan me këtë shprehje, me këtë kombinim gjuhësor të ri të paplotë:

**Allahu ekber... Allahu ekber... Allahu ekber... Allahu ekber...**

Allahu është më i madh, shprehje që nuk po e ngopte etjen e tyre që e paramendonin në imagjinatë, sepse ishin mësuar me shprehje të rëndomta, kurse kjo shprehje e re sikur i bënte më të etur...

Supozoni që në vend të fjalës “më i madh” të propozojmë fjalën “më i rëndësishmi”! Vallë si do ta dëgjonim atë? A do ta dëgjonim me veshët e njëjtë që janë mësuar ta dëgjojnë Allahu ekber? Të provojmë pra: Allahu është më i rëndësishmi, Allahu është më i rëndësishmi, Allahu është më i rëndësishmi, Allahu është më i rëndësishmi (**Allahu ekber dhe Allahu ehemm**)!

(Lexuesi shqiptar ndoshta nuk e vëren këtë dallim gjuhësor, sepse është veçori e gjuhës arabe, por emaneti shkençor nuk më la që së paku ta përkthej këtë pjesë të librit me disa shkurtime përmbajtjesore. Shënim i përkthyesit)

Që sa më mirë t’i kuptojmë ndjenjat e banorëve të Medines dhe etjen e tyre për këtë fjalë të bukur e magjike, do ta

paraqesim rrëfimin për Bilalin r.a., ai që nuk mundi ta duronte ndarjen me të Dërguarin e Allahut s.a.v.s, dhe për këtë shkak u largua nga Medina e shkoi në Siri. Bilali r.a. tregon: “Nuk duroja dot të rrija në Medinë pas vdekjes së Pejgamberit s.a.v.s.! Bilali qante me zë dhe rënkonte kur shqiptonte shprehjen **“eshhedu enne Muhammeden resulull-llah”**. Ai u nis bashkë me luftëtarët për në Siri. Pas disa vjetëve, Bilali pa në ëndërr të Dërguarin s.a.v.s. që po i thoshte: “Ç’është ky hidhërim, o Bilal? A nuk erdhi koha të na vizitosh?” U ngrit i mërzhitur nga gjumi. U nise për në Medinë. Shkoi te varri i të Dërguarit s.a.v.s. dhe filloi të qajë e të përgjarget. Ia mbërrin Hasani dhe Husejni, ai filloi t’i puthte e t’i përqaftonte, ndërsa ata i thanë: “duam ta thërrasësh ezanin në mëngjes. Ai u ngrit mbi çatinë e xhamisë dhe kur tha: “Allahu ekber... Allahu ekber”, Medineja u dridh, e kur tha: “eshhedu en la ilahe il-lallah”, filloi të dridhet edhe më shumë, e kur tha “eshhedu enne Muhammeden resulull-llah”, gratë dolën nga dhomat e tyre; atë ditë nuk kishin parë njerëz në atë numër që qanin, gra e burra.” Kur Omeri r.a. e vizitoi Sirinë, muslimanët iu lutën që ta urdhëronte Bilalin ta thërriste ezanin për namaz (vetëm një namaz). Omeri r.a. e thirri Bilalin dhe e luti që ta thërriste ezanin. Bilali i ngrit dhe filloi ta thërriste ezanin... sahabet të cilët jetuan me të Dërguarin s.a.v.s. filluan të qajnë, qanë sikur asnjëherë më parë, e Omeri qante më së shumti...” (Ekzistojnë transmetime të ndryshme të Ebu Derdasë, më i njohuri është i Dhehebiut në Sijer a’lam en-Nubela dhe i Muhamed ibn Abdu-l-Hadi në Sarim el-Menki, të gjithë e konsiderojnë rrëfim të dobët, **daif**).

Nuk na shqetëson ajo që ky transmetim llogaritet i dobët, nuk është rasti që na intereson, por jehona psikologjike është ajo që na intereson në këtë ngjarje, ajo që na bënë të paramendojmë sikur jemi në mesin e banorëve të Medines

në atë kohë, e dëgjojmë për herë të parë ezanin me zërin e Bilalit, e pranojmë siç e pranuan ata dhe zbulojmë disa nga shprehjet e tij, siç i kuptuan ata.

Pse të shkojmë aq larg? Të dëgjojmë një tregim të ri bashkëkohor i një të riu evropian i udhëzuar në Islam, që na përshkruan reagimet e tij kur dëgjoji fjalën **Allahu ekber**. Vallë çfarë ndodhi në shpirtin e tij kur për herë të parë dëgjoji ezanin në një nga xhamitë e Kajros?

“Isha i ri, sapo kisha mbushur të njëzetat. Do ta vizitoja Kajron. Edhe përkundër asaj se evropianët i joshin piramidat, bukuritë dhe muzetë, ajo që më së shumti më magjepsi mua ishte vizita e në xhamie historike. Ishte koha e ikindisë, qëndrova para derës së xhamisë dhe po shikoja pamjen që për juve është e zakonshme. I pashë njerëzit që dilnin nga xhamia, më magjepsi pamja e fytyrave të tyre të bukura, të buta e elegante, sikur i mbulonte imani, shpërndanin dritë e shkëlqim, rehati shpirtërore. Ishin fytyra ndryshe nga ato që i kam parë çdoherë dhe që i di në jetën time. I shikoja që buzëqeshnin me butësi, bukuri, nuk e kisha parë më parë një gjë të tillë. Nuk durova dhe u afrova pranë njerit dhe e pyeta në gjuhën angleze, por ai nuk dinte të më përgjigjej, sepse nuk më kuptonte, por përfundimisht në sytë e mi shkrepri një dashuri, sikur pa se vërtet më intereson shumë ajo që dua ta di, i shikoi të gjithë njerëzit derisa e pa njërin që fliste anglisht dhe e thirri. I thashë: “Dua të bëj siç bëni ju, dua të falem!” Njeriu buzëqeshi dhe kërkoi nga unë që pas dy ore të isha në xhami për namaz të akshamit, më tregoi për kohët e namazeve që falen me xhemat. Vendosa të prisja, njeriu i thjeshtë e i varfër më ofroi të pimë nga një gotë çaj egjiptase të rëndë, me anglishten e tij të thyer u mundua të më shpjegonte diçka për namazin. Unë po e pyesja, e ai më përgjigjej me zemërgjerësi, derisa erdhi koha kur thirri ezani i akshamit nga kubeja e zbukuruar e

Kajros. Ndjeva që ezani filloi të depërtonte në brendinë time, të depërtonte në nervin tim dhe gjakun tim... nuk i kuptoja fjalët e tij... por ndjeva se është thirrje e veçantë që po më vjen mbi mjegullat e larta dhe pas yjeve...!

Thoni **Allahu ekber** në namaz sikur vjen nga lart, përtej yjeve, ose sikur e dëgjoni nga vetë Bilali r.a. për herë të parë, sikur jeni banorë të Medinës që jetuan me të Dërguarin s.a.v.s.... vetëm kështu do të dëgjoni **Allahu ekber** me veshë të ri, nga një kënd i ndryshëm, e të kuptoni domethënien e tij.

**Allahu ekber** është kopsa e parë e kuqe midis kopsave të tjera, është fillimi i namazit, kopsa që është gati të vihet në punë, ndërkaq që ti je hipur në anijen kozmike të namazit për t'u ngjitur në lartësitë e qiellit: "*Çdo gjë ka bërthamë (elitë, përzgjedhje më e mirë), kurse bërthama e namazit është tek-biri i parë.*" (Sujuti në Xhami' es-Sagir)

Tekbiri fillestar i shëmbëllen vënies në veprim të motorit të avionit, prandaj është shtyllë esenciale e fillimit të namazit, ai nuk vërehet në fund të namazit. Është kopsa e ndezjes që nënkupton veprimin dhe punën, lëvizjen e avionit drejt qiellit. Djalli përpiqet të të hutojë dhe pengojë mendjen tënde në namaz, duke t'i kujtuar gjërat që kurrë më parë nuk i ke zënë ndërmend. Prandaj përsëri vjen shprehja **Allahu ekber**, që zë vendin e ziles që paralajmëron hyrjen e të huajve në linjë midis teje dhe Allahut. Kështu avioni ynë gjithmonë dhe gjithherë është në drejtim të saktë, drejt Allahut.

Është e vërtetë se kjo shprehje e çuditshme, e rëndësishme dhe esenciale në Islam nuk është shprehje kuranore, por Kur'ani fisnik në shumë vende dhe në shumë raste e thekson atë, edhe pse jo me tekst: "*...dhe madhëroje Atë...*" (El-Isra', 111)

"...që ju ta madhëroni Allahun..." (El-Haxh, 37)

"Zotin tënd madhëroje." (El-Muddeththir, 3)

Përpiqu sa të mundesh që shprehjen **Allahu ekber** ta thuash sikur e thua për herë të parë në jetë. Shprehja **Allahu ekber** në namazin tonë kalon me nderimet më të larta, ai nuk guxon të jetë thënie e rëndomtë dhe e thjeshtë, e me këtë të humbim kënaqësinë me kuptimin e tij të vërtetë, të humbim fuqitë e mëdha shpirtërore të pafund që na bartin në përfaqimin e tyre.

### Pjesa 3

#### Çelësa të tjerë në panelin e pilotimit

Avioni kozmik është vënë në lëvizje, udhëtimi i veçantë eksplorues drejt qiellit ka filluar, së pari ndezim motorin e lutjes fillestare (*duaaja iftitahije*), mos e preokupo mendjen me natyrën e kësaj lutjeje, para teje ka shumë zgjedhje të lutjeve, disa të shkurtra e disa të gjata, të gjitha të konfirmuara nga i Dërguari s.a.v.s., edhe pse disa drejtime juridike u përmbahen në veçanti disa lutjeve (Albani në librin e tij “Mënyra e të falurit të Pejgamberit s.a.v.s.” përmend jo më pak se 12 lutje. Botim i dytë i ekzemplarit të bibliotekës El-Mearif. Rijad, 1996, fq: 91-95. Albani thotë: I Dërguari s.a.v. s. një herë e lexonte këtë, e ndonjëherë tjetër e lexonte këtë”):

- *“Nuk pranohet namazi i dikujt prej njerëzve derisa të thotë Allahu ekber, ta falënderoj Allahun e Madhërishëm dhe të shpreh mirënjohje ndaj Tij, e të lexoj atë që e di nga Kur’ani.”* (Ebu Davudi, Albani thotë se hadithi është sahih)

- *“Kur i Dërguari s.a.v.s. e fillonte namazin, thoshte: “Subhaneke Allahumme ve bi hamdike, ve tebareke ‘smuke, ve teala xhedduke, ve la ilahe gajruke.”* (Tirmidhiu, Albani thotë se hadithi është sahih)

- *Kur i Dërguari s.a.v.s. e fillonte namazin, bënte tekbir dhe thoshte: “Vexhehtu vexhije li’l-ledhi fetare’s-semavati ve’l-erdi hanifen ve ma ene mine’l-mushrikin. Inne salati ve nusuki ve mahjaje ve memati li’l-lahi rabbi’l-alemin, la sherike lehu, ve bidhalike umirtu ve ene mine’l-muslimin. Allahumme ente’l-melik, la ilahe il-la ente,*

*ene abduke, dhalemto nefsi ve a'tereftu bi dhenbi, fagfir li dhunibi xhemian, la jagfiru dhunube il-la ente, vehdini li ahseni'l-ahlak, la jehdi li ahseniha il-la ente, vasrif anni sejjieha, la jasrif anni sejjieha il-la ente, lebbejke ve sa'dejke, ve'l-hajru kul-luhu fi jedejke, ve sherru lejse ilejke, ene bile ve ilejke, tebarekte ve tealejte, estegfiruke ve etubu ilejke.”* (Nesaiu, Albani thotë se hadithi është sahih)

- Kur i Dërguari s.a.v.s. bënte tekbirin në namaz, heshte për një çast para se të lexonte. E pyeta: “O i Dërguari i Allahut, të qofshim falë babë e nanë, çfarë thua në heshtjen tënde midis tekbirit dhe leximit?” Ai tha: “Them: “Allahumme baid bejni ve bejne hatajaje kema baadte bejne'l-mashriki ve'l-magribi, Allahumme nekini min hataje kema junekka ethevbu el-ebjedu mine denesi. Allahumme egsilni min hatajaje bi'th-thelxhi ve'l-mai ve'l-beredi.” (Buhariu dhe Muslimi)

- Kur i Dërguari s.a.v.s. hynte në namaz, bënte tekbirin e pastaj thoshte: “Allahu ekber kebiren, tri herë, ve'l-hamdu li'l-lahi kethiren, tri herë, subhanallahu ve bihamdihi, tri herë, eudhu bi'l-lahi min'esh-shejtani'r-rraxhim min hemezihi ve nefhihi ve nefethihi.” (Ibn Haxher El-Askelani)

Pas lutjes hyrëse vjen paneli i kopsave, kësaj here është kopsa e **Fatihësë**. Në këtë sure të dalluar e të veçantë ngërthehen disa çelësa dhe kopsa të rëndësishme. Ato do t'i shpjegojmë pas pak. Në mes të këtyre kopsave është një kopsë e kuqe shumë e rrezikshme. Pastaj vjen kopsa e sures që lexojmë pas Fatihësë, kopsa e tekbirit, rukusë etj. Kopsë pas kopse e çelës pas çelësi, derisa të arrijmë në panelin e çelësave tjera të rëndësishme e të veçanta, për pjesën tjetër shumë të rëndësishme, ndoshta edhe kulmin e namazit (**ettehijjatin**).

Më pas vijojnë shumë çelësa të tjerë, sidomos paneli i çelësave të salevateve ibrahimite, që më pas të arrijmë në çelësin e lutjes së fundit, që të afrohem afër përfundimit të udhëtimit, përshëndetjes së engjëjve me selam në të djathtë e në të majtë, i përgatitur për aterim dhe kthim përsëri në Tokë.



## TRIBUNJA E KATËRT FSHEHTËSITË E GJUHËS SË NAMAZIT

### Pjesa 1

#### Midis leximit dhe recitimit (kiraetit dhe tilavetit)

*Fatihaja* dhe ajetet ose suret që vijnë në rekatet e namazit, janë pjesa më e famshme e tij. Ti tani lexon me fjalët e Allahut, jo me kuptimet, urdhrat apo dispozitat e Allahut, por me fjalën e Tij dhe shkronjat e Tij, bile më shumë se kjo dhe më saktë, me *vokalet* (hareket) e fjalëve të Tij, *sukunet*, *ndaljet* (*vakf*), *zgjatjet* (*medd*), *lidhjet* (*vasl*), *shpalosjet* (*idhhar*), *fshehjet* (*ihfa*) dhe *shkrirjet* (*idgam*). Kjo nënkupton vlerën e lartë e të madhe të fjalëve të Allahut. Leximi i Kur'anit në namaz duke qenë në këmbë është leximi më i famshëm, është pozita më e famshme që e meriton fjala e famshme. Allahu i Madhërishëm i ndaloi të Dërguarit s.a.v.s. të lexonte Kur'an në pozitë tjetër, edhe nëse është në ruku dhe sexhde: *"I Dërguari s.a.v.s. e hoqi mbulesën, ndërsa njerëzit ishin të radhitur pas Ebu Bekrit, dhe tha: "O njerëz, dini se nuk ka mbetur nga përgëzimet e pejgamberisë përveç ëndrrës së mirë që e sheh muslimani ose i shfaqet atij, dini se ju kam ndaluar të lexoni Kur'an duke qenë në ruku dhe sexhde; për sa i përket rukusë, ju madhëroni në të Zotin e Lartësuar, kurse për sa i përket sexhdes, ngulmoni në lutje, se afër është t'ju përgjigjet (lutjeve tuaja)."* (Muslimi)

Fillimi i leximit të Kur'anit duhet të jetë sa më i bukur, ritmi i leximit tënd duhet të jetë sa më afër ritmit të bisedës që shërbëtori ia drejton zotërisë së tij të dashur e të respektuar, me nënshtrim dhe përkulje të plotë, të përfshijë çdo kuptim të fjalës, të çdo fjalisë dhe çdo ajeti që e shqiptojmë.

Por, nëse ndodh që melodia dhe ritmi i leximit tënd të jenë larg kontemplimit për kuptimet që i lexon, atëherë themi se leximi ka qenë i rëndomtë, pa ndonjë theks të veçantë. Melodia e leximit të Kur'anit kërkon shqiptimin e saktë të çdo shkronje, leximin e tij në forma të ndryshme, në përputhje me zërin dhe kuptimin e tij. Kujtoj se nuk ka zë (melodi, ton) më të bukur se zëri i leximit të butë, bren-gosës, përsjirtshëm dhe nënshtrues, ai që përputhet me kuptimet e asaj që e lexojmë. I Dërguari s.a.v.s. në shumë hadithe na flet për këtë: *“Ky Kur'an është shpallur me bren-gosje, prandaj qani kur ta lexoni, e nëse nuk qani, atëherë nxitni në qarje, këndon me të, se ai që nuk e këndon Kur'anin, nuk është na mesi ynë.”* (Ibn Maxhe)

*“Zbukuroni Kur'anin me zërat e juaja.”* (Ebu Davudi)

*“Allahu nuk ka dëgjuar diçka, siç ka dëgjuar zërin e bukur të Pejgamberit që këndon Kur'an dhe me zë.”* (Buhariu dhe Muslimi)

Në kohën kur fillojmë të lexojmë Kur'an, doemos të kemi parasysh faktin se nuk jemi duke lexuar tekst njerëzor, por diçka Hyjnore. Atë e lexojmë ashtu siç e lexoi vetë meleku Xhibril alejhi selam para të Dërguarit s.a.v.s. dhe para Allahut të Përlëvduar. Ky lexim na kujton lidhjen e pandërprerë dhe të drejtpërdrejtë me Allahun. Leximi ynë i Kur'anit duhet të jetë besnik e i saktë. Ky lexim na bënë të ndiejmë përgjegjësinë individuale që e kemi kundrejt tij, përgjegjësi që do të rrisë përsjirtshmërinë tonë dhe frikë-respektin, ta lexojmë atë ashtu siç është shpallur. Ky lexim nënkupton linjën e ngrohtë të hapur mes ne dhe Allahut të Madhërishëm.

## Pjesa 2

### Gjuha e re e Kur'anit të madhërishëm

Ajo që na ndihmon të ngrihemi në shkallë të lartë të leximit, është njohja e faktit të rëndësishëm se ne nuk lexoj-

më gjuhë arabe të thjeshtë e të rëndomtë, që i shëmbëllen gjuhës sonë njerëzore. Ajo që më së shumti i lëkundti muslimanët kur për herë të parë e dëgjuan Kur'anin e madhërishëm nga gjuha e të Dërguarit të tyre s.a.v.s. ishte risia e kësaj gjuhe, specifika e saj e veçantë, gjuhë ndryshe nga gjuhët e tjera që i njihnin, bile dhe vetë i Dërguari s.a.v.s. e përjetonte këtë.

Ata e njihnin gjuhën e njeriut që më parë u fliste në jetë, por kjo gjuhë që ai tani e flet me këtë libër nuk është i njëjtë! Një goditje e mahnitshme gjuhësore i goditi mëngjesin kur u zgjuan dhe dëgjuan për herë të parë këtë njeri që kishte dalë para tyre me një gjuhë ndryshe nga gjuha e tyre. Është ndryshe në çdo gjë, në metodë, mjet, shprehje, shqiptim, formë, lidhshmëri, raporte gjuhësore etj. Edhe përkundër asaj se është gjuhë e re, që nënkupton aspektin e çuditshëm dhe mahnitës të mrekullisë kuranore, ajo mbetet gjuhë e pastër arabe, e ndërtuar mbi rregullat e gjuhës arabe.

Ata nuk do ta lexojnë këtë gjuhë të re në mënyrë të njëjtë, siç lexojnë poezinë e tyre, siç i bëjnë bisedat e përditshme dhe mësyhet e letrat e njëri-tjetrit. Ata do të mendohen mirë, shumë mirë, kur do të qëndrojnë para kësaj gjuhe të re, para se të dalin me vendim përfundimtar për të. A thua do të munden, sado të mëtojnë, ta krahasojnë atë me traditat e tyre dhe kriteret e tyre gjuhësore të vjetra?! Ata nuk kishin dëgjuar më parë për shprehjen “sure” dhe “ajet”! S’ka dyshim se pas kësaj ata do të mendohen mirë dhe do të nënshtrohen para mrekullisë së tij!

### Pjesa 3

#### Gjuha konsonante dhe fusha e gjelbër

Në jetë shumë herë na ndodh që të dëgjojmë, lexojmë ose përsërisim fjalë të bukura duke mos ua vërë veshin do-

methënies së tyre të vërtetë, kujtesa jonë është kapluar nga spontaniteti dhe përditshmëria e zakonshme. Të shohim se ç'na thotë i Dërguari s.a.v.s. në një thënie të tij: *"I Dërguari s.a.v.s. në ruku dhe sexhde thoshte: "subbuhun, kuddusun, rabbul-lmelaiketi ver-ruh" (i përlëvduar, i shenjtë, Zoti i engjëjve dhe shpirtit (Xhibrilit)." (Muslimi)*

Shprehja **subbuhun** (i përlëvdëuar) është e njëjtë me shprehjen **subhane**, shprehje e re islame e panjohur për arabët para Islamit. Megjithatë, kjo shprehje është e përsëritur në Kur'an dhjetëra herë, shprehja **subhane** është përsëritur në Kur'an plot 41 herë.

Këto nuk janë shprehje të rëndomta, që të dyja janë shprehje konsonante, janë fushë e gjelbër që lë derën hapur para paramendimeve tona që vijojnë, siç kuptuam nga fjala **Allahu ekber** më parë.

Kur ne themi **subhane rabbii** (i përlëvduar është Zoti im), me këtë kemi thënë (e bëj të pastër Zotin tim...). Por, ne nuk vazhdojmë të themi se prej çka e pastrojmë, por të bindur jemi se para nesh hapen shumë mundësi, p.sh:

- **Subhane rabbijje'l-a'la/adhim** - ...i përlëvduar është Zoti im më i lartë/më madhështor... (i pastër) nga ndonjë mungesë,
- **Subhane rabbijje'l-a'la/adhim** - ...i përlëvduar është Zoti im më i lartë/më madhështor... (i pastër) nga ndonjë e metë,
- **Subhane rabbijje'l-a'la/adhim** - ...i përlëvduar është Zoti im më i lartë/më madhështor... (i pastër) nga lodhja,
- **Subhane rabbijje'l-a'la/adhim** - ...i përlëvduar është Zoti im më i lartë/më madhështor... (i pastër) nga padrejtësia,
- **Subhane rabbijje'l-a'la/adhim** - ...i përlëvduar është Zoti im më i lartë/më madhështor... (i pastër) nga gabimi,
- **Subhane rabbijje'l-a'la/adhim** - ...i përlëvduar është Zoti im më i lartë/më madhështor... (i pastër) nga dobësia... - gjumi... mërzia... sëmundja...

Namazi është fushë e gjelbër me derë të hapur, aty krijohen mundësi të panumërta që nxisin imagjinatën tonë

për shumëçka. Në fakt, në dy rekate që i falim ne përsërisim jo më pak se 33 shprehje të paplota, kjo nënkupton 33 fusha të gjelbra që na mundësojnë të mbushim imagjinatën tonë me mundësitë e shumënumërta. Ky numër nuk përfshinë fatihanë, as etehijatin, e as salevatet ibrahimite, po as ajetet dhe lutjet që i lexojmë në namaz. Këto ngërthejnë fusha të tjera të shumënumërta. Në vijim do t'i shohim detajet e shprehjeve konstante në dy rekate:

Allahu ekber – 11 herë, semiallahu limen hamideh – 2 herë, rabbena leke'l-hamdu – 2 herë, subhane rabbije'l-adhim – 6 herë, subhane rabbije'l-a'la – 12 herë, (33 gjithsej).

Ky numër i madh i shprehjeve të hapura ose të paplota shënon rëndësinë e elementit imagjinues në namaz që pasuron shumëllojshmërinë, siç kujdeset për sasinë sa më të madhe të përshpirtshmërisë dhe realizimit të lidhjes me qiellin.

Elementi që na mundëson paramendimin e fjalës apo fjalëve shtesë është i hapur para nesh dhe vazhdimisht mundëson zgjedhjen e fjalëve, varësisht nga realiteti që e jetojmë, të dhembshme ose të gëzuara, brengosëse ose të qeta, me ato që ballafaqohemi çdo ditë dhe çdo çast.

S'do mend se një gjë e tillë shmang spontanitetin dhe rutinën, na ndihmon të ballafaqohemi me problemet dhe brengat tona të përditshme me përkushtim të plotë, na nxit t'i prezantojmë kuptimet e asaj që e lexojmë, që nuk bëhet pa përshpirtshmëri të vërtetë e as pa ndjenjë të vërtetë të lidhjes me Allahun.

Është me rëndësi të dallojmë “shprehjen e hapur e të plotë gjuhësisht” nga “shprehja e hapur e paplotë gjuhësisht”, sepse çdo shprehje e paplotë gjuhësisht në të njëjtën kohë është edhe shprehje e hapur, kurse e kundërta nuk ndodh.

Shprehjet (**subhane rabbije...**) – (**semiAllahu limen hamideh**) - (**rabbena leke'l-hamdu**) janë të paplota, ato janë të hapura për shumë zgjedhje gjuhësore që mbushin

zbrazëtirat që pasojnë. Ndërkaq që shprehjet ose fjalët e hapura të cilat i gjejmë në **fatihan** janë të plota, andaj nuk kanë nevojë për shtesa horizontale për t'i plotësuar, por megjithatë ndërthejnë mundësinë e interpretimit në disa mënyra. Këto mundësi interpretimi nënkuptojnë shtesat vertikale, në thellësi, përkundër plotësimit të tyre gjuhësor. Shprehja e hapur, në bazë të këtij kuptimi, i shëmbëllen një ndërtesë disa katesh, një mbi një, çdo kat ka ngjyrën dhe shijen e veçantë.

Shprehja në suren el-Fatiha (**gajri'l-magdubi alejhim** - ... e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd) -, ishte e mundur të jetë më përkufizuese, si p.sh. (hebrenjtë), me këtë të ishte si një ndërtesë me një kat dhe kuptim të kufizuar, pra hebrenjtë. Por, që shprehja në fjalë është frytdhënëse, ajo nuk përkufizohet vetëm në hebrenjtë, por përfshinë të gjithë ata që shkaktuan zemërimin e Zotit, me ata që Zoti do të zemërohet në të ardhmen, tani dhe në të kaluarën. Kjo do ta bënte t'i shëmbëllente ndërtesë disa katesh, në njërin kat hebrenjtë, në tjetrin poshtë apo lart grupet e tjera që mund t'i përfshinë zemërimi i Allahut në çdo kohë dhe çdo vend.

#### Pjesa 4

#### Forma interaktive e leximit

Teknologjia moderne dhe revolucioni shkencor arritën që në botën moderne të bëjnë që studenti të komunikojë me kompjuterin e tij, ky të pyet e ai të përgjigjet. Ky është sistemi i leximit interaktiv që zhvillohet midis studentit dhe kompjuterit. Prosesi mësimor është shndërruar nga vetëm pranues në dy palë të barabarta që bashkëveprojnë në pranim dhe përgjigje.

Islami ishte i pari që në historinë e mësimin dhe pranimin krijoi këtë lloj të leximit interaktiv, ai përgatiti kushtet dhe rregullat e këtij leximi për muslimanët. Hadithet e të Dërguarit s.a.v.s. mësonin mënyrën e leximit të ajeteve kuranore dhe ndërlihdjen me kuptimet e tyre. Hadithi do të jetë shkollë e re ku muslimanët do të mësonin lexim të ri, aty do të bashkëveprojnë me tekstet qiellore me gjuhën e tyre të re jo të rëndomtë. Do ta lexonin me rolin për hir të cilit është shpallur nga qielli në tokë.

I Dërguari s.a.v.s. i mëson shokët e tij se si ta lexojnë Kur'anin, ai ua mëson edhe ritmin dhe melodinë e ajeteve, nivelin e zërit në lexim që është pjesë e procesit ndërlihdës midis robit dhe Zotit të tij: *“Ai që lexon Kur'an me zë (haptas) është sikur ai që jep sadaka zëshëm (haptas), kurse ai që lexon Kur'an me zë të ulët (fshehtas), është sikur ai që jep sadaka pa zë (fshehtas).”* (Ebu Davudi, Albani thotë se hadithi është sahih)

I Dërguari s.a.v.s. e dëgjoji leximin e Ebu Bekrit dhe të Omerit – Allahu qoftë i kënaqur me të dy - , njëri me zë të ulët, kurse tjetri me zë të lartë, ai kërkoi nga të dy që leximi i tyre të jetë në harmoni me sistemin e ri interaktiv: *“Katade el-ensariu thotë se i Dërguari s.a.v.s. doli një natë dhe e pa Ebu Bekrin, duke u falur me zë të ulët. Pas pak kaloi pranë Omerit dhe e pa duke u falur me zë të lartë. Kur të dy erdhën tek i Dërguari s.a.v.s., ai tha: “O Ebu Bekr, kalova pranë teje e ti ishe duke u falur me zë të ulët; ai (Ebu Bekri) tha: “O i Dërguari i Allahut, aq sa të më dëgjojë Ai që i lutesha.” Pastaj iu drejtua Omerit dhe i tha: “Kalova pranë teje e ti ishe duke u falur me zë të lartë; ai (Omeri) tha: “O i Dërguar i Allahut, i zgjoj ata që janë në gjumë dhe i largoj djajtë.” Hasani shton dhe thotë: “I Dërguari s.a.v.s. tha: “O Ebu Bekr, ngrite pak zërin, kurse ti Omer ule pak atë.”* (Ebu Davudi)

Leximi interaktiv shpaloset qartë në metodat e leximit të Dërguarit s.a.v.s., të prezantuar në shumë hadithe të tij. Pothuajse leximi i të Dërguarit s.a.v.s. i Kur'anit është i

njëjtë me mënyrën interaktive që zhvillohet sot midis kompjuterit dhe përdoruesit të tij. Ai nuk është lexim që bota e njohu deri në atë kohë: lexojmë e mësojmë, lexojmë e këshillohemi, lexojmë e studiojmë, lexojmë e mbajmë mend! Tani ai është lexim: lexojmë dhe përgjigjemi menjëherë, bile përgjigjemi me fjalë përshtatëse, e të mos flasim për punën dhe zbatimin e përshtatshëm. Kështu vepronte i Dërguari s.a.v.s. me Zotin e tij gjatë leximit të urdhrave, udhëzimeve dhe ndalesave të Tij, kështu na mësoi të veprojmë: *“I Dërguari s.a.v.s. lexonte pa ngutje, kur kalonte pranë ajetit ku kishte tesbih, madhëronte (Allahun), e kur kalonte pranë ajetit që ngërthente mbështetje, mbështetej.”* (Muslimi)

*“Kur i Dërguari s.a.v.s. kalonte pranë ajeteve të frikës, kërkonte mbështetje, e kur kalonte pranë ajetit të mëshirës, e kërkonte, e kur kalonte pranë ajetit ku Allahu pastrohej, ai madhëronte.”* (Albani thotë se hadithi është sahih)

*“Kur i Dërguari s.a.v.s. e lexonte: “Vallë, Ai Krijues, a nuk ka fuqi që t’i ngjallë të vdekurit?!”, thoshte: “I Përlëvdëruar qofsh Ti, po gjithsesi që po!” Ndërsa kur e lexonte: “Lavdëro emrin e Zotit tënd, më të Lartit.”. Thoshte: “I Lavdëruar qoftë Zoti im, më i Larti!”* (Ebu Davudi, Bejhekiu, Albani thotë se hadithi është sahih, kështu veprohet në të gjitha rastet, në namaz dhe jashtë namazit, në farz dhe në nafile)

Namazi përfshinë shumë elemente të tilla interaktive, jo vetëm në leximin tonë të Kur’anit, por në shumë situata tjera në të, veçmas në ezanin dhe përsëritjet e fjalëve pas myezinit, me të njëjtat ose me të tjera.

Ky lexim interaktiv përfshinë namazin në tërësi, duke filluar nga fjalët e para që e fillojmë namazin, falënderimin e parë drejtuar Allahut (*elhamdu li’l-lahi rabbi’l-alemin*) dhe fjalët e fundit që e mbarojmë uljen e fundit në namaz (*inneke hamidun mexhid*). Falënderimi që i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve nënkupton fjalët që ne i themi në

namaz e që kanë kuptimin e “ne të falënderojmë”, që pastaj të vijojnë përgjigjet e shpejta të Zotit tonë. Namazin e përbëjnë elemente që vazhdimisht e kujtojnë këtë interaktivitet që zhvillohet mes neve dhe qiellit gjatë namazit. Allahu i Madhërishëm bëri që gjuha e robit të Tij në çdo rekat të shqiptojë shprehjen Hyjnore pohuese “*semiAllahu limen hamideh*” (Allahu e dëgjoi atë që e falënderoi), ndërkaq që robi i përgjigjet me shprehjen që plotëson formën interaktive “*rabbena leke'l-hamdu*” (O Zot, Ty të takon falënderimi).

“Kur imami thotë “*semaillahu limen hamideh*”, ju thoni: “*rabbena leke-l-hamdu*”; Allahu ju dëgjon...” (Muslimi)

Ky interaktivitet zhvillohet gjatë tërë namazit, qysh nga shqiptimi i parë i **hamdit** dhe ndjenjën për praninë të përgjigjes; pohimit të adhurimit që e bëjmë vetëm për Allahun me formën e dialogut me Atë (**ijjake na'budu** - vetëm ty të adhurojmë), pas së cilës menjëherë vjen përgjigja dhe ndjenja për praninë të ndihmës (**ijjake nestein** – vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë); përshëndetja e Allahut (**ettehijatu**) dhe ndjenjat e mbushura plot mëshirë, paqe e selam; pastaj përshëndetja e të Dërguarit s.a.v.s. (**esselamu alejke ejuhu'n-nebijju** – paqe mbi ty, o i Dërguar) dhe kthimi i menjëherëshëm i kësaj përshëndetjeje nga ai s.a.v.s. për ne (**esselamu alejna** – paqe qoftë mbi ne) dhe për të tjerët (**ve ala ibadi'l-lahi 's-salihin** – dhe për robërit e mirë të Allahut); në fund salati dhe selami për të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. dhe të dërguarin Ibrahim a.s., respekt të urdhrat të Allahut, se Ai dhe engjëjt e Tij fisnik nuk ndalen nga salati për të Dërguarin besnik s.a.v.s.: “Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për atë. O besimtarë, lutuni për atë dhe përshëndeteni me “selam.” (El-Ahzab, 56)

A ju kujtohet biseda jonë e kuptimit vertikal të shprehjes (**Er-Rrahman**) në suren Fatiha? Është pothuajse e vërtetë se falësi vertikal interaktiv, i lidhur midis tokës dhe qiellit,

shumicën e pjesës së parë të sures, deri te fjalët e Allahut (**sirata'l-mustekim**), është midis dy drejtimeve: zbret dhe ngrihet. Ai në shprehjen "**Er-Rrahman**" merr formën e "zbritjes" që pret zbritjen e mëshirës mbi ne, ndërkaq që pjesa tjetër merr kuptimin e "ngritjes" nga toka kah qielli, edhe atë përmes metodave të bisedës që robi ia drejton Zotit të tij: **Ijjake** – vetëm Ty, **ve ijjake** – dhe vetëm ty, **ihdina** – na udhëzo, **en'amte** – që i begatove).

Shpirti do të lëviz dhe drejtohet kah lartësia në pjesën e dytë të kësaj lidhjeje. Ai ka fuqi të madhe për këtë, sidomos kur atë e furnizon vija që zbret nga qielli dhe sjell sasi të madhe të ndjenjave të mëshirës, faljes, kënaqësisë etj. Fuqia e tillë do të na ndihmojë tani që tesbihun dhe tekbirin, lutjet dhe duatë t'i çojmë lart, mbi krahët e ndërgjegjes së përemrit vetor, njëjës, që i referohet Allahut "**ijjake** – vetëm Ty", me fuqinë që e shtynë ta përsërisë dy herë "**ijjake..ve ijjake**". E gjithë kjo vetëm për të arritur ndihmën e pritur të Allahut dhe udhëzimin e Tij (**nestein... sirata'l-mustekim**).

Ky lloj i metodave interaktive, zbritës dhe ngritës dhe forma e dialogut me format e ndryshme e të shumëllojshme, do të na presin në çdo kënd dhe tek secila kthesë gjatë namazit.

## TRIBUNA E PESTË FSHEHTËSITË E FATIHASË DHE LEXIMIT

### Pjesa 1

#### Roli i Fatihasë dhe leximit

I Dërguari s.a.v.s na flet për madhësinë e sures Fatiha dhe thotë: *“Nuk është shpallur në Tevrat, e as në Inxil, e as në Zebur, po as në Furkan si ajo; janë vargje që përsëriten dhe Kur’ani i madhërisëm që më është dhënë.”* (Buhariu)

*“Derisa Xhibrili ishte i ulur tek i Dërguari s.a.v.s., dëgjoji një zë tërheqje mbi kokë, ngriti kokën lart dhe tha: “Është derë e qiellit që sot është hapur, kurrë më parë nuk është hapur, prej saj zbriti një engjëll; tha: “Është ky engjëll që zbriti në Tokë, kurrë më parë nuk ka zbritur.” Engjëlli përshëndeti, dhe tha: “Përgëzim për dy dritat që i solla, asnjë të Dërguari nuk iu janë dhënë para teje: Fatihaja e Librit dhe fundi i sures el-Bekare...”* (Muslimi)

A ke menduar ndonjëherë se kjo sure e madhërishme nuk është vetëm fillim i Librit, por edhe fillim i namazit? Ibn Kethiri në tefsirin e tij thotë: *“Quhen vargje që përsëriten; sepse përsëritet në çdo rekat të namazit.”* Ajo bile lexohet edhe në shumë manifestime të mëdha, punë të rëndësishme që zhvillohen në jetën tonë të përditshme.

A thua se ke menduar që surja Fatiha nuk është fjalë që i shëmbëllen fjalëve tona? Se nuk është gjuhë e zakonshme, siç është gjuha arabe që ne e flasim, po as ajo të cilën e fliste i Dërguari s.a.v.s. në jetë?

Si do të reagoje sikur të thosha se surja Fatiha ka 29 shprehje, jo më pak se 58 pozicione të reja gjuhësore të panjohura më parë për gjuhën arabe?!

Përpiqu ta kujtosh këtë gjatë leximit të saj në namaz. Shpirti i fjalëve të sures Fatiha depërton në brendinë tonë, na bënë të paramendojmë se ne i kemi përpiluar ato fjalë, se ato janë fryt i mendjes dhe arsyes sonë, të përpiluara me shprehjet tona, pa harruar se janë fjalë të Allahut që nuk i shëmbëllen asnjë fjalë tjetër, se përpilimit të Allahut nuk i shëmbëllen asnjë përpilim tjetër! Shqiptimi i fjalëve të Allahut, leximi i shprehjeve që i besojmë se janë të vërteta, e jo vetëm fjalë që i ka thënë dikush tjetër, vetëm atëherë ndjenjat fillojnë të burojnë nga brendia jonë e zemra të rrah pandërprerë.

Ky do të jetë hapi i parë në rrugë, do të bëhemi të aftë të ndiejmë çdo fjalë të Fatihasë, madhështinë e çdo shprehjeje, mrekullinë e kuptimeve që e bartin fjalët dhe shprehjet, veçantinë e saj të pashmangshme.

Gjithmonë kujto se kjo sure ka rëndësi të veçantë dhe është e dalluar prej sureve të tjera të Kur'anit të madhërishtëm. Në namaz mund të lexosh çfarë të duash dhe sa të duash, por doemos e ke ta lexosh Fatihanë. Nëse e lexon tërë Kuranin në namaz, por nuk e lexon Fatihanë, dije se nuk je falur. Llogaritet se ke lexuar, por jo namaz: *"Nuk ka namaz për atë që nuk e lexon Fatihanë e Librit."* (Buhariu)

*"Kush e fal namazin e nuk e lexon thelbin e Kur'anit (Fatihanë), le ta dijë se namazi i tij është i mangët, i mangët, i mangët, i paplotë."* (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih el-Xhami')

Surja Fatiha ka karakteristika të veçanta që e dallojnë nga suret e tjera të Kur'anit, edhe pse të gjitha janë të njëjta në shpërblim për leximin e tyre. Surja Fatiha ngërthen në vete të gjitha elementet e namazit, struktura e saj nënkupton vetë namazin, edhe pse nuk i paraprinë apo pason diçka nga shtyllat e namazit. Nuk duhet harruar se leximi i ndonjë pjese të Kur'anit, qoftë edhe një ajet apo shkronjë, ka shpërblim të madh tek Allahu, siç nxisin për këtë hadithet e

të Dërguarit s.a.v.s.: *“Kush i lexon dhjetë ajete në mbrëmje, atij i shkruhen për shpërblim një grumbull (shpërblimi), e grumbulli nënkupton atë që është më e mirë se dynjaja dhe gjithçka që është në të; kur të jetë Dita e Kiametit, Zoti yt i Lartëmadhëruar do të thotë: “Lexo dhe ngrihu me çdo ajet një shkallë, derisa të përfundojë në ajetin e fundit që ka me të, atëherë Allahu i Madhërishëm i thotë robit: “Merre, e robi do të thotë me dorën e tij – bën me dorë sikur kërkon pa thënë gjë - : O Zot, Ti e di më së miri; thotë: “Me këtë përjetësinë, e me këtë begatinë.” (Albani thotë hadithi është hasen, Sahih et-Tergib)*

*“Kush e lexon një shkronjë nga Kur’ani, i llogaritet një e mirë, kurse një e mirë shpërblehet me dhjetë të mira, nuk them Elif Lam Mim një shkronjë, por Elifi shkronjë, Lami shkronjë dhe Mimi shkronjë.” (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih el-Xhami’)*

Janë këto shpërblime të Ahiretit, ndërsa për atë të dynjasë thuaj çka të duash e mos u mërzit. Përpiqu ta krahasosh gjendjen tënde mendore dhe shpirtërore para leximit të Kur’anit dhe pas leximit të tij. Çfarë ndjenja drite, mëshire, sigurie e paqe na kaplojnë duke lexuar, e çfarë pasi të mbarojmë? Tani mëto ta lexosh përsëri, të kënaqesh me shikim në të, me ilaçin magjeps që e bartë Kur’ani në vete për ne: *“Çdonjërin që e godet mërzia ose brenga, e ai thotë: “Allahu im, unë jam robi Yt, biri i robit Tënd, biri i robëreshës Tënde, balli im është në duart e Tua, vendimi Yt për mua është i zbatuar, i drejtë është për mua vendimi Yt, të lutem me çdo emër Tëndin që e ke, apo që e ke shpallur në librin Tënd, apo ia ka mësuar ndonjërit nga robërit e Tu, ose e ke mbajtur për Vete në diturinë e gajbit tek Ti; (të lutem) ta bësh Kuranin pranverë të zemrës sime, dritë e gjoksit tim, heqje e brengës sime, largim të mërzisë sime” – (nëse e thotë këtë) – Allahu do t’ia largojë mërzinë e tij dhe në vend të mërzisë do t’i sjell gëzim (lumturi).” (Albani thotë se hadithi është sahih)*

*“Lexuesi i Kuranit nuk plaket (matufoste, dërdëlliset, fol jermi, telendisët)”* (Sujuti, Xhami’ es-Sagir, Ibn Asakir, Tarih ed-Dimeshk, Albani thotë se hadithi është daif)

Këtë hadith e kisha llogaritur për të dobët, derisa nuk lexova shtypin britanik të datës janar, viti 2012. Artikulli përmbante një të dhënë shkencore me shkronja të mëdha, që mua më bëri të interesohem për hadithin dhe ta studioj me vëmendje që ta rendis në hadithe të sakta (sahih). Lajmi thotë se shkencëtarët anglez kanë zbuluar ilaçin për sëmundjen Alzajmer, ishte puna e pandërprerë për stërvitjen e kujtesës për të mësuar përmendësh. Për këtë stërvitje, ata propozuan ndarjen e një kohe të veçantë për disa lojëra logjike, ndër to loja e fjalëve të ndara...

Pse të mos jetë kjo stërvitje e kujtesës në aktivitetin tonë dhe programin tonë të përditshëm? Është zgjedhja më ideale dhe ilaçi efikas stërvitës i kujtesës, siç na mësoi i Dërguari s.a.v.s. para 14 shekujve.

Në panelin e çelësave të sures Fatiha ka shumë kopsa, disa janë pjesë e çelësave të kuq. Në vijim do të ndalemi tek këto kopsa një nga një, të shqyrtojmë rolin e tyre në namazin tonë, të sqarojmë rolin e tyre në lëvizjen e anijes sonë kozmike që fluturon drejt qiellit.

### *Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit*

Është ndër ajetet më të bukura të Kur’anit famëlartë, nëse jo më e bukura në përgjithësi, por përditshmëria dhe zakonshmëria sikur e kanë hequr nga sytë e tanë këtë specifikë të tij dhe, sot e shqiptojmë vetëm si fjalë komplimenti të llojit të mirënjohjes, faljes, përsëritjes etj. Por, a kemi pyetur ndonjëherë se: pse Zoti i botëve e zgjodhi për ne këtë fjali që të jetë e para që e shqiptojmë në namaz? Pse është ajeti i parë me të cilin fillojmë Kur’anin? Pse është

shprehja e parë me të cilën hymë në çdo sure? Pse është pjesë e sures el-Fatiha?

Përsëritja e shpeshtë e besmeles në çdo vend dhe përsëritja e tij pothuajse në çdo çështje të jetës sonë, na ka bërë të kujtojmë se është një ajet që nuk nënkupton më shumë se fillimin e ndonjë pune. Ndoshta shkak i kësaj ka qenë shpjegimi i tij i thënë për besmelen se: filloj me emrin e Allahut.

Por, çështja është më tepër se kaq, më tepër se fillim ose hapje e ndonjë pune ose tekst hyjnor me emrin e Allahut. S'ka dyshim se prezenca e besmeles në fillim të sureve është domethënëse dhe me rëndësi të veçantë.

Besmeleja orienton drejt gjërave esenciale, drejt kumtimit kuranor që do ta lexojmë më vonë, se çdo urdhër, ndalesë, premtim, paralajmërim, përshkrim, lajm, këshillë, kujtim – do të lexohet me gjuhën tonë, kurse me autoritetin e Allahut të Madhërisëm.

Njeriu, si mëkëmbës i Allahut në tokë: *“Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë do të krijoj një mëkëmbës (që do të zbatojë ligjet e Zotit) në tokë.”* (El-Bekare, 30) – i përkushtuar ndaj kësaj pune të madhe, doemos t'i lexojë fjalët e Atij që e bëri mëkëmbës në tokë, vetë fjalët e Atij, në formën originale që burojnë nga vetë Ai i madhëruari, doemos t'i kujtoj vetes dhe atyre që e dëgjojnë se, janë fjalë që burojnë nga qielli, edhe pse ai vetë është në botën e tokës, se janë fjalë që ky i shqipton në vend të Zotit, me autorizimin e tij, në cilësinë e mëkëmbësit të Zotit të tokës.

Kur gjykatësi sjell vendimin për ndonjë çështje dhe fillojnë atë ta lexojë e thotë: në emër të popullit”, s'ka dyshim se dëshiron të thotë se shqiptimi i fjalës “në emër” nënkupton atë se ai këtë vendim se sjell në cilësi të të deleguarit të popullit për këtë çështje, se ai përfaqëson popullin, autoriteti i popullit e ka bërë të sjellë vendime dhe ligje. Në jetën e përditshme na ndodhë t'i lutemi ndonjë të afërmi për

përmbushje të ndonjë kërkese, e t'i themi: "të lutem në emër të familjes"!

Fillimi i Fatihës ose sures me ajetin **Bismi'l-lahi'r-rrahmani'r-rrahim** është përkujtim për lexuesin se mësimet qiellore që do t'i lexojë, do t'i lexojë me autorizim të Allahut. Shprehja "me emrin e Allahut" është më kuptimplote se shprehja "me lejen e Allahut".

Polici që zë kriminelin e bënë këtë me leje të shtetit, siç kontrollon shtëpinë e kriminelëve me leje të shtetit, e jo në emër të shtetit. Ambasadorët e vendeve të huaja shumë herë japin deklarata "në emër të" ose "me leje" ose "me gjuhën" ose "si përfaqësues" të shtetit.

Kujto fjalët e Isait alejhi selam në çastin kur i numëron-te mrekullitë e tij, ai ka kujdes që ato t'i konfirmojë se i ka bërë "me emrin e Allahut" ose me "lejen e Allahut": "*..bëj për ju diçka prej balte në formë shpendi, fryj në të dhe me lejen e Allahut ajo bëhet shpend i gjallë; shëroj të verbrit e lindur dhe të lebrosurit dhe i ngjall të vdekurit me lejen e Allahut...*" (Al-Imran, 49)

Lexo pra **bismi'l-lahi'r-rrahmani'r-rrahim**, duke ndier se ke filluar ta luash rolin tënd, përfaqësues dhe mëkëmbës i Allahut në këtë tokë, se çdo ajet që do ta lexosh pas kësaj që përmban urdhër, ndalesë, premtim, dënim, rrëfim, përshkrim, lajm, çështje metafizike – e lexon në vend të Zotit të këtyre vendimeve dhe mësimëve, Shpallësit të këtij libri për të Dërguarin besnik s.a.v.s., se ti lexon duke e orientuar atë lexim me emrin e Tij prej teje në ty.

Shqiptimi ynë i këtij ajeti në prag të çdo çështje të jetës sonë: kur hamë, kur pimë, kur dalim nga shtëpia (**me emrin e Allahut, u mbështeta në Allahun...**), kur kthehemi në shtëpi (**me emrin e Allahut u kthym, me emrin e Allahut dolëm...**), kur biem në gjumë (**me emrin Tënd, o Allah, vdes dhe zgjohem – me emrin Tënd, o Zoti im, e vë trupin tim...**), kur therim kurban, kur firmosim kontrata, kur filloj-

më fjalimin ose letrën; - vetëm se na kujton se gjëra që do t'i bëjmë ndodhin me dëshirën e Tij, përkushtim i ligjeve të Tij, përgjigje të natyrës në të cilën na krijoi dhe, me këtë kemi merituar të jemi përfaqësues dhe mëkëmbës të Tij në tokë. Pas kësaj të gjitha ndodhin me lejen e Allahut, e vogël apo e madhe qoftë ajo: *“Për çfarëdo peme palme që pretë apo e latë në këmbë, keni pasur miratimin e Allahut...”* (El-Hashr, 5)

Shiko pra punët që i bënë në këtë botë, a do të përshtaten me cilësinë tënde të përfaqësuesi dhe mëkëmbësi në tokë?

**Bismi'l-lah** na kujton se punët që bëhemi gati të fillojmë t'i kryejmë janë “realizim” dhe “përkushtim” i marrëveshjes sonë me Allahun, e jo vetëm fillim i mbarë e me be-reqet. S'do mend se duhet t'i përmbahemi neneve të marrëveshjes sonë, sikur na thotë: “i ke dhënë besën Allahut, prandaj vërtetoju për atë që do ta bësh, sepse e shqiptove emrin Tim kur fillove me përmbushjen e marrëveshjes.”

Fillimi i namazit me besmelen nënkupton zilen paralajmëruese që më kujton se këtë që do ta bëjë nuk është vetëm lëvizje spontane që del nga unë ose fjalë që dalin nga gjuha ime, por pa ndonjë rrahje të zemrës. Përkundrazi, besmeleja më bënë të ndiej lidhjen time të vërtetë me Allahun, çastin kur unë i vërtetoj Atij se atë që jam duke e bërë tani është zbatim i besatimit midis mua dhe Atij, se edhe më tej qëndroj besnik në pozitën e mëkëmbësit në tokë.

Kur faqen time të parë të librit e zbukurojë me **bismi'l-lahi'r-rrahmani'r-rrahim**, them se atë e kam përkujtim nga Zoti i botëve dhe vërtetim i imi për Atë, se çdo gjë që do të jetë në këtë libër, nga fjala e parë e deri në atë të fundit, do të jetë në pëlqim me marrëveshjen e ratifikuar midis mua dhe Atij, me qëllim të kënaqësisë së Tij, përkushtim i ligjeve të Tij, mos kalim i caqeve të caktuara nga Ai, i përmbajtur në suaza të kushteve të autorizimit të dhënë për mua në tokën e Tij.

**Bismi'l-lah** është marrëveshja midis meje dhe Allahut, se nuk jam më tepër se një përfaqësues i Tij në këtë tokë, se nuk ka pushtet përveç pushtetit të Tij, se nuk ka autoritet përveç autoritetit të Tij, se nuk ka pasuri përveç pasurisë së Tij, se nuk ka ushqim përveç ushqimit të Tij, se nuk ka pije përveç pijes së Tij, se ti, o njeri, je zbritur në këtë tokë për të drejtuar punët që i ke marrë përsipër t'i zbatosh në vend të Pronarit të vërtetë, prandaj përmbaju neneve të marrëveshjes që ke bërë, se për një kohë të shkurtë ajo mbaron dhe ti vdes, prandaj a je përgatitur për të dalë para Pronarit të vërtetë me fletoren tënde të llogarive?

*"I biri i Ademit thotë: "Pasuria ime, pasuria ime", po ti o biri i Ademit pasuri e pate atë që e ngrëne dhe e harxhove, atë që e veshe e që u vjetrua, apo atë që e dhe sadaka, e ajo mbeti."* (Muslimi)

Mirëpo rrëfimi i **bismi'l-lahi'r-rrahmani'r-rrahim** nuk përfundon këtu.

Do të kishte qenë e mundur që miratimi apo përfaqësimi të mbaronte me "**bismilah** – me emrin e Allahut" dhe kaq, por i Madhërishmi e lidhi këtë marrëveshje me atë që bëhet e pandarë, që numërohet pjesë e pandashme e tij "**er-rrahmani'r-rrahim**".

Këto dy shprehje të pandara e të pazakonta japin më shumë se një mesazh. Kujto se Allahu i Madhërishëm, i Cili thotë se mëshira e Tij ia ka kaluar zemërimit të Tij, siç thuhet në hadith kudsijj, ka zgjedhur për ty që të fillosh me ngulmim të mrekullueshëm leximin e 113 sureve me këtë emër të bukur.

Er-**rrahmani'r-rrahim** ngërthejnë rëndësi të madhe, ato janë pjesa esenciale e namazit tonë, fillim i çdo leximi, kjo nënkupton se ato janë shtyllë e besimit tonë, nëse vërtet meritojmë postin mëkëmbës i Allahut në tokë.

Këto dy shprehje na detyrojnë të jemi përfaqësues më të mirë dhe më të denjë, të ngrihemi në nivelin e përgjegjësisë (**rahmetit**) që e kemi marrë përsipër.

Ti je musliman, prandaj bota doemos të shoh në ty tolerancën, në fytyrë dhe buzë, të shoh buzëqeshjen e buzëve tua, butësinë e zembrës tënde, për të afërmin dhe të largëtin, dashurinë tënde për shoqërinë, tolerancën tënde për mikun dhe armikun, e tërë kjo buron nga kuptimi i Rahman dhe Rahim; falje, dashuri, humanitet, butësi dhe përulësi.

Ti je musliman, prandaj doemos të marrësh nga atributet e Allahut, nga ajo që gjuha jote e thotë në namaz, e të përgjigjet zemra, e të jesh gjithmonë përfaqësues i denjë dhe njerëzor në tokë, i Atij që veten e cilësoi se është Falës, i Butë, Bujar, i Dashur, Mëshirues, Mëshirëplotë.

A është pasqyra e muslimanit që sot paraqitet para botës ajo pasqyrë e vërtetë që duhet të jetë?

## Pjesa 2

### Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve

Suksesi i ndjenjave për vlerën gjuhësore të kësaj sureje dhe huazimi i veshëve të muslimanit të parë për ta dëgjuar këtë sure sikur për herë të parë, na bënë që të fillojmë leximin e **“Çdo lavdërim i takon Allahut”**. Nga thellësia e zembrës e ndiejmë këtë të vërtetë, ndiejmë se si e falënderojmë Allahun e Madhërisëm për gjërat që na i ka dhënë, të mirat e panumërta, që na mbrojti nga fatkeqësitë, nga cytjet e djallit që mundohet të na bind se Ai nuk na ka dhënë më shumë seç na kanë dhënë të tjerët, se Ai na ka dhënë shumë pak, ose asgjë!

Mos i shiko ata që kanë shumë të mira që ti nuk i ke, por mundohu ta krahasosh veten me ata që janë privuar nga të mirat ose nga disa të mira, kjo të bënë të njohësh mirësinë e Allahut për ty, që është mirësi e madhe, se ti kurrë nuk do të mund ta plotësosh të drejtën e Tij me falënderim e mirënjohje, sado që ta thuash atë apo mos ta thuash.

Me rëndësi të madhe është të kujtosh se qëndron para një shprehje të re të shprehjeve të hapura në namaz. **“Çdo lavdërim i takon Allahut”** – për çfarë e falënderojmë Atë? Çështja është lënë në duar e tua, që ti t’i plotësosh tri pikat e supozuara që vijojnë, atë që ty të përshtatet dhe që i përshtatet rrethanave të jetës tënde. Kujtoj se plotësimi i pikave do të mund të ishte kësisoj:

- Çdo falënderim i takon Allahut, Zotit të botëve për atë që më udhëzoi në Islam,
- Çdo falënderim i takon Allahut, Zotit të botëve, që më dha të mira që shumë të tjerë janë të privuar,
- Çdo falënderim i takon Allahut, Zotit të botëve, që më mësoi se si ti drejtohem Atij duke u falur,
- Çdo falënderim i takon Allahut, Zotit të botëve, që gjuha ime është e aftë të lëviz e të shpreh falënderim dhe mirënjohje,
- Çdo falënderim i takon Allahut, Zotit të botëve, për begatinë e Kur’anit,
- Çdo falënderim i takon Allahut, Zotit të botëve, për shikimin, dëgjimin, ndjenjën, shqisat, shëndetin, ushqimin, pijen, shtëpinë...

Mijëra të mira që nuk mund të numërohen, e që shumë prej tyre janë larg mendjes sonë për t’i kujtuar, vetëm atëherë e kujtojmë se sa jemi fatlum për të mirat që i kemi, e që shumë njerëz janë të privuar prej tyre, janë miliona njerëz të tillë.

Imagjinata jonë i vë para vetes të gjitha shkaqet e të mirave për të cilat e falënderon Allahun. Tani bëhemi gati të lexojmë pjesën tjetër **“Zotit të botëve”**. Në thellësi të zemrës ndiej se Allahu është Sunduesi i parë dhe i fundit, në duart e Tij është fati i robërve, fillim dhe mbarim...

Nëse i zoti i shtëpisë është ai që ushqen, furnizon me ushqime dhe plotëson nevojat e duhura të familjes së vogël, atëherë Zoti i botëve është Ai tek i Cili mbështetemi në çdo çast të dobësisë sonë, nën mbrojtjen e Tij strehohemi kur na godet diçka e pakëndshme ose ndonjë brengë. Shprehja

“Zoti i botëve” ngjall në shpirtin tonë besimin, shpresën, ndjenjën se Ai kurrë nuk na lë pas dore e të pandihmuar, sepse është Zoti ynë, se Ai do t’i përgjigjet namazit tënd dhe lutjes tënde.

Ai është Zoti ynë, Drejtuesi i të gjitha punëve tona, e kush është më i fuqishëm se Ai për këtë drejtim? A nuk është Ai Zotërues i gjithë pushtetit, Ai që ushqen, jep ujë, furnizon, ngrit, ulë, lavdëron, përul, mban në duar qiejt dhe Tokën të mos bien, Ai që nuk e merr gjumi e as kotja, as lodhja e mërzia, Ai që nuk bënë të padrejtë e as gabim në llogari, vendime ose dispozita? Krahas gjithë kësaj, Ai gjithashtu është: i Gjithëmëshirshëm, Mëshirëplotë.

### Pjesa 3

#### Të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Dy shprehje që nënkuptojnë mëshirën. A thua janë përsëritje e njëra tjetrës, apo çdonjëra ka kuptim më vete? Realiteti gjuhësor flet se çdonjëra nga këto dy shprehje ka karakter kuptimor ndryshe nga tjetra. Shprehja **Rrahman** nënkupton një gjendje të tanishme, por jo të përhershme e të vazhdueshme, siç bëhet fjalë për shprehjen **Rrahim!** Këtë do të mund ta krahasojmë me etjen, urinë, pagjumësinë, gëzimin, zemërimin, lodhjen, gjendje që ndodhin tani për tani dhe së shpejti mbarojnë, p.sh. zemërimi do të qetësohet dhe dalëngadalë humbet.

Që këtej themi se Rrahman është mëshirë që “tani” zbret mbi ne, pra në çastin kur ne e lexojmë atë fjalë, veprimi i saj, lëvizja dhe gjallëria e saj dallojnë nga Rrahim. Shprehja Rrahman ka kuptim vertikal që zgjatet nga qielli në Tokë, ndiejmë mëshirën që vazhdon të lëvizë drejt neve dhe bie mbi ne e freskët. Përpiqu ta lexosh duke ndier mëshirën e Rrahman, që sapo ka dalë nga burimi i saj origjinal, tek ti ka arritur e

ngrohtë, çasti i leximit të saj flet për rrahjet e saj me fuqi të madhe, lëvizje dhe jetë. Ajo bie mbi ty si ujëvarë që lëshon mëshirën nga maja e kokës e deri te shputat e këmbës.

Ndërkaq që shprehja Rrahim flet për mëshirën e përhershme e të pandërprerë. Bujari mbetet gjithmonë bujar, kurse koprraci mbetet gjithmonë koprrac, kështu ndodh me të shtrenjtën, të vlefshmen, të bukurën, të shëmtuarën etj. Pra, Ai është gjithmonë i mëshirshëm, në çdo kohë, mëshira e Tij është e pakohë, përfshinë të kaluarën dhe të ardhmen. Është atribut që shtrihet prej ezeli drejt përjetësisë, bashkohet me mëshirën tjetër që vjen prej qielli në Tokë, ka kuptim gjallërues, lëvizës, që vepron në ne në çastin kur e lexojmë.

Vallë, si i lexonte i Dërguari s.a.v.s. këto dy shprehje?

Dikush e pyeti Enesin: *"Si ishte leximi i të Dërguarit të Allahut s.a.v.s?" Ai tha: "Ishte lexim i zgjatur, e pastaj lexoi: bismilahi rrahmani rrahim, e zgjaste bismilahi, e zgjaste errahman, e zgjaste errahim."* (Buhariu)

Zgjatja e shprehjes Rrahman dhe Rrahim nuk përfshihet në rregullat e drejtë-leximit (texhvidit), megjithatë nënkupton se që të dyja kanë karakter ose identitet të pavarur dhe dallues, sepse zgjatja e tyre nënkupton kohën, kurse koha që ndan njërin prej tjetrës nënkupton pavarësinë dhe veçantinë e njëra tjetrës.

Sujutiu sjell një transmetim të Ibn Eshte se Omer ibn Abdu-l-Azizi ka urdhëruar zgjatjen e Rrahman, edhe në shkrim. Thuhet se u shkroi letër guvernatorëve të tij duke u thënë: *"Kur të shkruani (bismilahi-rrahmani-rrahim), zgjateni shprehjen Rahman."*

Mëshirë e Allahut e ngrohtë dhe e freskët, që derdhet mbi trupin tonë, në mënyrë vertikale dhe horizontale; na pastron nga gjynahet dhe brengat e tanishme, por edhe nga to që ndodh të na godasin në të ardhmen, mëshirë që depërton në zemër dhe zë vend të përhershëm.

## Pjesa 4

### Sunduesit të Ditës së Gjykimit

Para nesh qëndron pamja e Ditës së Gjykimit, Dita e Llogarisë së tmerrshme, Dita kur askush nuk flet, përveç Allahut, Sunduesit absolut, Dita kur foshnja do të thinjet, kur çdo grua me fëmijë në gji do ta harrojë fëmijën e saj dhe çdo grua shtatzënë do ta hedhë barrën e vet, Ditën kur njerëzit do të jenë si të dehur, ndonëse ata nuk janë të dehur. Shprehje e hapur, përkundër asaj se është e plotë, ajo më vete bart dimensione të mëdha imagjinuese që mund t'i imagjinojmë për atë Ditë të Madhe. E hapur për çdo lloj të perceptimeve dhe paramendimeve imagjinuese njerëzore, të pakufishme, por e paaftë për t'i përfshirë në fotografi të vërtetë për këtë Ditë të Madhe.

A thua ke arritur tani të kapësh qoftë një kënd nga kjo pamje? A mbarove nga zhytja në këtë eksperiencë imagjinuese e rrallë? E pra, nëse ke vënë veten para kësaj pamje, para Sunduesit absolut, Madhështorë, Sunduesit të kësaj Dite, Drejtuesit të këtyre pamjeve fillim dhe mbarim, është koha e përshtatshme që të dorëzohesh para Tij, të deklarosh nënshtrimin e plotë para Tij, çështjen tënde t'ia dorëzosh Atij, po edhe fatin tënd ta lësh në duart e Tij, sepse Ai është Sunduesi i parë dhe i fundit, i Vetmi që ka në dorë këtë fat...

Ardhja e shprehjes "Sunduesit të Ditës së Gjykimit" në suren Fatiha, menjëherë pas shprehjes "Të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit", e bënë kërkuesin e mëshirës të mbështetet më fuqishëm në mëshirën e Allahut. Se kjo mëshirë nuk vjen nga një që është i dobët, që nuk pritet mbrojtje e ndihmë, por vjen nga i Plotfuqishmi, i Madhërishmi, Ai që është "Zot i botëve", nga Sunduesi i Ditës së Gjykimit, Sunduesi i gjithësisë dhe krijesave, Ai tek i Cili mbështetemi për çdo gjë në jetën tonë, Ai tek i Cili është kthimi ynë.

Vetëm Allahut i drejtohem i me ibadet dhe teuhid (**Vetëm Ty të adhurojmë**).

Sa madhështi e gëzim kur shohim se mëshira e kërkuar vjen vetëm nga Ai, ndihma dhe mbështetja. Prandaj, përdërisa ky prej të cilit ne kërkojmë dhe i lutemi, ka këtë fuqi dhe madhështi dhe meriton të kërkohej prej tij, le t'i drejtohem duke mos pritur e as hamendur, bile le të jetë në të njëjtin ajet, le të plotëson pjesën e konfirmuar se vetëm Ai është Mbikëqyrësi, Furnizuesi, i Adhuruari ynë (**dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë**).

### Pjesa 5

#### Çelësi i kuq numër 2

*Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë*

Imagjinoni pamjen e njeriut që është nisur drejt zyrës qeveritare për t'u ankuar për të padrejtën që iu është bërë. Ai do të hyjë te nëpunësi zyrtar për të kërkuar të drejtën e tij, kurse ky do t'i kërkojë të shkruajë kërkesë të vulosur me pullë postare, ta vendos në postën e zyrës, që pastaj të arrijë te drejtori gjeneral që do ta shqyrtojë atë e të vendos për atë, qoftë vendim i saktë ose gabim, i drejtë apo i padrejtë.

Krahaso gjendjen e këtij njeriu dhe gjendjen e njeriut tjetër që është shumë fatlum, që është në lidhje të fortë miqësie me drejtorin e zyrës, që është përgjegjës i parë dhe i fundit që vendos për çështjet dhe vulos kërkesat, saktë ose gabim, drejtë ose padrejtë...

S'ka dyshim se pozita dhe skenari do të ndryshojnë tërësisht këtë herë. Njeriu do të hyjë te zyra e drejtorit gjeneral pa leje, pa procedura hyrëse që i kërkon roja, as që troket në derë për të marrë leje të hyjë. Kështu merr letrën dhe

lapsin dhe fillon ta shkruaj kërkesën me fjalët e drejtorit, i cili i thotë: “Shkruaj atë që ta them unë...”

Pas përfundimit të kërkesës, drejtori e merr dhe e vë para vete, përhëndet shokun duke i thënë: “Shko i qetë dhe i sigurt, mos u brengos fare për çështjen e kërkesës në fjalë, do të aprovohet në tërësi, me plot të drejtë.

Çfarë ndërmjetësimi i mrekullueshëm që i zgjedh problemet falas, vetëm me një vizitë të veçantë e të këndshme, me një filxhan kafe!!

Kështu do të ishte çështja me “vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”, edhe pse nuk mund fare të krahasohet, se Allahu është gjithmonë më i Lartë dhe më Madhështorë.

Në fillim të Fatihasë i drejtohem i Allahut me falënderim, lavdërim, mirënjohje, madhërim, me shprehje të ndryshme dhe emra të bukur që provojnë madhërinë dhe fuqinë e Tij, që vërtetojnë bindjen tonë në fuqinë e Tij, që do t'i përgjigjet çdo kërkesë që ia drejtojmë Atij: **“Çdo lavdërim i takon Allahut – Zotit të botëve – të Gjithëmëshirshmit – Mëshirëplotit – Sunduesit të Ditës së Gjykimit”** ...kërkesë e cila vërtetohet dhe vulozet me të gjitha këto attribute, veçmas nëse kësaj ia bashkëngjisim lidhjet tona të ngrohta që i kemi me Të, nënshtrimin e plotë dhe mbështetjen e veçantë në fuqinë e Tij, madhështinë, mbikëqyrjen dhe mëshirën. Është vetë Allahu që na mësoi formën e lutjes dhe kërkesës që do t'ia drejtojmë, të kërkojmë çdo gjë që dëshirojmë të na i realizojë: **“vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”**.

Këtu nuk ka nëpunës të vegjël që kërkojnë letër zyrtare të vulosur me pullë postare dhe pagesë të caktuar para se të merr shqyrtimin e duhur apo të vendoste në rrugën shkallë shkallë. Allahu nuk e lejon këtë me robin e Vet, Ai bile e urdhëron që vetë robi të flet me gjuhën e tij, të kërkojë atë që e do, e më shumë se kjo është fakti se Ai të mëson formën me të cilën do të kërkojë atë që e do, në gjuhën tënde i

vendos të gjitha atributet e theksuara në fillim të Fatilhasë, që në fund të konfirmoj se ti je rob i Tij, se Ai është Zoti yt dhe Përgjegjës për ty dhe kujdestar i interesit tënd: **“vetëm Ty të adhurojmë”**.

E tërë kjo ndodh para se të futemi në thelbin e temës e të kërkojmë drejtpërdrejtë, me shprehjen e qartë Hyjnore që na e mësoi, shprehjen që vetë Ai e zgjodhi për ne: **“vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”**.

A e kuptuam vlerën e asaj që vetë Allahu të na mësojë se çfarë të themi e të kërkojmë prej Tij? Cila është ajo ndihmë që ne e kërkojmë prej Tij? S’ka dyshim se është ndihma për kërkesat tona dhe nevojat e mëdha e të shumta, të mëdha e të vogla, të vjetra e të reja, të shumëllojshme. Ai është i Plotfuqishëm dhe na ndihmon për gjithçka.

A thua se ka diçka në jetë që mund të garantojmë realizimin e saj pa këtë Fuqi të lartë? Është Dora e ndihmës që na vjen gjithmonë kur e kërkojmë, që kujdeset dhe na mbron nga rreziqet e udhëtimit të jetës, që na ofron biletë falas për këtë udhëtim, që të kalojmë përtej: nga embrioni në varr!

*“I Dërguari s.a.v.s. thotë: “Allahu i Madhërishëm thotë: “E kam ndarë namazin midis Meje dhe robit Tim në dy pjesë, njëra pjesë është e Imja, kurse tjetra e robit Tim, e robit Tim i takon gjithçka që kërkon. Kur robi thotë: “Çdo lavdërim i takon Allahut, Zotit të botëve”, (Allahu) thotë: “Më falënderoi robi Im.” E kur ai thotë: “Të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit”, Ai thotë: “Më lavdëroi robi Im”. E kur ai thotë: “Sunduesit të Ditës së Gjykimit”, Ai thotë: “Më madhëroi robi Im.” E kur thotë: “Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”, Ai thotë: “Kjo është mes Meje dhe robit Tim, e robit Tim i takon çfarë të kërkojë.” E kur thotë “Udhëzoni në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi, e jo në të atyre që kanë shkaktuar zemërimin Tënd, as në të atyre që janë të humbur”, Ai thotë: “Kjo është për robin Tim dhe robit Tim i takon çfarëdo që kërkon.” (Muslimi)*

Pra, jemi me ajetin që është në mes të sures, aty ku mbaron qëndrimi konfirmues, madhërues e lavdërues, që menjëherë të fillojë qëndrimi lutës dhe kërkues, të kërkojmë prej Allahut çka të duam **“vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”**.

Kjo pavarësi e çuditshme e dy vend-ndaljeve të ndryshme që i bashkon një ajet na bënë të mahnitemi me bukurinë e tyre, sikur ndalemi në pjesën e parë të ajetit **“vetëm Ty të adhurojmë”** që pas pak të vazhdojmë pjesën tjetër **“vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”**.

Mu për këtë disa lexime të parregullta konsiderojnë se surja Fatiha ka 8 ajete! Janë këto lexime që nuk merren në konsideratë dhe janë të pabaza.

Me rëndësi është që ne në namaz ndiejmë sikur lexojmë një ajet por jemi para dy qëndrimeve, se dialekti i pjesës së parë **“ijjake na'budu”** ndryshon nga dialekti i pjesës së dytë **“ve ijjake nestein”**.

Do ta shqiptojmë **“ijjake na'budu”** me theks të zërit që provon respektin, madhërimin dhe frikë-respektin për Atë, në duart e të Cilit është fati ynë, jeta jonë, fati dhe jeta e familjeve tona, i të dashurve tonë, por së shpejti do ta shqiptojmë **“ve ijjake nestein”**, me theks të zërit që qetëson, shpreson, lutet, kërkon ndihmë, shpresë, ndiejmë frytet e përgjigjes dhe mëshirës, ndihmës që gati sa nuk ka zbritur mbi ne, të pastrojë njollat e dëshpërimit, shqetësimit, brengës dhe mendimit... e si jo, kur para nesh është Ai që dëgjon se çfarë i themi, që nëse është kundër teje, atëherë kush vallë do të jetë me ty?! E nëse është me ty, kush vallë do të mund të jetë kundër teje?!

**“Vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”** – është kulmi i sures Fatiha, është burimi nga i cili buron paqja, siguria, mëshira, dhënia...

Është gjysma e ajetit që Allahu e ka ndarë mes Tij dhe robit të Tij, siç na mëson hadithi kudsij, e që Allahu i premtton robit të Tij që falet premtimet më të bukura, që vijnë

nga Ai që mban premtimin, nga Ai që mund t'i realizon të gjitha premtimet: "Robit i takon ajo që kërkoi".

Është shprehje e përfshirë në dy fjalë, por nënkupton gjërat më të mëdha që mund t'i ëndërrojë njeriu në këtë botë. Nëse në xhepin tonë e kemi letërnjoftimin që na i hapë dyert për çdo gjë, atëherë çfarë ndërmjetësimi më i madh na duhet në këtë jetë?

Të mos kalojmë në leximin e ajeti që vijon përveçse të jemi të bindur se ishte një çast i mrekullueshëm i kënaqësisë sonë të paparë, se vërtet jemi kënaqur me ngadalë, ndiejmë freski shpirtërore dhe lumturi, ndjejnë të besimit të plotë dhe të vërtetë se do të realizohen kërkesat tona, pa marrë parasysh formën e ndihmës që do të vjen. I Dërguari s.a.v.s. i thirri një ditë shokët e tij dhe tha: *"Ejani pranë meje. Ata erdhën dhe u ulën pranë tij. Tha: "Xhibrili, i dërguari i Zotit të botëve më frymëzoi në shpirt: "Askush nuk do të vdes derisa të përmbush riskun e vet, edhe nëse vjen me ngadalë (vonohet), prandaj keni drojë Allahun dhe kërkoni riskun me bukuri (silluni bukur dhe butë), të mos ju shtyjë ngadalësimi (vonimi) i riskut që atë ta merrni duke i bërë gjynah Allahut, sepse gjërat që janë tek Allahu fitohen vetëm duke e respektuar Atë."* (Albani thotë se hadithi është sahih)

Lexo **"ve ijake nestein"** duke qenë i bindur për përgjigjen, për ndihmën e pritur që e ke kërkuar, me bindje të atij që shkoi për ta falë namazin me njerëzit e të kërkojnë prej Allahut shi, por me vete morri ombrellën, vetëm ky e mori, të tjerët jo.

## Pjesa 6

### Udhëzona në rrugën e drejtë. Në rrugën e atyre...

Dyert e mirënjohjes dhe falënderimit janë hapur, ti e falënderove dhe e lavdërove, edhe dyert e mëshirës u ha-

pën, e ti kërkove zbritjen e saj, para teje u shtrinë rastet për të kërkuar, e ti kërkove, por tani Allahu do të bëjë që gjuha jote të shqiptojë kërkesën më të madhe që mund ta kërkon njeriu në jetë: udhëzimin në rrugën e drejtë. A thua se ka gjë më të frikshme se devijimi nga rruga e drejtë?

Paramendoni sikur të jemi shumë të pasur, shumë të mençur, shumë të shëndoshë, të lumtur deri në skaj, e të mos furnizohemi me besimin e teuhidit dhe udhëzimin, çfarë dobie do të kishim prej gjithë asaj? Lumturinë e dynjasë? E sa peshon lumturia e dynjasë dhe stolitë e saj nëse nuk fitojmë lumturinë në botën tjetër? Sa janë 100 vjet, 1000 vjet ose 100 mijë vjet të kësaj jete në krahasim me vetëm një çast të jetës së amshueshme (ahiretit), Xhenetit dhe Xhehenemit?

*“Sa për ata që nuk besojnë, veprat e tyre janë si mirazhi në shkretëtirë e të cilin i etshmi e kujton për ujë, por, kur arrin tek ai vend, nuk gjen asgjë. Aty do ta gjej dënimin e Allahut, i Cili ia paguan llogarinë e Tij të plotë...”* (En-Nur, 39)

*“Në Ditën e Kiametit do ta sjellin njeriun më të pasur jobesimtar, e thuhet: “Zhyteni në Xhehenem një zhytje. Do ta zhysin në të, e pastaj do t’i thuhet: “O filan, a të ka goditur ndonjëherë ndonjë e mirë?” E do të thotë: “Jo, kurrë nuk më ka goditur ndonjë e mirë.” Do ta sjellin njeriun më të varfër besimtar që ka përjetuar vetëm fatkeqësi e skamje, e thuhet: “Zhyteni në Xhenet një zhytje. Do ta zhysin në të, e pastaj do t’i thuhet: “O filan, a të ka goditur ndonjëherë ndonjë fatkeqësi, skamje e varfëri?” E do të thotë: “Kurrë nuk më ka goditur asnjëfarë skamje e fatkeqësi.”* (Ibn Maxhe, Albani thotë se hadithi është sahih)

Kënaqësinë që e ndiejmë me leximin e “vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë” ndryshon nga kënaqësia që e ndiejmë me leximin e ajetit që menjëherë vijon: “udhëzona në rrugën e drejtë”. Shprehja e parë nënkupton kërkesë të dynjasë, kurse e dyta kërkesë e ahiretit, por duke mos përjash-tuar mundësinë e kuptimit shpirtëror të saj gjithashtu. Rru-

ga e drejtë (**siratu-l-mustekim**) është shprehje e hapur, që krahas udhëzimit dhe besimit, gjithashtu nënkupton edhe urtësinë, mendimin korrekt e të drejtë në çdo gjë! A ka mirësi më të madhe se njeriu të furnizohet në jetë, e mendim korrekt, të qëlluar e të drejtë, që e ndihmon në jetë, e me të ndihmon edhe të tjerët përreth?

Shprehja “**sirat**” në Kur’an ka kuptim ndryshe nga ajo që vërehet në thëniet e të Dërguarit s.a.v.s., ato nuk ngërthejnë ndonjë kundërthënie mes vete, por plotësojnë njëra tjetrën. Dallimin mes tyre mund ta vërejmë gjatë shqyrtimit të ajeteve dhe haditheve në një vend, ku qartë vërejmë dallimin e kuptimit kuranor që ka kjo shprehje, e që përmbledh disa veçori të natyrës së kësaj bote, si p.sh: e vërteta, drejtësia, udhëzimi, etj, për dallim nga kuptimi i saj në hadithin profetik që në të shumtën e rasteve ngërthen kuptimin e rrugës në ahiret, që nuk ka lidhje me dynjanë. Në vijim do t’i shtrojmë disa ajete dhe hadithe që e bëjnë të qartë këtë:

*“Kush mbahet fortë pas (fesë së) Allahut, sigurisht që është i drejtuar në rrugë të mbarë.” (Ali-Imran, 101)*

*“S’ka asnjë gjallesë që të mos jetë nën pushtetin e Tij. Me të vërtetë, Zoti im, është në rrugë të drejtë.” (Hud, 56)*

*“Por ata që nuk besojnë jetën tjetër, shmangen nga rruga e drejtë.” (El-Mu’minun, 74)*

*“E pyeta të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. për fjalët e Allahut të Madhërishëm: “Dita kur Toka do të ndërrohet me tokë tjetër, por edhe qiejt...” (Ibrahim, 48) -, se ku do të jenë njerëzit atë ditë, o i Dërguari i Allahut? ai tha: “Në urë (sirat).” (Muslimi, Aisha r.a.).*

*“...atyre do t’ju vjen Allahu e do t’ju thotë: “Unë jam Zoti juaj.” Ata do të thonë: “Ti je Zoti ynë”. Ai do t’i thërret, do të vendos një urë mbi kalimin e Xhehenemit, unë do të jem i pari nga të dërguarit që do ta kaloj me Umetin tim.” (Buhariu)*

*“...ata do të shkojnë te Musai s.a.v.s., e ju thotë: “Unë nuk jam i zoti i kësaj, shkoni tek Isai, fjala e Allahut dhe shpirti i Tij, e ju thotë Isai s.a.v.s.: “Unë nuk jam i zoti i kësaj.” Atëherë do të shkojnë te Muhamedi s.a.v.s., ky do të ngrihet në këmbë dhe do t'i jepet leje; amaneti dhe marrëdhëniet farefisnore do të ngrihen e do të vendosen në dy anët e urës, në të djathtë e në të majtë, i pari i juaj do të kaloj si vetëtima. Thashë: “Pash nënën dhe babain tim, çfarë si kalimi i vetëtimës?” Ai tha: “A nuk e keni parë vetëtimën se si kalon dhe kthehet sa çel e mshel syrin?” pastaj do të kaloj si era, pastaj si shpezët (fluturimi).....i Dërguari i juaj do të jetë mbi urë, e do të thotë: “O Zot, shpëto, shpëto, derisa punët nuk do të mund më t'i bartin njerëzit, derisa të vijë një njeriu që nuk mund të ecë veçse këmba dorës...” (Muslimi)*

Këto dallime kuptimore përfshijnë dimensionet e jash-tëzakonshme dhe krijojnë hapësirë më të madhe të fuqisë perceptuese dhe ilustruese që krijohen gjatë leximit.

Kjo veçori e shprehjes së hapur **“sirat”** në Fatihën nuk kufizohet vetëm në mbarim të saj, por shtrihet deri në fund të sures. Kush janë ata **“në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi”** dhe kush janë ata **“që kanë shkaktuar zemërimin Tënd”** dhe kush janë ata **“as në të atyre që janë humbur? A janë të parët muslimanët, të dytët hebrenjtë, e të tretit të krishterët, siç pretendojnë disa komentues të Kuranit dhe siç thuhet në disa hadithe?**

*“...” që kanë shkaktuar zemërimin Tënd” – janë hebrenjtë, kurse “as në të atyre që janë humbur” – janë të krishterët.”* (Albani thotë se hadithi është sahih, Sisilet es-Sahih, ibn Hatim)

Të tri shprehjet janë gjuhësisht të plota, ato nuk ngërthejnë ndonjë hapësirë supozuese pas vete, por nëse i krahasojmë këto shprehje kuranore me shprehjet e tjera njerëzore, do të vërejmë veçorinë e këtyre shprehjeve e të qenët të hapur. Ta lexojmë këtë ajet përsëri duke ndërruar shpreh-

jet kuranore me shprehje alternative, që të mësojmë dallimin që shihet qartë: **Ihdina's-sirata'l-mustekim – sirata'l-muslimine, gajri'l-magdubi alejhim ve le'd-dal-lin – udhëzона në rrugën e drejtë, në rrugën e muslimanëve, e jo...!**

Tani na bëhet e qartë “pasuria” i shprehjes së hapur kuranore e cila “hap” kuptimin e “**në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi!**”; çdonjërit që i ke dhënë mirësi; kurse shprehja “**që kanë shkaktuar zemërimin Tënd!**”; çdonjëri që ka shkaktuar zemërimin Tënd, ndërkaq shprehja “**as në të atyre që janë humbur!**”; çdonjëri që ka humbur dhe devijuar nga rruga e drejtë, duke mos e anuluar komentin profetik, por edhe duke mos i “mbyll” këto tri shprehje e të përkufizohen për një grup të njerëzve, siç bëjmë me shprehjet njerëzore.

Është shumë me rëndësi se gjatë leximit të “**ihdina sirata-l-mustekim!**” duhet të kujtojmë se për shkak të urtësisë Hyjnore nuk erdhi në formën njëjës, por në atë shumës (udhëzона). Që lutja e tillë t'i përfshijë të gjithë ata që i kemi përreth: fëmijë, farefis, grua, fqinjë, të njohur, bile të përfshijë të gjithë botën, të gjithë shokët dhe armiqtë, muslimanë e jo muslimanë! A ka më mrekulli dhe më madhështi që Allahu t'ju dëshiron dashuri të gjithëve, shokë e armiq, udhëzimin në rrugë të drejtë?!

Le të kujtojmë në mbarim të Fatihasë fjalën e veçantë përmbyllëse e të dalluar AMIN, se engjëjt me përkushtim të madh presin që kur gjuha jonë ta shqiptojë, edhe ata ta shqiptojnë së bashku me ne, sikur shkronjat tona përplasen me shkronjat e engjëjve. Ky është edhe një dialog interaktiv midis robit dhe Zotit të tij në namaz, siç vërteton i Dërguari s.a.v.s.: “Kur dikush thotë: “Amin”, engjëjt në qiell thonë: “Amin”. E nëse përputhet njëra me tjetrën, i falen gjynahet e kaluara.” (Muslimi)

“Kur imami thotë: “gajri-l-magdubi alejhim veled-dalin”, ju thoni: “Amin”, se Allahu ju përgjigjet.” (Albani thotë se hadithi është sahih)

## Pjesa 7

### Vendzgatjet në suren el-Fatiha

Edhe më tej në shpirtin tim është diçka që përpiqem ta shpjegoj, është çështja e vendzgatjeve në suren Fatiha. Zgatja (*meddi*) nënkupton një ndalje të thjeshtë ose që i shëmbëllen ndaljes, shprehja merr kohë më të gjatë, është e natyrës se fjalës ose shprehjes i jep karakter të veçantë, sidomos me frymëmarrjen kohore shtesë, siç i jep energji të fortë të pavarësisë dhe dallueshmërisë. Zgatja nënkupton pra hapësirë kohore, kurse hapësira kohore nënkupton ngadalësi e gjelbër shtesë për të menduar dhe studiuar fjalën ose shprehjen e zgjatur.

Doemos të dallojmë “ndaljen e plotë” në lexim dhe “zgatjen – **meddin**” që është lloj i ndaljes ose “sikur ndaljes”. I Dërguari s.a.v.s. lexonte para se të fillonte Fatihanë me ndalime të plota dhe pasi ta lexonte atë: *“I kam mbajtur mend dy ndalje nga i Dërguari i Allahut s.a.v.s.: njërën kur merrte tekbir – pas tekbirit fillestar – dhe tjetra kur mbaronte leximin (gajri-l-magdubi alejhim veled-dalin).* (Ebu Davudi, Sumrete ibn Xhundub)

Ai gjithashtu ndalej me ndalje të plotë në fund të çdo ajeti, siç pohon një hadith tjetër, e kjo nënkupton një hapësirë tjetër të gjelbër që ndan ajetet: *“I Dërguari i Allahut s.a.v.s. e ndante leximin e tij (këpuste), thoshte: “elhamdu li'l-lahi rabbi'l-alemin” dhe ndalej, pastaj thoshte “er-rrahmani'r-rrahim” dhe ndalej.”* (Ibn Haxher el-Askelani, Ummu Seleme)

Ndërkaq që zgjatjet që i shëmbëllejnë ndaljeve, ato sikur i japin leximit tonë më shumë përsipirtshmëri, paramendim të kuptimeve dhe imagjinim të asaj që e lexojmë, i japin më shumë hapësirë të gjelbër kohore që na jep kohë të mjaftuar për kontemplim në kuptimet e kaluara dhe na përgatisin për pranim të kuptimeve që vijojnë.

Më duket se është e udhës të propozojmë renditjen e ndërprerjeve të pjesë së parë të sures sipas vendëzgjatjeve në të. Kujtoj se kjo renditje do të na ndihmojë në shfaqjen e vendëndaljeve gjatë leximit, sidomos do të na ndihmojë në nënvizimin e karakterit të secilës fjalë ose ndërprerje, me qëllim të imagjinimit të kuptimit në namaz.

Unë personalisht, pas studimit të së vërtetës së zgjatjes, i udhëzuar në frymën se si e lexonte i Dërguari s.a.v.s. Fatihanë, ashtu siç transmeton Aliu r.a., se ai s.a.v.s. zgjaste shkronjën “**d**” në shprehjen “**na’budu**”, fillova që pjesën e parë të Fatihasë ta lexoj në namaz në këtë formë (duke u kujdesur për zgjatjet e shkurtra të gjelbra në këtë lexim):

- **Bismi'l-lahi...** ( zgjatje peygamberike, që i shëmbëllen ndaljes)
- **Er-Rrahman...** (zgjatje peygamberike, që i shëmbëllen ndaljes)
- **Er-Rrahim...** (ndalje: fundi i ajetit)
- **El-Hamdu li'l-lahi...** (zgjatje peygamberike, që i shëmbëllen ndaljes)
- **Rabbi'l-alemin...** (ndalje: fundi i ajetit)
- **Er-Rrahman...** (zgjatje peygamberike, që i shëmbëllen ndaljes)
- **Er-Rrahim...** (ndalje: fundi i ajetit)
- **Maliki jevm'i-d-din...** (ndalje: fundi i ajetit)
- **Ijjake na'budu...** (që i shëmbëllen ndaljes: mbushje e shkronjës “**d**” derisa prej saj të del një “**vav**”, në bazë të leximit të Aliut)
- **Ve ijyake neste'in...** (ndalje: fundi i ajetit)...

Përsëri më duhet të them e t'i kujtoj lexuesit se e tëra që është në këtë libër, meditime, analiza dhe propozime, nuk janë më tepër se “ide njerëzore” që pranojnë kundërshtimin dhe korrigjimin. Me këtë kemi dashur vetëm të heqim pluhurin nga spontaniteti dhe zakonshmëria që ka kapluar shumëçka në jetën tonë të përditshme, duke mëtuar të rizbulojmë qëllimin e namazit, intencat e tij etj. Nëse vërtetohet me provë pavlefshmëria e secilës nga këto mendime ose ide, atëherë ne gjithmonë jemi me provën dhe me tekstin, muslimanit i takon të jetë vetëm i këtilë.

## TRIBUNIA E GJASHTË DOMETHËNIET E ULJES SË FUNDIT

### Pjesa 1

#### Boshti i rukusë dhe i sexhdes

Tani kalojmë në një pozitë të re, nga ajo në këmbë kalojmë në ulje, në lëvizjen e parë që e bëjmë në namazin tonë pas tekbirit fillestar. Është lëvizje drejt tokës, por që shpirtin tonë e shtyn në largësitë e qiellit. Ai (tekbiri fillestar) ngërthen respektin, përkushtimin, nënshtrimin dhe përruljen para Allahut, që mjafton të na jep fuqi për t'u ngritur te Krijuesi Madhështor dhe të jemi sa më afër Atij.

Ndodh të pyesim: pse i paraprinë rukusë dhe sexhdes? Pse rukuja është vetëm një herë në çdo rekat, për dallim nga sexhdeja që është dy herë? Pse nuk lejohet të pakësojmë ose shtojmë diçka nga kjo, qoftë edhe nëse është në pyetje rritja e shpërblimeve? Bile edhe nëse bëjmë diçka të tillë (pra shtojmë ose pakësojmë) me harresë ose shkujdes, atë duhet shpëguar me dy sexhde të harresës në fund të namazit! Pse? Pse?

Janë pyetje njerëzore që ia parashtrojmë vetvetes e që nuk mund të japim përgjigje definitive. Këtu kemi të bëjmë vetëm me përpjekje njerëzore të kufizuara, por ndiejmë se gjithmonë duam të dimë për fshehtësitë e gjërave, sepse jemi Umet i "të menduarit të thellë" dhe "studimit të hollë", siç pohon Kur'ani i Urtë në çdo faqe të tij fisnike.

Është e vërtetë se lëvizjet e namazit janë elementet më të rëndësishme që i dallojnë muslimanët kudo që shkojnë, veçmas kur kemi parasysh se ato i bashkojnë muslimanët, varësisht nga drejtimit e tyre juridike. Po, ndodh që të ketë

dallime në shumë imtësi, por kurrë nuk ndodh të ketë dallime në formën e përgjithshme të namazit: numri i namazeve, numri i rekateve në namaz, numri i rukusë e si sexhdeve në çdo rekat, forma e rukusë dhe e sexhdes, karakteri i lëvizjes së tyre si dhe lëvizjet tjera themelore të namazit.

Ky është uniteti konstant i strukturës së përgjithshme të namazit, i detajeve të kësaj strukture. Faktori kryesor që kujdeset për platformën unifikuese të drejtimeve juridike islame, platformë që synon kthimin tonë në fund në unitet, bashkim të ri rreth shtyllave themelore të mentalitetit të parë, sikur zemrat të ishin të sinqerta e të zhvisheshin nga ndikimet njerëzore dhe emocionet e pazakonta.

Në këtë libër kemi mëtuar që lëvizjet e namazit të mund t'i shohim me sytë e muslimanëve të brezit të parë, të cilët hoqën petkun e injorancës dhe veshën petkun e urdhrave Hyjnor, me sytë e atyre që për herë të parë morën ta falin namazin e parë në jetë. Është e vërtetë se nuk ishte e lehtë për ata t'i përvetësonin e ti kuptonin këto lëvizje të reja, t'i pranojnë së të tilla, t'i praktikojnë me përkushtim, përsipirtshmëri dhe respekt. Kishte ndodhur që disa njerëz ta kundërshtonin atë, të mos e kryejnë atë, të mos e përqafojnë Islamin, kinse kishin parë "fyerje", siç thanë: "...ata nuk e falën namazin pasi i Dërguari s.a.v.s. i urdhëroi. Ata thanë: "Nuk përkulemi, sepse është fyerje për ne." Atëherë i Dërguari s.a.v.s. tha: "Nuk ka dobi në një fe ku nuk ka ruku e as sexhde." (Shevkani në Fet'h el-Kadir, 5-361, transmeton Ebu Hajjani në Tefsir Bahr el-Muhit, 8-399)

Ka shumë pika që shumica pre nesh i kanë humber, tërësisht ose pjesërisht; ndjenjën e fuqisë së rukusë dhe sexhdes dhe domethënies së tyre të thellë, e falim namazin sikur kalimtar rasti, duke mos i njohur fshehtësitë e tij dhe dimensionet e tij të shtrira anembanë, e pastaj nuk ndiejmë imagjinimin e tij dhe kënaqësinë e përsëritjes së tij pesë herë

në ditë. Në këtë kontekst duhet përmendur dy shprehjet e veçanta që ndajnë rukunë dhe sexhden: **semi'Allahu limen hamideh... rabbena leke'l-hamdu...!**

Siç mund të vërejmë, janë këto dy shprehje që mbarojnë me tri pika supozuese (...).

Këtë e thashë me qëllim që të vërtetohet se këto dy shprehje janë të hapura e të paplota. Nëse ndodh që t'i shkruaj ndonjërit letër falënderimi për ndonjë të mirë të bërë, i the: fale-minderit për këtë, ose për atë, ose për hir të kësaj etj... e nëse dua ta falënderoj Atë që më ka dhënë çdo gjë në jetë, e që do të më jep çdo gjë që e kërkoj, e ndoshta edhe që nuk më jep asgjë, qoftë edhe pas vdekjes, Allahu na ruajt, a thua çfarë shprehje falënderimi do të kisha zgjedh?

Kur shqiptoj (**semi'Allahu limen hamideh... Allahu e dëgjo atë që e falënderoi**) natyrisht se kjo nënkupton: e dëgjo atë që e falënderon për jetën, imanin, shëndetin, pasurinë, vendbanimin, fëmijët, shokët, për çdo gjë në jetë), ...e kur shqiptoj (**rabbena leke'l-hamdu... Zoti ynë, Ty të takon falënderimi**) natyrisht se me këtë nënkuptoj: Ty të takon falënderimi për begatinë e kësaj... e kësaj... e kësaj... e asaj... etj. Janë shprehje gjithmonë të hapura dhe çdo herë i mbushim me gjëra të imagjinatës sonë që merr nga jeta jonë e përditshme që e jetojmë. Të mira të panumërta që nuk i ndiejmë, për shkak të spontanitetit dhe adaptimit. Këto shprehje e kujtojnë besimtarin për këto të mira, për këto mirësi që shumë njerëz në botë janë të privuar sot.

A nuk vëreni se shprehja (**semi'Allahu limen hamideh**) me mënyrën e saj dëftore që nuk nënkupton kërkesë, lutje ose mirënjohje, sikur del nga zhvillimi i zakonshëm i nama-zit, që të na përkujtojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në krye të çdo rekati, se çdo gjë që themi tani shkon drejtpërdrejt te dëgjimi i Allahut, dhe të na konfirmojë të vërtetën se dëgjimi i Tij nuk kufizohet vetëm në këtë shprehje apo në

shprehjen që vijon, por përfshinë çdo gjë që e themi apo e bëjmë në namaz, duke filluar nga tekbiri fillestar e deri në mbarim të namazit me selam!

Isha dyzet vjet kur për herë të parë e bëja haxhin. Vetja më dukej si një fëmijë i vogël që po bëja tavafin reth Qabes. Mbi vete kisha vetëm dy copë pëlhure. Gjatë tavafit i thosha lutjet e zakonshme dhe dhikret e duhura. Më kujtohet që djalli më bënte vesvese për gjëra që nuk do të më shkonin kurrë ndërmend në këtë vend: o Bessam, e sikur të të shohin studentët e tu të universitetit në këtë gjendje? Muslimanë e jo muslimanë? Çfarë do të thonë për ty? Ndoshta do të thonë: çfarë i ka ndodhur profesorit tonë? A është çmendur? Ku është personaliteti i tij me të cilin jemi mësuar? Ku mbeti autoriteti i tij, eleganca e veshjes, ecja stabile, lëvizjet e ngadalshme? Mirëpo shpirti i vërtetë dhe i pastër islam së shpejti më kaplonte dhe shuante zjarrin e këtyre vesveseve djallëzore dhe më kujtonte se unë jam musliman.

Unë jam musliman, do të thotë unë i nënshtrohem, për-ulem, i përkulem vetëm Allahut, se jam rob i dobët, thënë më mirë jam asgjë para Allahut Fuqiplotë, të Fuqishëm, Madhështor, para Atij që ka në dorë qiejt dhe Tokën, që ngjall dhe vdes, i fuqishëm për çdo send.

Këto erëra (filad) të larta shpirtërore filluan të më freskojnë gjithmonë kur veten time ia nënshtroja Allahut, në çdo gjendje tjetër shqetësuese që kishte ndodhur të jem, jo vetëm në haxh, por edhe jashtë haxhit. Këto erëra të larta shpirtërore filluan të më shoqërojnë në përkuljen e rukusë, e madhëroja Allahun me kënaqësi (**subhane rabbije-l-adhim**)... in pastër është Zoti im nga çdo mangësi, dobësi, padrejtësi, lodhje... etj, në çdo qëndrim në këmbë pas rukusë, kur kujtoja rregullin e artë Hyjnor (**semi'Allahu limen hamideh**), e i përgjigjem duke e falënderuar Atë (**rabbena leke'l-hamdu**), i falënderohem për atë që më krijoi, më

udhëzoi, më dha... etj, pastaj në çdo sexhde që e madhëroj (subhane rabbijje'l-a'la)...

Kështu fillova të ndiej, në fjalë dhe vepër, e koka ime e përkulur gati përtokë për Allahun, ndiej se jam afër qiellit: "Më afër që mund të jetë robi prej Zotit të tij, kur është në sexhde, prandaj shtoni lutjen." (Muslimi)

Në sexhde, në këtë përkulje të plotë, përrulje të pafund, nënshtrim të lartë, ndiej se jam shumë më i lartë seç mund të jem, më i lartë se çdokush që mund të jetë në faqe të Tokës. Pluhuri i tokës që prek ballin tim është tregues se kam arritur pikën më të lartë të qiellit.

A thua ke ndier, kur balli yt të ketë prekur dheun, se me rënien më të ulët në tokë duke shqiptuar (subhane rabbijje'l-a'la) ke arritur lartësitë më të mëdha, atje ku (a'la-më i lartë)?

"E takova Theobanin, shërbëtorin e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s., e i thashë: "Më trego për një punë që ta punojë e Allahu të më futë me të në Xhenet." Ose i thashë: "Për punën më të dashur tek Allahu." Ai heshti. Unë përsëri e pyeta, e ai heshti. E pyeta për herë të tretë, e ai tha: "E kam pyetur të Dërguarin e Allahun s.a.v.s. për këtë, e ai tha: " (Theoban) Bëj shumë sexhde për hir të Allahut, sepse çdoherë që e bën një sexhde për Allahun, Ai të ngrit një shkallë lart dhe ta heq nga një gjynah." Ma'dani tha: "Pastaj e takova Ebu Derdanë dhe e pyeta atë për këtë, e ai më tha sikur që më tha Theubani." (Buhariu dhe Muslimi)

"Isha me të Dërguarin e Allahut s.a.v.s., ia solla ujin për abdes, siç i solla disa nga gjërat e nevojshme të tij, ai më tha: "Kërko." Unë i thashë: "Dua të të shoqëroj në Xhenet (të jemi afër teje)." Ai tha: "Po tjetër?" i thashë: "Kjo është e tëra." Ai tha: "Ndihmo veten tënde (për këtë) me shumë sexhde." (Muslimi)

"Nuk ka gjendje që mund të jetë robi më të dashur për Allahun sesa ta shohë në sexhde, pluhuros fytyrën e tij në dhe." (Mundhiri)

*"...derisa të dojë Allahu ta mëshirojë atë që do nga banorët e Xhehenemit, i urdhëron engjëjt t'i nxjerrin ata që e kanë adhuruar Allahun, e ata i nxjerrin duke i njohur me gjurmët e sexhdes që i kanë, se Allahu ia bëri haram zjarrit të hajë gjurmët e sexhdes, e ata dalin nga Xhehenemi. Birin e Ademit do ta hajë zjarri, përveç gjurmëve të sexhdes." (Buhariu)*

A e kemi ndier këtë kur jemi përkulur në ruku dhe sexhde? Apo vetëm kemi kaluar kështu, e vazhdojmë të kalojmë, bëhemi të kënaqur që jemi vjedhës, bile vjedhës më mizor!?

A keni menduar ndonjëherë se nga ata që falen ka vjedhës, vjedhës të namazit, të kohës së tij, të rekatit, të sexhdes, duke mos e ditur se çfarë bënë? Ç'është më e keqja, këta vjedhës nuk vjedhin nga të tjerët, por e vjedhin vetveten, nuk vjedhin nga thesaret e dynjasë, por më keq se kjo, vjedhin nga thesaret e ahiretit: "Ç'mendonit për atë që pi alkool, për atë që bënë zina dhe vjedhësi? Kjo ndodhi para se të shpallen dispozitat e masave ndëshkuese. Të pranishmit thanë: "Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri." Ai tha: "Vërtet janë vepra të shëmtuara, dhe meritojnë dënim, por vjedhja më e keqe është vjedhja e atij që vjedh namazin." Të pranishmit thanë: "E si e vjedh namazin e tij?" Ai tha: "Nuk e plotëson rukunë e as sexhden." (Albani thotë se hadithi është sahih)

E pse jo? A nuk është namazi dhuratë e Allahut, që duhet kryer në kohë të caktuar, që na e rregullon orarin e punëve të përditshme, që na shpërblen me të mira të mëdha, të shënuara në fletët e ahiretit dhe kapitalit tonë të ahiretit?! Për fat të keq, namazi për shumë njerëz është shndërruar në mjet zbavitës dhe humbje kohe, është vetëm lëvizje e shpejtë e gjymtyrëve të trupit, lëvizje e shpejtë e gjuhëve, mbarim i shpejtë i tij, e pastaj kthim në punët e përditshme ose në dëfrimin e zbavitjen tonë sa më shpejtë.

Kështu dalim prej namazit, nëse meriton të quhet namaz, kur kemi vjedhur nga llogaria jonë, nga rekati ynë,

sexhdeja jonë, nga lëvizjet, leximi, lutja etj. Ndodh të kemi humbur shumëçka nga punët dhe shpërblimet që më parë ishin në fondin bankar, para se të falemi: “...*kush e plotëson atë, i pranohet e tërë puna tjetër, e atij që i refuzohet namazi, i refuzohet edhe puna tjetër.*” (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih et-Tergib)

A vërejmë se rukuja dhe sexhdeja janë dy lëvizjet e vetme farz të namazit? A vërejmë koncentrimin e të Dërguarit s.a.v.s. në të së bashku me heshtjen? Secila lëvizje kërkon pritje, ngadalësim dhe heshtje, pasi ta shqiptojmë atë që duhet për të.

Ne shqiptojmë (**Allahu ekber**), por natyra e saj kërkon pak pritje dhe heshtje, sa të mbushim me mendjen tonë zbrazëtirën që e krijon përbërja gjuhësore e paplotë dhe përgjigja për pyetjen që e parashtron kjo përbërje: Allahu është më i madh se çka?!

Kur themi (**semi’Allahu limen hamideh**) e pastaj (**rabbena leke’l-hamdu**), imagjinojmë natyrën e këtyre shprehjeve që kërkojnë pak pritje dhe heshtje, sa të mbushim me mendjen tonë zbrazëtirën që e krijon përbërja gjuhësore e paplotë dhe përgjigja për pyetjen që e parashtron kjo përbërje: Ta falënderojmë për çka?!

Edhe kur themi (**subhane rabbijje’l-adhim**) dhe (**subhane rabbijje’l-a’la**), imagjinojmë natyrën e këtyre dy tesbiheve (madhërimeve), që nënkuptojnë pak pritje dhe heshtje, sa të mbushim me mendjen tonë zbrazëtirën që e krijon përbërja gjuhësore e paplotë dhe përgjigja për pyetjen që e parashtron kjo përbërje: e madhërojmë për çka? E pastrojme prej çka?!

Për rëndësinë e madhe dhe pozitën e rukusë dhe sexhdes në namaz, i Dërguari i Allahut s.a.v.s. kërkoi nga njeriu që e kishte falur namazin ta përsërisë atë edhe një herë, sepse nuk ishte falur. Të kujtojmë pra se kur i Dërguari

s.a.v.s. e mësoi njeriun për përshpirtshmërinë në namaz nuk mëtoi ta mësonte se çfarë të thoshte apo si ta thoshte, sepse nuk e kishte dëgjuar fare, por mëtoi ta mësonte si të lëvizte, e s'ka dyshim se lëvizjet e njeriut ishin provë e asaj se çfarë kishte thënë dhe si e kishte thënë. *“Transmeton Ebu Hurejre r.a. se një njeri hyri në xhami për t'u falë, kurse i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ishte në anën e xhamisë. Pas namazit erdhi dhe e përshëndeti atë (të Dërguarin), e ky i tha: “Kthehu dhe falu se nuk je falur.” Ai shkoi dhe u falë, pastaj e përshëndeti, e ky s.a.v.s. ia ktheu përshëndetjen “Edhe mbi ty (qoftë shpëtimi)” – kthehu e falu se nuk je falur.” Për të tretën herë njeriu tha: “Më mëso pra si të falem?” Ai s.a.v.s. tha: “Kur të bëhesh gati për namaz, merr abdes për bukuri, pastaj kthehu kah Kibla dhe merr tek-bir, lexo çka ke nga Kur'ani, pastaj bjerë në ruku, ashtu që të qetësohesh në ruku, pastaj ngrite kokën, drejtohu mirë në këmbë, pastaj shko në sexhde, derisa të qetësohesh mirë në sexhde, pastaj ngrite kokën, të qetësohesh i ulur mirë, pastaj shko në sexhde dhe bëje atë me qetësi, pastaj ngrihu e drejtohu në këmbë. Kështu ve-pro në tërë namazin tënd.” (Buhariu)*

Pozita e rukusë dhe e sexhdes në namaz na bëhet e qartë kur mësojmë se atij që i kalon leximi i sures Fatiha në namazin me xhemat, nuk detyrohet ta kompensojë atë, por nëse i kalon sexhdeja, e para kësaj rukuja, atij i ka kaluar një rekat i plotë i namazit, gjë që nuk mund ta kompensojë me tjetër, përveçse me faljen e një rekati të plotë.

Janë shumë hadithe që flasin për rëndësinë e rukusë dhe sexhdes, mënyrën e plotësimit të tyre sa më mirë. I Dërguari s.a.v.s. ishte shumë i kujdesshëm që rukunë dhe sexhden ta plotësonte sa më mirë, të plotësonte lëvizjen dhe përshpirtshmërinë e tyre, sado që namazi të ishte i shkurtër.

*“Allahu nuk e shikon namazin e një robi që nuk e drejton shpinën midis rukusë dhe sexhdes.” (Albani thotë se hadithi është sahih)*

*“Ndodh që njeriu të falet gjashtëdhjetë vjet e të mos i pranohet namazi, ndoshta e plotëson rukunë, por jo sexhden, e plotëson sexhden, por jo rukunë.” (Albani thotë se hadithi është hasen)*

*“Hudhejfa e pa një njeri që nuk e plotësonte rukunë e as sexhden, e tha: “Nuk je falur, e sikur të vdisje do të vdisje jo në natyrën në të cilën Allahu e krijoi Muhamedin s.a.v.s.” (Buhariu)*

*“Nuk na ka treguar dikush që i Dërguari s.a.v.s. e ka falë namazin e paradites, përveç Umu Hanit, që përmend se i Dërguari s.a.v.s. ditën e çlirimit të Mekës u pastrua në shtëpinë e tij dhe i fali tetë rekate (thotë): “Nuk e kam parë që ndonjëherë ishte falur aq lehtë (shpejtë), por ai e plotësoi rukunë dhe sexhden.” (Buhariu)*

*“Kur i Dërguari s.a.v.s. e ngrinte kokën nga rukuja, drejtohej në këmbë dhe rinte ashtu, derisa dikush thoshte: “ka harruar”, e kur e ngrinte kokën nga sexhdeja, qëndronte derisa dikush thoshte: “ka harruar.” (Muslimi)*

*“Kur i Dërguari s.a.v.s. binte në ruku drejtohej, nuk e ulte kokën teposhtë e as nuk e ngrinte lart, duart i vinte mbi gjunjë.” (Nesaiu, Albani thotë se hadithi është sahih)*

*“Vërtet Allahu qesh me tre njerëz: njeriun që ngrihet natën, pastrohet bukur dhe falet, njeriun që e zë gjumi në sexhde...” (Bezzari)*

Është urtësi që të ujdism një program në namazin tonë që do të kujdeset për këto dy lëvizje të rëndësishme, të mos i shpërfillim e me këtë të shpërfillim edhe namazin dhe gjithë punën. Shqiptimi i tri *tesbiheve* (të thënë subhanallah) në ruku mund të merr dy sekonda e më pak, siç bëjnë disa, por mund të merr edhe më shumë, nëse duam që t'ia japim hakun çdonjërit tesbih; mendimin e thellë për çdonjërin, studimin dhe imagjinimin se për çfarë e madhërojmë Allahun e Madhërishëm. Sikur të rizbulonim çdo fjalë që e themi, pasi ta kemi hequr pluhurin e spontanitetit dhe adaptimit, do të thoshim: Ç'nënkupton falja (**subhane**)? Pse (**subhane**)? Ç'kuptim ka (**el-adhim**)? Pse (**el-adhim**)? Ç'kup-

tim ka (a'ala)? Pse (e'ala)? Kështu duhet të jemi me çdo fjalë që e shqiptojmë në namaz, nga tekbi i fillestar e deri te përshëndetja e fundit me selam.

A thua dyshon në aftësinë tënde për ta zotëruar vetveten që shpejton dhe djallin tënd i cili dëshiron që rukunë dhe sexhden ta bësh sa më shkurtër, e me këtë të humbasësh tërë shpërblimin tënd dhe shumicën e kapitalit? Mirë, atëherë çfarë duhet bërë? Si zgjedhje e mundshme le të jetë përkushtimi yt për lutjet dhe tesbihet shtesë që i shqiptojmë në ruku dhe sexhde e që shtojnë kohën e tyre! Mos mendo shumë, sepse i Dërguari s.a.v.s. të ka ndihmuar për këtë dhe të ka propozuar këtë zgjedhje, të cilën vetë ai e praktikonte në ruku dhe sexhde, pas tri tesbihëve të zakonshme.

*"I Dërguari s.a.v. .s. në ruku dhe sexhde thoshte shumë – pas tesbihëve: "Subhaneke Allahumme rabbena leke-l-hamdu, Allahumme igfir li"..." (I Përlavdëruar je Ti, o Zot, Allahu ynë, Zoti ynë, Ty të takon falënderimi, Allahu ynë, më fal mua). (Muslimi)*

*"I Dërguari s.a.v.s. në ruku dhe sexhde thoshte: "Subbuhun Kuddusun, rabbu'l-melaiketi ve'r-rruh" (Muslimi)*

*"I Dërguari s.a.v.s. kur e ngrinte kokën nga rukuja, thoshte: "Rabbena leke'l-hamdu, mil'es-semavati ve mil'el-erdi ve mil-e ma shi'te min shej'in ba'd, ehlu thinai vel-mexhdi, ehakku ma kale el abdu, ve kuluna abdun, Allahumme la mania lima a'tajte ve la mu'ti lima mena'te, ve la jenfeu dhe'l-xheddi minke 'l-xheddu." (O Zoti ynë, Ty të takon falënderimi, sa janë të mbushur plot qiejt dhe sa është e mbushur plot toka dhe sa është e mbushur plot ajo që Ti e do pas kësaj, Ti meriton mirënjohjen dhe lavdërimin, është e vërteta që e thotë robi, e ne të gjithë jemi robërit e Tu, Allahu ynë, nuk ka kush që e pengon atë që Ti e jep, dhe nuk ka kush që e jep atë që Ti e pengon, nuk bënë dobi i pasuri e as pasuria e Tij." (Muslimi)*

*“I Dërguari s.a.v.s. në sexhde thoshte – pas tesbihëve – “Allahumme igfir li dhenbi kul-lehu, dikkahu ve xhel-lehu, ve evvelehu ve ahirehu. Në transmetim tjetër: “alanijjetehu ve sirrehu” (Allahu im, më fal gjithë gjynahun tim, të vogël e të madh, të parin e të fundit, të dukshmin e të padukshmin). (Ebu Davudi, Albani thotë se hadithi është sahih)*

*“Ishte nata e ime me të Dërguarin s.a.v.s., e ai doli. Unë mendova se doli për të shkuar te ndonjëra nga gratë e tij, dola edhe unë nga xhelozia, dhe kur e pashë atë në sexhde, si petku i shtrirë, e dëgjova që thoshte: “sexhde leke sevadi ve hijali, amene bike fuadi, rabbi hadhi jedi ve ma xhenejtu ala nefsi.” (Ty të ka ra në sexhde trupi im dhe imagjinata ime, ty të besoi zemra ime, o Zot, ja dora ime dhe ajo që ia bëra vetvetes.” (Ibn Näsër, Bezzari, Hakimi, Albani thotë se hadithi është sahih, Aisha r.a.)*

*“Një natë e kërkova të Dërguarin s.a.v.s. dhe e gjeta në xhami, ishte në sexhde... thoshte: “eudhu biridake min sehatike, eudhu bi muafatike min ukubetike, eudhu bike minke, la uhsi thenaen alejke, ente kema ethnejte ala nefsike.” ( Kërkoj mbrojtje tek Ti me kënaqësinë Tënde nga zemërimi Yt, me faljen Tënde nga dënimi Yt, kërkoj mbrojtje te Ti nga Ti, Unë nuk mund të të falënderoj, ashtu siç Ti e ke falënderuar veten Tënde.” (Ebu Davudi, Aisha r.a.)*

*“...pastaj doli në vendin e faljes dhe u fal, filloi të thoshte në namazin e tij apo në sexhde: “Allahumme ixhal fi kalbi nuren, ve fi sem'i nuren, ve fi besari nuren, ve an jemini nuren, ve an shimali nuren, ve emami nuren, ve halfi nuren, ve fevki nuren, ve tahti nuren, vexh'al li nuren- vexh'alni nuren)” (Allahu im, bëj në zemrën time dritë, në dëgjimin tim dritë, në shikimin tim dritë, në të djathtë dritë, në të majtë dritë, para meje dritë, pas meje dritë, mbi mua dritë, nën mua dritë, më bëj mua dritë ose më bën dritë). (Muslimi, Aisha r.a.)*

*"I Dërguari s.a.v.s. midis dy sexhdeve në namaz të natës thoshte: "Rabbi igfir li, verhamni, vexhburni, verzukni, verfa'ni." (O Zoti im, më fal, më mëshiro, më mbro, më furnizo dhe më ngrit lart). (Ibn Maxhe, Albani thotë se hadithi është sahih)*

Transmeton Ali ibn Ebi Talibi – Allahu i Madhërisëm qoftë i kënaqur me të – se i Dërguari s.a.v.s.: "...kur binte në ruku, thoshte: *"Allahumme leke reka'tu, ve bike amentu, ve leke eslemtu, hashea leke sem'i ve besari ve muhi, ve adhami ve asabi."* (Allahu im, Ty të përkulem, ty të dorëzohem, Ty të përulet dëgjim im, shikimi im dhe truri im, ashti im dhe nervi im). E kur e ngrinte kokën lart, thoshte: *"Rab-bena leke'l-hamdu, mil-es-semavati ve mil-e-l-erdi ve mil-e-ma bejnehuma"* (O Zoti ynë Ty të takon falënderimi, sa janë të mbushur plot qiejt dhe sa është e mbushur plot toka dhe sa është e mbushur plot mes tyre). Kur Pejgamberi s.a.v.s. binte në sexhde, thoshte: *"Allahumme leke sexhedtu, ve bike amentu, ve leke eslemtu, sexhde veshhi li'l-ledhi halekahu ve savverehu, ve shekka sem'ahu ve besarehu, tebareke Allahu ahsene'l-halikin"* (Allahu im, vetëm Ty të përulem, vetëm Ty të besoj, vetëm Ty të dorëzohem, fytyra ime i ra në sexhde Atij që e ka krijuar, Atij që ia dha formën, që ia hapi dëgjimin dhe shikimin (vrmat), i Lartësuar është Allahu, Krijuesi më i mirë). Prej gjërave që i thoshte në fund, pas teshehudit dhe selamit, ishte: *"Allahumme igfir li ma kedemtu ve ma ehhertu, ve ma esrertu, ve ma a'lentu, ve ma esref-tu, ve ma ente a'lemu bihi minni, ente el-mukaddim ve ente el-muehhir, la ilahe il-la ente"*. (Allahu im, më fal atë që e kam bërë dhe për atë që kam harruar të kërkoj falje, atë që e kam bërë fshehtas dhe haptas, për atë që e kam tepruar, e Ti e di më mirë se unë, Ti je i Pari dhe i Fundit, nuk ka zot tjetër përveç Teje." (Muslimi)

Është e natyrshme që ky program në ruku dhe sexhde të reflekton në çdo lëvizje tjetër të namazit, përndryshe ru-

kuja dhe sexhda do të ishin në një anë, e namazi në anën tjetër, asnjëra nuk do të kishte lidhje me tjetrën. Dëgjo këtë perfeksion të plotë i lëvizjeve të Dërguarit s.a.v.s. në namazin e tij: “Tregon Ebu Humejd es-Saidi se derisa ishte i ulur me disa nga shokët e të Dërguarit s.a.v.s., e përmendën namazin e të Dërguarit s.a.v.s., ai tha: “Unë jam ai që më së miri e mbaj mend namazin e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.: *“E kam parë që kur merrte tekbir, duart i ngrinte deri në drejtim të shpatullave, ndërsa kur përkulej në ruku, ai i vendoste dy duart në kupat e gjunjëve dhe përkulej duke e mbajtur kurrizin shtrirë drejt, pastaj e ngrinte kokën dhe qëndronte drejt, derisa i gjithë kurrizi kthehej në qëndrim të zakonshëm. Kur binte në sexhde, ai i vendoste dy duart përtokë me parakrahët larg tokës dhe larg grupit, ndërsa gishtat e këmbëve të përkulur nga përpara në drejtim të Kiblës. Kur ulej pas dy rekateve, ulej mbi këmbën e majtë, ndërsa të djathtën e mbante të mbështetur me gishtat e këmbëve të përkulur nga përpara. Kur ulej në rekatën e fundit, e shtynte këmbën e majtë përpara, ndërsa të djathtën e mbante (po ashtu) të mbështetur dhe ulej ndenjor.”* (Buhariu dhe Muslimi)

Shokët e të Dërguarit s.a.v.s. vepruan njëjtë, lëvizjet e tyre pas të Dërguarit ishin plot përkushtim dhe respekt, me qetësi të plot dhe kohë të saktë, që është pjesë esenciale e namazit, ashtu siç kërkon Islami ynë: *“Ne faleshim pas të Dërguarit s.a.v.s., e kur ai thoshte “semiallahu limen hamideh” – asnjëri nga ne nuk fillonte me ulje në tokë, derisa ai e lëshonte ballin në tokë.”* (Buhariu)

Kjo ka të bëjë me çdo lëvizje tjetër të namazit. Në hadithet e Buhariut dhe të tjerëve thuhet se i Dërguari s.a.v.s. nuk ngrihej nga rekatë i parë për në të dytin e as nga i dyti për në të tretin, vetëm pasi bënte një ulje të shkurtër, qoftë edhe disa sekonda: *“Transmeton Malik ibn el-Huvejrith se e ka parë të Dërguarin s.a.v.s. duke u falë, dhe kur ishte në rekatën e*

*parë ose të tretë, ai nuk ngrihej derisa ulej mirë, para se të ngrihej në këmbë”* (Buhariu)

Kjo ulje e shkurtër midis sexhdes dhe ngritjes në këmbë na jep më shumë përshtirshmëri dhe qetësi shpirtërore, sepse bënë ndarje të udhëtimit të gjatë të trupit, si në aspektin kohor ashtu edhe në atë hapësinor. Ai kalon nga ulja maksimale (sexhdeja) në ngritjen maksimale (ngritjen në këmbë); nga dy lëvizje të shkurtra, në kohë dhe hapësirë, e para nga sexhdeja në ulje, kurse e dyta nga ulja në këmbë, që lëvizjet tona para Allahut të jenë me sa më shumë edukatë, respekt, butësi, frikë dhe mirësi, duke mos marrë parasysh atë se gjaku që është mbledhur në kokë gjatë rënies në sexhde nuk mund të kthehet me shpejtësi, por kthehet në damarët e trupit me ngadalësi, kështu ruajmë shëndetin e trupit, zemrës dhe trurit.

Mbushjet (energjitë) e fuqishme shpirtërore që ndodhin në ruku dhe sexhde luajnë rol të madh në ngritjen e falësit nga niveli i ulët i tokës në lartësitë e qiellit (nga vlera tokësore në vlera qiellore), nga materializmi i tokës në shpirtëroren e *gajbit*.

Së pari vjen rukuja për të na dhënë një mbushje shpirtërore të përljes, modestisë, kënaqësisë, qetësisë, sigurisë pranë madhësisë së Allahut, fuqisë së Tij dhe madhërisë së Tij. Balli ynë në tokë provon ngritjen e shpirtit lartë. Kështu dalëngadalë afrohemi drejt çastit vendimtar të namazit tonë; të përsëndesim Allahun, ndërkaq që për këtë na nevojitet edhe një fuqi e madhe që na shtyn përpjetë, janë dy sexhdet, dy mbushjet e fuqishme një pas një që na shtynë edhe më shumë drejt lartësive, që na përgatisin për çastin e mrekullueshëm që do të na jep rastin për ta përsëndetur Krijuesin e Madhërishëm e t'i themi: *“Ettehijjatu li'l-lahi...*

Mbaj mend gjithmonë se fjala (**subhaneke**) në ruku dhe sexhde nuk është fjalë e thjeshtë, ajo ka të bëjë me Qenien e Lartë, se kurrë nuk ndodh që dikush të thotë (i përlëvdëruar mbret – subhane el-melik) apo i përlëvdëruara i dërguar – subhane resul). Kujtimi i kësaj të vërtete do të na bëjë më të përgatitur për qëndrim para Allahut, më paramendues të madhërisë së Tij, kur ne i drejtohem me këtë fjalë të veçantë e të dalluar. S'ka dyshim se nuk ka fjalë tjetër që zëvendëson këtë formë të kësaj fjale.

Mbaj mend se me shqiptimin e (**subhaneke**) – ne e pas-trojmë Allahun nga çdo dobësi, e me këtë ngrihem mbi çdo krijesë në gjithësi. T'i paramendojmë të gjitha arritjet dhe zbulimet moderne shkencore që flasin për madhësitë e fuqisë së Allahut, për çudirat e krijesës së Tij dhe gjerësisë së kozmosit. Kujto faktin që e zbuloi teleskopi kozmik Habel, atë se kozmosi vazhdimisht zgjerohet, me shpejtësi prej 100 bilionë mila në orë, në të gjitha anët (mu sikur që fryhet baloni). Kujto zbulimet e deritanishme të ekzistimit të 100 bilionë galaktikave në gjithësi, në secilën galaktikë ka 70 deri 100 bilion yje! Po çfarë është puna me galaktikën më të largët të zbuluar deri tani? Se ajo është larg nesh 13 bilionë vite drite.

Kujto çfarë të duash, le të jenë gjëra që të ndihmojnë paramendimin e madhërisë së Allahut, fuqisë së Tij, çdoherë që bie në ruku dhe sexhde, e ti shqipton (**subhane rabbijje'l-adhim dhe subhane rabbijje'l-a'la**).

**Tesbihët** llogariti adhurim e jo traditë.

Bëje namazin tënd adhurim e jo traditë.

Nëse **Allahu ekber** (Allahu është më i madh) është shprehja që të jep fuqi të ballafaqohesh me vështirësitë e jetës, kurse **el-hamdu li'l-lahi rabbi'l-alemin** (falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve) të bënë t'i shijosh të mirat e Allahut dhe mirësinë e Tij për ty, atëherë **subhane rabii-**

**jje'l-adhim** dhe **subhane rabbijje'l-a'la** të japin fuqinë e imagjinimit, studimit dhe njohjes.

Në fund, sexhdeja dhe zgjatja e saj sikur na jep rast që sa më shumë gjak të depërton vullshëm kapilaret më të imëta e më të ngushta të gjakut, në kokën tonë dhe në rrokët e trurit tonë, që zemra jonë nuk do të kishte arritur me vjet të tëra ta bënte këtë.

## Pjesa 2

### Çelësi i kuq numër 3

#### *Ettehijjatu li'l-lahi...*

*“Kur të faleni drejtoni rreshtat tuaj, pastaj njëri prej jush le të del imam, e kur ai të merr tekbir, edhe ju merrni tekbir, e kur të lexoj, ju heshtni, e kur ta lexojë “Gajri-l-magdubi alejhim veledalin”, thoni Amin, do t’ju dojë Allahu. E kur imami të merr tekbir dhe të shkojë në ruku, edhe ju merrni tekbir dhe shkoni në ruku. Vërtet imami shkon në ruku para se ju të shkoni dhe ngrihet para se ju të ngriheni. Kujdesuni për njëra-tjetrën. E kur imami të thotë “Semiallahu limen hamideh”, ju thoni: “Allahumme rab-bena leke-l-hamdu”, ju dëgjon Allahu juve. E kur imami të merr tekbir për në sexhde, edhe ju merrni tekbir dhe shkoni në sexhde. Vërtet imami shkon në sexhde para juve dhe ngritët para juve, por kujdesuni për njëra-tjetrën. Kur imami të ulet, fjalët e para të ju-aja le të jenë: “Ettehijjatu lil-lahi ves-salevatu vet-tajjibatu, es-selamu alejke ejuhen-nebijju ve rahmetullahi ve berekatuhu, ess-selamu alejna dhe ala ibadi-l-lahi es-salihine. Eshhedu en la ilahe ila-llahu ve eshhedu enne Muhameden abduhu ve resuluhu.” (Albani thotë hadithi është se sahih, Sahih el-Xhami’)*

*“Ne nuk e dinim çfarë të themi në çdo dy rekate, vetëm se e lavdëronim, madhëronim dhe falënderonim Zotin tonë, por i Dërguari s.a.v.s. që i dinte fillimet e të mirave dhe fun-*

din e tyre, tha: “Kur të uleni në dy rekate, thoni: “*Ettehiyyatu lil-lahi ves-salevatu vet-tajjibatu, es-selamu alejke ejjuhen-nebijju ve rahmetullahi ve berekatuhu, ess-selamu alejna dhe ala ibadi-l-lahi es-salihine. Eshhedu en la ilahe ila-llahu ve eshhedu enne Muhameden abduhu ve resuluhu.*” Pastaj çdokush le të lutet me çfarë të dojë dhe i pëlqej, le t’i lutet Allahut të Madhërishëm.” (Albani thotë se hadithi është sahih, Abdullah ibn Mes’udi)

A e kuptojmë vërtet vlerën e hapjes së dymës para nesh për të hyrë tek Allahu, që t’i themi: “Ettehiyyatu lilahi... Përshëndetjet për Allahun!)? Të përshëndes Ty, o Zoti im?!

Sikur këtë t’ia themi ndonjë individ me post të lartë, me autoritet e pushtet, a thua çfarë do të kishim bërë para se të ndodh takimi me të?

Me çfarë sapuni do të ishim larë? Çfarë rroba do të kishim veshur? Çfarë këpucë do të kishim blerë? Me çfarë parfumi do të ishim parfumosur? Si do të dukeshin vijat e fytyrës sonë, lëvizjet e gjymtyrëve të trupit para tij? Shumë gjëra do të na vinin ndërmend para se të takoheshim me këtë individ të kësaj dynjaje që një ditë vdes...

Para derës na pret roja, që bën kontrollin nga koka e deri te shputat e këmbëve, me sy të mprehtë vëzhgojnë çdo gjë që kemi në trup, për t’u vërtetuar se pamja, forma dhe rrobat tona janë të përshtatshme për këtë takim, bile afrohen më afër që të vërejnë se era e parfumit tonë është e përshtatshme, ndodh të përdorin mjete elektrike moderne se mos ndoshta kemi fshehur nën rroba diçka që nuk e duan, e pas kësaj ndodh të ketë edhe disa procedura të tjera, disa herë nënçmuese, para se të lejojnë të hymë tek “ekselenca” e tij, për t’i thënë: Përshëndetje...

Ndërkaq, kjo nuk ndodh në namaz, në çastin kur ne përshëndesim krijuesin e krijesave, Drejtuesin e qiejve dhe të Tokës, Syrin që kurrë nuk kotet e as nuk fle, Atë që kurrë nuk ligështohet e as lodhet, Atë që kurrë nuk ndalet nga

puna ditë e natë, nga ezeli e deri në përjetësi. Çasti i arritjes sonë në fazën e përshëndetjes nënkupton se kemi arritur në platformën kryesore ku do të shprehim përshëndetjen. Allahu ynë, ja tani kemi filluar të hymë në eskortën e gjerë të kënaqësive, lumturive, shpërblimeve të mëdha, skenave shpirtërore etj.

**Ettehijjatu li'l-lahi...** vjen në formë të veçantë, që vlen për Allahun, e për askënd tjetër, as për të Dërguarin e as për të dërguarit e tjerë s.a.v.s.

### *Ettehijjatu li'l-lahi*

Përshëndetje me veçori të pakrahasueshme (superiore), me trajtë përpilimi të veçantë që dallohet nga çdo përshëndetje tjetër:

**Ettehijjatu... es-salevatu... ez-zakijatu... el-mubarekatu...**

**Ettehijjatu lilahi** – shprehje që nuk duhet të na kalojë shpejtë, doemos të merr kohën e duhur që të mund të imagjinojmë dhe të kuptojmë atë që e themi, atë që jemi duke bërë: jemi duke përshëndetur Allahun... ajetet që i lexuam, shprehjet e tesbihut, tahmidit e tekbitit që i shqiptuam, kënaqësia, freskia shpirtërore, qetësia e plotë dhe siguria absolute që e ndiejmë gjatë kësaj, të gjitha këto janë në një krah, kurse përshëndetja e Allahut dhe ettehijjati i Tij, me këtë trajtë të dalluar është në një krah tjetër.

Është **ettehijjatu** e jo **es-selamu**, sepse **es-selamu ala** nënkupton lutjen për dikë, siç themi (er-rahmetu li fulanin – mëshira qoftë për filanin) ose (el-mevtu li filanin – vdekje për filanin), janë pra lutje për mëshirë e vdekje. Ne këtu nuk lutemi për Allahun e Madhërishëm e të Lartë, por i lutemi dhe kërkojmë prej Tij. Mu për këtë ettehijjatu merr trajtën e zhveshur nga çdo formë lutëse, ndërkaq që përshëndetjet tjera në këtë ngërthejnë kuptimin e lutjes dhe zbritjen

e paqes mbi të Dërguarin tonë, mbi ne dhe mbi robërit e mirë (*esselamu alejke ejjuhe'n-nebijju... esselamu alejna... ve ala ibadi'l-lahi 's-salihine*).

Vërtet shprehje e merituar për ta përshëndetur Allahun në veçanti, vetëm me të, andaj t'i përkushtohemi me vëmendje të plotë kësaj shprehjeje, të shijojmë ëmbëlsinë e saj në shpirt para se të kalojmë në përshëndetjet që vijojnë.

Gjithmonë jam pyetur: si ndodh që në namaz ta përshëndesim Allahun vetëm me emrin e Tij, pa ndonjë atribut tjetër, ndërsa kur përshëndesim dikë tjetër, kryetarin, mbretin, komandantin, para emrit të tyre themi gjëra të tjera, si p.sh. zotëria juaj, ekselencia juaj, madhëria juaj etj? Por, m'u bë e qartë se në të vërtetë kësaj përshëndetjeje i paraprijnë disa attribute dhe falënderime të panumërta..

Filluam me tekbir, me lutjen fillestare, mirënjohjen, Fatihanë, atributet që ajo i ngërthen, emrat e Tij të bukur: rabbu-l-alemin, errahman, errahim, maliki jeumi ddin; pastaj atributet dhe emrat e bukur që i lexuam në ajete. Lavdërimi bëhet edhe më i përqendruar dhe më i shpeshtë kur fillojmë t'i shqiptojmë këto tri shprehje njëra pas tjetrës: **Allahu ekber... subhane rabbijje'l-adhim** (tri herë) ... **rabbena leke'l-hamdu... Allahu ekber... subhane rabbijje'l-a'la** (tri herë)... **Allahu ekber** (një herë në fund), para se të ndalemi para platformës kryesore dhe përshëndetjen e drejtpërdrejtë për Qenien e Lartë: **Ettehijjatu li'l-lahi...**

Ulja në prag të përshëndetjes na ndihmon të përqendrohemi, të qetësohemi, t'i nënshtrohemi dhe t'i drejtohemi me sinqeritet dhe bukuri Allahut të Madhërishëm, të kujtojmë se këtë përshëndetje të jashtëzakonshme e bëjmë vetëm për Krijuesin Madhështorë.

Pastaj, zgjatja e dyfishtë me të cilën mbarojnë shprehjet të cilat e përbëjnë tehiatin: ettehija-aa-t, li'l-laaah, ves-sale-va-aat, ve't-tajjiba-aat, el-mubareka-aat. Siç vërejmë, shprehjet

e tilla në vete ngërthejnë edhe theksin e përgjërimit, kërkesës dhe lutjes, shpirtin e përruljes dhe nënshtrimit. Këtu hasim 16 apo 18 zgjatje horizontale që bëjnë rrugën tonë të lehtë e të hapur për ngritjen e shpirtit drejt qëllimit final: Allahut.

Është i çuditshëm fakti se struktura gjuhësore e veçantë e “ettehijatu li’l-lahi” vlen vetëm për namazin, atë nuk e hasim jashtë namazit, qoftë në Kur’an ose në hadith, ku hasim tesbihe, tevhide, tahmide, takdise, por jo ettehijjat. Ne ndodh të lexojmë: subhanallah, el-hamdu li’l-lah, la ilahe illa’l-lah, la kuvvete il-la bi’l-lah, subhane’l-ledhi, tebareke’l-ledhi, amentu bi’l-lah, tevekkeltu ala’l-lah, subbuhun kuddusun, por jo “ettehijatu li’l-lah”!

A e kupton tani se ç’do të thotë ta përshëndesësh Allahun? Vlerën e asaj që e thua para Tij, çastin kur Ai të sheh, mbi Arshin e Tij, te Sidreti Munteha, hapësirën e pafund, atje ku është Xheneti: Të përshëndes, o Allahu im!

Hapat e bëra më parë ishin vetëm periudha përgatitëse që të ndihmojnë të fitosh këtë çast madhështor, që të mbushin me energji të mjaftueshme shpirtërore për ta kaluar këtë rrugë të gjatë, që në fund të bënë të përgatitur për këtë qëndrim të jashtëzakonshëm, për shpërblim të jashtëzakonshëm: ta përshëndesësh Allahun..

Çfarë qëndrimi madhështor dhe çfarë çasti i mrekullueshëm? Përjetim i të gjitha dimensioneve të tij, ndjenjë se vërtet jam duke e përshëndetur Allahun dhe po flas me Atë, drejtpërdrejt, pa ndërmjetësim! Allahu është më i Lartë dhe më Madhështor.

Edhe nëse ky takim nuk të shpërblen me shpërblim fisnik e madhështor që të pretë te dera, edhe pse do të ndodh së shpejti, është vetë takimi ai që kultivon ndjenjën e vërtetë e të ëmbël në shpirt, që llogaritet shpërblim mbi shpërblim, kënaqësi mbi kënaqësi, shpërblim që nuk ka send që i del përpara...

### Pjesa 3

## Hapësirat e gjelbra në ettehijatu

Në lutjet “ettehijatu” jemi para katër përshëndetjeve të ndryshme madhështore, jo vetëm një.

Së pari ballafaqohemi me Krijuesin e Madhërishëm të Cilin e përshëndesim me përshëndetje të veçantë e të këndshme, që vlen vetëm për Allahun e Lartëmadhëruar (**ettehijatu li'l-lah**), pastaj përshëndesim të Dërguarin s.a.v.s., përshëndetje me aromë të veçantë (**esselamu alejke ejjuhe'n-nebijju**), dhe vetëm atëherë fillojmë me pranimin e shpërblimit të madh, atëherë kur përshëndesim veten tonë me përshëndetjen e tretë të çuditshme (**esselamu alejna**), kjo para se të përfundojmë me përshëndetjet e shenjta, çastin kur i përshëndesim të gjithë (**ibadi'l-lahi's-salihin**).

Midis këtyre katër përshëndetjeve kultivohen një numër i “hapësirave të gjelbra”, që janë element i rëndësishëm gjuhësor në namaz. Është me rëndësi të kuptojmë se Allahu i Madhërishëm deshi që përshëndetja e besimtarit për Të në namaz të jetë e gjatë (duke i marrë parasysht zgjatjet dhe hapësirat kohore që krijohen midis tyre që jep mundësi për imagjinim), pjellore dhe e gjelbër. Ai dëshiron që të ketë kohë të mjaftuar për të ndier mëshirën dhe bekimin e Tij që zbret nga qielli e bie mbi kokën e besimtarit.

**Esselamu alejke ejjuhe'n-nebijju** – shprehja nuk ndalet te shqiptimi i fjalës “nebijju”, por kalon menjëherë te përshëndetja e tretë “**esselamu alejna**”. Para kësaj krijohet një zonë e lirë që për disa sekonda na mundëson kënaqësinë e imagjinimit të domethëniesve të larta “**ve rahmetu'lllahi.. ve berekatuhu...**”.

**Ve ala ibadi'l-lahi 's-salihine** – një hapësirë e gjelbër që mundëson shpërblime të panumërta, tre shprehje që në një hapësirë kohore përfshijnë të gjithë ata të mirë, lutjen

për mëshirë dhe paqe që do t'i kaplojë ata dhe ne së bashku, e çfarë të themi për kënaqësinë me ndjenjat e qetësisë së plotë të pranimit të shpërblimit nga Allahu i Madhërishëm për çdo individ të cilin e ka prekur përshëndetja jonë universale?!

## Pjesa 4

### *Esselamu alejke ejuhe'n-nebijju*

Sapo e përshëndetëm Zotin tonë, Ai tani na shikon, e dëgjon përshëndetjen tonë, pranon salavatet tona për Atë, të bekuara dhe të freskëta (tajjibat dhe mubarekat), vallë, a thua do ta dëgjojmë përgjigjen e Tij për këtë përshëndetje? A thua në çfarë forme do të jetë përgjigja e Tij për përshëndetjen tonë? Si do ta vendos në gjuhën tonë e ta dëgjojmë sikur vjen prej Tij, i Lartëmadhëruar qoftë Allahu?

Mirëpo, para se të pranojmë këtë përgjigje, doemos të plotësojmë përshëndetjen në fjalë, të përshëndesim të Dërguarin s.a.v.s., atë që barti misionin madhështor, emri i të cilit gjithmonë është pranë emrit të Tij, nuk ndodh që dikush të thotë **“La ilahe ilallahu”** e të mos thotë **“ve enne Muhammeden resulullah”**.

Ne përshëndesim krijesën më të dashur të Allahut, më të dashurin për ne, dy kënaqësi që nuk mund t'i ndajmë njëri nga tjetra, prandaj i japim vetes kohë të mjaftuar që të mos e tejkalojmë këtë ndalim përveçse të kemi shijuar kënaqësinë e kësaj përshëndetjeje:

- Kënaqësinë e përshëndetjes së të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. sikur na shikon, sikur është para nesh, ndërsa sapo kemi dalë nga përshëndetja e Zotit tonë, sikur të jetë para nesh, me kënaqësinë e bindjes se Ai na dëgjoji kur e përshëndetëm.

- Kënaqësia kur Ai na përgjigjet, veçmas kur e dimë dhe jemi të bindur se Allahu ia kthen jetën në varr, jo për tjetër, por vetëm për të na u përgjigjur me përsëritje.

*“Kush më përsëritet te varri im, unë e dëgjoj, e kush më përsëritet nga larg, unë njoftohem për të.”* (Sehaviu)

*“Allahu ma kthen shpirtin derisa ta përsëritet çdo musliman që më përsëritet mua.”* (Ibn Tejmijje në Mexhmua el-fetava dhe Neveviu, Ebu Hurejre)

*“Më përsëritetni sa më shumë, sepse Allahu ka caktuar një engjëll te varri im, që kur dikush nga Umeti im më përsëritet, engjëlli më thotë: “O Muhamed, filani i biri i filanit të përsëritet tani.”* (Albani thotë se hadithi është hasen, Sahih el-Xhami', Ebu Bekër es-Siddiku)

Mrekullia dhe kënaqësia e paparë qëndron në atë kur e dimë që Allahu i Madhërishëm merr përsipër kthimin e përsëritjes, vetë Ai përsëritet robërit që e përsëriten me selam dhe salevat të Dërguarin e Tij, siç konfirmon hadithi kudsij në vijim: *“Transmeton Abdurrahman ibn Auf dhe thotë: “Hyra në xhami, ndërkaq i Dërguari i Allahut s.a.v.s. po dilte nga xhamia. Fillova ta ndjek e të shkoj pas tij, ai nuk e dinte. Hyri në një vend të hurmave, u drejtua kah kibla, ra në sexhde dhe e zgjati atë shumë. Unë isha pas tij, mendova se mos Allahu ia morri shpirtin. U nisa për tek ai derisa arrita, ula kokën dhe e shikoja fytyrën e tij. Ai e ngriti kokën, dhe tha: “Çfarë ka ndodhur, o Abdurrahman?” Thashë: “O i Dërguari i Allahut, kur të pashë se e zgjate sexhden, u frikova se mos Allahu i Madhërishëm ta ka marrë shpirtin, prandaj erdha të shoh.” Ai tha: “Unë kur hyra në vendin e hurmave më takoi Xhibrili, dhe më tha: “Të përgëzoj (O Muhamed) se Allahu thotë: “Kush të dërgon selam ty, Unë i dërgoj atij selam, e kush të dërgon salevat ty, Unë atij i dërgoj salevat.”* (Ibn Mulkin)

*“Më dërgoni shumë salevat mua ditën e xhuma, sepse Xhibrili më erdhi tani me lajm nga Zoti i tij i Lartëmadhëruar, që thotë:*

*“Nuk ka musliman në tokë që ty të dërgon salevat një herë, e Unë dhe engjëjt e Mi të mos ia kthejmë me dhjetë herë.”* (Albani thotë hadithi është hasen, Sahih et-Tergib)

Çfarë shpërblimi i madh! A mundemi të imagjinojmë vlerën e salevatit për ne që na vjen nga Allahu i Madhërishtëm?! Që Ai të na dërgon salevate dhe selame?! Vlerën e miliona engjëjve që na dërgojnë gjithashtu salevate dhe selame?! Jo një herë, por dhjetë herë një pas një!? Pastaj të mos harrojmë se këto salevate kudsijje përsëriten çdoherë, gjatë ettehijsatit në namaz dhe jashtë ettehijsatit! Çfarë përsëritjeje e shejntë për ne që na vjen nga qielli i lartë! Çfarë shpërblimi se?! Çfarë pasurie?!

Tani kur e kemi përsëritur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. dhe atë e kemi bërë në mënyrë të përsosur, vjen koha të pranojmë nderin e lartë Hyjnor, një përsëritje tjetër, pas shpërblimit të marrë për përsëritjen e të Dërguarit të Tij fisnik s.a.v.s., një shpërblim të madh që pason pas atij të parit, e që është çelës i kuq i çelësive të fuqisë së lartë shpirtërore që na furnizon në namaz.

## Pjesa 5

### Çelësi i kuq numër 4

#### *Esselamu alejna ve ala ibadi'l-lahi 's-salihine*

Nuk është vetëm përsëritje, por është shpërblim i madh që e marrim në çastin e hyrjes tek Allahu dhe përsëritjen tonë për Atë dhe për të Dërguarin e Tij s.a.v.s.

Gjatë vizitës së ndonjë kryetari ose mbreti, vërejmë se dyert e pallatit mbretëror janë të hapura, kur ne lëshojmë atë dhe, shpërndahen dhurata të çmuara për çdonjërin që kalon. Ato nuk mund të jenë dhurata të rëndomta, por dhurata të çmuara që i përshtaten oborrit mbretëror.

E çfarë do të mund të ishte dhurata e Krijuesit të krijesave, qiejve dhe Tokës, nëse shkojmë dhe e përshëndesim? S'ka dyshim se dhurata e Tij është shumë herë më e madhe seç mund ta imagjinojmë. Janë miliarda e miliarda shpërblime, sa është numri i krijesave të Allahut dhe sa është numri i robërve të Tij të mirë, në qiej dhe në Tokë, qysh nga krijimi i Ademit e deri në Ditën e Ringjalljes. Të gjithë këta do të na përshëndesin tani, pasi kemi përshëndetur të Dërguarin e Tij s.a.v.s., pasi kemi përshëndetur veten tonë dhe ata përreth (**alejna**). Përshëndetja e radhës përfshinë të gjithë ata që Allahu i ka krijuar, robër të Tij të mirë në botë:

*Esselamu alejna ve ala ibadi'l-lahi 's-salihine*

A mund ta paramendojmë numrin e robërve të mirë që i përfshinë përshëndetja jonë? Pastaj, a mund ta paramendojmë sasinë e shpërblimit që e kemi arritur me përshëndetjen e gjithë këtyre? Në jetën e përditshme ndodh t'i përshëndesim robërit e Allahut kudo që i takojmë, në shtëpi, rrugë, xhami, shkollë, punë etj. I Dërguari i Allahut s.a.v.s. thotë: “Kush thotë: “Esselamu alejkum” – i shkruhen dhjetë të mira; e kush thotë: “Esselamu alejkum ve rahmetullah” – i shkruhen njëzet të mira; kurse kush thotë: “Esselamu alejkum ve rahmetullahi ve berekatuhu” – i shkruhen tridhjetë të mira.” (Albani thotë se hadithi është sahih)

Sa është numri i robërve të mirë të Allahut në qiell? E sa është numri i tyre në Tokë? Po sa është numri i tyre që janë midis Tokës dhe qiellit? E sa është numri i shpërblimeve që e marrim për këtë përshëndetje në fund? Çfarë bujarie dhe çfarë mirësie dhe çfarë shpërblimi?!

Gjatë shqiptimit të kësaj përshëndetjeje të dyfishtë në namaz doemos të ndiejmë shpërblimin e dyfishtë që zbret në ne:

1. Shpërblimin e përshëndetjes së pakufishme të Allahut, që zbret mbi ne, familjen tonë dhe të dashurit tanë (**esselamu alejna**).

2. Shpërblimin e sasisë së pakufishme të të mirave, që ndiejmë se si depërtojnë në ne, që na pastrojnë me qetësinë shpirtërore, nga koka e te shputat e këmbëve, shpërblim për përshëndetjen e këtij grupi të madh të (**ibadi'l-lahi 's-salihine**).

Shprehja "**es-selam**" nuk nënkupton vetëm qetësinë, sigurinë dhe paqen, ajo është atribut i attributeve të Allahut të Madhërishëm, emër i emrave të Tij të bukur. Kur themi:

### *Es-selamu alejna*

Ndiejmë sikur e kemi pastruar veten me stuhi të fortë të erës së Allahut që nga ne largon njollat e jetës, lodhjeve, brengave dhe dhembjeve të saj. Mos të lejojmë që gjatë kësaj përshëndetjeje të na shkoj huq rasti i kënaqësisë së pakufishme për përshëndetjen e Allahut për ne që na pastron njollat tona, të dalim nga namazi sikur kemi lindur përsëri... pa brenga, pa shqetësime, pa mllef, pa kokëdhembje, pa sëmundje, gjëra që ishin me ne para se të fillojmë të falemi! Po si ndodhi kjo? Furtuna e erës së selamit të Allahut na pastroi me fuqi të madhe dhe me vrull të madh!

Kjo duhet të ndodh me shqiptimin e selamit për ne dhe për familjen tonë, kur takohemi me ta. Me rëndësi është të dimë se selami nuk është vetëm për ne, por për të gjithë ne:

### *Alejna*

Është dallim i madh midis përshëndetjes së vetvetes dhe përshëndetjes së gjithë atyre që i kemi përreth: miq, të afërm, të largët, dhe besimtarë, pastaj edhe atyre që formojnë karvanin e pakufishëm të besimtarëve të mirë, në Tokë e

në qiell dhe midis tyre, për të gjithë fitojmë shpërblime të mëdha që kurrë nuk mbarojnë: *“Kur faleshim me të Dërguarin s.a.v.s., thonim: “Esselamu ala’ll-llahi kable ibadihi (Paqe për Allahun para robërve të Tij), esselamu ala Xhibril (për Xhibrlin), esselamu ala Mikail (për Mikailin), esselamu ala fulan ve fulan (për filanin dhe për filanin). E kur mbaronte i Dërguari s.a.v.s. namazin, kthehej me fytyrë kah ne dhe thoshte: “Allahu është Paqe (Selam), kur dikush nga ju të ulet në namaz, le të thotë: “Ettehiyatu li’l-lahi, ves-salevatu, ve’t-tajjibatu, esselamu alejke ejuhu’n-nebijju ve rahmetullahi ve berekatuhu, esselamu alejna ve ala ibadi’l-lahi ‘s-salihine.” Se kur e thotë këtë, le ata dijë se e ka qëlluar çdo rob të mirë në tokë dhe në qiell. Eshhedu en la ilahe il-la’ll-llahu ve eshhedu enne Muhammeden abduhu ve resuluhu.” Pastaj le të zgjedh fjalë të cilat vetë i dëshiron (për lutje). (Buhariu)*

*“Thoni: “Ettehiyatu li’l-lahi ettajjibatu ve’s-salevatu ve’l-mulku li’l-lah, pastaj dërgoni selam për të Dërguarin dhe përsëndetni me selam të afërmit tuaj dhe veten tuaj, duke thënë: “Esselamu alejna.” (El-Ajni në Umdet ‘ul-Kari’)*

A e kupton tani sasinë e asaj që zbret mbi ty vetëm brenda një pjese të sekondës, kështu përnjëherë, miliarda shpërblime Hyjnore, jo njerëzore, e të përfshijnë me lumturi, të ngritin në qiellin e lartë çdoherë që e përsërit këtë përsëndetje të mrekullueshme? Sa dallim i madh midis shpërblimeve Hyjnore dhe atyre njerëzore, sado që të jenë të mëdha e të vlefshme!

Më kujtohet kur isha i vogël, pothuajse pesë apo gjashtë vjet, që luanim në oborrin e lojërave me fëmijët e tjerë. Më kujtohet se midis atyre lojërave kishte një kuti prej qelqi ku ishin vendosur shumë ëmbëlsira dhe gjëra të tjera. Aty duhej të futej një para dhe po të kishte fat, nga vrima e kutisë dilnin një, dy apo më shumë ëmbëlsira e gjëra të tjera. Unë kisha fat, sepse më dolën qindra gjëra të bukura. Më kujto-

het që shitësi m'i mbushi xhepat plot, nuk i zinte gjithë ato gjëra që i fitova. Isha shumë i lumtur, fluturoja nga gëzimi. Ky është gëzimi dhe kënaqësia e një fëmije të vogël me thesarin e tij. kjo nuk është asgjë në krahasim me shpërblimet apo thesaret që vijnë nga çdo anë, e të habitesh se si do t'i mbash të gjitha, ku do ti vendosësh të gjitha ato, e si do t'i numërosh të tillat, vetëm kur thua:

*Esselamu alejna ve ala ibadil-lahi es-salihine*

Shpërblime të mëdha për ettehijjatin, në namaz dhe jashtë namazit, për vetëm nëntë herë më së paku që e shqip-tojmë në namazet e ditës. A thua sa do të jetë numri i shpërblimeve ditore që i marrim? Po ato javore? Mujore? Vjetore? Të tërë jetës?

Nëse arrijmë ta paramendojmë këtë e njëherit ta ndiejmë kënaqësinë e kësaj, atëherë kjo do të na ndihmojë ta kuptojmë hadithin e të Dërguarit s.a.v.s. që vijon dhe dimensionet e tij të largëta: "I Dërguari s.a.v.s. i vëllazëroi dy njerëz. Ndodhi që njëri të ishte vrarë, kurse tjetri të kishte pësuar të njëjtën pas një jave. Muslimanët thanë: "O Allah, fale atë dhe bëje bashkë me shokun e tij." I Dërguari s.a.v.s. tha: "Po ku është namazi i tij në krahasim me namazin e këtij... puna e tij në krahasim me punën e këtij? Midis tyre ka dallim sikur midis qiejve dhe tokës." (Ebu Davudi, Albani thotë se hadithi është sahih)

A ka provë më të madhe dhe më madhështore se namazi është e "drejtë"? E drejtë e jo detyrë? Bile çfarë e drejte se? E çfarë shpërblimi! Thesare të pakrahasuara me thesaret e tokës! Vetëm një javë shtesë e namazit, siç pohon ky hadith, ngrit në shkallë sa është Toka e qielli, e çfarë mendojmë për namazet që zgjasin me muaj, vie, dhjetë vjet, tërë jetën? Sa kanë humbur ata që shpërfillin namazin e tyre apo janë neglizhentë për të, qoftë edhe për një ditë të jetës së tyre?!

Gjithmonë të dalim nga namazi me ndjenja të fëmijës që i ka mbushur xhepat plot shpërblime, i lumtur, i gëzuar dhe i sigurt.

## Pjesa 6

### *Eshhedu en la ilahe ilallahu ve eshhedu enne Muhammeden abduhu ve resuluhu*

Shumë herë e kam pyetur veten time për këto dy dëshmi: pse janë mu në këtë vend të namazit?! Pse nuk janë në fillim të namazit? Pas tekbirit fillestarë? Pas Fatihasë? Pse nuk janë në vend të përshëndetjeve me selam? Ose...?!

Është e drejtë e jona të parashtrojmë këso pyetje, jo për të kundërshtuar pozitën e tyre të tanishme, por, për shkak se jemi musliman të urdhëruar të mendojmë thellë dhe të shqyrtojmë me vëmendje gjërat e fesë sonë, të hulumtojmë interpretimin njerëzor të urtësisë që e kërkon praninë e kësaj në këtë vend apo diku tjetër, edhe pse vlerësimet dhe gjykimet tona njerëzore gjithmonë do të mbesin të paafta për të kuptuar në tërësi urtësinë Hyjnore të largët.

Po, shumë herë jam pyetur për urtësinë e dy dëshmimeve që janë në këtë vend. Më tërhoqi vëmendjen fakti se dëshmitë vijnë menjëherë pas selamit për veten tonë dhe robërve të mirë të Allahut (**esselamu alejna ve ala ibadi'l-lahi 's-salihine**), sikur namazi e lidh këtë përshëndetje me këtë dëshmi..

Si thua, kur ne përshëndesim me selam robërit e mirë të Allahut (**ibadi'l-lahi 's-salihine**), a jemi të regjistruar në listën e këtyre të mirëve tek Allahu? Në listën e atyre që shpërblehen për këtë? A e meritojmë që ne t'i përshëndesim këta? Që përshëndetja jonë të meritojë t'i përfshijë këtë, e me këtë, të meritojmë shpërblimin që do ta marrim me

përshëndetjen e këtij grupi të madh të robërve të mirë të Allahut, prej njerëzve ose engjëjve, banorë të Tokës apo të qiejve, në të kaluarën, të tashmen ose të ardhmen?

Me siguri se hadithi kudsij në vijim do të na hedh pak dritë mbi numrin e këtyre krijesave që jetojnë në botët për të cilat nuk kemi dëgjuar dhe nuk kanë dëgjuar për ne: *“Allahu i Madhërishëm tha: “O Xhibril! Unë kam krijuar mijëra popuj (Umete), që asnjëri nuk dinë se Unë kam krijuar diçka përveç tij; nuk i kam treguar për këtë Levhi Mahfudhit e as gërvimës së Lapsit. Unë kur dua diçka të bëj, vetëm i them: bëhu, e bëhet, nuk ia kalon kafi nunit (kun) – e krijoj më shpejtë se koha që merr kur shqiptojmë fjalën kun. (Dejlemiu)*

Që këtej themi se dëshmitë vijojnë për të konfirmuar anëtarësinë tonë në “klubin e të mirëve”, klubin kozmik gjigant. Siç konfirmon meritën tonë për përshëndetjen e tyre, pranimin nga ne, sepse dëshmojmë atë që edhe ata e dëshmojnë, besojmë atë që edhe ata e besojnë, vërtetojmë përkatësinë tonë të Umetit të njeriut që na udhëzoi për Zotin tonë dhe Zotin e tyre, të Dërguarin besnik, të Dërguarin e fundit, vulën e pejgamberisë!

Aroma e këtyre përshëndetjeve nuk na lë të kalojmë më tej fill pasi të ndiejmë kënaqësinë dhe ëmbëlsinë e përshëndetjes së atyre që i përshëndetëm më parë, pastaj ndjenjën e ëmbëlsisë dhe kënaqësisë për shpërblimet e mëdha fisnike që i morëm.

## Pjesa 7

### Salevatet për Ibrahimin alejhi's-selam

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. na mëson që lutjen tonë ta përfundojmë me salevat për të, në transmetim tjetër thuhet edhe për familjen e tij gjithashtu: *“Çdo lutje është e penguar, përderisa nuk dërgoni salevat për Muhammedin dhe familjen e*

*Muhammedit.*" (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih el-Xhami' dhe Sahih et-Tergib, Enes ibn Maliku, Ali ibn ebi Talibi etj)

Namazin e përfundojmë me salevatet për të Dërguarin s.a.v.s., kurorën e salevateve, salevatet ibrahimore, që ndoshta ngërthejnë pranimin e lutjeve tona, tesbihëve dhe leximin, që ndoshta vërtetojnë atë që Allahu na është përgjigjur.

Salevatet ibrahimore nënkuptojnë respektin e urdhrin të Allahut në Librin e Tij të urtë, respekt interaktivi me ajetin kuranor. Allahu i Madhërishëm kërkoi nga ne që gjithmonë të dërgojmë këso salevate për të Dërguarin e Tij s.a.v.s., sepse Ai dhe engjëjt e Tij pandërprerë i dërgojnë salevate të Dërguarit s.a.v.s.: *"Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për atë. O besimtarë, lutunu për atë dhe përshëndeteni me "selam".* (El-Ahzab, 56)

Siç vërejmë ajeti nuk vjen në kohën e kaluar, ai nuk thotë: "Allahu dhe engjëjt e Tij e bekuan të Dërguarin", sikur që ka ndodhë më herët e më nuk ndodhë, por vjen në kohën e tashme e të përherëshme "bekojnë", që nënkupton se bekimi i Allahut për të Dërguarin e Tij nuk ndërpritet, ai vazhdon pandërprerë dhe përgjithmonë. Allahu dhe engjëjt e Tij e besojnë të Dërguarin tani në këtë çast dhe përherë. Prandaj, muslimanët detyrohen të veprojnë njëjtë, bile pas salevatit për të të dërgojnë edhe selam. *"O besimtarë, lutuni për atë dhe përshëndeteni me "selam" – nënkupton mënyrën urdhëruese, salevati dhe selami qofshin për atë që Allahu dërgoi mëshirë për botët.*

Vërejmë gjithashtu se kur i dërgojmë salevat të Dërguarit fisnik apo e bekojmë atë, me mënyrën të cilën na e mësoi vetë i Dërguari s.a.v.s., se ky nuk është salevati ynë, por në fakt është salevati i Allahut për atë (Allahumme sal-li ala Muhammedin - Allahumme barik ala Muhammedin..). pra, ne nuk jemi ata që vërtet dërgojmë salevat ose e bekojmë

atë, por kërkojmë që Allahu ta bekojë të Dërguarin e Tij, Ai dhe engjëjt e Tij. Ndërkaq se si ndodh kjo që Allahu ta bekojë të Dërguarin e Tij dhe engjëjt e Tij, kjo është edhe një hapësirë e gjelbër e hapur që i lë imagjinatës sonë të mendojë për shumëçka, sidomos për natyrën e këtij salevati hyjnor.

Unë, si çdo herë, pyesja veten për fshehtësinë e lidhjes midis salevatit për të Dërguarin tonë fisnik s.a.v.s. dhe salevatit për Ibrahimin alejhi's-selam, bile më shumë se kjo, gjithmonë pyesja për fshehtësinë e salevatit për Ibrahimin dhe për familjen e tij gjithashtu...

Thosha më vete: pse për Ibrahimin? Pse në vend të Ibrahimit dhe familjes së tij të mos jetë Musai, Isai ose pejgamberët e tjerë, Allahu i bekoftë të gjithë?

Pse të jetë "salevat - bekim" e jo "et-tehijjat - përshëndetje"? Ç'nënkupton këtu salevati? Cila është natyra e tij? Ç'është kjo këmbëngulje për lidhjen midis salevatit për Muhamedin s.a.v.s. dhe salevatit për Ibrahimin alejhi selam: "*Allahumme sal-li ala Muhamedin ve ala ali Muhamedin, kema salejte ala Ibrahim ve ala ali Ibrahim*"? Pse kjo këmbëngulje në bekimin e tyre dhe familjes së tyre: "*Ve barik ala Muhamedin ve ala ali Muhamedin, kema barekte akla ibrahime ve ala ali ibrahime*"?

Në fund përsëri pyesja: pse të gjithë janë vendosur në hapësirë të pafund kohorë dhe vendor "*fi'l-alemin*"? pa përkufizim të kohës dhe vendit ku jetuan? Pse në fund vjen falënderimi dhe mirënjohja e pafund për Allahun "*inneke hamidun mexhid*"?

Pyetje që doemos të parashtrohen e të shqyrtohen. Për ne mbetet që vetëm të vlerësojmë nga aspekti ynë njerëzor, të vlerësojmë shkaqet apo disa shkaqe në bazë të aftësive tona njerëzore, që gjithmonë mbeten të paaferta për të kuptuar në tërësi urtësinë e plotë Hyjnore.

Namazi është një lloj i konfirmimi i lidhjes, jo vetëm me Krijuesin, edhe pse në namaz i drejtohem vetëm Atij, por edhe me galaktikën astronomike të Shpalljes qysh nga fillimi i pejgamberisë së parë në Tokë. Muslimanët nuk janë planet i hutuar e pa orientim në hapësirën kozmike, ata janë pjesë e pandarë e sistemit të tevhidit hyjnorë, i përfaqësuar në shpalljet e Tij dhe në ata që e bartën atë, pejgamberë e engjëj, këtë na e kujton selami ynë në fund të namazit, në të djathë e në të majtë, e para kësaj përshëndetja jonë për robërit e mirë të Allahut.

Orientimi drejt Kibles na bënë të ndiejmë se jemi në pozitë ndryshe nga pozitat e përditshme që i jetojmë në jetë kur nuk jemi në namaz, ose pasi ta mbarojmë namazin. Se ne nuk jemi në pozitë të rëndomtë tokësore, por jemi me Allahun, në gjendje që i përkushtohemi vetëm Atij, me përkushtim të plotë, e që ky përkushtim i plotë kërkon gjithashtu konfirmimin e lidhjes vendore me të tjerët të cilët na shoqërojnë në namaz, nuk është e thënë doemos ata që na shoqërojnë në namaz me xhemat, por të gjithë të tjerët që bashkë me ne radhiten në të njëjtën kohë rreth Qabes, në Lindje e në Perëndim, për ta falë namazin që edhe ne e falim, me fjalë të njëjta, me lëvizje të njëjta, me fytyrë të njëjtë. Kjo gjithashtu nënkupton lidhjen tonë kohore me ata që jettuan para nesh, para të Dërguarit tonë dhe të dërguarve të tjerë (ala Ibrahim ve ala ali Ibrahim), me ata që jetojnë me ne ose që do të jetojnë pas nesh, pas të Dërguarit dhe të mirëve (alejna ve ala ibadil-lahi es-salihine – ala Muhamedin ve ala ali Muhamedin). Duke mos harruar se salevati për familjen e Ibrahimit alejhi's-selam përfshinë edhe të Dërguarin tonë s.a.v.s., sepse edhe ai është nga familja e Ibrahimit alejhi selam, kështu salevati i përfshinë të gjithë ata që ishin përpara familjes së Muhamedit dhe atyre që do të vijnë më vonë.

Këto dimensione kohore dhe vendore të namazit hedhin pak dritë për të kuptuar vërtetimin e çuditshëm kuranor se njeriu është një hallk e hallkave të krijimit, se para tij ka pasur shumë hallka të tjera dhe vazhdojnë të ketë, se ai nuk mundet ta ndajë veten nga kjo hallkë njerëzore. S'ka dyshim se kjo na shpjegon lidhjen e Islamit dhe këmbënguljen e tij të jashtëzakonshme midis besimit në Allahun, Një e të Vetëm dhe mirësinë ndaj prindërve, jo vetëm duke qenë gjallë, por edhe pas vdekjes së tyre:

*“Kujtoni kur Ne morëm besën tuaj, o bijtë e Izraelit, se do të adhuroni vetëm Allahun, do të silleni mirë me prindërit...”* (El-Bekare, 83)

*“Bëhu falënderues ndaj Meje dhe prindërve të tu”.* (Lukman, 14)

*“Kur njeriu vdes, i ndërpriten të gjitha punët, përveçse në tri raste: nga sadakaja që vazhdon të funksionojë, dituria me të cilën të tjerët kanë dobi dhe fëmija i dobishëm që lutet për të.”* (Muslimi)

Kujtoj se ajeti i sures el-Bekare, i shpallur për bijtë e Izraelit, duhet të jetë kandil për muslimanët, bile për gjithë njerëzimin, se si duhen të sillen fëmijët me prindërit? A nuk nxit çudi ajeti i sures Lukman i cili krijon lidhje të ngushtë midis besimit në Allahun, falënderimin për begatitë e panumërta dhe mirësinë ndaj prindërve dhe falënderimin e tyre?!

Më duket se krahas funksioneve tjera të namazit, është edhe vërtetimi i ruajtjes së lidhjeve të shenjta e të pandërprera me prindërit, qoftë mes fëmijëve dhe prindërve, siç vërteton surja Bekare, apo mes të mirëve dhe të mirëve, siç vërteton ettehijjati ku ne dërgojmë selam për ata që ishin para nesh dhe ata që do të vijnë pas nesh (ibadi'l-lahi 's-salihine), ose mes të dërguarve dhe të dërguarve, siç vërteton salevati ibrahimor, apo mes neve dhe të dërguarve i përfaqësuar në të dërguarin Ibrahim alejhi selam (Sal-li ala Muhammedin... kema salejte ala Ibrahim... barik ala Muha-

mmedin... kema barekte ala Ibrahimë...). S'ka dyshim se sinqeriteti i kësaj reflekton lidhjen e shëndoshë dhe madhështore midis krijesës dhe Krijuesit. Këtë më së miri e vërteton thënia e të Dërguarit s.a.v.s.: *"Kush nuk i falënderon njerëzit, ai nuk e ka falënderuar Allahun."* (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih el-Xhami')

## Pjesa 8

### Dy selamet në fund të namazit

Tekbiri fillestar i shëmbëllen çelësit që vë në funksion anijen kozmike të namazit që është niseu drejt qiellit; ai jep fuqi të mjaftuar për fluturim; rukuja e parë e pastaj e dyta i shëmbëllejnë vënies në funksion të motorit shtesë të kësaj anije kozmike për të depërtuar thellë në gjithësi; sexhdet e dy rekateve të para i shëmbëllejnë motorit me fuqi të madhe, është fuqi dyenergjike (dy sexhde në rekat), që anijen kozmike e shtynë sa më afër Allahut, ku arrijmë në fund të rrugës, për të dhënë përshëndetjen më madhështore për Allahun e Madhërishëm, për të Dërguarin e Tij dhe për të gjithë robërit e Tij të mirë.

Kurse tani, është afruar çasti i kthimit në Tokë, para se të nisemi i lutemi Allahut të Madhëruar me lutje të cilat i kemi zgjedhur, lutje të transmetuara nga i Dërguari s.a.v.s për këtë qëndrim të veçantë të namazit. Nuk është e thënë se këto lutje përkufizohen vetëm në këtë gjendje e jo në shumë të tjera, siç nuk është e thënë që ato të mos jenë të shumëllojshme kohë pas kohe. Ne mund të zgjedhim çfarë të duam nga lutjet pejgamberike të transmetuara për këtë gjë:

*"Abdullah ibn Mes'udi thotë se i Dërguari s.a.v.s. ua mësoi teshehhudin, e pastaj në fund tha: "Pastaj zgjidh nga lutja (kërkesa) çfarë të duash."* (Muslimi)

*"Allahumme inni eudhu bike min adhabi'l-kabri, ve eudhu bike min adhabi'n-nari, ve eudhu bike min fitneti'l-mahja ve'l-memati, ve eudhu bike min fitneti 'l-mesih'i 'd-dexhali."* (Allahu im, kërkoh mbrojtje të Ti nga dënimi i varrit, nga dënimi i zjarrit, nga fitna e jetës dhe vdekjes dhe nga mesihu dexhall). (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih el-Xhami')

"I Dërguari i Allahut s.a.v.s. në namaz lutej e thoshte: *"Allahumme inni eudhu bike min sherri ma amiltu ve min sherri ma lem a'mel."* (Allahu im, kërkoh mbrojtje të Tij për të keqen e punës që e kam bërë dhe për të keqen e punës që nuk e kam bërë). (Nesaiu, Albani thotë se hadithi është sahih)

"Aisha e kishte dëgjuar të thotë në namaz: *"Allahumme hasibni hisaben jesira"* (Allahu im, më llogarit me llogari të lehtë (Në Ditën e Gjykimit). Kur mbaroi namazin, ajo i tha: *"O i Dërguari i Allahut, ç'është llogaria e lehtë?"* Ai tha: *"Që Allahu të shikojë në librin e tij e t'ia falë. O Aishe, ai që do t'i nënshtrohet diskutimit të llogarisë, ai atë ditë do të jetë i humbur."* (Ibn Kethiri, hadithi është sahih në bazë të kushtit të Imam Muslimit)

*"Allahumme bi ilmike el-gajb, ve kudretike ale'l-halki exhmein, ahjini ma alimte el-hajate hajren li, ve teveffeni idha kanet el-vefatu hajren li, Allahumme es'eluke hashjeteke fi'l-gajbi ve'sh-shehadeti, ve kelimete'l-haki ve'l-adli fi'l-gadabi ve'r-rida, ve es'eluke el-kasde fi'l-fakri ve'l-gina, ve es'eluke neimen la jebidu, ve es'eluke kurret ajnin la tenkati', ve es'eluke er-rida bade 'l-kada, ve es'eluke berde'l-ishi bade'l-mevti, ve es'eluke 'ledhdhete 'n-nadhri ila vexhhike, ve es'eluke 'sh-shevka ila likaike fi gajri darrae mudarretin ve la fitnetin mudil-letin, Allahumme zejijina bi zineti'l-iman, vexh'alna hudaten muhtedine."* (Allahu im, me dijen Tënde të gajbit, fuqinë Tënde për të gjitha krijesat, më le në jetë përderisa e di se jeta për mua është e dobishme, dhe më vdis nëse e di se vdekja është më mirë për mua, Allahu im, kërkoh frikën Tënde ta kem kur jam në vetmi

dhe kur jam me të tjerë, ta them fjalën e vërtetë e të drejtë kur jam i zemëruar dhe i kënaqur, të lutem më bëj të jem korrekt e i matur në shpenzim, kur jam i varfër dhe i pasur, kërkoj begati të pashtershëm, kërkoj kënaqësi që nuk ndërpritet, kërkoj të jem i kënaqur me vendimin Tënd, të lutem më jep freski e kënaqësi në jetën pas vdekjes, të lutem më jep kënaqësinë e shikimit në fytyrën Tënde, dashurinë për takimin me Ty... Allahu im, na zbukuro me zbukurim të imanit, na bëj udhëzues që udhëzojnë." (Nesaiu, Albani thotë se hadithi është sahih)

"Ebu Bekri i kërkoi duke i thënë: "Ma mëso lutjen që do të lutem në namaz!" Ai tha: "Thuaj: *"Allahumme inni dhalimtu nefsi dhulmen kethiren, ve la jagfiru dhunube il-la ente, fagfir li megfireten min indike, verhamni, inneke ente'l-gafuru 'rr-rrahim"* (Allahu im, unë i bëra shumë padrejtësi vetes si me, por gjynahet i fal vetëm Ti, andaj më fal mua me falje që vjen nga Ti, më mëshiro, se Ti vërtet je Mëshiruesi më i madh." (Buhariu dhe Muslimi)

"E urdhëroi Aishen të thotë: *"Allahumme inni es'eluke mine'l-hajri kul-lihi, axhili ve axhilihi, ma alimtu minhu ve ma lem a'lem, ve es'eluke el-xhennete ve ma karrebe ilejha min kavlin ve amelin, ve eudhu bike mine'n-nari ve ma karrebe ilejha min kavlin ve amelin, ve es'eluke mimma se'eleke bihi Muhammedun, ve eudhu bike mimma teavedhe minhu Muhammedun, ve ma kaddejte li kadaen fexh'al akibetehu rushden"* (Allahu im, kërkoj nga Ti gjithë të mirën, tani e më vonë, që e di e që nuk e di, të lutem për Xhenetin dhe gjërat që afrojnë te ai, fjalë ose punë, më mbroj nga Xhehenemi dhe gjërat që afrojnë te ai, fjalë ose punë, kërkoj nga ti atë që e kërkoi Muhamedi, dhe mbrohem te ti nga ajo që u mbrojt Muhamedi, kurse për atë që ma ke caktuar mua, të lutem fundin e saj bëje për mua urtësi). (Buhariu në Edeb el-Mufred)

“I Dërguari i Allahut s.a.v.s. hyri në xhami dhe pa një njeri që po falej dhe që në teshehud po thoshte: *“Allahumme inni es’eluke ja Allahu el-ehad es-samed, el-ledhi lem jelid ve lem juled ve lem jekun lehu kufuven ehad, en tagfir li dhunubi inneke ente’l-gafuru er-rrahim.”* (Allahu im, kërkoj të m’i falësh të gjitha gjynahet, se Ti je Falës dhe i Mëshirshëm). Atëherë i Dërguari s.a.v.s. tha: *“Iu është falë, iu është falë, tri herë.”* (Ebu Davudi, Albani thotë se hadithi është sahih)

*“Isha me të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. ulur. Një njeri po falej pranë nesh. Kur ra në ruku dhe sexhde dhe në teshehud, u lut dhe tha: “Allahumme inni es’eluke bi enne leke-l-hamdu, la ilahe il-la ente, vahdeke la sherike leke, el-mennan, ja bedia es-semavati ve’l-erdi, ja dhe’l-xhelali ve’l-ikrami, ja hajju ja kajjumu, inni es’eulke el-xhennete, ve eudhu bike mine’n-nari.”* Atëherë i Dërguari s.a.v.s. u tha shokëve të vet: *“A e dini se çfarë tha ky njeri?”* Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së mirë, thanë! Ai tha: *“Pasha Atë që shpirti im është në dorë të Tij, iu lut Allahut me emrin e Tij më madhështor; në transmetim tjetër: “më madhor”, që nëse lutet me të, i përgjigjet, e nëse kërkon, i jepet.”* (Albani thotë se hadithi është sahih, Enes ibn Maliku)

“I Dërguari s.a.v.s. e dëgjoi një njeri që lutej e thoshte: *“Allahumme inni es’eluke bi enni eshhedu enneke ente Allahu la lahe il-la ente, el-ehad es-samed, el-ledhi lem jelid ve lem juled ve lem jekun lehu kufuven ehad”* – pastaj tha: *“Pasha Atë që shpirti im është në dorë të Tij, i kërkoj Allahut me emrin e Tij më madhështor, që nëse lutet me të, i përgjigjet, e nëse kërkon, i jepet.”* (Tirmidhiu, Albani thotë se hadithi është sahih)

“Lutja më të cilën i Dërguari s.a.v.s. lutej shumë herë ishte: *“Rabbena atina fi’d-dunja haseneten ve fi’l-ahireti haseneten ve kina adhabe’n-nari”* (Allahu im, na jep të mirë në dynja dhe të mirë në Ahiret, dhe ruana nga dënimi i zjarrit.” (Buhariu, Enes ibn Maliku)

“I Dërguari s.a.v.s. midis teshehudit dhe selamit thoshte: *“Allahumme igfir li ma kademt看 ve ma ehartu, ve ma esrertu ve ma a’lentu ve ma esreftu, ve ma ente a’lemu bihi minni, ente el-mukaddim ve ente el-muehhir, la ilahe il-la ente.”* (Allahu im, më fal gjynahun që e kam bërë më parë dhe atë që ka vonuar, atë që e kam bërë fshehtas dhe atë që e kam bërë haptas, dhe për atë që e kam tepruar, e që Ti e di më mirë se unë, se Ti je i Pari dhe Ti je i Fundi.” (Muslimi)

Sa shumë propozime që janë. Ndoshta ndiesh i dobët për mësimin e të gjitha këto lutjeve përmendësh? Por mos u brengos, sepse edhe shokët e të Dërguarit u treguan të dobët, e përgjigja e të Dërguarit për këtë dobësi të tyre ishte: *“I Dërguari i Allahut s.a.v.s. i tha një njeriu: “Çfarë thua në namaz?” Ai tha: “E them shehadetin e pastaj kërkoj prej Allahut Xhenetin dhe të më ruaj nga Xhehenemi, Vallahi unë nuk di intonimin tënd e as intonimin e Muadhit.” Ai tha: “Rreth kësaj edhe ne sillemi.”* (Ibn Maxhe, Albani thotë se hadithi është sahih)

Është koha e kthimit, jemi gati që përsëri të aterojmë në Tokë, një gjë e tillë kërkon zvogëlimin e shpejtësisë së motorit dhe ngadalësimin e tij pak nga pak. Energjitë shpirtërore kanë filluar të pushojnë qysh në sexhden e fundit, tekbiret dhe tesbihet gjithashtu. Pothuajse e gjithë ajo që ndodh para se të japim selam, salevatet për të Dërguarin s.a.v.s., selamet për ne dhe për robërit e mirë, shënon procesin e përgatitjes për aterim i cili nuk kërkon sasinë e fuqisë që kërkohej në procesin e fluturimit lartë.

Ne nuk e përfundojmë namazin ashtu siç e filluam me tekbirin fillestar, që ishte plot energji e mbushje shpirtërore, por fundi do të jetë shumë më ndryshe, që do të na ndihmojë shumë për të dalë nga sfera e shpejtësisë së dritës e të futemi në sferën e shpejtësisë së tokës:

### *Esselamu alejkum ve rahmetullahi*

Përschëndetja e fundit në namaz, që vjen për të realizuar më shumë afërsi dhe bashkëpunim me grupet tjera të reja në namazin tonë, njëjtë siç veproi ettehiijati për Allahun, për të Dërguarin e Tij dhe për robërit e Tij të mirë, e më pas salevatet tona për të Dërguarin e Tij, familjen e tij, për Ibrahimin dhe familjen e tij, paqja e Allahut qoftë mbi të gjithë ata: *“Kur faleshim me të Dërguarin e Allahut s.a.v.s., thoshim: “esselamu alejkum ve rahmetullah – esselamu alejkum ve rahmetullah” – dhe bënim me dorë nga të dy anët.”* I Dërguari i Allahut s.a.v.s. tha: *“Çfarë po bëni me duart e juaja sikur të jenë bisht i kalit? Mjafton që ta veni dorën në kofshë e pastaj të jep selam (të përschëndet) vëllanë e tij në të djathtë e në të majtë.”* (Muslimi)

A nënkuptojnë selamet e namazit fundin e këtij udhëtimit?

NËN KUBEN E TRETË  
Vjelja





## TRIBUNA E PARË KTHIMI NË TOKË

### Pjesa 1

#### Dalja nga namazi

Mos u mendo që pas namazit menjëherë të kërcesh në punë, sikur diçka të të ketë pickuar. Mos u trego para Allahut, i cili është i Gjithëdijsëm dhe di gjithçka që fsheh në gjoks, se kinse prisje çastin e mbarimit të namazit për t'ia kthyer shpinën Atij dhe të kthehesh sa më shpejtë në obligimet e dynjasë, që shpresoj të mos jenë, pas këtij shpejtimi të tmerrshëm, program televiziv, ndeshje futbolli, lexim i ndonjë reviste ose gazete apo ndonjë punë që nuk të bënë dobi e as dëm në jetë...

Namazi nuk mbaron me dhënien selam në të djathtë e në të majtë. Dalja nga aeroplani nuk nënkupton arritjen në shtëpi. Janë procedurat e njëpasnjëshme dhe transferet që edhe më tej të ndajnë nga takimi me familjarët. Ulja pas namazit është pjesë e pandashme e namazit. Provë për këtë janë thëniet e të Dërguarit s.a.v.s., që pohojnë se asgjë nuk duhet ndarë midisi namazit dhe lutjes, qoftë veprim ose fjalë: *“Transmeton Muslim ibn Harith Et-Temimi se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. i tha diçka fshehurazi, dhe tha: “Kur të mbarosh me namazin e akshamit, para se të flasësh, thuaj: “Allahumme exhirni mine ‘n-nar – shtatë herë – Allahu im, më mbroj nga zjarri” -, se nëse e thua këtë e pastaj vdes atë natë, do të jesh i mbrojtur prej zjarrit; dhe kur të mbarosh namazin e sabahut thuaje të njëjtën, se nëse vdes atë ditë, do të jesh i mbrojtur prej tij.”* (Ibn Haxher El-Askelani, Tahrixh Mishkat el-Mesabih)

Në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut s.a.v.s. na nxit të mos lëvizim fare nga pozita që jemi pas namazit të akshamit dhe të sabahut, vetëm atëherë kur të kemi shqiptuar dhjetëra herë disa **tesbihe**. Mbaje mend se ky nuk është urdhër, por është thirrje e çmuar, mirësi, nxitje e këndshme për më shumë shpërblime që i shtohen shpërblimit të namazit: *“Kush thotë para se të mbaron dhe pëstjtjellë këmbët nga namazi i sabahut dhe i akshamit: “La ilahe ilallahu, vahdehu la sherike lehu, lehu’l-mulku ve lehu’l-hamdu, juhji ve jumit, ve huve ala kul-li shej’in kadir” – dhjetë herë, për çdo njëren prej tyre do të shpërblehet me dhjetë të mira, do të fshihen dhjetë të këqija, do të ngrihet dhjetë shkallë lart, do të jenë mbrojtje për të (garanci) nga çdo e keqe (e padëshiruar)..”* (Ibn Haxheri, El-Emali El-Halebije)

Sigurish që mjafton ta thuash këtë qoftë vetëm një herë, siç pohon hadithi tjetër: *“Mugire ibn Shu’be thotë se i Dërguari s.a.v.s. pas çdo namazi farz, thoshte: “La ilahe ilallahu, vahdehu la sherike lehu, lehu’l-mulku ve lehu’l-hamdu, juhji ve jumit, ve huve ala kuli shej’in kadir”. Allahumme la mania lima a’tajte, ve la mu’ti lima menate, ve la jenfeu dhe’l-xheddi minke’l-xheddu.”* (Buhariu dhe Muslimi)

Procedurat e aeroportit mund të jenë të gjata ose të shkurtra. Edhe ulja pas namazit mund të jetë e gjatë ose e shkurtër, kështu na mëson i Dërguari i Allahut s.a.v.s., i cili na i lë të hapura dyert para nesh për shumë dobi dhe shpërblime të mëdha. Ti dhe vetëm ti je ai që vlerëson kohën tënde, rrethanat dhe faktorët e programit tënd ditor, ti vlerëson sasinë e uljes pas namazit, gjatë ose shkurtër. Na tregon nëna e besimtarëve, Aisha se ulja e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. pas namazit ishte sa më shkurtë që mundej të ishte: *“Kur i Dërguari s.a.v.s. jepte selam – në fund të namazit – rrinte ulur aq sa thoshte: “Allahumme ente ‘s-selamu ve minke ‘s-selamu, tebarekte ja dhe’l-xhelali ve’l-ikram.”* (Muslimi)

Nëse dëshiron që ulja të zgjat, shpërblimet të rriten, fondi i llogarisë së Ahiretit të shënojë rritje, atëherë lexo hadithet fisnike që japin më shumë raste për këtë, jep selam e pastaj drejtoju Allahut të Madhëruar duke thënë *estagfirullah* tri herë: “Kur i Dërguari s.a.v.s. e mbaronte namazin, bënte tri herë *estagfirullah*, dhe thoshte: “Allahumme ente ‘s-selamu, ve minke ‘s-selamu, tebarekte ja dhe‘l-xhelali ve‘l-ikram.” Velidi tregon se e kishte pyetur Evzaiuun: “E si është *istigfari*?” Tha: “Të thuash: “*Estagfirull-llah, estagfirull-llah.*” (Muslimi)

Kujto se ky *istigfar* është prej rregullave të mirësjelljes. Sapo dole nga takimi i veçantë me Zotin e botëve dhe, nuk e di apo ndonjëherë të kujtohet, se ky takim i pazakontë meriton këtë mirësjellje të përshtatshme dhe koncentrim të plotë me Atë të Cilit i lutesh dhe i përkushtohesh, që shprejon dhe kërkon.

Pas këtyre gjërave që na i mësoi i Dërguari s.a.v.s., ne mund të kalojmë në *tesbihet* që i shqiptojmë pas namazit. Disa hadithe flasin se ato shqiptohen tridhjetë e tri herë: “Kush e përlovdëron Allahun pas namazit tridhjetë e tri herë (thotë *subhanallah*), e falënderon tridhjetë e tri herë (thotë *elhamdulil-lah*) dhe e madhëron tridhjetë e tri herë (thotë *Allahu ekber*), e këto bëjnë nëntëdhjetë e nëntë, e në të njëqindtën thotë: “La ilahe il-lallahu vahdehu la sherike lehu, lehu‘l-mulku ve lehu‘l-hamdu ve huve ala kul-li shej’in kadir” – i falen gabimet e tij, edhe nëse janë si shkuma e detit.” (Muslimi)

Ky shpërblim i madh nënkupton faljen e gabimeve tona, edhe nëse janë si shkuma e detit, për të cilën ne paguajmë çmimin e merituar. Është një dallim i madh midisi çmimit të dynjasë dhe mallit të shtrenjtë të Allahut, prandaj të mundohemi që çdo shqiptim i *tesbihut* të merr hakun e merituar, në mendim dhe kohë, atë që e kërkojnë hapësirat e gjelbra. Kur themi **subhanallah**, ta themi atë sikur jemi duke shikuar një gjë të habitur ose mrekulli që ndodh para

syve tanë në atë çast, ndërkaq ne e madhërojmë Allahun për atë madhështi që ndodhë. Janë shumë ato mrekulli madhështore që ndodhin përreth nesh, sikur t'i shikonim me shikim të zemrës dhe t'i studionim në imtësi të gjitha gjërat përreth nesh, sikur jemi duke i parë ose zbuluar për herë të parë.

Shqiptimi i fjalës **elhamduli'l-lah** na kujton begatitë e shumta të Allahut, gjë për të cilën edhe e falënderojmë: shikimin, dëgjimin, mendjen, mendimin, sigurinë, shëndetin, lëvizjen, ecjen, hyrjen në banjo, daljen nga banjoja, furnizimin, vendbanimin, familjen, ngrënien, pirjen... dhe shumë-çka që na vjen ndërmend për të numëruar, por kurrë nuk do të mund t'i numëronim të gjitha, veçmas ato begati që shumë njerëz sot nuk i kanë, ndërkaq që ne dhe miqtë e tanë i gëzojmë në jetë..

Ndërkaq fjala **Allahu ekber** na kujton që t'i sjellim ndërmend gjërat që na frikësojnë në jetë, apo ato që presim të na ndodhin, gjërat që kemi frikë se mos vallë djalli do të na mashtrojë për ato, qoftë brengë, shqetësim, dobësi, sëmundje, mashtrim, dëm, padrejtësi, armik, ziliqar, ngacmim seksual, material, interes dynjaje, mëkat -, për të gjitha këto vlen fjala Allahu ekber (Allahu është më i madh). Imagjinata jonë nuk mbaron me të numëruarit e shumë gjërave që na vijnë ndërmend, përderisa janë shprehje të hapura e të paplota, siç kemi thënë më parë. Hapësirat e gjelbra presin që imagjinata jonë t'i mbushë ato. Është e udhës të përmendim se çdo shqiptim i fjalës Allahu ekber duhet të jetë i theksuar mirë, të mos shpejtojmë në shqiptimin e tyre e t'i ngjitem një rënë pas tjetrën, pa ndonjë ndarje midis secilës, ndarje kohore dhe imagjinuese gjatë së cilës do të veprojë mendja jonë dhe imagjinata jonë, prezenca e tekbitit të vërtetë.

Mos harro se këto tri tesbihe përbëjnë ekuivalentin thelbësor dhe pikën baraspeshëse të namazit tënd; a nuk janë

vëzhgimi, durimi dhe kujtimi, shtyllat mbi të cilat ngrihet namazi?! Shprehja **Allahu ekber** është rast për të shprehur durimin, kurse **elhamduli'l-lahi rabbi'l-alemin dhe rabbe-na leke'l-hamdu** rast për kujtim, ndërkaq **Subhane rabbi-je'l-adhim dhe subhane rabbijje'l-a'la** rast për vëzhgim.

Mos bëni ashtu siç bëjnë shumë njerëz sot, që këto tesbihe i shqiptojnë sikur të jenë në gjumë, sikur bëjnë gara se cili prej tyre do të jetë më i shpejtë në shqiptimin e tyre, sikur është një mësim i lëndës së gjeografisë që e themi para mësuesit!

Nëse e di se nuk mundesh t'i përmbahesh kësaj, se koha nuk të lejon këtë ngadalësim dhe shëtitje në hapësira të gjelbra, atëherë, që të mos humbësh gjithçka të propozojë të zgjedhësh diçka nga mësimet pejgamberike, atë se disa hadithe flasin se numri i këtyre tesbihëve mund të jetë njëzet e pesë, e jo tridhjetë e tre: *“Ishin të urdhëruar që pas çdo namazi të thonë tridhjetë e tri herë subhanallah, tridhjetë e tri herë elhamduli'l-lah dhe tridhjetë e katër herë Allahu ekber. Një njeri nga mesi i ensarëve pa në ëndërr që dikush i tha: “I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ju urdhëroi që pas çdo namazi të thoni tridhjetë e tri herë subhanallah, tridhjetë e tri herë elhamduli'l-lah dhe tridhjetë e katër herë Allahu ekber?” Ai tha: “Po.” Tha: “Bëjeni njëzet e pesë herë, dhe në të futni edhe tehlilin – la ilahe ilallahu – “. Kur u zgjua shkoi tek i Dërguari s.a.v.s. dhe ia përmendi këtë, e ai tha: “Veproni edhe kështu.”* (Nesaiu, Albani se thotë hadithi është sahih)

Nëse koha është shumë e shkurtër dhe dëshiron që të mos jesh pa shpërblime të mëdha, atëherë bëji njëmbëdhjetë herë, siç thuhet në hadith: *“Të varfrit erdhën tek i Dërguari s.a.v.s. dhe i thanë: “Të pasurit kanë kapur shkallët më të larta të Xhenetit dhe mirësitë e përjetshme, sepse edhe ata falin namaz siç falim ne, agjërojnë siç agjërojmë ne, kanë shumë pasuri, me të bëjnë haxhin dhe umren, shkojnë në xhihad e japin sadaka.”* Ai tha:

*"A t'ju tregoj për diçka që nëse e merrni do t'i arrini ata që ua kanë shkuar, e juve nuk ka për t'ju arritur ata që do të vijnë pas jush, e të jeni më të mirët mes tyre, përveç atij që vepron siç veproni ju? - Pas çdo namazi të thoni subhanallah, elhamduli'l-lah dhe Allahu ekber 33 herë." Filluam të polemizonim mes vete, disa thanë: të themi 33 herë subhanallah, 33 herë elhamdulilah dhe 34 herë Allahu ekber." Unë u ktheva tek ai, e ai tha: "Subhanallah, elhamduli'l-lah, Allahu ekber, që e tërë kjo të jetë 33 herë." (Buhariu)*

*Ose mund të jetë dhjetë herë, siç pohojnë hadithet tjera: "A t'ju tregojë për një gjë me të cilën do t'i arrini ata që ishin para jush, e t'ua kaloni atyre që vijnë pas jush, e askush të mos mund të bëjë atë që ju e bëni, përveç atij që vepron njëjtë si ju? Pas çdo namazi të thoni 10 herë subhanallah, 10 herë elhamduli'l-lah dhe 10 herë Allahu ekber." (Buhariu)*

*"Umu Seleme erdhi tek i Dërguari s.a.v.s. dhe tha: "O i Dërguari i Allahut, mi mëso fjalët me të cilat do të lutem në namazin tim." Ai tha: "Thuaj 10 herë subhanallah, 10 herë elhamduli'l-lah dhe 10 herë Allahu ekber, e pastaj kërko çfarë të duash nga nevojat e tua." Allahu i Madhërishëm thotë: "Po, po." (Nesaiu, Albani thotë se hadithi është sahih)*

*"Dy veçori janë që nëse njeriu musliman i vepron, do të hyjë në Xhenet, janë të lehta, por janë shumë pak që i veprojnë." I Dërguari i Allahut s.a.v.s. tha: "Pas kohëve të namazit; pas çdo namazi të thotë dikush 10 herë subhanallah, 10 herë elhamduli'l-lah dhe 10 herë Allahu ekber, ato janë 150 në gjuhë e 1500 në peshore." Unë e kam parë të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. që i bënte me dorën e tij. Kur dikush nga ju të shtrihet në shtrat dhe thotë 33 herë subhanallah, 33 herë elhamduli'l-lah dhe 34 herë Allahu ekber, ato janë 100 në gjuhë, kurse 1000 në peshore." I Dërguari i Allahut s.a.v.s. tha: "E cili prej jush i bënë çdo ditë e çdo natë 1500 të këqija!?" (A mund pra numri i gjynaheve tuaja t'ua kalojë numri të tesbihëve tuaj). Dikush tha: "O i Dërguari i Allahut, e si të mos i bëjmë ato?" Ai tha: "Djali i vjen ndonjërit nga ju*

*duke qenë në namaz, e i thotë: “Kujtoje këtë, kujtoje këtë – d.m.th. e heq nga tesbihët; i vjen në gjumë dhe e bënë të habitet para se t’i plotësojë ato.”* (Nesaiu, Albani thotë se hadithi është sahih, Abdullah ibn Amri)

Janë shumë zgjidhje, merre cilën ta duash, por mos lejo ta zgjedhësh të parën e në vend se të fitosh shumë, të humbësh shumë, ose hiq. Shqiptimi i tesbihëve 10 herë, por më ngadalë, kohë të mjaftuar, me kontemplim, studim, përkushtim, përsheptshmëri, është më e mirë se shqiptimi i tyre 33 herë ose 3 mijë herë, por në mënyrë të detyrave shkollore apo garave olimpike.

Përsheptshmëria, përkushtimi dhe qetësia e plotë e leximit të çfarëdo që lexojmë, na bënë që të besojmë se pas çdo namazi krijojmë një lidhje të frytshme me Allahun, se kështu na mësoi i Dërguari s.a.v.s.

Ulja e namazit i shëmbëllen pjatës që polarizon imitimin hapësinor. Pas namazit ndiejmë se me vete bartim energji të madhe të fuqisë së imitimit (transmetimit), ngrohësinë e takimit dhe entuziazmin e lidhjes, se linja me Allahun edhe më tej është e hapur. Janë çaste të tërëqethjes trupore, ndjenjës së afrimit me qiellin, e rrugës së hapur për robin e Allahut që t’i drejtoj lutjet e t’u përgjigjet atyre, të kërkoj e t’i jepet, të kërkoj mbrojtje e të mbrohet, dhe asnjëherë të mos ngurroj t’i rrëmbej këto çaste:

- *“I Dërguari i Allahut s.a.v.s. më urdhëroi që pas çdo namazi t’i lexojë **muavedhatet** (kul eudhu bi rabbi’l-felek dhe kul eudhu bi-rabbi’n-nas).”* (Nesaiu, Albani thotë se hadithi është sahih)

- *“Kush e lexon ajeti kursijen pas çdo namazi, vetëm vdekja e pengon të hyjë në Xhenet.”* (Nesaiu, Albani thotë se hadithi është sahih)

- *“Ibn Zubejri pas çdo namazi që e falte (kur jepte selam), thoshte: “La ilahe ilallahu vahdehu la sherike lehu, lehu’l-mulku ve lehu ‘l-hamdu ve huve ala kul-li shej’in kadir, la havle ve la kuvvete il-la bi’l-lah, la ilahe ilallahu, ve la na’budu il-la ijjahu, lehu en-ni’metu ve lehu el-fadlu, ve lehu eth-thinau el-hasenu, la ilahe ilallahu,*

*muhlisine lehu'd-dine ve lev kerihel-kafirune.*" (...nuk ka fuqi pos fuqisë së Allahut, vetëm Atë e adhurojmë, Atij i takon merita e begatisë dhe mirësisë, mirënjohjes së mirë, të sinqertë jemi ndaj Tij dhe të përkushtuar me fe të sinqertë, edhe nëse jobesimtarët e mohojnë). Tha: "I Dërguari i Allahut s.a.v.s. vepronte kështu pas çdo namazi." (Muslimi)

- "Seidi ua mësonte bijve e vet këtë fjalë dhe thoshte se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. kërkonte mbrojtje me ato pas çdo namazi: "Allahu-mme inni eudhu bike min 'l-xhubni, ve eudhu bike min 'l-buhli, ve eudhu bike min en uredde ila erdheli'l-umuri, ve eudhu bike min fitneti 'd-dunja ve adhabi'l-kabri." (Allahu im, kërkoi mbrojtjen Tënde prej frikës, kërkoi mbrojtjen Tënde prej koprracisë, kërkoi mbrojtjen Tënde që të mos e arrijë pleqërinë e shtyrë dhe kërkoi mbrojtjen Tënde nga sprova e dynjasë dhe dënimi i varrit.)" (Ibn Kudame)

- "Kur ndonjëri nga ju të mbaroj me teshehuddin e fundit, le të kërkoi mbrojtjen e Allahut prej katër gjërave: prej dënimit të varrit, dënimit të Xhehenemit, sprovës së jetës dhe vdekjes dhe prej sherrit të Mesihu Dexhallit." (Muslimi)

- "Muadh ibn Xhebeli tregon se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. e morri për dore dhe i tha: "O Muadh, pasha Allahun unë të dua, dhe tha: "Të këshilloj, o Muadh: "Mos e le që pas çdo namazi të thuash: "Allahumme eini ala dhikrike ve shukrike ve husnu ibadetike (Allahu im, më ndihmo të të përmend, të të falënderoj dhe të të adhuroj bukur)." (Ebu Davudi)

- "I Dërguari i Allahut s.a.v.s. në namazin e vitrit lexonte (**sebbihisme rabbike'l-a'la**), kurse në rekatin e dytë lexonte (**kul ja ejuhu'l-kafirune**), ndërkaq në të tretin lexonte (**kul huvallahu ehad**) dhe pas selamit thoshte: "**Subhane'l-meliki'l-kuddus**" – tri herë." (Nesaiu, Albani thotë se hadithi është sahih)

## Pjesa 2

### Një kohë për lutje dhe pjesë të caktuara (evrad)

Lutja (duaja) është lloj i namazit, ajo ka shpirt të namazit, por nuk ka procedura zyrtare dhe rregulla dhe kohëra të caktuara. Është lloj i namazit të lirë e të lehtë, të befason

në çdo çast dhe në çdo vend. Nuk mërzitesh nëse atë e bënë kudo që je dhe kudo që të thërret. Namazi është i detyruar në kohë të caktuar, por ka namaze që falen edhe në kohë të pacaktuar, kurse duaaja është lloj i namazit që vlen për çdo kohë, edhe pse disa kanë vlerë më të madhe se disa të tjera. Është e çuditshme çështja e duasë, ka çaste kur erërat e freskisë fryjnë papritmas në shpirtin tonë dhe përnjëherë e gjejmë veten shumë afër me Allahun. Kjo mund të ndodh menjëherë pas namazit, para se të flemë, siç ndodh kur jemi në kulmin e punës, në rrugë, në çastin kur bëhemi gati të bëjmë ndonjë gjynah, atëherë kur dëshirojmë të bëjmë një punë të mirë për hir të Allahut, ndiejmë sikur dikush na thotë me zë: është Allahu në linjë, lutu tani, se je shumë afër, je shumë afër.

Nëse të ndodh që erërat e filladit të fryjnë në ty, mos lejo të të shkoj huq duaaja, kërko prej Allahut çfarë të duash, mos u turpëro që të kërkojsh më shumë e më shumë, se Ai është Bujari i madh:

- *“Zoti i juaj është i Gjallë, Bujar, turpërohet nga robi i Tij që i ngrit duart tek Ai e t’ia kthejë bosh, apo të pashpresë.”* (Ibn Maxhe, Albani thotë se hadithi është sahih)

- *“Kur dikush nga ju të kërkoj, le të kërkoj shumë, sepse ai i kërkon Zotit të tij.”* (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih el-Xhami’, Aisha)

- *“Kur të fshihen hijet e të vjen mbrëmja, e të fryjnë erërat, përmendni nevojat e juaja, sepse është çasti i penduesve – i atyre që i përkushtohen Allahut, që i kthehen Allahut.”* (Sujutiu)

- *“Kërkoni përgjigjen e lutjes në çastin e takimit të ushtrive, në çastin e ikametit për namaz dhe zbritjes së shiut.”* (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih el-Xhami’, Mekhuli)

- *“Kur të kalon gjysma e natës apo një e treta e saj, Allahu i Lartëmadhëruar zbret në qiellin e dynjasë, dhe thotë: “Nuk pyes për tjetër rob Timin, kush është që më kërkon falje, e ta fali, kush më lutet e t’i përgjigjem, kush më kërkon e t’i jap, kështu deri sa të del*

*mëngjesi.*" (Ibn Kajimi në Muhtesar es-savaik el-mursele, Rufa'a ibn arabe el-xhehni)

- "Lutja e njeriut për vëllanë e tij që e bënë kur ai nuk është prezent është e pranuar, tek koka e tij qëndron një engjëll që thotë amin për lutjen e tij, sa herë që ai lutet për të për të mirë, ai thotë: "Amin, edhe ty të takoftë ajo që lutesh për atë." (Ibn Maxhe, Albani thotë se hadithi është sahih)

- "Lutja më shpejtë e përgjigjur është lutja e të panjohurit për të panjohurin (që nuk janë të pranishëm ." (Ebu Davudi)

"I Dërguari s.a.v.s. kur dëshironte të lutej për dikë ose kundër dikujt, atëherë bënte kunutin pas rukusë." (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih el-Xhami')

- Abdullah ibn Zejdi thotë se: "I Dërguari s.a.v.s. doli në xhami dhe u fal dhe, kur lutej apo dëshironte të lutej, kthehej kah Kibla dhe e kthente në anën tjetër petkun që e kishte." (Buhariu)

- "Transmeton i Dërguari s.a.v.s. se Allahu i Madhëruar thotë: "Një rob e bëri një gjynah, dhe tha: "Allahu im, ma fal gjynahun tim." Allahu i Lartësuar thotë: "Robi Im e bëri një gjynah dhe e di se ka Zot që fal gjynahun dhe ndëshkon për gjynahun." Pastaj ai përsëri bëri gjynah, dhe tha: "O Zot, ma fal gjynahun tim." Allahu i Lartësuar thotë: "Robi Im e bëri një gjynah dhe e di se ka Zot që fal gjynahun dhe ndëshkon për gjynahun." Pastaj ai përsëri bëri gjynah, dhe tha: "O Zot, ma fal gjynahun tim." Allahu i Lartësuar thotë: "Robi Im e bëri një gjynah dhe e di se ka Zot që fal gjynahun dhe ndëshkon për gjynahun." Puno çfarë të duash, ta kam falur ty." Abdu-l-A'la thotë: "Nuk e di, a për të tretën herë apo për të katërtën tha: "Puno çfarë të duash." (Muslimi)

Kërko prej Allahut duke qenë i bindur në përgjigjen e Tij, le të jetë dua ja që del nga zemra jote dhe shpirti yt, e jo nga buzët e tua, që ta shqiptosh sikur e ke mësuar përmendësh: "Lutuni Allahut duke qenë të bindur në përgjigje, dijeni se Allahu nuk i përgjigjet lutjes që del nga zemra e të shkujdesurit, të pavëmendshmit." (Mubarekfuri, Tuhfet El-Ahvedhi, Ebu Hurejre)

Nëse e bënë këtë, dhe tregohesh i sinqertë me Allahun, të mos kesh fare dyshim se kërkesa jote do të plotësohet,

nuk është e thënë në formën që ti e zgjedh, Allahu e di më së miri se çfarë të bënë ty dobi, Ai është më i mëshirshëm për ty se që je vetë ti për veten tënde, Ai do të zgjedh vetëm atë që ty të përshtatet dhe është më e mirë, edhe pse djalli nuk të lë rehat por kohë pas kohe të cytë në shpirt se atë që ti e do është më e mirë se ajo të cilën për ty e ka fshehur Mëshuruesi, Mëshirëploti.

*“Çdo rob që i lutet Allahut me ndonjë lutje, ku nuk ka ndërprerje të marrëdhënieve familjare, le ta di se Allah do t’i jap njërën nga këto tri gjëra: “T’ia përshpejtojë plotësimin e lutjes në dynja, t’ia ruajë atë për ahiret, ose t’ia pengojë ndonjë të keqe për duanë e bërë.” Të pranishmit thanë: “o i Dërguari i Allahut, atëherë të kërkojmë shumë pra?” Tha: “Allahu ka shumë.” (Ahmedi)*

*“Çdo besimtar që e drejton fytyrën kah Allahu dhe parashtron ndonjë kërkesë, le të dijë se Allahu do t’ia japë atë; ose do t’ia shpejtojë në dynja ose do t’ia ruajë në ahiret, nëse nuk e përshpejton.” Të pranishmit thanë: “O i Dërguari i Allahut, e ç’është përshpejtimi i duasë? Ai tha: “Të thotë: “U luta, u luta, dhe nuk mendoj se do të më përgjigjet mua.” (Albani thotë se hadithi është sahih, Edeb el-Mufred, Ebu Hurejre)*

*“Kërkoni Allahut prej të mirave të Tij, se Allahu do që t’i kërkohet; (por ta dini) ibadeti më i vlefshëm është pritja e zgjidhjes (e ndonjë kërkesë).” (Tirmidhiu, e transmeton Ahmed Esh-Shakir në Umdet et-Tefsir, Abdullah ibn Mes’udi)*

Mos harro se në çastin kur lutesh je në lutje, e të jesh në lutje do të thotë të jesh në dobësi, përrulje, përkushtim, nënshtrim, shpresë, kurse gjithë këtë e dëshmon trupi yt, forma e tij, tiparet e fytyrës tënde, shkëlqimi i syve të tu dhe dridhma e zërit tënd. Kujtoj se është e udhës të dish se gjatë lutjes është mirë t’u përmbahemi disa suneteve të të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.

Disa dijetarë janë të mendimit se duart nuk ngrihen gjatë lutjes. Ata mbështeten në hadithin që thotë se i Dërgu-

ari s.a.v.s. i ngrinte duart vetëm në namazin e *istiskasë* (lutjes për shi): *“Enes ibn Maliku thotë se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. nuk i ngrinte duart e tij në ndonjë dua përveç të istiskasë, i ngrinte duart aq sa i shihej e bardha e nënsjetullave.”* (Buhariu)

Duke u nisur nga zgjidhjet e hapura që na i ofron Islami, dhe gjithashtu nisur nga parimi i bashkërenditjes së vijës së trupit në namaz me vijën e gjuhës, do të kishim dashur që të bëjmë një zgjidhje tjetër, pa e llogaritur të gabuar mendimin e atij që mbështet hadithin e Buhariut të shënuar më lartë; të ngremë duart lart, që me të të pohojmë besnikërinë midis duarve dhe gjuhës gjatë duasë, duke u mbështetur në hadithin e Selmanit dhe hadithe tjera të sakta (sahih). **Bile hadithi i Buhariut mund të komentohet se qëllimi i ngritjes së duarve në lutjen e istiskasë ka për qëllim stërmadhimin e ngritjes së duarve, e jo vetëm ngritjen e tyre normale. Këtë e vërteton edhe transmetimi tjetër i qartë i këtij hadithi që flet për istiskanë.** Në vijim do t'i shtrojmë disa hadithe që flasin për këtë çështje:

- *“I Dërguari s.a.v.s. kërkoi ujë dhe mori abdes, e pastaj i ngriti duart, dhe tha: “O Allah, fale Ubejd ibn Amrin); - e pashë të bardhën e nënsjetullave të tij, dhe tha: “O Allah, bëje në Ditën e Kiametit të jetë përmbi shumë krijesave të Tua të njerëzve.”* (Buhariu)

- *“I Dërguari s.a.v.s. e angazhoi për mbledhjen e sadakasë një njeri të fisit beni esed, të cilin e quanin ibn El-Utbije. Kur ai erdhi, tha: “Kjo është e juaja, kurse kjo më është dhënë dhuratë mua.” Atëherë i Dërguari s.a.v.s. doli në minber... e falënderoi Allahun dhe e lavdëroi, pastaj tha: “Çfarë ndodhi me punëtorin që e dërguam (për ta mbledhë sadakanë) që na vjen e na thotë: “Kjo është e juaja, kurse kjo më është dhënë dhuratë mua”-, pse nuk qëndroi në shtëpinë e babait të tij dhe nënës së tij e të shikonte se a do t'i dhurohej apo jo? Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, secili nga ju që, me të drejtë merr pjesë të zekatit, do të vijë në Ditën e Kiametit duke e bartur atë në qafën e vet. Nëse e ka marrë devenë, do ta bartë atë në qafë dhe ajo me pëllitje do ta kumtojë turpin e tij. nëse e ka marrë*

*lopën, do ta bartë në qafë dhe ajo me pëllitje do ta kumtojë turpin e tij. nëse e ka marrë delen, do ta bartë në qafë dhe ajo me blegërimën e saj do ta kumtojë turpin e tij.” Pas kësaj, i Dërguari s.a.v.s. ka ngritur duart e veta, aq sa e kemi parë bardhësinë e sqetullave të tij, dhe tha: “O Allah, a e komunikova (mjaft)?”*

- Në librin e fetvave të Bin Bazit (Nurun ala Derb) është e theksuar se i Dërguari s.a.v.s. i ngrinte duart në duanë e kunutit, 9/139.

Bile i Dërguari s.a.v.s. na i mësoi rregullat e ngritjes së duarve në dua, ai bëri dallimin e ngritjes së duarve midis duasë dhe *ibtihalit* (lloji i lutjes), mu ashtu siç na mësoi rregullat e lutjes; si të fillojmë me lavdërim dhe falënderim të Allahut dhe si ta mbarojmë me të namazin e shumë gjëra të tjera.

*“Kur t’i luteni Allahut, lutuni me brendinë e shuplakave tuaja, e mos i luteni Atij me pjesët e jashtme të shuplakave.”* (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih el-Xhami’)

*“Ibn Abasi thotë: “Kërkesë – dua – është t’i ngritësh duart paralelisht me shpatullat – dy duart të jenë të barazuara dhe paralel; istigfari bëhet me sinjalizim të një gishtit, kurse ibtihali t’i shtrish duart kah qielli.”* (Ebu Davudi, Albani se thotë hadithi është sahih)

*“I Dërguari i Allahut s.a.v.s. kur i ngrinte duart në dua nuk i ulte përderisa nuk e fërkonte fytyrën me to.”* (Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Ibn Haxhe el-Askelani, Albani thotë hadithi është daif, Omer ibn Hatabi)

*“Fudala ibn Abid thotë: “I Dërguari s.a.v.s. e dëgjoji një njeri që lutej në namaz dhe nuk dërgoi salevat për të Dërguarin. I Dërguari s.a.v.s. tha: “Shpejtoi ky.” Pastaj e thirri dhe i tha: “Kur ndonjëri të falet le të fillon me falënderim për Allahun dhe lavdërim për Atë, pastaj le të dërgojë salevat të Dërguarit, e pastaj le të lutet për çka të dojë.”* (Tirmidhiu dhe Ibn Bazi në Mexh-mua el-Feteva)

Sa'd ibn Vekasi tregon dhe thotë: *"Babai im më dëgjoi duke thënë: "Allahu im, të lutem për Xhenetin, të mirën e saj, bukurinë e saj dhe këtë e atë, dhe kërkoj mbrojtjen Tënde nga zjarri, prangat dhe zinxhirët, këtë e atë." Ai më tha: "Biri im, unë e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. të thotë: "Do të ketë njerëz që e teprojnë në dua, kujdes mos u bë prej tyre. Se ti, nëse të jepet Xheneti, të jepet me të gjitha të mirat që janë në të dhe, nëse mbrosh nga zjarri, do të jesh i mbrojtur prej tij dhe e keqja që është në të." Në transmetim tjetër thuhet: "Të mjafton të thuash: "Allahu im, të lutem për Xhenetin dhe çdo fjalë e punë që afron tek ai dhe kërkoj mbrojtjen Tënde nga zjarri dhe çdo fjalë e punë që afron tek ai." (Ebu Davudi, Albani thotë se hadithi është sahih)*

Nëse je nga ata që hulumtojnë në minierat e të mirave Hyjnore për të gjetur më shumë thesare dhe, nga ata që dëshirojnë më shumë fonde, dije se dera është e hapur para teje për të marrë çdo gjë që dëshiron. Mos harro se ti bashkëvepron me Allahun, Bujarin më të madh, me Mëshiruesin, Mëshirëplotin: *"Djalli tha: "O Zot, pasha madhërinë Tënde, nuk do të ndalem duke i devijuar robërit e tu, derisa shpirti i tyre të jetë në trupin e tyre." Zoti i Lartësuar tha: "Pasha madhërinë dhe lartësinë Time, Unë edhe më tej do t'ua fali atyre, përdërisa të mos kërkojnë falje." (Sujutiu, Xhami' es-Sagir, Albani thotë se hadithi është hasen, Ebu Seid El-Hudëriu)*

*"Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, ose pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti i Muhamedit, sikur të gaboni (bënë gjynahe), a gabimet e juaja të arrijnë të jenë sa midis qiellit dhe tokës, e pastaj t'i kërkon Allahut falje, Ai do t'ju falë; Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, ose pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti i Muhamedit, sikur ju të mos gaboni, Allahu i Madhërishëm do të sjell një popull që gabojnë e pastaj kërkojnë falje, e Ai ua falë." (Hejthemiu, Mexhme' ez-Zevaid)*

*"Sikur ta dinte besimtari se çfarë dënimi ka tek Allahu, asnjëri nuk do të lakmonte për Xhenetin, e sikur ta dinte jobesimtari*

se çfarë mëshire ka tek Allahu, asnjëri nuk do të humbte shpresën për Xhenetin." (Tirmidhiu, Albani thotë se hadithi është sahih)

"Allahu i Madhëruar thotë: "Kush e di se Unë jam i Plotfuqishëm dhe i Mundshëm për t'i falë gjynahet, e fali dhe nuk kam fare dert, përderisa nuk më bënë asgjë shirk." (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih el-Xhami')

Zgjedh çfarë të duash prej gjërave që i Dërguari s.a.v.s. i vuri para teje, shijo çka të duash nga dhikri, duatë, leximet dhe tesbihet. Përpiqu të vendosësh një rend të bukur të dhikrit ditor, atë që do ta përsëritësh ditën dhe natën. Do të ishte mirë që këtë ta praktikosh pas namazit të sabahut dhe pas namazit të akshamit. Lum për ty nëse arrin të përpilosh disa lutje të veçanta e të zgjedhura, të cilat përputhen me personalitetin tënd, rrethanat e tua dhe pozitat e jetës tënde, familjes dhe qytetit ku jeton. S'ka dyshim se këto lutje mund të pësojnë zhvillim, varësisht nga zhvillimi i rrethanave të jetës tënde dhe rrethanave të ngjarjeve lokale dhe globale që ndodhin përreth teje dhe atyre që i ke përreth.

Lexoi këto hadithe me kujdes dhe durim, zgjidhi ato që ty të përshtaten, mbaj mend se këto nuk përfshihen në kapitullin e urdhrave ose detyrave ditore, ato përbëjnë nderime të mëdha e fisnike, thirrje dhe nxitje për më shumë shpërbllim dhe mirësi dhe mëshirë nga Allahu: "Allahu i Madhëruar thotë: "O biri i Ademit! Përkushtoju adhurimit Tim, do ta mbash kraharorin pasuri, e ta mbylli varfërinë (ta paguaj borxhin), se nëse nuk bënë kështu, atëherë ta mbushi kraharorin punë (angazhim) dhe nuk ta mbyll varfërinë tënde." (Ibn Muflih, ebu Hurejre)

"Allahu i Madhëruar thotë: "Unë jam pranë të menduarit e robit Tim që mendon për Mua, Unë jam me atë kur ai më përmend, e nëse më përmend në vete, edhe Unë e përmendi në Vete, por nëse më përmend në publik, Unë e përmendi atë në publik më të mirë se ata, nëse ai më afrohet një pëllëmbë, Unë i afrohem një arshin, e nëse më afrohet një arshin, Unë i afrohem me hapa të

*mëdhenj, por nëse më vjen duke ecur, Unë shkoj tek ai me vrap.”*  
(Buhariu)

“Kulmi i istigfarit është të thuash: *“Allahumme ente rabbi, la ilahe il-la ente, halekteni ve ene abduke, ve ene ala ahdike mesteta’tu, eudhu bike min sherri ma sana’tu, ebuu leke bi ni’me-tike alejje ve ebuu leke bi dhenbi, fagfir li, fe innehu la jagfiru dhunube il-la ente.”* (Allahu im, Ti je Zoti im, nuk ka zot tjetër përveç Teje, më krijove e unë jam rob i Yt, unë i përmbahem besës Tënde dhe premetimit Tënd aq sa mundem, më ruaj nga e keqja që e kam bërë, pranoj begatinë Tënde për mua dhe pranoj gabimin e bërë, më fal mua, sepse vetëm Ti je Ai që falë) -, *tha: “Kush e thotë këtë ditën, i bindur në të, dhe vdes atë ditë para mbrëmjes, ai do të jetë banorë i Xhenetit, e kush e thotë natën, i bindur në të dhe vdes para se të gdhijë mëngjesi, ai do të jetë nga banorët e Xhenetit.”* (Buhariu)

“Lutja e vëllait për vëllanë pas shpine është e pranuar, te koka e tij qëndron një engjëll që thotë Amin për lutjen që ai e bënë, sa herë që ai lutet për atë për ndonjë të mirë, engjëlli thotë: *“Amin, edhe për ty qoftë e njëjta.”* (Ibn Maxhe, Albani thotë se hadithi është sahih)

“Lutja që më së shpejti i përgjigjet është lutja e të padukshmit për të padukshmin.” (Ebu Davudi)

“Kush thotë për çdo ditë në mëngjes dhe çdo natë në mbrëmje nga tri herë: *“Bismi’l-lahi ‘l-ledhi la jedurru mea ismihi shej’un fi’l-erdi ve la fi’s-semai, ve huve semi’u ‘l-alim”* – asgjë nuk e dëmton.” (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih edeb el-Mufred, Uthman ibn Afani)

“Kush thotë: *“estagfirull-llahe ‘l-ledhi la ilahe il-la huve, el-hajju ‘l kajjum ve etubu ilejhi, tri herë -, i falen atij (gjynahet) edhe nëse ka ikur nga fushëbeteja.”* (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih et-Tergib)

“Kur të zgjoheni në mëngjes, thoni: *“Esbahna ve esbaha el-mulku li’l-lahi rabbi’l-alemin, Allahumme inni es’eluke hajre hadha*

*'l-jevm, fet'hahu, ve nasrehu, ve bereketehu ve hudahu, ve eudhu bike min sherri ma fihî, ve sherri ma kablehu ve sherri ma ba'dehu"* (U zgjuam në mëngjes, pushteti i takon Allahut, Zotit të botëve, Allahu im, kërkoj nga Ti të mirën e kësaj dite, fillimin e mbarë, fitoren, bekimin, udhëzimin, siç kërkoj mbrojtjen Tënde nga e keqja e kësaj dite, e keqja para saj dhe pas saj) -, *le ta thotë këtë edhe në mbrëmje."* (Albani thotë se hadithi është hasen, Sahih el-Xhami')

Ummu Seleme e bija e Ebu Umejjes thotë: *"I Dërguari i Allahut s.a.v.s. më mësoi të them në mbrëmje: "Allahu im, ja nata po vjen, dita po shkon, janë zërat e lutësve që Ty të luten, është koha e namazit, të lutem më fal."* (Ebu Davudi, Tirmidhiu, Ibn Kethiri, Albani thotë se hadithi është daif)

Abdullah ibn Hubejbi thotë: *"Ishte një natë me shi kur ne dolëm për ta kërkuar të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. që të na falte namazin. Pas pak e gjetëm. Ai na tha: "A jeni falur?" Unë nuk thashë asgjë." Ai tha: "Thuaj, e unë nuk thashë asgjë." Pastaj tha: "Thuaj, e unë nuk thashë asgjë." Pastaj tha: "Thuaj! E unë thashë: "O i Dërguari i Allahut! E çfarë të them?" Ai tha: "Kul huwallahu ehad" dhe "kul eudhu birabbi-l-felek dhe kul eudhu birabbin-nas", në mëngjes dhe në mbrëmje tri herë, do të mjaftojnë për çdo gjë (do të mbrojnë nga çdo gjë)." (Ebu Davudi, Albani thotë se hadithi është sahih)*

Transmeton Ebu Hurejre r.a. se Ebu Bekr Es-Siddiku ka thënë: *"O i Dërguari i Allahut, më urdhëro disa fjalë që do t'i them në mbrëmje dhe në mëngjes." Ai tha: "Thuaj: "Allahumme fatire 's-semavati ve'l-erdi, alime 'l-gajbi ve'sh-shehadeti, rabbe kul-li shej'in ve melikehu, eshhedu en la ilahe il-la ente, eudhu bike min sherri nefsi, ve sherri 'sh-shejtani ve shirkihî."* (Allahu im, Krijuesi i Tokës dhe i qiellit, Ti që di të dukshmen e të padukshmen, Zot i çdo sendi dhe Pronar i tij, dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Teje, kërkoj mbrojtjen Tënde nga e keqja e vetes sime dhe e keqja e djallit.) *Tha: "Thuaje në mëngjes e në*

*mbrëmje dhe kur të shtrihesh në shtrat.*" (Tirmidhiu, Ebu Davudi, Albani thotë se hadithi është sahih, Edeb el-Mufred)

Transmeton Ajesh Ez-Zerki se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. thotë: *"Kush thotë në mëngjes: "La ilahe ilallahu vahdehu la sherike lehu, lehu'l-mulku ve lehu'l-hamdu ve huve ala kul-li shej'in kadir" është e barabartë me lirimin e një robi nga bijtë e Ismailit a.s., i shkruhen dhjetë të mira, i hiqen dhjetë të këqija, ngritët në dhjetë shkallë më lartë dhe është në mbrojtje nga djalli deri në mbrëmje; e nëse e thotë në mbrëmje, i ndodh e njëjta deri në mëngjes."* Hamadi tha: *"Një njeri e pa të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. në ëndërr, dhe tha: "O i Dërguari i Allahut, Ebu Ajashi po flet për ty këtë e këtë?" Ai tha: "E tha të vërtetën Ebu Ajashi."* (Ebu Davudi, Albani thotë se hadithi është sahih)

*"I Dërguari i Allahut s.a.v.s. në mbrëmje thoshte: "em-sejna ve emsa el-mulku li'l-lah, ve-l-hamdu li'l-lah, ve la haole ve la kuvvete il-la bi'l-lahi vahdehu, la sherike lehu, lehu'l-mulku ve lehu'l-hamdu ve huve ala kul-li shej'in kadir, rabbi es'eluke hajre ma fi hadhihi 'l-lejlete ve hajre ma ba'deha ve eudhu bike min sherri ma fi hadhihi 'l-lejlete ve sherri ma ba'deha, rabbi eudhu bike min 'l-kesl, ve sui 'l-kibr, rabbi eudhu bike min adhabi'n-nari ve adhabi'l-kabri" (...Zoti im, të lutem për dobinë e kësaj nate dhe dobinë e së mirës që vjen pas asaj, më mbroj nga e keqja e kësaj nate dhe e keqja që vjen pas saj, Zoti im, kërkoj mbrojtjen Tënde nga përtacia, mendjemadhësia e keqe, Zoti im, më ruaj nga dënimi i zjarrit dhe dënimi i varrit); - dhe kur zgjohej e thoshte të njëjtën: "esbaha ve esbaha 'l-mulku li'l-lahi, vel-hamdu li'l-lah...)" (Muslimi)*

*"Kush thotë në mëngjes: "Allahumme ma esbaha bi min ni'metin ev bi ehadin min halkike fe minke vadeke, la sherike leke, fe leke'l-hamdu ve leke 'sh-shukru" (Allahu im, çdo e mirë që më ka rënë sot mua ose ndonjërit nga krijesave të Tua, është vetëm prej teje, vetëm prej Teje, Ti nuk ke shok, andaj vetëm Ty të takon falënderimi dhe mirënjohja); - le ta dijë se e*

*ka plotësuar falënderimin e asaj dite, e kush e thotë në mbrëmje, le ta dijë se e ka plotësuar falënderimin e asaj nate.”* (Ebu Davudi dhe Ibn bazi në Mexhmu’ el-Fetava)

Abdullah ibn Mes’udi lutej shumë me këto lutje (në një transmetim thuhet: *“I Dërguari i Allahut s.a.v.s. na i mësonte këto fjalë): “Rabbenā eslih bejnena, vehdina subule ‘s-selami, ve nexhina mine’dh-dhulumati ila’n-nuri, vasrif anna el-fevahishe ma dhahere minha ve ma betane, ve barik lena fi esmaina ve ebsarina ve kulubina ve ezvaxhina dhe dhurrijatina, ve tub alejna inneke ente ‘t-tevvabu’r-rrahim, vexh’alna shakirine li ni’metike muthnine biha kailine biha (në transmetim Kabilihā, e në tjetër transmetim Kabiline leha) ve etimmeha alejna”* (Zoti ynë, na bashko neve, udhëzona në rrugët e shpëtimit, na shpëto nga errësira në dritë, largo nga ne veprat e shëmtuara, që duken e që nuk duken, bekoje dëgjimin tonë, shikimin tonë, zemrën tonë, gratë tona dhe fëmijët tanë, na fal neve, se Ti me të vërtet je Falës i Madh dhe Mëshirues, na bëj falënderues të të mirave të Tua, të flasim për to, e t’i pranojmë, dhe na i plotëso.” (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih edeb el-Mufred)

*“I Dërguari i Allahut sd.a.v.s. një ditë hyrë në xhami dhe pa një njeri të ensarëve që i thoni ebu Umame, e i tha: “O Ebu Umame, ç’ke që po të shoh i ulur në xhami në këtë kohë që nuk është kohë namazi?” Ai tha: “Brenga dhe borxhe, o i Dërguari i Allahut, janë që më kanë bërë të jem këtu.” Ai tha: “Po, a të të mësoj për disa fjalë, që nëse i thua Allahu do ta largojë brengën dhe do ta paguajë borxhin?” Thashë: “Gjithësesi, o i Dërguari i Allahut.” Ai tha: “Thuaj në mëngjes e në mbrëmje: “Allahumme inni eudhu bike minel-hemmi ve ‘l-hazeni, ve eudhu bike minel-axhzi ve ‘l-keseli, ve eudhu bike min el-xhubni ve el-buhli, ve eudhu bike min galebetiddejni ve kahri ‘r-rixhali”* (Allahu im, kërkoj mbrojtjen Tënde nga brenga dhe shqetësimi, kërkoj

mbrojtjen Tënde nga paaftësia dhe përtacia, kërkoj mbrojtjen Tënde nga frika dhe koprracia, kërkoj mbrojtjen Tënde nga borxhi që më ka kapluar dhe shtypja e njerëzve); - *tha*: “Unë bëra kështu, dhe Allahu i Lartëmadhëruar ma largoi bren-gën time dhe ma hoqi borxhin që e kisha.” (Ebu Davudi)

“Kush thotë në mëngjes e në mbrëmje: “Allahumme inni es-bahtu ushiduke ve ushidu hamlete arshike ve melaiiketike ve xhe-mia halkike enneke ente Allahu ‘l-ledhi la ilahe il-la ente, ve enne Muhammeden abduke ve resuluke” (Allahu im, u zgjova duke të dëshmuar Ty dhe duke dëshmuar për bartësit e Arshit Tënd, engjëjt dhe gjithë krijesat, se Ti, Ti je Allahu, që nuk ka zot tjetër përveç Teje, se Muhamedi është rob i Yti dhe i Dërguari i Yti); - *Allahu do ta liroj një të katërtën e tij nga zjarri, e nëse thotë dy herë, Allahu do ta lirojë gjysmën e tij nga zjarri, e nëse e thotë tri herë, Allahu do ta lirojë të tretën e tij nga zjarri, e nëse thotë katër herë, Allahu do ta lirojë nga zjarri.*” (Ibn Kajjimi në Zad el-Mead)

“Këmbëngulni të thoni ja dhe ‘l-xhelali ve ‘l-ikrami’”. (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih el-Xhami’)

“Transmeton Berra ibn Azib se i Dërguari s.a.v.s. thotë: “Kur të bëhesh gati për t’u shtrirë në shtrat merr abdes sikur që merr abdes për namaz, pastaj shtrihu në krahun e djathtë, e pastaj thuaj: “Allahumme inni eslemtu nefsi ilejke, ve vexhehtu vexhhi ilejke, ve fevedtu emri ilejke, ve elxhe’tu dhahri ilejke, ragbetetn ve rehbeten ilejke, la melxhe’ ve la menxha minke il-la ilejke, amentu bi kitabike ‘l-ledhi enzelte ve nebijjuke el-ledhi erselte” (Allahu im, Ty ta dorëzoi shpirtin tim, fytyrën time e kthej kah Ti, çështjen time ta dorëzoi ty, shpinën time e mbështes te Ti, nga dashuria dhe frika për Ty, nuk ka strehim e as shpëtim prej teje, përveç se të mbështetem në Ty, besoj në Librin që e shpalle dhe në të Dërguarin që e dërgove); - nëse vdes atë natë, dije se ke vdekur në natyrën (Islamin). *Le të jenë këto fjalë të fundit që i thua.*” Berari thotë: “Unë i thashë këto fjalë,

*dhe kur arrita te: "amentu bi kitabike el-ledhi enzelte", thashë: "ve bi resulike", ai tha: "Jo, por thuaj: "ve bi nebijjike el-ledhi erselte." (Buhariu dhe Muslimi)*

Kështu flet i Dërguari s.a.v.s., me gjuhën e bukur peygamberike, të qartë e plot harmoni. Mundohu që edhe ti të jesh i tillë në lutjet e tilla. Mos u shqetëso nëse për shkaqe të ndryshme nuk ke arritur t'i plotësosh disa nga këto lutje të bukura peygamberike të mëngjesit e të mbrëmjes, sepse ka ende kohë për ta bërë këtë, para teje ka raste tjera të vulltshme, më të lehta, Allahu të mundëson kompensimin e shpërblimeve që të kanë ikur dorësh: *"Kush flet dhe nuk e lexon pjesën e tij të duhur të lutjeve apo diçka tjetër, e pastaj atë e lexon midis namazit të sabahut dhe të drekës, i llogaritet sikur ta ketë lexuar natën."* (Muslimi, Omer ibn Hattabi)



## TRIBUNA E DYTË BILANCI (KAPITALI)

### Pjesa 1

#### Bilanci dhe ballafaqimi me djallin

Ndoshta thua: A nuk mjafton që kthimi ynë kah Kibla të provon përshpirtshmërinë tonë? Lidhja e duarve në kraharor? Shikimi ynë në vendin e sexhdes? Që kjo të jetë shenjë e qartë se jemi të përkushtuar thellë ndaj Allahut? Se vetëm kah Ai jemi të orientuar dhe vetëm me Atë flasim? Pa marrë parasysh mënyrën e kësaj bisede, formën e leximit apo atë që ndiejnë zemrat tona dhe ajo që na sillet ndërmend?

Mirë. Paramendoni një djalosh të ri që vjen në shtëpinë e të fejuarës së tij, ulet para saj, e shikon dhe nuk e lakon shikimin tjetërkund, pastaj e nxjerr një letër nga xhepi dhe ia lexon asaj me shpejtësi të madhe një letër dashurie të përbërë nga dhjetë rreshta, gjatë leximit nuk e ndryshon fare theksin e tij, e as theksin e zërit, në fytyrën e tij nuk vërehen fare ndonjë ndryshim, as në sytë e tij ndonjë lëvizje që përputhet ose vërteton atë që e nxjerr nga goja e tij, frymëmarrjet i ka të pandërprera midis fjalive dhe fjalëve dhe, pasi ta mbarojë leximin mbyll fletën dhe e vë në xhepin e tij dhe del me shpejtësi nga shtëpia duke mos e kthyer kokën mbrapa!! Ç'mendoni si do të veprojë e fejuara e tij pas kësaj ndeje "emocionale-romantike"?

Si presim pra që Allahu të na vërtetojë saktësinë e namazit tonë, të njeriut që lexoi atë që e lexoi në namaz, përsëriti ajetet, tesbihet, tehijjatin, salevatet, selamet, lutjet dhe gjithë ato që u desh t'i thoshte, por asnjëherë gjatë namazit nuk e lëvizi kapakun e syrit, nuk nxori asnjë pikë djersë,

nuk e ndryshoi zërin gjatë leximit, nuk e ndryshoi ngjyrën e fytyrës, e pastaj doli nga namazi siç hyri, zemra nuk u lidh me Allahun, nuk fitoi ndjenja të ngrohta të takimit me Allahun, nuk ndjeu kënaqësinë e as ëmbëlsinë e bisedës që e bëri me Allahun, Krijuesin e krijesave, Drejtuesin e gjërave, Dhuruesin e shpirtit dhe jetës dhe vdekjes?

A thua ka ndonjë nga ne që kur del nga namazi morri lapsin dhe filloi t'i shkruajë llogaritë, t'i regjistrojë çastet ku ndjeu se vërtetë po bisedonte me Allahun, se gjatë namazit pati çaste kur vërtet shijoi kënaqësinë e lidhjes me Allahun, se zemra e tij u dridh, trupi u rrëqeth, qoftë edhe një herë, qoftë një sekondë, qoftë edhe një pjesë e sekondës, që të mund në fund t'i numërojë këto çaste, e të vlerësojë, qoftë përafërsisht, me natyrën njerëzore, të paramendojë shpërblimet e namazit, sipas plan-programit që na e ofron i Dërguari i Allahut s.a.v.s.: "Transmeton Amar ibn Jasir r.a. se i Dërguari s.a.v.s. ka thënë: "Njeriu del nga namazi, ndërsa i shkruhet (se është falur) vetëm një e dhjeta e namazit të tij, një e nënta, një e teta, një e shtata, një e gjashta, një e pesta, një e katërta, një e treta, gjysma." (Ebu Davudi, Nesaiu, Albani thotë se hadithi është sahih)

*"Ka nga ju që namazin e falin të plotë, po ka nga ju që atë e falin gjysmën, një të tretën, një të katërtën, një të pestën, derisa numëroi një të dhjetën."* (Albani thotë se hadithi është sahih)

Po, është e vërtetë se ne e dimë që djalli, sado që të përpiqemi ta mbisundojmë, do të këmbëngul pandërprerë dhe me kokëfortësi që të depërtojë në ndejat e namazit tonë. Po, është vështirë rezistenca e tij e plotë gjatë namazit, është e vështirë që dikush nga ne të del nga namazi me notën 100%, të qëllimeve, shpërblimeve, qetësisë dhe kënaqësisë. Megjithatë, doemos e kemi të përpiqemi aq sa mundemi. Është e vështirë pos nuk është e pamundur.

Si do të ishte çështja sikur çdo namaz ta llogarisnim sikur një ndeshje dhe sfidë e djallit ku dëshirojmë të regjistrojmë sa më shumë pikë kundër tij, ose të regjistrojmë kundër tij humbje të mëdha?

Mos u brengosni shumë për këtë ndeshje që do të hyni, mos u brengosni për pikat e shënuara në dobinë tuaj, sepse Omeri, i biri i Hattabit r.a., që ishte ai i cili gjithmonë e fitonte djallin në ndeshjet e përditshme, në shumë raste tregon se nevojat e muslimanëve ishin që shumë herë e largonin nga vëmendja e namazit, kishte ndodhur që në namaz të llogariste buxhetin e Umetit, të rregullonte karvanët e tregtisë, të përgatiste ushtrinë e muslimanëve: “Omeri r.a. thotë: *“Unë në namaz e llogaris xhizjen e banorëve të Bahrejnit.”* (Ibn Haxher El-Askelani)

*“Unë në namaz e përgatis ushtrinë time.”* (Ibn Haxher El-Askelani)

*“Ibrahim en-Na’hi thotë se Omeri r.a. ishte duke e falur namazin e akshamit me njerëzit dhe, nuk lexoi asgjë derisa dha selam. Kur mbaroi, i thanë: “Ti nuk lexove asgjë!” Ai tha: “E përgatita karvanin që do të niset për Siri, pastaj fillova t’i caktoj vendet ku do të pushon karvani, derisa arrita në Siri, e shita mallin e karvanit dhe atë që u desh.” Tha: “Omeri e përsëriti namazin dhe ata e përsëritën.”* (Imam Shafiu, hadithi është *mursel*)

Cila është mënyra më e saktë për realizimin e përshpirtshmërisë në namaz, që mjafton të dalim nga namazi me sa më shumë pikë të mundshme të regjistruara?

Një njeri e pyeti Hatim El-Esammin – Allahu e mëshiroftë – për mënyrën e përshpirtshmërisë së tij në namaz, e ai tha: “Unë ngrihem dhe marr tekbinin për namaz, e paramendoj Qaben para syve të mi, Urën e Siratit nën këmbët e mia, Xhenetin në anën e djathtë, Xhehenemin në të majtë, Engjëllin e vdekjes pas shpinës sime, që i Dërguari i Allahut po e vëzhgon namazin tim, e mendoj se është namazi im i

fundit, them Allahu ekber me madhështi, lexoj dhe kontem-ploj, bie në ruku me përkushtim, në namazin tim kam frikë prej Allahut dhe shpresoj në mëshirën e Tij, pastaj jap selam dhe nuk e di se, a më është pranuar namazi apo jo?!”

Kujtoj se ky shembull i veçantë që na e prezanton Ha-tim Esammi është bazë mbi të cilën mund ta ndërtojmë përrshpirtshmërinë tonë në namaz.

Sa bukur do të ishte që ne të paramendojmë se falemi tani në xhaminë e lagjes sonë ose në shtëpinë tonë, bile në haremin e Mekes, ku Qabeja është para syve tanë, të para-mendojmë se tani jemi duke qëndruar në Urën e Siratit, në Xhenet ose në Xhehenem, apo që engjëlli i vdekjes është pas nesh dhe pret urdhrin Hyjnor që gati sa nuk ka zbrit, apo se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. po vëzhgon namazin tonë tani, për të dhënë gjykimin për atë e ndoshta na thotë, siç i tha atij njeriu: “Kthehu e falu, se ti nuk je falur.”

Nëse arrin që veten tënde ta vendosësh brenda kësaj sfere të mrekullueshme e rrethuar me mure që të mbrojnë nga bredhjet, leximit të zakonshëm, preokupimit me men-dime të kota që të bëjnë të mos dish se çfarë thua, garës së shpejtë me kohën duke bërë që sa më shpejtë ta përfun-dosh, shqiptimit spontan të zhveshur nga ndjenjat dhe reaksionet e gjithë asaj që e thua në namaz, vetëm kështu do të themi se ke filluar të falesh...

Shohim që muslimanët në Ramazan kundërshtojnë njëri-tjetrin në xhami rreth numri të rekateve të namazit të teravisë, se a janë tetë rekate apo njëzet? Por shumë pak ndodh që ata të flasin për kohën e një rekati, leximin në na-maz, plotësimin e rukusë dhe të sexhdes?! Bile edhe ata që këmbëngulin që në muajin e Ramazanit ta bëjnë hatme Kur’anin në namaz, duke lexuar çdo natë nga një xhuz të tij, shumë pak prej tyre pyesin; në çfarë shkalle të përrshpirt-

shmërisë ishte leximi i imamit në namaz, po kijami, rukuja dhe sexhdeja e tij?

Pse të kemi mosmarrëveshje për numrin e rekateve të namazit të teravisë dhe numrit të xhuzave të lexuara të Kuranit, e të mos kemi mosmarrëveshje për sasinë e përshpirtshmërisë sonë në namazin në fjalë?

Janë shenjat që vërtetojnë përshpirtshmërinë tonë në namaz: qetësia, përkushtimi, rrëqethja, dridhja, përlojtja e syrit, butësia e zemrës, qetësia e plotë, kënaqësia shpirtërore e nënshtrimit absolut para Fuqisë së lartë, para Mëshirës, Drejtësisë absolute.

Mos dil nga namazi pa ndjenja të ngrohta, pa ndonjë nga këto shenja, nëse jo në rekatin e parë, atëherë së paku në rekatin e dytë, të tretë, e të katërt, nëse jo në sunete, atëherë në farze, nëse jo në namazin e sabahut, atëherë në namazin e drekës, në atë të ikindisë, akshamit, e të jacisë, mos lejo që dita të kalojë e të mos kesh qarë në ndonjë namaz farz, së paku në ato nafile, të mos kesh dridhja të trupit, rrëqethje të zemrës, të mos ndiesh kënaqësinë e lidhjes madhore me Allahun e Lartëmadhërisëm, e ky është besimi më i dobët. Sa bukur është që këto ndjenja të rriten sa më shumë, sepse me këtë rriten edhe begatitë e mëdha dhe shpërblimet e panumërta që i investon në jetën tënde, e të rritet bilanci i Ahiretit tënd.

Njerëzit që e shihnin Sufjan Eth-Thevriun duke u falë, thoshin: "Po vdes (nga përshpirtshmëria e madhe që kishte në namaz)" Dëgjo se çfarë i ndodhi Urve ibn Zubejrit, birit të Esmës, bijës së Ebu Bekrit r.a.; Urven e kishte goditur sëmundja e gangrenës në këmbë, andaj i thanë se doemos t'i këputej këmba, që sëmundja të mos i përfshinte pjesët e tjera të trupit. I thanëse doemos të pinte pak alkool, që të humbë vetëdijen. Ai tha: "Të humbë gjuha dhe zemra ime nga kujtimi i Allahut? Pasha Allahun, unë kurrë nuk mbë-

shtetem në atë që t'i bëjë Allahut gjynah për ta respektuar Atë." Atëherë thanë: "Të japim pak opium (anestezi)." Ai tha: "Nuk dua që një pjesë e trupit tim të hiqet e unë të jem në gjumë." Atëherë thanë: "Të sjellim ca burra për të të mbajtur fortë." Ai tha: "Jo, unë do ta ndihmoj veten time." Thanë: "Nuk mundesh!" Tha: "Më leni të falem! Kur të më shihni se nuk po lëviz, ndërkaq gjymtyrët e trupit tim janë përqendruar mirë, më pritni derisa të bie në sexhde, e kur të bie në sexhde, dijeni se nuk kthehem në dynja, atëherë bëni çka të doni me mua." Mjeku erdhi dhe priti derisa ky ra në sexhde, e kur ra në sexhde morri mjetin dhe ia preu këmbën pa bërë ai zë fare, po bile thoshte: "La ilahe ilallahu, i kënaqur jam me Allahun për Zot, me Islamin për fe dhe me Muhamedin për të dërguar dhe lajmëtarë"; i ra të fikët por nuk lëshoi zë. Kur u zgjua ia sollën këmbën, e shikoi dhe tha: "Betohem në Allahun se unë nuk kam ecur kurrë me ty në haram, e di Allahu se sa kam qëndruar me ty në këmbë natën për hir të Allahut." Njëri nga sahabet i tha: "O Urve, sihariq, një pjesë e trupit tënd kaloi para teje në Xhenet." Ai tha: "Pasha Allahun, nuk më ka ngushëlluar dikush me ngushëllim më të mirë se ky."

Ç'mendon, deri në cilën shkallë të përsëritshmërisë mund të arrijmë ne në krahasim me këta burra të mëdhenj? Nëse jo deri në maje, atëherë të mundohemi bile një pjesë të madhe ose diçka bile?

## Pjesa 2

### Llogaritë pas namazit

Të provojmë që pas namazit të marrim lapsin, qoftë laps të vërtetë ose atë logjik, e t'i llogarisim, qoftë edhe në mënyrë të përafërt, çastet që mendojmë se kemi qenë shumë afër me Allahun, pikat e realizimit të përsëritshmërisë që

kërkuar në namaz, që ta paramendojmë sasinë e asaj se sa ka qenë e mundur të na pranohet namazi: një e dhjeta, një e pesta, një e treta, gjysma, më shumë, më pak, apo hiq fare?!

Disa depo të mëdha shpallin lojë shpërblyese për klientët të tyre të përherëshëm, para se të dalin nga depoja ata mbushin fletën e zbrazët duke shënuar emrin, adresën dhe numrin e telefonit të tyre, që më vonë të lajmërohen nëse kanë qenë fitues të shpërblimit.

Në namaz jemi brenda depos hyjnore, aty mbushim dhjetëra fleta, çdo fletë ka shpërblimin e saj. Është dallim i madh midis depove tregtare dhe depos Hyjnore, mjafton vetëm një dallim midis këtyre dallimeve, ajo se ne nuk i jemi vetëm kandidat për fitimin e shpërblimeve të shumta, por kandidat që arrijmë t'i fitojmë të gjitha shpërblimet të garantuara 100%, vetëm nëse arrijmë t'i mbushim fletët e shtruar në mënyrë të saktë, jo më shumë se kaq e as më pak.

Hyrja në namaz shënon projektin më të madh investues që realizon fitime të mëdha dhe që jep garanacë absolute, e tërë kjo me harxhime shumë të vogla, i tërë kapitali që kërkohet për këtë projekt të madh tregtar gati se është zero. Për të dhënë zekat na duhet më së paku të kemi sasinë e duhur të pasurisë, andaj japim 2,5%, haxhi kërkon një buxhet që garanton udhëtimin dhe qëndrimin në vendet e shenjta, agjërimi kërkon privimin nga ushqimi dhe gjëra tjera, sidomos dhënien e sadekatit fitrit në fund të muajit të Ramazanit.

Ndërkaq që namazi ka harxhime që nuk janë më tepër se disa pika uji që i harxhojmë për abdest dhe kohën që e falim namazin. Kjo është e tëra, nuk ka tatime e as pagesa shtesë, por njëkohësisht fitojmë shpërblime të mëdha që menjëherë shkojnë në llogaritë tona, bile disa i marrim në dorë para se të dalim nga namazi: qetësinë shpirtërore, shëndetësore, prehjen, kthjelltësinë mendore, ndjenjat se kemi lindur përsëri, disa shpërblime mbështillen me njëra tjetrën dhe dërgo-

hen në arka elegante, ose në adresën tonë në dynja: pëlqimin e Allahut, bekimin, paqen, përgjigjen e lutjeve të ndryshme, ose në adresën tonë të Ahiretit: shlyerje e gjynaheve të mëparshme dhe shtim të të mirave të panumërta në fondin tonë atje.

Nëse jemi fatlum dhe kemi sukses në faljen e namazit në mënyrë elegante dhe të përkryer, ashtu siç i ka hije të jemi para Allahut të Madhërishëm, shpërblimi pa dyshim do të jetë i madh, i shumëllojshëm, i shumënumërt, shumë forma dhe shumë aspekte. Ja disa forma të këtij shpërblimi e jo të gjitha: “Aliu r.a. thotë: “ *Më tha Ebu Bekri, e Ebu Bekri e thotë të vërtetën, se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. të thotë: “Nuk ka rob që bënë gjynah e pastaj merr abdest për bukurri, e pastaj i falë dy rekate dhe i kërkon falje Allahut, e të mos ia falë Allahu.” Ai pastaj lexoi – i Dërguari s.a.v.s. – këtë ajet: “Për ata që, kur bëjnë vepra të turpshme ose i bëjnë dëm vetes, e kujtojnë Allahun, i kërkojnë falje për gjynahet e tyre – e kush i fal gjynahet përveç Allahut? – dhe nuk ngulmojnë me vetëdije në gabimet që kanë bërë.” (Alu Imran, 135) (Buhariu)*

“Ç’mendoni për lumin që e ka dikush para dere e që lahet pesë herë në ditë, a i mbetet këti ndonjë njollë?” Të pranishmit thanë: “Jo nuk i mbetet asnjë njollë.” Ai tha: “Kështu është shembulli i pesë namazeve, me të Allahu i shlyen gjynahet.” (Buhariu)

“Çdo namaz i shlyen gabimet që ka përpara – pra gjynahet e kaluara.” (Albani thotë se hadithi është sahih, Sahih el-Xhami’)

“Njeri njeri erdhi tek i Dërguari s.a.v.s. dhe tha: “O i Dërguari i Allahut s.a.v.s., bëra një gabim (të rëndë), andaj zbatoje masën ndëshkuese mbi mua.” Pastaj erdhi koha e namazit dhe ai u fal me të Dërguarin e Allahut s.a.v.s., e kur mbaroi namazi, tha: “O i Dërguari i Allahut, bëra një gabim (të rëndë), zbatoje masën e caktuar nga Libri i Allahut mbi mua.” Ai s.a.v.s. tha: “A e fale namazin me ne?” Po, tha njeriu. Ai tha: “Të është falur.” (Buhariu dhe Muslimi)

“Transmeton Hudhejfe ibn Jemani se një njeri e kishte puthur një grua dhe, erdhi tek i Dërguari s.a.v.s. dhe i tregoi se çfarë kishte

bërë. Atëherë Allahu shpalli: “Fale namazin në mëngjes e mbrëmje dhe në një kohë të natës, sepse veprat e mira i shlyejnë veprat e këqija.” (Hud, 114) – Njeriu tha: “O i Dërguari i Allahut s.a.v.s., a vetëm për mua vazhdon kjo?” Pejgamberi s.a.v.s. tha: “Për gjithë Umetin tim.” (Buhariu dhe Muslimi)

“Ai që e fal namazin e sabahut është në mbrojtje të Allahut (garancë).” (Bezzari)

“Pesë kohët e namazit, xhumaja deri në xhuma, janë shlyerje e gjynaheve që ndodhin ndërmjet tyre.” (Muslimi)

“...derisa të dojë Allahu ta mëshirojë atë që do nga banorët e Xhehenemit, i urdhëron engjëjt t’i nxjerrin ata që e kanë adhuruar Allahun, e ata i nxjerrin duke i njohur me gjurmët e sexhdes që i kanë, se Allahu ia bëri haram zjarrit të hajë gjurmët e sexhdes, e ata dalin nga Xhehenemi. Birin e Ademit do ta hajë zjarri, përveç gjurmëve të sexhdes.” (Buhariu)

“...Ndriçoje shtëpinë tënde aq sa mundesh” – namazi i njeriut nafile në shtëpi.” (Ibn Haxher El-Askelani)

Projekt tregtar që garanton fitime të majme e të larta, në këtë dhe në botën tjetër, investime të namazit tonë. A nuk meriton ky projekt përgatitje të fletoreve të veçanta ku do t’i regjistrojmë fitimet dhe humbjet? Humbjet nuk janë të natyrës që ne e kuptojmë, ato nuk janë pakësim i kapitalit, por pakësim i sasisë së fitimit që kemi mundur t’ia shtojmë kapitalit tonë. Që këtej, kapitali ynë mbetet i tillë, në rastet më të këqija, i shëndoshë e i plotë në namaz, as nuk rritet e as nuk pakësohet, vetëm atëherë kur namazi ynë është mashtrim, syfaqësi e lojë, mos dhashtë Allahu.

Në bazë të këtij koncepti të ri investues për llogaritë e fitimit dhe humbjes, do të mund të vlerësojmë në mënyrë logjike fitimet shtesë në fund të çdo namazi që e falim, gjithashtu edhe fitimet që na shkuan huq duke qenë brenda preokupimeve të përditshme që na sillen në kokë e na largojnë nga namazi!



## TRIBUNA E TRETË SHKALLËT E NIVELEVE

### Pjesa 1

#### Lista e xhevahireve të arritura të namazi

Mos harro që gjatë rishikimit të llogarive të namazit tënd të kthehesh te pesë pikat kryesore që i prezantuar më herët për namazin, që të shohësh sasinë e përkushtimit tënd me të gjitha ato: koha, gjuha, trupi, zemra, puna. Mos harro që të rishikosh edhe minutat e harxhuara në namaz, se nëse për vetëm dy ose tri minuta ke përfunduar dy rekate të namazit, atëherë përsëri falu, sepse nuk je falur, koha e tillë nuk ka mjaftuar as për frymëmarrje midis shkronjave, e lëre më për tjetër gjë.

S'ka dyshim se zgjatja e kohës së namazit provon përkushtimin tënd për të gjitha dimensionet e namazit, kurse shënon edhe afrimin tënd tek Allahu. Një gjendje e tillë do të na bëjë që nga namazi të dalim me qese të mbushura plot me të mira të dynjasë dhe të ahiretit. Nuk është keq që të përpiqemi të përdorim listën në vijim, me qëllim që të vlerësojmë përafërsisht sasinë e fitimeve. Duhet pasur parasysh se arritjet përfundimtare të namazit tonë kurrë nuk mund t'i dimë saktësisht, e as që mund t'i peshojmë me peshore të vërtetë, këtë e di vetëm Allahu i Gjithëdijsëm për të Cilin edhe falemi.

Çdo musliman është i detyruar që para vetes ta shtojë peshoren me të cilën do t'i masë shkallët e përafërta që mund t'i arrijë pas çdo namazi. Vetëm Allahu e di se si ka qenë namazi i tij, por megjithëkëtë propozoj këtë peshore njerëzore të thjeshtë për të cilën i këshilloj të gjithë musli-

manët që të mbështeten në të dhe të shqyrtojnë llogaritë e tyre dhe vlerësimet e përafërta njerëzore të fryteve të çdo namazi të falur:

1. A thua vërtetë ndjeva se hoqa dorë nga çdo gjë e kësaj bote dhe hyra në botën tjetër të lartë, që nuk ka të bëjë me këtë botë, kur i ngrita duart për tekbinin fillestar?

2. Sa herë fjala Allahu ekber (Allahu është më i Madh) ka arritur të më kapë për dore e të mos më lë të humbëm në namaz, të heqë nga mendja ime gjërat që gati se më largonin nga bota ime e re që sapo kisha hyrë, e unë ngrihesha përsëri duke e lartësuar veten dhe duke e ngritë atë nga gjërat e pavlera të dynjasë?

3. Sa herë fjala Errahman ka arritur të më pastrojë me dritën e tij vertikalisht? E sa herë fjala Errahim ka arritur të më pastrojë me dritën e tij horizontalisht? A ndjeva se një gufim drite ma pastroi shpirtin në fillim, e pastaj erdhi dhe ma pastroi përsëri në pjesën e dytë, kështu që i tërë trupi mu mbulua me dritë? Sa herë kam ndier zbritjen e rahmetit mbi mua, atë rahmet që gufonte, rahmet i ngrohtë e i freskët që vinte në fillim, e pastaj rahmetin absolut që shtrihej deri në pafundësi e që më kaplonte në pjesën tjetër?

4. Sa shprehje kuranore i kam lexuar në Fatihanë, si p.sh. (el-hamdulil-lah, rabbi'l-alemin, maliki jevmi 'd-din, ijake na'budu etj) e i kam paramenduar në vete dhe kam ndier kuptimin e tyre në shpirt? Sa herë kam parafytyruar madhërinë e Allahut që shfaqet para meje dhe, ndjeva se diçka ndryshoi brenda meje kur po i lexoja ato?

5. Sa isha i kujdesur që midis ajeteve të lija hapësirë të gjelbër kohore, që t'i kontemploja ajetet dhe t'i ndieja me kuptim në shpirt:

6. A thua se kur i lexoja fjalët e Allahut "Udhëzona në rrugën e drejtë", para syve të mi paraqiteshin miqtë e mi, shokët, të dashurit, muslimanët, jo muslimanët, kundërshta-

rët e mi, muslimanë e jo muslimanë, që ky udhëzim hyjnore t'i përfshinte edhe këta? A e kisha ndier kënaqësinë e shpërblimit të menjëhershëm që po zbriste mbi mua për shkak të pastërtisë sime shpirtërore ndaj atyre? Për atë se kërkova që Allahu mbi ata të zbriste udhëzimin në rrugë të drejtë?

7. Sa herë jam munduar që ta mbush në mendjen time zbrazëtirën e supozuar të gjelbër që pason pas çdo herë që thosha Allahu ekber? Pas çdo tesbihi të rukusë dhe sexhdes? Sa sekonda të freskëta ia lejova vetes sime pas çdo tek-biri dhe tesbihi për ta mbushë këtë zbrazëtirë me ide të përshtatshme supozuese?

8. Sa pulla të kuqe i kam shtypur gjatë namazit? Sa herë kam ndier se rryma e saj ka arritur në thellësitë e mia dhe më ka lëkundur dhe dridhur zemrën apo më ka bërë të qajë?

- Pulla (ijjake nestein)? Sa sekonda i lejova vetes sime për të ndier natyrën e asaj që e kërkoi, që para meje të kisha foto-grafinë time dhe fotografinë e njerëzve që i përfshinë kjo kërkese që vjen me formën e saj gjithëpërfshirëse (Prej Teje (ne) kërkojmë ndihmë)?

- Pulla (ettehijjatu)? Sa zgjati koha e shqiptimit të këtyre dy fjalëve të mrekullueshme, kur unë përpiquesha që vetes sime t'i jepja një kohë për të zbritur para meje pamjen e mrekullueshme: hyrjen tek Allahu, përsëndetjen e Tij me formën të cilën vetë Ai ma mësoi, e pastaj ndjenja e kënaqësisë e arritur pas kësaj përsëndetjeje?

- Pulla (esselamu alejke ejjuhe'n-nebijju ve rahmetullahi ve berekatuthu)? Sa ndjeva kënaqësi kur po e përsëndesja të Dërguarin s.a.v.s.? Po kënaqësia e kthimit të përsëndetjes nga ana e tij s.a.v.s. menjëherë?

- Pulla (esselamu alejna ve ala ibadi'l-lahi 's-salihine)? A e ndjeva këtë përsëndetje mbi mua dhe mbi ata që më interesojnë, për njerëzit që i kam përreth, pastaj për miliona robër të mirë të Allahut në tokë dhe në qiell, kudo që janë, në çfarëdo kohe të kishin jetuar dhe jetojnë, se një fllad i **selamit** të shenjtë e të pastër zbriti mbi mua dhe mbi ata, e pastroi the-

llësinë time dhe thellësinë e atyre nga çdo gjë që më dëmton dhe i dëmton? Po pastrimi i dytë që vjen menjëherë pas pranimit të përshëndetjes nga qielli, e që më pastron nga maja e kokës e deri në shputat e këmbës, që të largon nga unë çdo kokëdhembje, sëmundje, lodhje, brengë dhe mërzi?

9. A jam përpjekur që ajo që më kaloi në namazet sunet ta kompensoja në namazet farz dhe anasjelltas?

10. A arrita të dalë nga namazi ashtu siç hyra? Apo ndodhi diçka që nuk meritonte të ndodhë? A ndjeva se pas namazit diçka në brendinë time u shtua, se diçka më ndryshoi në brendi, shpirtërisht, fizikisht dhe moralisht, sado që ky ndryshim të ishte i vogël?

## Pjesa 2

### Lista e xhevahireve të humbura të namazit

1. Sa herë kam thënë Allahu ekber pa e ndier rolin e tij në dimensionet e gjithpërfshira të jetës sime?

2. Sa ajete kam lexuar, të sures Fatiha dhe të tjera, e pranë tyre kam kaluar me dinjitet, por nuk arrita që të bashkëveprojë me kuptimin e tyre dhe ta imagjinoj atë?

3. Sa tesbihe në ruku dhe në sexhde i kam përsëritur si papagaj dhe nuk arrita ta ndiej kënaqësinë e tyre? I shqip-tova pa menduar fare për kuptimin e tyre?

4. Sa herë u detyrova që të përvjelë rrobat e mia, pantallonat ose flokët gjatë uljes në sexhde?

5. Sa herë e lëkunda dorën pa dashje në veprimet e namazit tim, e fërkova pluhurin nga balli im?

6. Sa herë ma kanë tërhequr vëmendjen nga namazi fotografitë dhe pikturat përreth meje apo në sexhaden e shtruar para meje?

7. Sa herë e largova shikimin nga vendi i sexhdes sime në namaz?

8. Sa herë ka ndodhur që ndonjë gjë e kësaj bote të ma largonte vëmendjen nga namazi apo ndonjë bisedë që vinte nga ata që ishin me mua në dhomë ose xhami? Po zëri i televizorit, radios, cingërima e telefonit ose trokitja e derës?

9. Sa herë e lëvizja dorën në namaz, e që nuk ishte e thënë ta lëvizja, por që më largoi nga namazi dhe shkalla e pëshpirtshmërisë sime?

10. Koha, gjuha, trupi, zemra dhe puna – sa prej këtyre mbetën të porealizuara për mua në namaz?

Është koha e gjumit, shtrihem në shtrat dhe nuk harroj t'i them lutjet e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s., siç nuk harroj që shpejt e shpejtë t'i rishikoj të gjitha pikat e regjistruara në namazet e ditës sime, jo të kësaj dite, por edhe të ditëve tjera, të shohë se sa kam arritur në jetë? Sa më janë shtuar fondet ditore? Sa kam humbur? A janë gjithmonë në rritje e sipër?

Kështu do të bëjë edhe në fund të javës, që kohë pas kohe të vërtetohen se llogarive të mia nuk ju ndodh asgjë e keqe që mund t'i humbasë, inshaallah.

Nuk harroj të mbështetem në hadithet e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. të shënuara më lartë, që shënojnë vlerësimin e përafërt të shkallëve të arritura të namazit, javore, mujore dhe vjetore.

Kriteri yt i parë dhe i fundit për vlerësimin e namazit tënd le të jetë përgjigja e kësaj pyetje me sinqeritet, objektivitet dhe besnikëri, sepse tani ballafaqohesh me vetveten, bëhu pra i sinqertë me vetveten, i drejtë në vendim, për ose kundër:

A thua se falem vetëm për ta hequr nga supet e mia këtë detyrë? Apo falem sepse e ndiej të drejtë që doemos ta arrijë për t'u kënaqur me frytet e tij dhe shpërblimet e mëdha në këtë dhe në botën tjetër?



## REZYME E LIBRIT

### Le të bëhet e tërë jeta namaz

Nuk lodhem duke menduar për hadithin profetik që na flet për zbritjen e urdhrit për faljen e namazit, çastin kur i Dërguari s.a.v.s. u ngrit në qiell dhe pranoi urdhrat e larta që pohonin çështjen e namazit. I Dërguari s.a.v.s. na flet se në fillim ishin 50 namaze farz për t'i falë, por i Dërguari fisnik kërkonte nga Zoti i tij që t'ia lehtësonte Umetit të tij këtë numër të madh të namazeve, derisa u bënë 5 namaze: *"...dhe Allahu i caktoi Umetit tim pesëdhjetë namaze. I Dërguari s.a.v.s. thotë: "U ktheva me këto urdhra Hyjnore, derisa kalova pranë Musait, e Musai a.s. më tha: "Ç'farë e detyroi Zoti yt Umetit tënd?" Thashë: "I detyroi për pesëdhjetë namaze." Musai a.s. më tha: "Ktheu te Zoti yt (të shqyrtosh këtë), se Umeti yt nuk mund ta bëjë këtë." Tha: "U ktheva për ta shqyrtuar këtë Zoti im, e ai i hoqi gjysmat." Tha: "U ktheva te Musai a.s. dhe i tregova se ç'ndodhi, por ai tha: "Kthehu te Zoti yt, se Umeti yt nuk mund ta bëjë këtë." Unë u ktheva te Zoti im, e Ai tha: "Ato janë pesë dhe janë pesëdhjetë (bëjnë pesëdhjetë), nuk e ndryshoj më fjalën Time." U ktheva te Musai a.s., e ai më tha: "Kthehu te Zoti yt, kurse unë i thashë: "Kam turp prej Zotit tim." Tha: "Pastaj më morri Xhibrili derisa arritëm në **Sidre Munteha**, që e mbulonin ngjyra që nuk e di çfarë ishin. Pastaj hyra në Xhenet, aty pashë kulla të larta nga margaritari, kurse dheu i saj ishte misk.." (Muslimi)*

Gjithmonë pyesja veten dhe jam i sigurt se edhe ju e keni pyetur ndonjëherë: "vallë, si do të ishte e mundur që ne t'i faleshim pesëdhjetë namaze çdo ditë? A do të mjaftonte koha për tjetër gjë përveç namazit? Kur do të kishim ngrënë, fjetur, zgjuar, lexuar, shkruar, folur, mësuar, punu-

ar e ndërtuar tokën? Kur do të dëfreheshim me jetën e të vizitonim të afërmit dhe shokët dhe..dhe..dhe?

Këtë e kuptova fill pasi arrita të mësojë se namazi është jetë, atëherë kur kuptova thelbin e namazit, natyrën e rolit të tij interaktiv me shpirtin dhe jetën, efektin që krijon ai në falësin. Jeta është një lloj namazi, bile lloje të ndryshme të ngjyrosura të namazit.

Pasi zgjohemi nga gjumi shohim se ende jemi gjallë, fill pas vdekjes së shkurtër të gjumit që ishim, ndiejmë mirënjohje për Allahun që na ringjalli përsëri në jetë, andaj falemi.

Kur dalim nga shtrati dhe ecim me këmbë tona, vërejmë se çdo gjë është në shërbimin tonë: tualeti për pastrim, uji i ngrohët etj, dhe ndiejmë kënaqësi të plotë kur vërejmë se çdo gjë na pret neve, kënaqemi dhe bindemi se me mirësinë e Allahut ende jam i aftë të ndihmoj veten time, pra jam në namaz.

Kur dalim në kopsht për të shëtitur dhe për t'i parë lulet, erën e tyre, fletët, pemët, e të mahnitemi me ndryshimin e ngjyrave dhe formave që ndryshojnë për çdo ditë dhe për çdo stinë, duke mos bërë gjë me duart tona, pra jemi në namaz.

Kur shohim fytyrën e fëmijëve tanë dhe të tjerëve dhe kur habitemi me rritjen dhe zhvillimin e tyre, fizikisht dhe moralisht, se për çdo ditë marrin formë të re, aftësi të reja, fjalë dhe shprehje të reja, pra jemi në namaz.

Kur udhëzojmë familjen për të mirë, kur i thërrasim në rrugë të Allahut me urtësi dhe këshillë të mirë, të dëgjojnë apo nuk të dëgjojnë pastaj, dije se je në namaz.

Kur e fal vëllain tënd, shokun, komshiun, me gjithë zemër, për ndonjë gabim që e kanë bërë ndaj teje, dije se je në namaz.

Kur dëgjon të sharat e dikujt për ty e ti nuk i përgjigjesh, por duron për hir të Allahut, dije se je në namaz.

Kur largohesh nga ndeja ku hahet mishi i vëllait tënd për së gjalli dhe, e gjen veten të paaftë për të reaguar apo për të ndryshuar kahjen e bisedës, dije se je në namaz.

Kur përpilon listën e atyre për të cilët do të lutesh, pas-taj i premtos Allahut se nuk fsheh ndonjë të keqe për askënd në botë, dije se je në namaz.

Kur lutesh për jomuslimanin që të jetë në rrugë të drejtë, në vend se ta luftosh apo të tregosh armiqësi ndaj tij, dije se je në namaz.

Kur jomuslimanit i tregohet mëshira e Islamit, toleranca e tij, butësia, dashuria, civilizimi, morali, buzëqeshja, dije se je në namaz.

Kur ti i përmbahesh rregullave të shtetit ku jeton, qof-të edhe në shtet jomusliman dhe, zbaton të gjitha detyri-met e atij shteti, ekonomike dhe tatimore dhe morale, dije se je në namaz.

Kur kujdesesh për bukurinë e qytetit, pastërtinë e tij, kopshtet e tij, rrugët publike, shërbimet publike dhe pronat e tij, dije se je në namaz.

Kur e keqja të rrethon nga çdo anë, e ti e urren në vet-vete, por nuk gjen fuqi për ta ndryshuar, me dorë dhe me gjuhë, dije se je në namaz.

Kur mundohesh shumë për të kënaqë familjen tënde apo ata që i ke përreth, e qëllon apo gabon në vlerësimin tënd, dije se je në namaz.

Kur beson se çështja jote me Allahun është e tëra dobi dhe , kurrë mos të shkon mendja vetëm se për të mirë, sado që djalli të cytë tjetrën, dije se je në namaz.

Kur Allahun e falënderon për atë që të ka dhënë dhe për gjërat me të cilat të ka sporvuar, dije se je në namaz.

Kur ul shikimin nga gjërat që të joshin nga çdo anë, dije se je në namaz.

Kur jep para për ta ndihmuar veten, familjen ose të tje-rët, nuk dyshon në pastërtinë e kësaj, dije se je në namaz.

Kur mbledh pasuri, për ta larguar ndonjë të keqe, për vete ose për të tjerët, dije se je në namaz.

Kur merr para, për ta ushqyer veten, familjen dhe të tjerët, nuk dyshon në pastërtinë e tij, dije se je në namaz.

Kur jep sadaka, qoftë pasuri, ndihmë, këshillë, dituri, urreksi të mirë, kur pajton midis dy personave, dije se je në namaz.

Kur duron sëmundjen, skamjen, fatkeqësinë, jetën e thjeshtë, dije se je në namaz.

Kur bëhesh shkak për ndalje të gjakderdhjes, qoftë për musliman ose jomusliman dhe, nuk dyshon fare se mund të ketë dikush që e lejon gjakderdhjen, dije se je në namaz.

Kur u bashkëngjitesh dhembjeve dhe shqetësimeve të muslimanëve në vendin e tyre, qoftë me zë, ndjenja ose lutje, dije se je në namaz.

Kur viziton të sëmurin, kushdo qoftë ai, dije se je në namaz. A nuk të ka këshilluar i Dërguari yt s.a.v.s. për të marrë abdes për këtë namaz?

Kur bëhesh gati për gjumë, për ta pushuar trupin nga lodhjet e ditës së gjatë dhe bëhesh gati për ditë të re të punës dhe gjallërimit, dije se je në namaz. A nuk të ka këshilluar i Dërguari yt s.a.v.s. për të marrë abdes për këtë namaz?

Në fund, llogaria para gjumit, për gjërat e dobishme dhe të padobishme, dije se edhe këtë herë je në namaz.

Jeta jonë është e tëra namaz, nëse e shikojmë atë në thelb dhe me sytë e falësit, kur bashkëveprojmë me çdo pjesë të tij, kur falësi bashkëvepron me fjalët e namazit, atëherë mësojmë se pjesët e jetës s'janë tjetër veçse fjalë që shqiptojnë madhësitë e Krijuesit dhe falënderojnë mirësitë e Tij. Kjo na kujton se ne jemi gjithmonë në namaz, edhe pse nuk kemi marrë abdes për këtë namaz.

Mos u zemëro nëse dikush të bën keq, mos e urre atë, por këtë bëje tesbih dhe namaz, duke përsëritur në vete: subhanallah, pse të lejoj që unë dhe ky njeri, që jemi krijesë e Allahut të kemi këtë dallim në karakter? Po cila fuqi është që i bëri këta miliona njerëz të kenë karaktere të

ndryshme dhe forma të ndryshme, qysh nga Ademi e deri në Ditën e fundit?!

Le të jetë çdo gjë që e dëgjojmë, e shohim përreth dhe e vëzhgojmë tesbih për Allahun, edhe nëse nuk e kuptojmë. Si ta urrej ndonjë pamje, krijesë, karakter, kur është krijesë e Allahut? Edhe vetëtimja që ma humb shikimin, rrufeja që ma trondit zemrën, po edhe gjërat trishtuese që i fsheh natyra, të gjitha në shpirtin tim kanë kuptim të tesbihut për Allahun, e që mua më shtojnë afërsinë me Allahun.

*“Bubullima e madhëron Atë me falënderim, por edhe engjëjt, nga frika ndaj Tij...” (Er-Ra’d, 13)*

*“Atë e madhërojnë shtatë qiejt, Toka dhe gjithçka gjendet në to. Dhe nuk ka asgjë që nuk e madhëron Atë, duke e lavdëruar, por ju nuk e kuptoni madhërimin që i bëjnë ata.” (El-Isra’, 44)*

*“Allahun e përlevdon gjithçka, që gjendet në qiej dhe në Tokë. Atij i takon pushteti epror dhe lavdia.” (Et-Tegabun, 1)*

*“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.” (Edh-Dharijat, 56)*

Bëhu pra pjesë e kësaj gjithësie që e përmend, lavdëron, falënderon dhe madhëron pandërprerë Allahun, kur je i qetë dhe kur lëvizë, kur je në këmbë e kur je i shtrirë, kur dëgjon dhe kur shikon, kur flet dhe kur mendon, dije se je në namaz përderisa je në jetë, le të jenë kushtetutë e jetës tënde këto këshilla të arta:

- Fale namazin sikur i thua lamtumirë jetës, duke ndier se e falë namazin për të shkuar tek Allahu...
- Çdo fjalë të namazit shqiptoje me bindje se do ta zbatosh në praktikë..
- Jep sadaka me dorë të djathtë, por me qëllim se me të majtën do të largosh një ves të keq që e ke..
- Mos e laj njollën e trupit gjatë abdesit, por laje edhe pjesën shpirtërore të tij...
- Mos dil nga xhamia i njëjtë, por ndrysho...

- Thuaji lamtumirë muajit Ramazan, vetëm duke heqë një të keqe dhe duke shtuar një të mirë...
- Therja e kurbanit të çon në Xhenet, por mos harro të therësh gjynahun që të çon në Xhehenem...
- Mos e humb kohën kot, por mendo se nuk të ka mbetur shumë kohë për të jetuar...
- Kur të hash ushqim, mendo edhe për ata që nuk e kanë as atë që ti e ke pranë vetes...
- Mos harxho më shumë seç duhet, mendo se ka që ëndërrojnë për paratë që ti i harxhon që të shpëtojnë nga uria, etja, sëmundja, të ftohtit...
- Mos e hedh ushqimin në mbeturina, para se të kujtosh se Allahu është i mundshëm që të të privojë nga çdo gjë që e ke në sofër...
- Mos e harxho ujin kot, mendo për ata që çdo ditë vdesin nga etja...
- Mos e mbush gotën plot, nëse e di se nuk do ta pishë të tërën..
- Ushqimi kripoet, por gjuha duhet të ëmbëlsohet...
- Nëse i thua dikujt diçka, mendo se ka dikush që mund ta thotë të njëjtën për ty...
- Mos i thuaj gjë të pahijshme babait dhe nënës, sepse do të vijë koha kur të njëjtën do ta dëgjosh nga fëmija jot...
- Çdo hap që e bënë jashtë shtëpisë për të siguruar dynjanë, krijë një hap në brendinë tënde për ta përmirësuar ahiretin...
- Kënaqësia me frutat e kësaj bote doemos të na kujtojnë kënaqësinë e frutave të botës tjetër...
- Mos u shqetëso me pajisjet shtëpiake nëse ato prishen, sepse ka shumë që nuk i posedojnë fare ato...
- Mos u zemëro nëse nuk ke këpucë të përshtatshme, sepse ka njerëz që nuk i kanë as këmbët e tyre...
- Mos lejo kurrë që urrejtja të hyjë nga dritarja e zemrës tënde, por lejoj zemërgjërësisë dhe mëshirës të hyjnë nga dritaret e tjera...
- Mos kërko falje nga Zoti yt për gjërat e këqija që i ke bërë, përveçse nëse ti e ke falë atë që ty të ka bërë keq...

- Mos i thuaj gjë të keqe atij që e ke përsipër, sepse një ditë ty do të thotë gjë të keqe ai që do të të ketë përsipër...
- Mos e nënçmo atë që është më poshtë se ti, dije se Allahu është më i fuqishëm që të nënçmojë ty, më shumë se që ti e nënçmove atë..
- Mos kërko falje nga Allahu nëse ke gabuar ndaj Tij, përveç nëse ia ke falur më parë atij që ty të ka bërë keq...
- Mos u kënaq me atë që e ke harxhuar dhe ka kaluar, por kënaqu me atë që e ke dhënë dhe ajo ka mbetur..
- Mos u lut për ata që i do, vetëm nëse je lutur për ata që mendon se vërtet i do...
- Mos e ul kokën para Allahut në namaz, përveç nëse e ke ul veten me modesti në jetë...
- Mos e llogarit durimin të vështirë e të gjatë, kënaqu me bindjen tënde se zgjidhja është shumë afër..
- Mos harro të veprosh sipas porosisë së Pejgamberit s.a.v.s.: *“Adhuroje Allahun sikur ta shohësh, llogarite veten në mesin e të vdekurve, përmende Allahun pranë çdo guri dhe pranë çdo druri, e nëse e bënë ndonjë të keqe, bëje menjëherë pranë saj një të mirë, ajo që bëhet fshehtas mbetet fshehtas, kurse ajo që bëhet haptas.”* (Albani thotë se hadithi është hasen, Sahih et-Tergib)

Me çdo frymëmarrje kujto se jeta jote është e tëra namaz. Bëhu shpirtpastër dhe trup-pastër kur të falesh, pas-troje shpirtin sikur që pastron gjakun që është në damarët e tu, duke falënderuar Zotin tënd me falënderim të çdo qelize të qelizave të gjalla, me falënderim të çdo gjymtyre dhe çdo organi të trupit tënd: *“Për çdo gjymtyrë të njeriut ka namaz (në transmetim tjetër thuhet: për çdo gjymtyrë të birit të Ademit ka sadaka). Një njeri tha: “Po kush mund ta bënë këtë?” Ai tha: “Të urdhëruarit për të mirë dhe të ndaluarit nga e keqja është namaz, ndihma e të dobëtisë është namaz, çdo hap që e bënë dikush për të shkuar në namaz, është namaz.”* (Albani thotë se hadithi është sahih, Silsiletu es-Sahih, Ebu Dherr El-Gifariu)

Dije se vullneti yt për namazin tënd është vullneti për jetë. Islami të ka dhënë shtyllën e tij të parë që ta siguron

ahiretin, kurse të ka dhënë shtyllën e dytë për ta siguruar dynjanë dhe ahiretin. Dije se unë dëshirova që ky libër të jetë vetëm çelës i vogël që ta kesh në dorë, e që me të t'i hapësh shtresat e mendimit tënd, të fluturosh me të në botët e mendimit tënd me Allahun, të zhytesh thellë në detet e zbulimit me krijesat e Allahut. Dëshira ime ishte që ti të kesh çdoherë nga libër të vogël e të veçantë, për ta menaxhuar namazin dhe për ta menaxhuar jetën tënde.

Allahu im, unë kërkoj falje për gjynahun që jam penduar te Ti, e pastaj përsëri jam kthyer në atë,

Kërkoj falje për atë që ta kam premtuar, e nuk kam arritur ta përmbushë.

Kërkoj falje për çdo të mirë të cilën me dhurove, kurse unë i përdora për ta forcuar veten në mos respektin Tënd

Kërkoj falje për çdo të mirë që për qëllim kisha Fytyrën tënde, por në mua u përzje diçka që nuk ishte për Ty.

## BIBLIOGRAFIA

Mbështetja ime në radhë të parë ka qenë në enciklopedinë elektronike të Hadithit, veçmas faqja elektronike “*Ed-Durer ‘us-sunije*”, që zë vendin e parë në listën e burimeve të hadithit. Më pas jam mbështetur edhe në enciklopedinë e përgjithshme (*El-Mevsuatu esh-shamile*), duke mos shpërfillë shumë herë burimet e shumta të hadithit, të botuara dhe korrigjuara, siç janë gjashtë librat e njohur të Hadithit: Buhari, Muslim, Ebu Davud, Tirmidhi, Nesai dhe Ibn Maxhe. Përveç kësaj para meje ishin edhe cikli i librave me hadithe autentike (sahih) të Albanit. Nuk munguan as edhe tefsiret e njohura të Kur’anit të madhërishtëm. Në vijim do të shënoj disa nga burimet tjera të rëndësishme të botuara, e ato nuk janë shumë:

- *El-Itkan fi ulum el-Kuran*. Xhelaludin es-Sujuti, dar el-kutub el-ilmije, Bejrut, 2003
- *Tarih el-Kuran*. Abdus Sabur Shahin, dar el-Kalem, Kairo, 1961
- *Tefsir Fet’h el-Kadir*. Muhamed bin Ali esh-Shevkanî, dar el-Fikr, Kairo, ?
- *Tefsir el-Bahr el-Muhit*. Muhamed ibn Jusuf ebu Hajjan, Dar el-Fikr, Bejrut, 1403
- *El-Xhami li Ahkam el-Kuran*. Ebu Abdullah Muhamed el-Kurtubi, dar Alem el-kutub, Rijad, 2003
- *Sifetu salati en-nebij*. Muhamed Nasirudin El-Albani, Mektebetu el-Mearif, Rijad, 1996
- *Fikhu es-sune*. Sejid Sabik, Dar el-Kitab el-Arebi, Bejrut, 1987
- *El-Kutubu es-sitetu (li-l-hadith esh-sherif)*. Dar es-Selam, Rijad, 1999
- *Mexhmua el-Fetava*. Ibn Tejmije, Meke, 1404 hixhri
- *Muslimun fi muvaxhehet el-Islam, Mesihijun fi muvaxhehet el-Mesihije*. Ahmed Besam es-Sai’, Londër, 2008
- *El-Vakijetu el-Islamijetu fil-edebi ve ‘n-nakdi*. Ahmed Besam es-Sai’. Dar el-Menare, Xhidde, 1985
- *Tefsir el-bahr el-muhit*. Muhamed ibn Jusuf ebu Hajjan. Dar el-Fikr, Bejrut, 1403 hixhri.
- *El-Vakijetu el-Islamijetu fi el-edebi ve en-nakdi*. Ahmed Bessam es-Sai’, Dar el-Menaretu, Xhidde, 1985



## SHËNIME PËR AUTORIN

I Lindur më 1941 në qytetin Ladhikije, Siri. Mësimet universitare i kreu në Damask. Magjistroi dhe doktoroi në letërsinë arabe në Universitetin e Kajros. Ishte mësimdhënës në universitetet e Sirisë dhe Arabisë. Punoi si kryetar i degës së gjuhës arabe në universitetin e Ladhikijes. Në vitin 1981 u punësua si mësimdhënës në degën e studime posdiplomike në Universitetin e Medines. Në vitin 1983 kaloi në Britani, mësimdhënës në Universitetin e Oksfordit. Në vitin 1991 themeloi Akademinë e Oksfordit për studime posdiplomike që të jetë instituti i parë universitar në Perëndim i themeluar nga një arab ose musliman dhe që arriti njohje qeveritare. Punoi dhe vazhdon të punojë në disa institucione dhe asamble shkencore të Britanisë. Aktualisht punon si inspektor i parë në Asamblenë britanike për njohje të instituteve dhe universiteteve (BAC). Mbikëqyrë studentët e studimeve posdiplomike në Universitetin e Uelsit.

### Librat e autorit:

1974: *Hikajat esh-sha'bije fi Ladhikje*.

1978: *Hareketu esh-shi'ri el-hadith fi el-edebi ve en-nakdi*.

1984: *Es-Suretu el-belaqije ve en-nakd*.

1985: *El-Vakiijetu el-islamijetu fi 'l-edebi ve en-nakdi*.

1987: *Ureba ve sh-shejh ve ez-zindik*. (Dramë teatrale)

1999: *Dhruzad emir el-huruf*.

2001: *Kasidetu el-kasaid*. Akademia e Oksfordit për studime posdiplomike.

2008: *Muslimun fi muvaxhehet el-islam, Mesihijun fi muvaxhehet el-mesihijeh*.

2011: *El-Gurfetu vahide bade el-Mie'*. Anglo Arabic Graphic, London.

2012: *El-Mu'xhizetu, iadetu kiraetu el-i'xhaz fi el-Kur'an el-Kerim*. Washington.

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека  
"Св. Климент Охридски", Скопје

CIP - Katalogu në publikim  
Biblioteka Kombëtare Universitare  
"Shën Kliment Ohridski", Shkup

28-534.3

AHMED Bessam Es-Saî  
Menaxhimi i namazit : rizbulim i shtyllës së dytë në Islam / Ahmed  
Bessam Es-Saî ; [përktheu nga arabishtja Sadush Tahiri]. - Shkup:  
Logos-A, 2015. 344 faq - 21 cm. - (Biblioteka Mendimi Islam)


Библиографија: стр. 343

ISBN 978-9989-58-600-2

а) Молитва - Ислам  
COBISS.MK-ID 99196682

**[www.logos-a.com](http://www.logos-a.com)**

Copyright©Logos-A, 2015



**LOGOS·A**